



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar auditimi financiar dhe përputhshmërie në**  
**Bashkinë Mallakastër**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË**  
**PËRPUTHSHMËRISË**  
**NË**  
**BASHKINË MALLAKASTËR**

**Korrik 2023**

<b>Nr.</b>	<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	
I.1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	<b>3-9</b>
I.2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
I.3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	
II.1.	Objekti i auditimit	<b>10-14</b>
II.2.	Qëllimi i auditimit	
II.3.	Identifikimi i çështjes	
II.4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
II.5.	Përgjegjësitë e audituesve	
II.6.	Kriteret e vlerësimit	
II.7.	Standardet e auditimit	
II.8.	Metodat e auditimit	
II.9.	Dokumentimi i auditimit	
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI AUDITIMIT</b>	<b>14-113</b>
III.1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	14-15
<b>III.2.</b>	<b>Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit</b>	15-113
III.2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	15-17
III.2.1.1	Mbi auditimin e brendshëm	17-20
III.2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	20-46
III.2.3	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2021	46-54
III.2.4	Mbi planifikimin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit publik	54-92
III.2.5	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit	92-102
III.2.6	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)	102-108
III.2.7	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	108-113
III.2.8	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	113-113
<b>IV.</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	<b>113-129</b>
<b>V.</b>	<b>ANEKSE</b>	<b>133-161</b>

## Shkurtime

<b>AAJM</b>	Aktive Afatgjata Jo Materiale
<b>AAM</b>	Aktive Afatgjata Materiale
<b>AK</b>	Autoritet Kontraktor
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
<b>ASHK</b>	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
<b>AKBN</b>	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
<b>BOE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
<b>DRT</b>	Drejtoria Rajonale Tatimore
<b>DSHP</b>	Drejtoria e Shërbimit Pyjor
<b>ERE</b>	Enti Rregullator i Energjisë
<b>FSHZH</b>	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
<b>GMS</b>	Grupi i Menaxhimit Strategjik
<b>INTOSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit
<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>KVO</b>	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
<b>LPP</b>	Ligji i Prokurimit Publik
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
<b>MAB</b>	Manuali i Auditimit të Brendshëm
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues
<b>NJA</b>	Njësi Administrative
<b>NJAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm
<b>NJP</b>	Njësia e Prokurimit
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues
<b>OE</b>	Operator Ekonomik
<b>PF</b>	Pasqyrat Financiare
<b>QKB</b>	Qendra Kombëtare e Biznesit
<b>SHA</b>	Shoqëri Aksionare
<b>SHPK</b>	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
<b>SKK</b>	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
<b>STTV</b>	Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore
<b>SPE</b>	Sistemi i Prokurimeve Elektronike
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>TNI</b>	Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë
<b>QKB</b>	Qendra Kombëtare e Biznesit
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak
<b>ZK</b>	Zonë Kadastrale

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **I.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Mallakastër, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, planifikimit, realizimit të prokurimeve dhe zbatimit të kontratave të lidhura për punë publike, planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, aktivitetin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 13.03.2023 deri në datën 05.05.2023 u krye auditimi, i cili kishte objekt: “Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë të Bashkisë Mallakastër” dhe mbuloi periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 11 akt-konstatime dhe 1 akt-verifikim. Mbi aktet e mbajtura nga grupi i auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur.

-Për projekt raportin e auditimit nga subjekti i audituar me shkresën nr.204/5 prot., datë 22.06.2023, janë paraqitur observacione, të cilat janë trajtuar dhe pasqyruar në Kapitullin “Anekse”. Në shkresën e konfirmimit të njohjes së projekt raportit të auditimit dhe përcjelljes së observacioneve, nga subjekti i audituar nuk është kërkuar takimi i ballafaqimit.

### **Në mënyrë të përmbledhur, në përfundim rezultoi se nga auditimi i procedurave të prokurimit, u konstatua:**

- Në 8 procedura prokurimi të audituara me fond limit 275,745 mijë lekë, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kriterëve jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP.
- Në 4 procedura prokurimi të audituara me fond limit 246,895 mijë lekë, OE i kualifikuar nuk plotëson kriteret e vendosura.
- Bashkia Mallakastër në rolin e autoritetit vendor të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në 4 raste nuk ka zbatuar plotësisht kuadrin rregullator të fushës dhe atë sektorial, në miratimin e aplikimeve për leje ndërtimi.

### **Gjithashtu nga auditimi i:**

- Veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme, kjo strukturë nuk e ka përmbushur qëllimin e saj, garantimin dhe mbrojtjen për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas kuadrin rregullator të fushës, si dhe ndëshkimit të drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat ligjore përkatëse.
- Debitorëve të Bashkisë Mallakastër, rezulton se më datën 31.12.2022 detyrimet e paarkëtuara (taksa, tarifa dhe qira) janë në vlerën 1,260,835 mijë lekë.
- Raportimit të transaksioneve dhe ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2022, ka rezultuar kontabilizimi jo i saktë dhe i drejtë për:
  - Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, është pasqyruar më pak për vlerën 257,264,483 lekë;
  - Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është pasqyruar më shumë për vlerën 33,059,961 lekë;
  - Llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, është pasqyruar më pak për vlerën 622,907,000 lekë;
  - Llogaria nr. 202 “Studime dhe kërkime” është pasqyruar më shumë për vlerën 9,083,682 lekë;
  - Llogaria nr.231 “Investime në proces”, është pasqyruar më shumë për vlerën 38,170,024 lekë;
  - Llogaria nr.467 “Kreditor të tjerë” është pasqyruar më pak për vlerën 3,977,574 lekë;
  - Llogaria nr.401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”, është pasqyruar më pak për vlerën 5,325,960 lekë;
  - Llogaria nr. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” është pasqyruar më shumë për vlerën 61,111,859 lekë.

**I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon.**

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, për punë publike mallra dhe shërbime, u konstatua se në 8 raste, në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar plotësisht vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.	54-92	I Lartë	Njësia e Prokurimit Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.
2	Nga auditimi rezultoi se në 4 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, duke sjellë në total lidhjen e 4 kontratave me vlerë 246,895 mijë lekë pa TVSH, me OE të cilët janë shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.	54-92	I Lartë	Kryetari i Bashkisë Mallakastër për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorit ekonomik, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.
3	Nga auditimi i procedurave të ndjekuara nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Mallakastër, për miratimin e lejeve të ndërtimit/deklarata paraprake për kryerjen e punimeve, u konstatua se në 4 raste është miratuar leja e ndërtimit në kushtet e mungesës së dokumentacionit të plotë në formë dhe përmbajtje, si dhe në kundërshtim me tipologjinë e ndërtimit që lejohet në njësinë strukturore përkatëse	92-102	I Lartë	Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit, të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit të munguar në lejet e ndërtimit të miratuara përgjatë periudhës 2022, si dhe bashkërendimin e punës, vlerësimin dhe marrjen në konsideratë të mendimeve të autoriteteve publike kompetente gjatë aplikimit deri në miratimin e lejes së ndërtimit.
4	Nga auditimi u konstatua se vlera progresive e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore në datën 31.12.2022 është në vlerën 1,147,936,403 lekë për 140 subjekte, që përfshin debitorët e krijuar gjatë vitit 2022 dhe të viteve të mëparshme, të cilat përbëjnë të ardhura të pa arkëtuara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Nga vlera e mësipërme, janë 1,113,818,553 lekë, detyrim që kanë kompanitë e naftës ndaj Bashkisë Mallakastër, detyrim i pakontabilizuar, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Pra gjatë vitit 2022 janë krijuar debitor për vlerën 28,018,213 lekë. Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Mallakastër, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje duke mos aplikuar masa shtrënguese (vendosjen e barrës sigurose për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), nuk është vazhduar me masa të tjera shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokimi i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal.	20-46	I Lartë	Sektori i Tatim Taksave të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 1,147,936,403 lekë për 140 subjekte (principal dhe kamatë vonesë).
5	Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Mallakastër me palët e treta, konkretisht të respektimit të detyrimeve ligjore për përllogaritjen dhe pagesën e qirasë (për vitin 2022), përllogaritjen	20-46	I Lartë	Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Mjedisit të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>e kamat-vonesave, si dhe marrjen e masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, u konstatua se në vitin 2022, janë krijuar 4 subjekte debitorë për vlerën 215,715 lekë, si dhe progresivisht në fund të vitit 2022 janë 92 subjekte për vlerën 2,466,047 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Gjithashtu u konstatua se kontratat e qirasë së tokës bujqësore nuk janë përditësuar sipas formatit të ri të kontratës tip, miratuar me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar, pasi nëpërmjet formatit të ri, ka ndryshuar masa e kamatvonesës për mospagesën në kohë, pra nga 1% bëhet 0.5%, si dhe është parashikuar indeksimi i tarifës së qirasë 1 herë në 5 vite, periudhë e cila përkon me indeksimin që duhet t’i bëhet tarifës së qirasë në vitin 2023.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e këtyre subjekteve, konstatohet se nuk janë njoftuar subjektet për zgjidhje të njëanshme të kontratës së qirasë, si dhe nuk është hapur proces gjyqësor, me qëllim mbledhjen e detyrimeve me forcë nëpërmjet shërbimit të përmbartimit.</p>			<p>vlerës debitorë 2,466,047 lekë (principal dhe kamatë vonesë).</p> <p>Drejtoria Juridike të marrë masa, për ndryshimin e përmbajtjes së kontratave të qirasë për tokat bujqësore, duke reflektuar ndryshimin në kamatvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.</p>
6	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit, rezulton se përgjatë vitit 2022 në territorin e Bashkisë Mallakastër dhe NJA, është ushtruar aktivitetet për tregëtimin e karburantit nga 12 stacione shitje. Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2022, gjithsej rezultojnë 8 subjekte debitor për vlerën 1,116 mijë lekë, si rrjedhojë e moslicencimit/moslikuidimit të tarifës së licencimit të tregëtimit të karburantit. Për këto stacione konstatohet se përgjatë vitit 2022 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitetet pa licencë, kërkesë për bashkëpunim nga sektori i të ardhurave dhe Policisë Bashkiake.</p>	20-46	I Lartë	<p>Drejtoria e Financës, Sektori i të Ardhurave, Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në tregëtimin e karburanteve, me qëllim licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t’i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial, për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregëtimit me pakicë të karburanteve.</p> <p>Drejtoria e Financës, Sektori i të Ardhurave, Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme për ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 1,116 mijë lekë.</p>
7	<p>Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e ndotjes, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Mallakastër (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Mallakastër) u konstatua se nga Sektori i Tatim Taksave, Drejtoria e Mjedisit, si dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Mallakastër, nuk është aplikuar dhe nuk është arkëtuar tarifa e ndotjes, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e bashkisë. Nga përlllogaritjet e kryera rezulton se për vitin 2022 në 10 raste, subjektet e ndërtimit nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit, ndriçimit, ndotjes në vlerën 986,696 lekë gjithësej, vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Mallakastër.</p>	20-46	I Lartë	<p>Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Drejtorinë Mjedisit, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë 986,696 lekë.</p>

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
8	Nga auditimi i procedurave të ndjekura për miratimin e lejeve të ndërtimit, në një rast u konstatua përlllogaritje e gabuar e taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën 228,066 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të Paketës Fiskale të Bashkisë Mallakastër, për vitin 2022.	92-102	I Lartë	Drejtoria e Planifikimit të Territorit në bashkëpunim me Sektorin e Tatim-Taksave Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën 228,066 lekë ndaj subjektit "SH.A 24 Sh.P.K", si rrjedhojë e diferencës së krijuar nga përlllogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.
9	Nga auditimi i veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, u konstatua se: -Në strukturën e IVMT Mallakastër nuk janë të gjithë punonjësit me formimin profesional të fushës; -Kryeinspektori i IVMT nuk ka miratuar akt-kontrolli për të gjithë objektet e pajisura me leje ndërtimi, sipas fazave të punimeve (Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues deri në përfundimin e sistemit të jashtëm); -Kryeinspektori nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, gjatë ushtrimit të detyrave; -Nuk dokumentohet kryerja e inspektimeve pranë subjekteve të cilët përgjatë vitit 2022 kanë kryer punime ndërtimi, me qëllim verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga zotëruesit e mbetjeve inerte, gjatë prodhimit, përpunimit dhe dorëzimit të tyre pranë subjekteve të cilat janë të pajisura me leje mjedisore; -Ndërmjet IVMT dhe Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, ka munguar bashkëpunimi, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit.	102-108	I Lartë	Kryetari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore, të marrë masat e nevojshme për, rekrutimin në stafin e IVMT të punonjësve me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.  Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe IVMT Mallakastër të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre, ku për çdo leje ndërtimi të miratuar/deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, të informohet edhe IVMT, me qëllim miratimin e akt-kontrolleve për lejet e ndërtimit, si dhe rritjen e efektivitetit të inspektimit të zhvillimit të territorit në Bashkinë Mallakastër.

### I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit.

#### **Opinion i modifikuar me rezervë mbi pasqyrat financiare.**

##### **Për drejtimin e Bashkisë Mallakastër:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Mallakastër për vitin ushtrimor 2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705, dhe ISSAI 1200<sup>1</sup>, pasi kemi marrë evidencat dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të modifikuar me rezervë për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Mallakastër, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërpunueshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, të cilat janë të shprehura në bazën për opinionin.

<sup>1</sup> Objektivi i auditimit është të formulohet një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit. Objektivi i auditimit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomalitë materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

### **Opinionin:**

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin me rezervë”<sup>2</sup>, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare Bashkisë Mallakastër më 31 dhjetor 2022, referuar Udhëzimit të MFE nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

### **Baza për Opinionin:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Mallakastër, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme<sup>3</sup> për të dhënë një bazë për opinionin tonë<sup>4</sup>.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura, të cilat sipas gjykimin tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të Bashkisë Mallakastër. Për këto arsye kemi dhënë opinion me rezervë, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

#### **Përshkrimi i çështjeve kryesore<sup>5</sup>:**

-Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, është pasqyruar më pak për vlerën 257,264,483 lekë;  
-Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është pasqyruar më shumë për vlerën 33,059,961 lekë;

-Llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, është pasqyruar më pak për vlerën 622,907,000 lekë;

-Llogaria nr. 202 “Studime dhe kërkime” është pasqyruar më shumë për vlerën 9,083,682 lekë;

-Llogaria nr.231 “Investime në proces”, është pasqyruar më shumë për vlerën 38,170,024 lekë;

-Llogaria nr.467 “Kreditor të tjerë” është pasqyruar më pak për vlerën 3,977,574 lekë;

-Llogaria nr.401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”, është pasqyruar më pak për vlerën 5,325,960 lekë;

-Llogaria nr. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” është pasqyruar më shumë për vlerën 61,111,859 lekë.

### **Opinion mbi përputhshmërinë për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022**

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Mallakastër, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar të përputhshmërisë.

### **Baza për Opinionin:**

#### **Opinionin e dhënë mbi përputhshmërinë e mbështesim në konstatimet e mëposhtme:**

Në auditimin e veprimtarisë së subjektit Bashkia Mallakastër për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë bazuar në analizën e riskut, janë konstatuar anomali në vendosjen e kriterëve dhe

<sup>2</sup> SNA 705

<sup>3</sup> SNA 500

<sup>4</sup> SNA 700

<sup>5</sup> SNA 701



shpalljen fitues të OE me kritere të plotësuar, në miratimin e aplikimeve për leje të ndërtimit, si dhe inspektimeve për kontrollin e punimeve të ndërtimit.

- Në 8 procedura prokurimi të audituara me fond limit 275,745 mijë lekë, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kritereve jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP.

- Në 4 procedura prokurimi të audituara me fond limit 246,895 mijë lekë, OE i kualifikuar nuk plotëson kriteret e vendosura.

- Bashkia Mallakastër në rolin e autoritetit vendor të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në 4 raste nuk ka zbatuar plotësisht kuadrin rregullator të fushës dhe atë sektorial, në miratimin e aplikimeve për leje ndërtimi.

- Moszbatimin plotësisht të kuadrin rregullator të fushës për arkëtimin e të drejtave të konstatuara (taksa, tarifa dhe qira) ndaj palëve të treta, në vlerën 1,260,835 mijë lekë.

Sa më sipër, shkeljet dhe mangësitë e evidentuara përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura që justifikojnë dhënien e opinionit të modifikuar.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Mallakastër**

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Mallakastër, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrin rregullator të fushës.

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafit drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Këto standarde kërkojnë që në të përmbarëmi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit<sup>6</sup>.

## **II. HYRJA.**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 204/1 datë 10.03.2023 prot., i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin “Bashkia Mallakastër” nga data 13.03.2023 deri në datën 05.05.2023, u krye “*Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë*”,

<sup>6</sup> Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryej ato procedura auditimi që ju japin mundësi të sigurojë evidencën e auditimit e cila duhet të jetë e mjaftueshme, përkatëse dhe e besueshme (ISSAI 1500, ISA 300).

i cili mbuloi periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022, auditim financiar, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K.K., Auditues, Përgjegjës Grupi.
2. A.G., Auditues, Anëtar.
3. E.V., Auditues, Anëtar.
4. M.M., Auditues, Anëtar.
5. A.T., Auditues, Anëtar.

### **II.1. Objektiv i auditimit.**

-Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

-Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbimeve e investimeve, planifikimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit.

### **II.2. Qëllimi i auditimit.**

-Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

-Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara, miratimin e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit, si dhe kontrollin e territorit për ndërtimin e objekteve pajisur me leje zhvillimi dhe ndërtimi, ose deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, për periudhën objekt auditimi.

-Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

### **II.3. Identifikimi i çështjes.**

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Mallakastër, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Fushat të cilat u audituan janë si vijon:

1. Aktiviteti i Njësisë së Auditit të Brendshëm;
2. Implementimi dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
3. Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit;
4. Raportimi financiar;
5. Planifikimi, realizimi i prokurimeve dhe zbatimi i kontratave të lidhura për investime në punë publike;
6. Aktiviteti i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit;
7. Planifikimi dhe zhvillimi i teritorrit;
8. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

### **II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.**

Niveli drejtues i Bashkisë Mallakastër (Kryetari i Bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Drejtori i Drejtorisë së Financës, në rolin e Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën

ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontrolleve të brendshme të nevojshme, për të mundur përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit. Gjithashtu Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Drejtorët e drejtorive dhe Përgjegjësit e sektorëve pranë Bashkisë Mallakastër kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

### **II.5.Përgjegjësitë e audituesve.**

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njësisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërputhshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose Raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

### **II.6.Kriteret e vlerësimit.**

Standardet dhe kuadri ligjor që shërbeu si kriter për vlerësimin e aktivitetit të subjektit të audituar, është si më poshtë vijon:

#### **Lloji i dokumentit:**

#### **Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore.**

#### **Standardet e auditimit:**

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;  
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);  
Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;

Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;

Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;

#### **Ligje:**

Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”;

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;

Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;  
Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;  
Ligji nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;  
Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;  
Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;  
Ligji nr.9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;  
Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;

**VKM:**

VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;  
VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar;  
VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar;  
VKM nr.736, datë 1.7.2009 për disa ndryshime në VKM nr.808, datë 4.12.2003 të këshillit të ministrave “Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”;  
VKM nr. 165, datë 2.3.2016 “Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

**Udhëzime:**

Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, i ndryshuar;  
Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;  
Udhëzimi i MFE nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;  
Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;  
Udhëzimi i MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJVQ-ve”;  
Udhëzimi i MFE nr.10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, etj;  
Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;

**Rregullore:**

Rregullore mbi organizimin e funksionimit të Bashkisë, etj.

## **II.7.Standardet e auditimit.**

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 100, 200, 400, Manualit të Auditimit të Financiar dhe të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar.

## **II.8.Metodat e auditimit.**

1. Kontrolli aritmetik.
2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.
3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.
4. Kontrolli i vlerësimeve.
5. Konfirmimi nga të tretët.
6. Kontrolli sipas një treguesi.
7. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe MFK.

## **II.9.Dokumentimi i auditimit.**

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve 13 gjithësej dhe akt-verifikimeve 1 gjithësej, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili është edhe materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

### **▪ Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

### **▪ Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

### **▪ Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

### **III.PËSHKRIMI AUDITIMIT**

#### **III.1.Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.**

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Auditimi në subjektin “Bashkia Mallakastër”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës (*materiale por jo të përhapura*), si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve, lejeve të ndërtimit etj.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

#### **Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik**

**Zona Gjeografike:** Mallakastra kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Fier, në jug me bashkitë Selenicë dhe Memaliaj, në lindje me bashkitë Poliçan dhe Berat, ndërsa në veri me bashkitë Patos dhe Fier. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Ballshit.

#### **Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat**

Emri i Njësisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
<b>Ballsh</b>	Qyteti Ballsh
<b>Qëndër Dukas</b>	Visokë, Belishovë, Belistan, Drenovë, Drenovë Fushë, Kash, Usojë, Ngraçie, Lavdan, Lapulec, Lofkënd, Dukas
<b>Greshicë</b>	Greshicë, Greshicë e Re
<b>Aranitas</b>	Aranitas, Panahor, Kalenjë, Cfir, Metoh, Çyçen
<b>Hekal</b>	Hekal, Klos, Mollaj, Rromës
<b>Ngraçan</b>	Ngraçan, Riban
<b>Kutë</b>	Kutë, Drizar, Anëbreg, Çorrush, Poçëm
<b>Fratar</b>	Behaj, Damës, Gadurovë, Malas, Kremenar, Ninësh
<b>Selitë</b>	Selitë, Gjerbës, Kapaj, Çërrilë

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

#### **Njësitë Shpenzuese në varësi të Bashkisë Mallakastër:**

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

#### **Funksionet kryesore të Bashkisë Mallakastër kryhen në fushën e:**

- Infrastrukturës dhe shërbimeve publike.
- Shërbimeve sociale.
- Kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese.
- Mbrojtjes së mjedisit.
- Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike.
- Zhvillimit ekonomik vendor.
- Sigurisë publike.

## **Financat.**

Bashkia Mallakastër ka të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

- a) krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
- b) vendos taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) harton, miraton dhe zbaton buxhetin e tyre;
- ç) mban llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofron informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

-Për vitin 2022 nga Bashkia Mallakastër janë shpenzuar gjithësej 736,105 mijë lekë, nga të cilat:

- 224,938 mijë lekë për investime;
- 163,646 mijë lekë për paga;
- 37,894 mijë lekë për mallra të ndryshëm;
- 248,901 mijë lekë për transferta në ndihmë ekonomike për familje në nevoj, invalidë etj.

-Për vitin 2022 Bashkia Mallakastër nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithësej 169,753 mijë lekë.

## **III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.**

### **III.2.1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditin i Brendshëm.**

Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetëtori i Vetëvlerësimit.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Mallakastër nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i

*Kontrollit*”, “*Menaxhimi i Riskut*”, “*Aktivitetet e Kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

**Titulli i gjetjes:** Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit<sup>7</sup>.

**Situata:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, është pjesërisht efektiv, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

**“Mjedisi i Kontrollit”**

-Nga shqyrtimi i Strukturës dhe Organigramës së Bashkisë Mallakastër në rregulloren e saj, u konstatua se në disa raste ka mbivendosje dhe mbingarkesë kompetencash.

- Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.

- Në rregulloren e brendshme, por edhe me urdhër të titullarit, nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë.

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

-Në bazë të pyetësorit dërguar njësisë të menaxhimit, nuk ka një urdhër nga titullari i institucionit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi.

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.

-Për vitin 2022, Bashkia Mallakastër nuk ka hartuar dhe miratuar Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

-Bashkia Mallakastër nuk ka një plan strategjik për zhvillimin institucional.

-Në Bashkinë Mallakastër nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.

-Në Bashkinë Mallakastër nuk ka Koordinator Risku.

-Nuk administrohen procesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.

-Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut dhe regjistri i riskut.

-Nuk ka raportim të riskut operacional, për shkak të strukturave të pa plotësuara.

-Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues pranë Bashkisë Mallakastër.

**“Aktivitetet e Kontrollit”**

- Bashkia Mallakastër nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm.

- Në Bashkinë Mallakastër nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

- Në Bashkinë Mallakastër, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

<sup>7</sup> Trajtuar më hollësisht në Kapitullin “Aneke” – “Aneksi nr.1” të raportit përfundimtar të auditimit.



### **“Informimi dhe Komunikimi”**

-Për vitin 2022 nga Bashkia Mallakastër (për vendimmarrje për dhënien e pasurive të paluajtshme me qira, buxhetin etj.), nuk janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit.

- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

### **“Monitorimi dhe Raportimi”**

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore nuk lidhet me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

-Titullari i Bashkisë Mallakastër nuk ka miratuar gjurmën e auditimit.

*Sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. Q.I, Kryetar i Bashkisë Mallakastër, znj. L.S, Drejtor i Drejtorisë të Burimeve Njerëzore, z.A.R, Drejtor i Financës.*

**Kriteri:** Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Risk i shtuar për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

**Rëndësia:** I Mesëm.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe investimit për blerjen e programit kompjuterik të licencuar, për administrimin e taksave dhe tarifave vendore etj.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për:

-Kryejën e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.

-Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proceseve të punës në Bashkinë Mallakastër.

### **III.2.1.1. Mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.**

Në zbatim të pikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njësisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Mallakastër;
2. Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2022;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

### **Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.**

Në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, është krijuar Njësia e Auditit të Brendshëm në

Bashkinë Mallakastër, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Ky sektor përgjatë periudhës 2022, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendim Këshillit Bashkiak nr. 61 dt. 25.12.2017, duke pasur në strukturën e saj tre punonjës, një përgjegjës dhe dy specialistë. Përgjegjëse e kësaj njësie është znj. A.B. Znj Xh.E është emëruar në pozicionin 01.07.2022 në pozicionin e Specialistet në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, dhe duhet të certifikohet si Audituese e Brendshme brenda dy vitesh nga data e emërimit.

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime te vijueshme
	<b>Për vitin 2022</b>						
1	A.B	Pergjegjes i sektorit	05/11/2022		13	2010	Po
2	X.H.E	Specialiste	01/07/2022	Administrim Biznesi	-	Nuk është certifikuar	Jo
3	D.B	Specialist i jashtem	02/11/2022	Ekonomik biznesi	25	2009	Jo

Burimi: NJAB Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

### **Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2022.**

Përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, nga sektori i auditit të brendshëm pranë Bashkisë Mallakastër, është kryer një auditim nga katër të tilla të planifikuara, miratuar me shkresën nr. prot. 2402/1 datë 18.10.2021. Të dhënat në tabelën më poshtë të dërguar nga subjekti i audituar nuk përputhet me Planin Vjetor të Auditimeve, ku ishin planifikuar për t'u audituar këto subjekte: -Në planin vjetor të hartuar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, ishin planifikuar të kryeshin 4 auditimet e planifikuara: Drejtoria e IMT, Njësia Administrative Fratar, Ujësjetllësi SH.A Mallakastër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, është realizuar vetëm auditimi i Drejtorisë së IMT. Përgjatë vitit 2022 është ushtruar auditim vetëm në Drejtorinë e IMT, duke devijuar nga Plani Vjetor i Auditimeve.

Nr	Subjekte të Audituar sipas viteve		
	Planifikuar 2022	Realizuar 2022	
1	Drejtoria e IMT-së Mzsh-së dhe policia Bashkiake	Drejtoria e IMT-së MZSH-së dhe Policia Bashkiake	Niveli i Riskut
2	Drejtoria ekonomike dhe e çeshtjeve sociale		I lartë
3	Ujësjetllës kanalizime Sh.a Mallakastër		I lartë

Burimi: NJAB Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Plani strategjik 2022-2024 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2022 janë përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr.2402/1 prot., dt. 18.10.2021.

-Për aktivitetin e vitit 2022 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr.333/1 prot., dt. 14.02.2023. Raporti vjetor është hartuar në përputhje me strukturën e parashikuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, kreu I dhe modelin përkatës në fund të kapitullit.

- Kryetari i Bashkisë Mallakastër ka miratuar Kartën e Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 2025/3 datë 14/09/2018 dhe nuk ka pasur përditësime.

**Titulli i Gjetjes:** Mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik në Bashkinë Mallakastër, përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022.

**Situata:** Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm.

-Karta e Auditimit të Brendshëm nuk është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

-Nga shqyrtimi i Kartës së Auditimit të Brendshëm për Bashkinë Mallakastër, pika 1 e saj, "Objekti i kartës së auditimit të brendshëm" nuk është përditësuar sipas përcaktimeve të bëra në Urdhërin e mësipërm të MFE.

-Plani Strategjik nuk është hartuar në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Nuk janë bërë pjesë e planit prioritetet për vitet në vijim. Në pikën 1/3 të planit, ku duhet të përcaktohen objektivat e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, janë përcaktuar objektivat e institucionit të Bashkisë Mallakastër.

- Në planin vjetor të hartuar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, ishin planifikuar të kryeshin 4 auditime: Drejtoria e IMT, Njësia Administrative Fratar, Ujësjetllësi SH.A Mallakastër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse. Në zbatim të programit vjetor, është realizuar vetëm auditimi i Drejtorisë së IMT. Nuk administrohet arsyetimi i

mosrealizimit, si dhe ndryshimi nga plani vjetor i auditimit nuk është miratuar dhe argumentuar.

-U konstatua se grupi i auditimit të brendshëm i ka dërguar njësisë së audituar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna, por në vijim nuk janë hartuar dhe dërguar shkresa rikujtuese për zbatimin e këtyre rekomandimeve. Për sa më sipër nuk janë respektuar parimet dhe rregullat e vendosura në Manualin e Auditimit të Brendshëm, kreu IV, paragrafi 4.1.13.1.

-Në auditimet e kryera për vitin 2022, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore.

-Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Për periudhën 2022, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Mallakastër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Financës, Sektori i të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm “Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”.

*-Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të konstatuara, mbajnë përgjegjësi Z. Q.I, Kryetar i Bashkisë Mallakastër, Z. E.I, ish përgjegjës i NJAB, Znj. A.B, Përgjegjës i NJAB.*

**Kriteri:** Shkronja “ç” në nenin 6, shkronja “ç” pika 2 në nenin 11, nenin 12, nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”; Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar;

-Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;

-Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

**Ndikimi/Efekti:** Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë si Financa, Taksat apo Prokurimet.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe Përgjegjësi i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për:

-Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

**Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Mallakastër, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve, ndërmarrjen e shërbimit publik etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

### **III.2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2021.**

#### **➤ Dokumentacioni i audituar si më poshtë:**

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;

2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat;
4. Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;
5. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të palikuiduara dhe vendime gjyqësore;
6. Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimet të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.
7. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimine zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
8. Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin “EXCEL”, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj.).

### **2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022.**

Për vitin 2022 PBA dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr.59, nr.4369 prot., datë 20.12.2021 (PBA 2022-2024 dhe buxheti vjetor) dhe VKB nr.58, nr.4368 prot., datë 20.12.2021 (buxheti vjetor 2022). Gjithashtu janë konfirmuar me shkresat e Prefektit të Qarkut Fier, respektivisht shkresa nr.1343/1 prot., datë 30.12.2021. Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Mallakastër.

Fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:

- a. *Infrastruktura rrugore;*
- b. *Furnizimi me ujë të pijshëm;*
- c. *Ujitja dhe Kullimi;*
- d. *Shërbimi zjarrëfikës;*

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr.23 datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësisive të Qeverisjes Vendore*”. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

Programi i të ardhurave për vitin 2022 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me VKB nr.45, nr.3940 prot., datë 25.11.2021.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2022, vijnë nga dy burime:  
**Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen.  
**Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionët e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.  
 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2022, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor.

Tabela nr.1 PBA për vitin 2022 sipas programeve ekonomike që menaxhon Bashkia Mallakastër

Nr	Kodi	Programi	Fakti i vitit paraardhës viti 2021	PBA Plan viti 2022	Buxheti vjetor 2022 Plani i Rishikuar	Realizimi i periudhës progresiv	Diferenca 5=(4-3)
1	01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	93,458	127,845	134,712	93,318	-41,394
2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	7,712	8,893	8,893	7,521	1,372
3	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	13,378	33,698	16,714	14,670	-2,044
4	04240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	18,558	17,316	6,567	2,088	-4,479
5	04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	1,240	2,996	1,314	951	-363
6	04520	Rrjeti rrugor rural	42,901	267,656	197,671	119,102	-78,569
7	05100	Menaxhimi i mbetjeve	0	44,429	25,050	0	25,050
8	06260	Shërbime publike vendore	20,041	82,806	26,196	23,907	-2,289
9	08130	Sport dhe argëtim	925	9,239	6,739	775	-6,964
10	08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	9,680	14,831	0	0	0
11	09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	72,178	95,831	91,065	77,375	-13,690
12	09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	6,350	8,384	8,384	7,113	-1,271
13	10430	Përkujdesi Social	228,569	250,645	250,739	243,367	-7,372
14	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	174,568	13,000	88,884	88,471	-413
15	06140	Planifikimi Urban Vendor	0	20,378	25,508	9,704	15,804
16	01170	Gjendja civile	0	0	5,227	5,044	-183
17	05200	Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve	0	0	5,000	4,397	-603
18	05630	Ndërgjegjësimi mjedisor	0	0	1,056	0	1,056
19	06190	Strehimi	0	0	31,546	26,834	-4,712
20	06330	Furnizimi me ujë	0	0	7,300	0	7,300
21	08250	Programe specifike kulturore dhe të turizmit	0	0	22,031	10,957	-11,074
22	10910	Emergjencat Civile	0	0	10,735	511	-10,224
23	06440	Ndriçim rrugësh	0	0	10,300	0	10,300
<b>Totali i shpenzimeve të njësisë</b>			<b>689,558</b>	<b>997,947</b>	<b>981,631</b>	<b>736,105</b>	<b>(245,526)</b>

Burimi: Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2022-2024, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezulton se, ka diferenca në programe të ndryshme buxhetore, ku veç atyre programeve për të cilat Bashkia Mallakastër nuk mund të bëjë planifikim të saktë fondeve që do të shpenzohen (investime të reja gjatë vitit buxhetor me fonde të Ministrisë së linjës), ka programe si, aparati, rrjeti rrugor rural, planifikim, menaxhim dhe administrim, menaxhim i mbetjeve për të cilat Bashkia Mallakastër gjatë vitit buxhetor nuk ka pritshmëri për alokim të fondeve shtesë. Këto diferenca në gjykimin e grupit të auditimit tregojnë pasaktësi në planifikimin e fondeve buxhetore në PBA krahasuar me planin e buxhetit vjetor.

Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Kështu për vitin 2022 Bashkia Mallakastër ka planifikuar të arkëtojë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.2 Planifikimi i të ardhurave

Përshkrimi	Planifikimi 2022
Të ardhura tatimore	172,341
Të ardhura jo tatimore	210,817
<b>TOTAL</b>	<b>383,158</b>

Burimi: Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

**Titulli i gjetjes:** Zbatimi i Procedurave në përgatitjen e PBA 2022-2024.

**Situata:** Për PBA 2022-2024 dhe Buxhetin vjetor 2022 Kryetari i Bashkisë Mallakastër nuk ka marrë masat për të përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin e Bashkisë, kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 1 të nenit 33 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2022-2024, u konstatua se:

- Për PBA 2022-2024 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 35 të Ligjit të mësipërm, pasi nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;

- Për PBA 2022-2024 nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit;

- Për PBA 2022-2024 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Mallakastër;

- Nuk administrohet dokumenti përfundimtar i PBA për periudhën 2022-2024, por në dosje administrohet vetëm VKB që kanë miratuar buxhetin vjetor 2022. Lidhur me PBA 2022-2024 nga Bashkia Mallakastër na u vendos në dispozicion dokumenti në formatin EXCEL për pasqyrat e PBA 2022-2024;

- Procedura e përgatitjes së PBA 2022-2024 nuk dokumentohet plotësisht, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat e bëra për fondet nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Mallakastër, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

- Tavanet Përgatitore të PBA-së 2022-2024, janë miratuar jashtë afateve;

- Në buxhetin vjetor të vitit 2022 nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin dhe përmirësimin e fondit pyjor.

**Kriteri:** Pikën 3 të nenit 13, pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 6 në Kreun I, pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”. Udhëzimi nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

**Efekti:** Planifikim jo i saktë dhe real i kërkesave buxhetore, si dhe mos kryerjen e investimeve në fusha të caktuara të aktivitetit të Bashkisë Mallakastër.

**Rëndësia:** I Mesëm.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Mallakastër.

-Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;

-Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat çënojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;

-Gjithashtu për çdo vit të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Mallakastër.

## **2.2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.**

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit parardhës.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të KB. Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduara me Degën e Thesarit Mallakastër dhe janë të raportuara periodikisht në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shitesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuar sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2022, rezultoi se është realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Mallakastër ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Fier.

U verifikuan situacionet mujore të rakorduara me Degën e Thesarit Mallakastër dhe u gjetën të rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat e Bashkisë dhe nga grantet. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të Bashkisë Mallakastër janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit Mallakastër, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Planifikimi i të ardhurave 2022		Planifikimi i shpenzimeve 2022	
Burimi i të ardhurave	000/ lekë	Emërtimi i zërave	000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022	383,158	Art. 600 Paga	173,765
Te ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm nga viti 2021	80,000	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shend.	29,018
<b>Total të ardhurat e veta</b>	<b>463,158</b>	Art.602 Shpenzime operative	96,965
Transferte e pa kushtëzuar	164,087	Art.604 Transferime korrente te brendshme	250,000
Transferte e kushtëzuar	267,693	606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	251,145
Transferte specifike	123,362	Art.230-231 Investime	184,574
		Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	32,830
<b>Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit</b>	<b>555,142</b>		
<b>Totali të Ardhurave</b>	<b>1,018,300</b>	<b>Totali Shpenzimeve</b>	<b>1,018,300</b>



Rezultoni se buxheti i konsoliduar (Bashki+Njësia e Varësisë Agjencia e Shërbimeve Komunale) vitit 2022 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **1,018,300 mijë lekë**.

Përgjatë vitit 2022 buxheti i Bashkisë Mallakastër ka pësuar 4 ndryshime, me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, konkretisht:

Me VKB nr.319 prot., datë 20.01.2022, kanë ndodhur pakësim në artikullin 609 në vlerën 8,000 mijë lekë dhe shtesa në artikullin 604 në vlerën 6,000 mijë lekë, artikulli 606 në vlerën 2,000 gjithësej.

Me VKB nr.15, nr.1141/1 prot., datë 28.02.2022, kanë ndodhur shtesa të fondeve për investime në vlerën 94,010 mijë lekë gjithësej.

Me VKB nr.2927 prot., datë 27.05.2022, kanë ndodhur shtesa të fondeve për artikullin 602 në vlerën 700 mijë lekë dhe pakësime në artikullin 604 në vlerën 700 mijë lekë gjithësej.

Me VKB nr.3232 prot., datë 14.06.2022, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për investime në vlerën 136,319 mijë lekë gjithësej.

Tabela nr.3 Ndryshimet buxhetore gjatë vitit 2022

Artikujt e shpenzimeve	Buxheti Fillestar	Ndryshimi nr 1 Nr 319 Dt 20-01-2022		Ndryshimi nr 2 VKB Nr 15 Dt 28-02-2022		Ndryshimi nr 3 Nr 2927 Dt 27-05-2022		Ndryshimi nr 4 VKB Nr 28 Dt 18-05-2022
		Shtesa	Pakesime	Shtesa	Pakesime	Shtesa	Pakesime	Shtesa
600	173,766							
601	29,019							
602	96,965					700		
603	0							
604	0	6,000					700	
606	251,145	2,000						
609	32,830		8,000					
230	10,000							
231	174,574			94,010				136,319
NSHP	250,000							
<b>SHUMA:</b>	<b>1,018,300</b>	<b>8,000</b>	<b>8,000</b>	<b>94,010</b>	<b>0</b>	<b>700</b>	<b>700</b>	<b>136,319</b>

Burimi: Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore të shpeshta përgjatë vitit buxhetor, tregon për një performancë jo të mirë në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Tabela nr.4 Realizimi i buxhetit vjetor në nivel programi ekonomik

Nr	Kodi	Programi	Plan progresiv 2022	Fakti 2022	%
1	01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	134,712	93,318	69%
2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	8,893	7,521	85%
3	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	16,714	14,670	88%
4	04240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	6,567	2,088	32%
5	04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	1,314	951	72%
6	04520	Rrjeti rrugor rural	197,671	119,102	60%
7	05100	Menaxhimi i mbetjeve	25,050	0	0
8	06260	Shërbime publike vendore	26,196	23,907	91%
9	08130	Sport dhe argëtim	6,739	775	12%
10	08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	0	0	0
11	09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	91,065	77,375	85%
12	09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	8,384	7,113	85%
13	10430	Përkujdesi Social	250,739	243,367	97%
14	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	88,884	88,471	100%
15	06140	Planifikimi Urban Vendor	25,508	9,704	38%
16	01170	Gjendja civile	5,227	5,044	96%
17	05200	Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve	5,000	4,397	88%
18	05630	Ndërgjegjësimi mjedisor	1,056	0	0
19	06190	Strehimi	31,546	26,834	85%
20	06330	Furnizimi me ujë	7,300	0	0
21	08250	Programe specifike kulturore dhe të turizmit	22,031	10,957	50%
22	10910	Emergjencat Civile	10,735	511	5%
23	06440	Ndriçim rrugësh	10,300	0	0



<b>Totali i shpenzimeve të njësisë</b>	<b>981,631</b>	<b>736,105</b>	<b>75%</b>
--	----------------	----------------	------------

Burimi: Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se:

**Për vitin 2022** realizimi i buxhetit është në nivelin 75%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimi më të lartë është “Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime” dhe “Përkujdesi Social”; Programi me realizimin më të ulët është “Emergjencat Civile”, “Strehimi”, “Menaxhimi i nfrastukturës së ujitjes dhe kullimit” dhe “Planifikimi Urban Vendor”.

### **2.2.3. Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.**

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Mallakastër, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Mallakastër, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuara me Vendim të KB ose të diktura nga transferta e deleguar nga pushteti qendror.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2022, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.5 Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2022 (000/lekë)

Art.	Emertimi	Plani	Fakti	%
600	Paga	177,020	163,646	92%
601	Sigurime Shoqërore	29,695	27,169	91%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	89,465	37,894	42%
603	Subvencione	326	495	152%
604	Transferta Korente të Brendshme	16,735	3,267	20%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	255,569	248,901	97%
609	Rezerva	11,566	4,000	35%
230	Kapitale të Patrupëzuara	25,517	25,795	101%
231	Kapitale të Trupëzuara	375,738	224,938	60%
	<b>TOTAL</b>	<b>981,631</b>	<b>736,105</b>	<b>75%</b>

Burimi: Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2022 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik për 12-mujorin është në masën 75%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 “Transfertat për buxhetet familjare” ku përfshihet ndihma ekonomike dhe PAK, ndjekur nga shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe realizimin më të ulët e kanë shpenzimet për mallra e shërbime dhe transferta korente të brendshme.

Vihet re që për vitin 2022 transferta korente të brendshme (604) paraqiten me realizim mesatarisht 20%, dhe mallra dhe shërbime të tjera (602) paraqiten më realizim mesatarisht 42% pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët, ose ½ e fondit të planifikuar nuk shpenzohet, ç’ka tregon një planifikim jo të saktë të shpenzimeve për mallra dhe shërbimeve dhe transferta korente të brendshme.

#### ➤ **Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit.**

Tabela nr.6 Buxheti sipas burimeve të financimit për vitin 2022

Nr.	Art.	Emertimi	Burimi i financimit 2022					Totali
			Tr. Pakushtezuar	Tr. Kushtëz Specificke	Të Ardhurat	Tr. Kushtez për Investime	Tr. Kushtëz për Funksione të deleguara	
1	600	Paga	67,419	76,408	15,616		4,203	163,646
2	601	Sigurime	11,142	12,442	2,894		690	27,168
3	602	Shpenzime Operative	13,602	6,165	18,125			37,892
5	604	Transferta Korente të brendshme	2,756				511	3,267
6	606	Transf. familje dhe individ	5,237	1,671	759		241,234	248,901
7	609	Subvencione			4,000			4,000
8	230-231	Investime		11,966	123,631	115,136		250,733
	<b>TOTALI</b>		<b>100,156</b>	<b>108,652</b>	<b>165,025</b>	<b>115,136</b>	<b>246,638</b>	<b>736,102</b>

Burimi: Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se fondet e shpenzuara nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara kanë peshën më të lartë në burimet e financimit, 246,638 mijë lekë ose 33% të fondeve të shpenzuara për vitin 2022, për të vijuar me të ardhurat e veta në vlerën 165,025 mijë lekë ose 10 % dhe transfertës së kushtëzuar për funksione të deleguara në vlerën 115,136 mijë lekë ose 16% të fondeve sipas burimit të financimit.

#### **Transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara.**

-Buxheti nga transferta e kushtëzuar për vitin 2022 është realizuar në vlerën 115,136 mijë lekë, ose 16% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës kushtëzuar për funksionet e deleguara, e zënë transferta për familje dhe individ, paga dhe fonde të shpenzuara për transferime korrente të brendshme.

#### **Transferta e kushtëzuar për Investime.**

-Buxheti nga transferta e kushtëzuar për investime për vitin 2022 është realizuar në vlerën 142,819 mijë lekë, ose 16% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës kushtëzuar për investime, e zënë shpenzimet për investime.

#### **Transferta e pakushtëzuar.**

-Buxheti nga transferta e pakushtëzuar për vitin 2022 është realizuar në vlerën 100,156 mijë lekë, ose 14% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative.

#### **Të ardhurat e veta.**

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2022 është realizuar në vlerën 165,025 mijë lekë, ose 22% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga, investime dhe shpenzime operative.

#### **Transferta kushtëzuar specifike.**

-Buxheti nga transferta specifike për vitin 2022 është realizuar në vlerën 108,652 mijë lekë, ose 15% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës specifike, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe sigurime shoqërore.

-Fonde nga FZHR nuk ka pasur përgjatë periudhës 2022.

#### ➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.**

Me miratimin e buxhetit për vitin 2022 është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë dhe i kontigjencës, ku për vitin 2022 është planifikuar në masën 2,806 mijë lekë, pra brenda nivelit 3% të fondit total të planifikuar, përjashtuar transfertat e kushtëzuara, të cilat nuk janë përdorur.

#### ➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile.**

Nga Bashkia Mallakastër është krijuar edhe fondi për emergjencat civile, ku për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 10,735 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 217 mijë lekë, për transferta korrente të brendshme.

#### ➤ **Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Mallakastër.**

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se, Bashkia Mallakastër për vitin periudhës 2022 nuk ka marrë dhe nuk ka dhënë asnjë subvencion.

#### ➤ **Realizimi i Investimeve.**

**Titulli gjetjes:** Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli.

**Situata:** Grupi i KLSH konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele jo të mira në vitin 2022, konkretisht në masën 75%. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Mallakastër në fillim të vitit buxhetor planifikon procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

**Kriteri:** Shkronja “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Pika 24 dhe 25 në nenin 3, neni 47 në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

**Shkaku:** Planifikim i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke i planifikuar ato në raport me planin dhe jo me faktin e të ardhurave të vitit të mëparshëm.

**Efkti:** Mos realizim i investimeve të planifikuara.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

**Titulli i gjetjes:** Angazhime buxhetore pas datës 15 Tetor të vitit 2022.

**Situata:** Nga shqyrtimi i kontratave të lidhura nga Bashkia Mallakastër për kryerjen e punëve publike (investime) dhe listës së projekteve (E3 sipas PBA 2022-2024), u konstatua se në 5 raste për vlerën e kontratave 11,213,576 lekë gjithësej, janë ndërmarrë angazhime buxhetore pas datës 15 Tetor të vitit 2022, për projekte të cilat nuk janë pjesë e PBA 2022-2024, konkretisht:

-Për vitin 2022 janë ndërmarrë **5 angazhime** buxhetore sipas kontratës datë 02.12.2022 me OE "F. 06" shpk për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit në vlerën 8,280,030 lekë, kontratës datë 22.11.2022 për blerjen e ushqimeve për kopështin dhe çerdhen Ballsh në vlerën 1,197,240 lekë, me OE F.F, kontratës datë 18.11.2022 për materiale kancelarie në vlerën 556,000 lekë, kontratës datë 18.10.2022 për mbikqyrje punimesh për "Përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara" në vlerë 319,906 lekë si dhe kontratës datë 12.12.2022 për pakot e vitit të ri në vlerë 860,400 lekë;

**Kriteri:** Shkronja "c" në pikën 4 në nenin 36 në Ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";

Pika 2 të VKM nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore", i ndryshuar, "Pas datës 15 tetor, procedurat e prokurimeve publike, të parashikuara në regjistrin e prokurimeve publike, mund të fillojnë/vazhdojnë vetëm për ato projekte që janë pjesë e buxhetit tre-vjeçar, të miratuar për njësinë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme. Lidhja e kontratës në këtë rast bëhet vetëm pasi fondi të jetë vënë në dispozicion në llogarinë e autoritetit kontraktor, në buxhetin e tij, të miratuar për vitin buxhetor pasardhës".

Neni 51 në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

**Efkti:** Angazhime buxhetore të cilat nuk raportohen në dokumentet standarde që shoqërojnë hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Njësia e Prokurimit, të marrë masa për eliminimin e praktikave të ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore pas datës 15 Tetor të vitit buxhetor, për projekte të cilat nuk janë planifikuar në PBA.

#### ➤ **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 muhor në Këshillin Bashkiak.**

Në zbatim të nenit 48 "Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor" të ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 dt.30.07.2018 "Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në

*Njësitë e Qeverisjes Vendore*”, si dhe nenin 44<sup>8</sup>, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, konstatohet se për vitin 2022 nuk administrohen raportet 4, 8 dhe 12 mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit të shtetit, si dhe nuk janë realizuar dhe përcjellë shkresat në Këshillin Bashkiak dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra më sipër.

#### **2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.**

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Mallakastër, rezulton se, është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për cdo vit buxhetor, janë raportuar periodikisht në Këshillin Bashkiak dhe MFE.

Me fondet buxhetore 2022, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përbaluara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministrinë e linjës sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022 ka ardhur duke u ulur. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2022.

Tabela nr.7 Detyrime për periudhën 2022

Detyrime e NJQV 2022	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2021	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2022	Total detyrime	Shlyerja gjatë 2022	Mbetja në fund të vitit 2021
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Detyrime për shërbime	237,403		237,403		237,403
Detyrime për mirëmbajtje	607,525		607,525		607,525
Vendime Gjyqësore	945,792		945,792		945,792
Detyrime për investime	4,131,839		4,131,839	153,802	3,978,037
Detyrime të tjera	4,651,012		4,651,012		4,651,012
<b>Total Detyrime</b>	<b>10,573,571</b>		<b>10,573,571</b>		<b>10,419,769</b>
<b>Gjendja e llogarisë 520 në fund të vitit 2021</b>					<b>158,788,270</b>

Burimi: Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që ka Bashkia Mallakastër ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare 2022 si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyruet (faturë tatimore/vendim gjykate) që krijon detyrimin përkatës.

-Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2022, përcjellë në MFE me shkresën nr.860 prot., datë 24.02.2022, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Mallakastër ndaj palëve të treta raportuar në MFE është në vlerën 10,422 mijë lekë, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime korrente, shpenzime kapitale dhe vendime gjyqësore, pasqyruar në tabelën më poshtë;

Tabela nr.8 Situata Financiare 2022

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
<b>I</b>	Borxhe (a+b)	-		
a	Hua sftatgjatë	-		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	-		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			

<sup>8</sup> Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim te këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

b,3	Kredi të furnitorëve			
<b>II</b>	<b>Detyrime (a+b+c)</b>	<b>10.422.499</b>		<b>1.75%</b>
a	Shpenzime korrente	5.495.940		
a,1	Mallra dhe shërbime	844.928		
a,2	Paga dhe sigurime	0		
a,3	Të tjera	4.651.012		
b	Shenzime kapitale	3.980.767		
b,1	Insitucione buxhetore	0		
b,2	Subjekte private	3.980.767		
c	<b>Vendime gjyqësore</b>	<b>945.762</b>		
c,1	Marrëdhënie pune	945.762		
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>10.422.499</b>	<b>594.616.814</b>	<b>1.75%</b>

Burimi: Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Në vijim parashtrojmë përcaktimet e bëra për detyrimet e prapambetura, cfarë përfaqësojnë dhe cilat detyrime përfshihen:

“Detyrime të prapambetura ndaj palëve të treta”, nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJVQV-ve, të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat 3 e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) nga data e pagesës së specifikuar në kontrat, faturë ose sipas ligjit”. “Detyrimet e prapambetura rregjistrohen në llogarinë ekonomike nr.4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura”<sup>9</sup>.

“Njësitë e qeverisjes së përgjithshme përpara mbylljes së llogarive vjetore 2022, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë nr.486 në debi të llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në llogari në datën 31.12.2022”<sup>10</sup>.

-Pra sa më sipër vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është në masën 1.75% ndaj totalit të shpenzimeve të miratuara për vitin 2022.

Stoku i detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta paraqitet më pak se 15% të shpenzimeve vjetore të miratuara, ç’ka do të thotë se Bashkia Mallakastër në fund të vitit 2022 rezulton në një situatë normale.

**Titulli i gjetjes:** Efektet negative në buxhet si rezultat i likuidimit të vendimeve gjyqësore si dhe pasqyrimin e shpronsimeve në raportin e monitorimit dërguar në MFE.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2022 janë në vlerën 945,762 lekë ose rreth 9% mbi totalin e detyrimeve të raportuara. Përgjatë vitit 2022 nuk ka kryer likujdime të vlerës së detyrimit të mbartur nga viti 2019. Në fund të vitit 2022 Bashkia Mallakastër ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 158,788,270 lekë, të cilat mund t’i përdorte për likujdimin e plotë të vendimeve gjyqësore si dhe nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Mallakastër.

Nga kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e Bashkisë Mallakastër ndaj palëve të treta, kryesisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, konstatohet se:

- Si rrjedhojë e Vendimit nr. 357, datë 12.10.2022 të Gjykatës së Apelit, ndaj Bashkisë Mallakastër është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit G.D, SH.K, A.G dhe I.E antarë të këshillit Bashkiak në vlerën 846,572 lekë. Këto detyrime janë krijuar për Bashkinë Mallakastër gjatë vitit 2022, dhe janë likujduar përgjatë vitit 2022.

-Gjithashtu konstatohet për likujdimet e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por në urdhrin e likujdimit nuk është nxjerrë edhe përgjegjësia

<sup>9</sup> Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

<sup>10</sup> Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar”.

administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Mallakastër.

Për rrjedhojë kemi një nivel të lartë të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore (të cilat janë nga periudha më të hershme), si dhe nga ana e Bashkisë Mallakastër nuk kemi patur një planifikim të saktë në buxhetet vjetore dhe nuk është respektuar radha e shlyerjes të detyrimeve duke i dhënë prioritet vendimeve gjyqësore të formës së prerë, e cila në 31.12.2022 përbën 9% të totalit të detyrimeve, pra nuk janë respektuar udhëzimet e buxhetit vjetore.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për shpronsimet u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2022 janë në vlerën 3,977 mijë lekë ose rreth 38 % mbi totalin e detyrimeve të raportuara si dhe për 2 subjekte nuk janë raportuar 2 fatura konkretisht për subjektin “G.” shpk në vlerën 4,242 mijë lekë dhe subjektin “V.K & Z” shpk në vlerën 1,083 mijë lekë ose rreth 48% mbi totalin e detyrimeve të raportuara.

Konstatohet se detyrimet për shpronësimet si dhe 2 faturat për dy 2 subjekte në fund të periudhës ushtrimore 2022 nuk janë pasqyruar në Raportin e Monitorimit dërguar në MFE.

**Kriteri:** Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

**Efekti:** Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Mallakastër.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të marrë masat e nevojshme për rapoerimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndal palëve të treta.

#### ➤ **Faturat e palikuiduara Brenda afatit 30 ditor.**

**Titulli gjetjes:** Fatura të pa likuiduara brenda afatit 30 ditor përgjatë vitit 2022, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura, si dhe mosrespektimi i rradhës në likuidimin e tyre.

**Situata:** Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Mallakastër, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2022, ky afat nuk është respektuar në 30 raste për vlerën 48,202,350 lekë, pasqyruar në tabelën përmbledhëse më poshtë dhe tabelën analitike në Kapitullin “Anekse” - “Aneksi nr.2”.

Tabela nr.9 Përmbledhëse e faturave për vitin 2022

Artikulli	Sasia	Viti2022/lekë
602	30	48,202,350
<b>Totali</b>	<b>30</b>	<b>48,202,350</b>

Burimi: Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën deri në fund të vitit 2022 janë 81 fatura të palikuiduara për shpenzime për vendime gjyqësore, shërbime dhe mirëmbajtje në vlerën 10,419,769<sup>11</sup> lekë.

<sup>11</sup> Analitikisht pasqyruar në Anekse.



**-Sa i përket likujdimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet rradha e likujdimit të tyre, pra fatura e parë likujdohet më parë.**

Konkretisht për rastin e detyrimit ndaj subjektit:

- I, faturë e datës 20.04.2020 në vlerën 153,802 lekë, likujduar më datë 03.10.2022, ndërkohë që deri më datë 03.10.2022 janë likujduar fatura të mbërritura më vonë se fatura e subjektit të mësipërm, si p.sh., subjekti “SH. 07” shpk me faturë të datës 24.03.2021 me vlerë 10,513,920 lekë, likujduar më datë 07.06.2021 dhe 13.09.2021, subjekti “K.” shpk me faturë të datës 26.02.2021 me vlerë 159,924 lekë, likujduar më datë 09.07.2021, subjekti “G.C” me faturë të datës 17.04.2021 me vlerë 240,000 lekë, likujduar më datë 14.07.2021 dhe subjekti “SH.” shpk me faturë të datës 12.05.2021 në vlerë 1,472,502 lekë likujduar më datë 11.10.2021;

-Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

**Kriteri:** Pikat 8, 106 dhe 107 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

**Shkaku:** Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

**Efekti:** Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikujduara.

**Rëndësia:** I Lartë

**Rekomandimi:** Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës.

-Planifikimin e grafikut të likujdimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

### **2.2.5. Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR/Ministritë e linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.**

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Ekonomike për vitin 2022, në lidhje me investimet publike, rezultoi se, nuk ka financim projektesh nga FSHZH/FZHR. Nga Ministritë e Linjës për vitin 2022, rezultoi se janë financuar 4 projekte investimi me vlerë kontrate 1,120,227,436 lekë, pasqyruar në tabelat si më poshtë vijon:

Tabela nr.10 Fonde të deleguara për vitin 2022 nga Ministria e linjës për investime të cilat kanë filluar në vitin 2020 kanë vazhduar në vitin 2021 dhe sipas kontratave përfundojnë në vitin 2022 ose janë në proces gjatë vitit 2022 si dhe likujdimi i tyre.

Nr	Objekti	Burimi i Financimit	Kontrata			Likujdimi deri në 2022	Mbetur
			Nr.	Datë	Vlerë		
1	Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh	MIE - AKUM	1973/5	10.10.2020	497,726,607	88,440,420	409,286,187
2	Ndërtim linje trasmetimi rrjeti i jashtëm ujsjellesi Rajonal (Nga burimi i Pocemit)	MIE- AKUM	777/7	06.07.2021	568,485,332	169,243,256	399,242,076
3	Permiresimi i kushteve te banimit ne ndertesa, per komunitetet e pafavorizuara	MFE- BASHKIA	2431	24.12.2021	26,123,990	21,658,356	4,465,634
4	Permiresimi i kushteve te banimit ne ndertesa, per komunitetet e pafavorizuara	MFE- BASHKIA	4050	26/10/2022	27,891,507	11,444,872	16,446,635
5	Projektim ujesjellsi Aranitas	MIE- AKUM	4162	18.10.2022	2,868,480	2,868,480	0
6	Projektim Ndërtim UjesiL FSHATRAVE Drenove,Belistan,Visoke	MIE- AKUM	4161/3	17.10.2022	3,157,056	3,157,056	0
	<b>Totali</b>				<b>1,126,252,972</b>	<b>296,812,440</b>	<b>829,440,532</b>

Burimi: Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Për vitin 2020, Bashkia Mallakastër ka lidhur kontratë për investim në punë publike me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të shpërndarës të qytetit Ballsh” me burim financimi nga MIE-AKUM. Vlera e investimit është 497,726,607 lekë, deri në 31.12.2022, për këtë objekt janë likuajduar fondet e përcjella nga MIE-AKUM në vlerën 88,440,420 lekë. Sipas kontratës ky investim ka nisur në vitin 2020, ka vazhduar në 2021 dhe përfundon në vitin 2022.

-Për vitin 2021, Bashkia Mallakastër ka lidhur kontratë për investim me objekt “Ndërtim linje transmetimi rrjeti i jashtëm ujësjellësi Rajonal (nga burimi i Poçemit)” me burim financimi nga MIE-AKUM. Vlera e investimit është 568,485,332 lekë, deri në 31.12.2022 janë likuajduar fondet e përcjella nga MIE-AKUM në vlerën 399,242,076 lekë. Sipas kontratës ky investim ka nisur në 2021 dhe përfundon në vitin 2022 si dhe kontratë për investim me objekt “Përmirësimi i kushteve të banimit në ndërtesa, për komunitetet e pafavorizuara” me burim financimi Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe nga të ardhurat e Bashkisë. Vlera e investimit është 26,123,990 lekë, deri në 31.12.2022 për këtë objekt janë likuajduar nga fondet e përcjella nga MFE dhe të ardhurat e Bashkisë në vlerën 21,658,356 lekë. Sipas kontratës ky investim ka nisur në vitin 2021 dhe ka përfunduar në vitin 2022.

-Për vitin 2022, Bashkia Mallakastër ka lidhur kontratë për investim me objekt “Përmirësimi i kushteve të banimit në ndërtesa, për komunitetet e pafavorizuara” me burim financimi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe nga të ardhurat e Bashkisë. Vlera e investimit është 27,891,507 lekë, deri në 31.12.2022 janë likuajduar fondet e përcjella nga MFE dhe të ardhurat e Bashkisë në vlerën 11,444,872 lekë.

- Bashkia Mallakastër ka lidhur kontratë për investim me objekt “Projektim ujesjells Aranitas” me burim financimi nga MIE-AKUM. Vlera e investimit është 2,868,480 lekë, deri në 31.12.2022 janë likuajduar fondet e përcjella nga MIE-AKUM në vlerën 2,868,480 lekë.

- Bashkia Mallakastër ka lidhur kontratë për investim me objekt “Projektim Ndërtim i Ujësjetllësit të fshatrave Drenove, Belistan, Visoke” me burim financimi nga MIE-AKUM. Vlera e investimit është 3,157,056 lekë, deri në 31.12.2022 janë likuajduar fondet e përcjella nga MIE-AKUM në vlerën 3,157,056 lekë.

-Kontratat nuk janë likuajduar sipas afateve të përcaktuara, por në periudha të mëvonshme, kjo si rezultat i mos alokimit të fondeve nga ministritë e linjës.

-Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Mallakastër dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas shkresës përcjellëse nga Ministria e linjës. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

### **Konkluzion i përgjithshëm:**

-Buxhetet e Bashkisë Mallakastër dhe PBA, në përgjithësi janë miratuar në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore të ligjit të buxhetit për vitin 2022;

Kanë ndodhur ndryshime në buxhetet fillestare (shitesa/pakësimi), të cilat në çdo rast janë miratuar me VKB.

- Për hartimin e PBA 2022-2024 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Mallakastër, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

- Tavanet Përgatitore të PBA-së 2022-2024, janë miratuar jashtë afateve;

- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;

-Për PBA 2022-2024 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjen përkatëse të PBA dhe buxhetit vjetor, nuk administrohet dokumentacioni mbi PBA 2022-2024, kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Mallakastër, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

-Në PBA, si dhe buxhetet vjetore të vitit 2022, nuk janë planifikuar fonde për investime në fondin pyjor.



- Për vitin 2022 në krahasim me planet vjetore respektive, realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik për 12-mujorin është mesatarisht në masën 75 %, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 “Transfertat për buxhetet familjare dhe individ” ku përfshihet ndihma ekonomike dhe PAK, ndjekur nga shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe realizimin më të ulët e kanë Transferta Korrente të Brendshme. Vihet re se për vitin 2022 art. (602) Transferta Korrente të Brendshme paraqiten 20%, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

-Nga shqyrtimi i kontratave për investime të Bashkisë Mallakastër, financuar nga Ministria e linjës, konstatohet se në 4 raste janë lidhur kontrata me vlerën e plotë të projektit ndërkohë që i është deleguar pjesërisht fondi nga ministria e linjës, duke ndërmarrë angazhime buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, si dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit buxhetor.

-Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Mallakastër, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2022, ky afat nuk është respektuar në 30 fatura për vlerën 48,202,350 lekë si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

*Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: z. A.R me funksion Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.*

## **2.2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor<sup>12</sup>.**

Në zbatim të pikës II.2, nënpika 2.6, të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Evidencat analitike të llogarive debitoare për taksat dhe tarifatat vendore.
- 2) Akt rakordimi me degën e thesarit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore.
- 3) Evidencat e debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore për subjektet dhe për detyrimet familjare.
- 4) Të tjera dokumente për arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifatat vendore.
- 5) Vendimin e Këshillit të Bashkisë për paketën fiskale.
- 6) Vendimet e Këshillit të Bashkisë për strukturën organike.

### **I.Struktura e Sektorit të tatim-taksave, Bashkia Mallakastër.**

Për vitin 2022 me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB nr.55, nr. 4365 prot., datë 20.12.2021, është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Fier me shkresën nr.4394/1, datë 31.12.2021. Me urdhrin nr.4, nr.4448 prot., datë 28.12.2021 të Kryetarit të Bashkisë është miratuar struktura organizative sipas drejtorive/sectorëve, ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë dhe sektori i tatim - taksave.

-Sektori i tatim-taksave ka në përbërjen e saj, 1 përgjegjës sektori, 5 specialist dhe 1 agjent tatimor. Në datë 14.11.2022 përgjegjësi i sektorit z.B.J është larguar nga puna dhe me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me nr.5924 prot., datë 25.11.2022 në këtë pozicion është emëruar z.A.M, përgjegjës i sektorit të Tatim –Taksave.

Struktura e Sektorit të taksave dhe tarifave Bashkia Mallakastër, si dhe lëvizjet e punonjësve përgjatë vitit 2022 pasqyrohet si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemer	Pozicioni	Date fillimi	Ndryshimi gjatë 2022 nëse ka pasur
1	B.J	Përgjegjës sektori i të Ardhurave	07.08.2015	Larguar 14.11.2022
2	A.XH	Specialist	01.10.2015	
3	E.G	Specialist	08.08.2016	
4	A.M	Specialist	04.04.2018	Emëruar P/Sektori 25.11.2022
5	G.H	Punonjës për kontabilizimin e të ardhurave (taksave)	21.02.2022	

Burimi: Sektori i tatim-taksave Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

<sup>12</sup> Observacionet janë trajtuar në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

-Sektori i tatim-taksave Bashkia Mallakastër, për vitin 2022 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Mallakastër nga taksat dhe tarifave.  
Veç Sektorit të tatim - taksave, në Bashkinë Mallakastër janë të angazhuara edhe struktura të tjera për faturimin dhe/ose mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, si më poshtë vijon:

Struktura	Lloji i të ardhurës	Plani	Fakti
Sektori i tatim-taksave	Taksa dhe tarifa Vendore për biznesin dhe familjarët	173,615,000	138,865,452
Drejtoria e Urbanistikës	Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	23,727,000	4,377,006
	Taksën e ndikimit në infrastrukturë për leje ndërtimi	12,699,000	2,503,877
	Certifikatë përdorimi	8,917,000	1,119,121
Drejtoria/Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor	Qira për fond pyjor dhe kullosor	2,228,000	4,787,121
	Shitja e lëndës drusore	0	1,396,500

Burimi: Sektori i Tatim-Taksave Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

## **II.Taksat dhe Tarifave e aplikuar dhe arkëtuara nga Bashkia Mallakastër.**

Përgjatë vitit 2022, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar dhe zbatuar 1 paketë fiskale, konkretisht:

-Paketa fiskale për vitin 2022 është miratuar me VKB nr.45, nr.3940 prot., datë 25.11.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr.1449/1 prot., datë 09.12.2021.

-Mbështetur në paketën fiskale të mësipërme në Bashkinë Mallakastër, sipas sektorëve përkatës, në mënyrë të përmbledhur janë aplikuar/mbledhur rreth 20 lloje taksash dhe tarifash. Për vitin 2022 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Mallakastër dhe NJA, ndahen në 4 kategori:

- 1.Biznes;**
- 2.Ambulant;**
- 3.Familjar;**
- 4.Institucione.**

Kategoritë e mësipërme (përfshirë institucionet) ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:

-Kategoria e parë ndahet në Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël.

-Kategoria e tretë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Llojet e subjekteve mbi të cilët janë aplikuar taksat dhe tarifave vendore, si dhe numri i tyre.

Nr	Lloji	2022
1	Biznesi i Madh	66
2	Biznesi i Vogël	431
3	Ambulant (Hapësirat e tregut)	3
4	Institucione	19
	<b>Total</b>	<b>519</b>

Burimi: Sektori i tatim-taksave Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Të gjitha sa më sipër, mbi planifikimin dhe realizimin e tyre në lekë, për vitin 2022, pasqyrohen në Aneksë – Aneksi nr.3 në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Për vitin 2022 të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën **359,431 mijë** lekë dhe janë realizuar në vlerën **169,753 mijë** lekë, ose 47% / rreth 189,678 mijë lekë më pak nga plani.

-Në tabelën e mësipërme vihet re për disa lloje taksash dhe tarifash nuk planifikohet saktë niveli i arkëtimin/nuk ndryshon planifikimi, pavarësisht se në vitin e kaluar janë realizuar të ardhura, konkretisht për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tabelës dhe reklamës, psh., në vitin 2021 kjo taksë është planifikuar 2,384 mijë lekë dhe janë arkëtuar 846 mijë lekë, ndërkohë që përsëri në vitin 2022, kjo taksë është planifikuar në vlerën 2,456 mijë lekë dhe realizimi është 856 mijë lekë; taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura; tarifa për përdorimin e pyjeve dhe kullovave; tarifave për zënien e hapsirave publike; tarifa veterinerë të bagëtive të therura dhe tarifa për dhënie licenca për tregëtimin e naftës.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjat “a” dhe “e” të nenit 5 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e njëjësive të vetëqeverisjes vendore”.

*-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. B.J, Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave, dhe z.A.M specialist i sektorit të tatim taksave.*

### **Detyrimet e palëve të treta ndaj Bashkisë Mallakastër sipas kategorive të tyre.**

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur ecuria e debitorëve për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, si dhe trashëguar nga vitet e mëparshme.

<b>Në fund të vitit 2021 (Progresive)</b>	<b>Nr</b>	<b>Vlerë</b>	<b>Principal</b>	<b>Kamat-Vonesë</b>	<b>Gjobat e aplikuara</b>
	<b>5675</b>	<b>1,232,817,217</b>	<b>868,708,746</b>	<b>229,552,135</b>	<b>8,620,934</b>
Biznesi i Madh	18	12,372,800	9,666,250	963,456	1,743,094
Kompanitë e naftës	7	1,097,007,926	812,326,387	227,451,388	
Biznesi i Vogël	263	17,810,914	14,180,664	510,504	3,119,746
NIPT Sekondar për punime të kryera	2	367,064	292,249	10,521	64,294
Tarifa e licencimit për karburantet	7	7,536,000	6,000,000	216,000	1,320,000
Institucione	2	13,202,644	10,790,000	38,844	2,373,800
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	4880	68,669,251			
Taksa e ndikimit në infrastrukt. për legalizimin e objekteve informale	381	11,835,166	11,534,944	300,222	
Taksa e tokës bujqësore					
Gjoha të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit	6	1,761,200	1,700,000	61,200	
Gjoha të Policisë Bashkiake	21	36,000			
Qira trualli			-		
Qira objekti			-		
Qira fond pyjor dhe kullosor	88	2,218,252	2,218,252		
<b>Krijuar brenda vitit 2022</b>	<b>Nr</b>	<b>Vlerë</b>	<b>Principal</b>	<b>Kamat-Vonesë</b>	<b>Gjobat e aplikuara</b>
Biznesi i Madh	23	2,124,537	2,124,537		
Kompanitë e naftës	7	16,810,627	9,450,540	7,360,087	
Biznesi i Vogël	94	2,145,426	2,145,426		
NIPT Sekondar për punime të kryera	1	225,520	225,520		-
Tarifa e licencimit për karburantet	8	1,116,730			
Tregëtar Ambulant	-	-	-		
Institucione	4	913,580	913,580		
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore, <b>vetëm qyteti</b> )	2214 (qyteti)	18,660,123	18,660,123		
Taksa e ndikimit në infrastrukt. për legalizimin e objekteve informale	42	1,339,017	1,339,017		
Taksa e tokës bujqësore					
Gjoha të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit					
Gjoha të Policisë Bashkiake	1	1,000	1,000		
Qira trualli	-		-		
Qira objekti	-		-		
Qira fond pyjor dhe kullosor	208	1,371,187	1,371,187		
<b>Në fund të vitit 2022 (progresive)</b>	<b>Nr</b>	<b>Vlerë</b>	<b>Principal</b>	<b>Kamat-Vonesë</b>	<b>Gjobat e aplikuara</b>
Biznesi i Madh	23	14,497,337	14,497,337		
Kompanitë e naftës	7	1,113,818,553	1,113,818,553		
Biznesi i Vogël	107	8,183,295	7,898,933	284,362	
NIPT Sekondar për punime të kryera	0		0		
Tarifa e licencimit për karburantet	8	1,116,730			
Tregëtar Ambulant	0		0		
Institucione	3	12,124,909	11,703,580	421,329	
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	6532	98,950,036	98,950,036		
Taksa e ndikimit në infrastrukt. për legalizimin e objekteve informale	314	9,678,523	9,678,523		
Taksa e tokës bujqësore					
Gjoha të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit	-		-		
Gjoha të Policisë Bashkiake	-		-		
Qira trualli	-		-		
Qira objekti	-		-		
Qira fond pyjor dhe kullosor	92	2,466,047	2,466,047	35,710	
<b>Total</b>	<b>7086</b>	<b>1,260,835,430</b>	<b>1,259,013,009</b>	<b>741,401</b>	

Burimi: Sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme rezulton se:

-Vlera e detyrimeve në fund të vitit 2022 është 1,260,835,430 lekë për taksat dhe tarifave vendore, qiratë, gjobat, kamatëvonesa etj. Në krahasim me fundin e vitit 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitorë me 28,018,213 lekë.

*Situata e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme të Bashkisë Mallakastër në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta.*

#### **III.1. Kategoria “Biznes” dhe “Institucione”.**

**Titulli gjetjes:** Debitorët “Biznes”, “Institucione” dhe “Qiramarrës” të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore, si dhe mosmarrja e masave ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e detyrimeve përkatëse.

**Situata:** Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Sektori i Tatim Taksave, rezulton se në fillim të vitit 2022 kanë qenë debitor 290 subjekte të kategorisë “Biznes”, Institucione në vlerën 1,137,138,382 lekë.

-Në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 137 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 1,136,232,823 lekë dhe 3 institucione në vlerën 11,703,580 lekë, pra gjithësej **1,147,936,403 lekë** për **140** subjekte, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.

-Në fund të vitit 2022 në krahasim me fillimin e vitit 2022, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” ka ardhur në rritje.

-Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga sektori i tatim taksave Bashkia Mallakastër, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje duke aplikuar masa shtrënguese (deri në vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), nuk është vazhduar me masa shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. B.J, përgjegjës sektori i tatim taksave.

### **“Subjektet qiramarrës”.**

#### Qira për tokën bujqësore.

Bashkia Mallakastër administron 211 kontrata qiraje për tokën bujqësore në NJA Hekal, Qëndër, Aranitas, Selitë, Kutë dhe Fratar, të cilat janë lidhur përgjatë viteve 2009-2013 dhe me afat kryesisht 99 vite. Tarifa e dhënies së tokës bujqësore është sipas VKM-së nr.373, datë 20.06.2018, konkretisht 7,000 lekë/Ha/vit.

Në një vit buxhetor, të ardhurat që pret të arkëtojë Bashkia Mallakastër nga qiraja e tokës bujqësore janë gjithësej 1,371,187 lekë. Nga auditimi i kontratave për dhënien me qira të tokës bujqësore, u konstatua se në fund të vitit 2021 janë debitor 88 subjekte në vlerën 2,250,332 lekë. Në krahasim me vitin 2022, në fund të vitit 2022 konstatohet se janë debitor 92 subjekte për vlerën 2,466,047 lekë. Pra gjatë vitit 2022 janë krijuar 4 subjekte për vlerën debitore 215,715 lekë<sup>13</sup>. Gjithashtu konstatohet se kontratat e qirasë së tokës bujqësore nuk janë përditësuar sipas formatit të ri të kontratës tip, miratuar me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar, pasi nëpërmjet formatit të ri, ka ndryshuar masa e kamatvonesës për mospagesën në kohë, pra nga 1% bëhet 0.5%, si dhe është parashikuar indeksimi i tarifës së qirasë 1 herë në 5 vite, periudhë e cila përkon me indeksimin që duhet t’i bëhet tarifës së qirasë në vitin 2023.

Për arkëtimin e vlerës debitore të krijuar nga mospagesa e qirasë, nuk administrohet dokumentacion mbi masat e marra, pra zgjidhjen e kontratës në zbatim të kapitullit “zgjidhja e kontratës” në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, si dhe padi gjyqësore me qëllim ngarkimin e shërbimit përmbartimor, për ekzekutimin me forcë të detyrimit.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi z. E.A, Drejtor i Bujqësisë, znj. E.S, Përgjegjës i sektorit të pyjeve, pranë Bashkisë Mallakastër.

**Kriteri:** Lidhja 2, tabela 2 në VKM nr.391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar;

Paketa fiskale e vitit 2022, pika 4, pika 17, shkronja “b”;

Neni 3 dhe neni 4 në Ligjin nr.8318, datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar;

Pika 2 në nenin 89 në Kreu XI të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar;

-Pikat 1 dhe 2 në nenin 4 dhe neni 22/5 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

<sup>13</sup>Lista e subjekteve debitore në fund të vitit 2022, bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.

**Efekti:** Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër në vlerën 2,466,047 lekë, nga të cilat 1,371,187 lekë janë krijuar brenda vitit 2022.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Mjedisit të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitoare 2,466,047 lekë (principal dhe kamatë vonesë).

**Rekomandimi:** Drejtoria Juridike të marrë masa, për ndryshimin e përmbajtjes së kontratave të qirasë për tokat bujqësore, duke reflektuar ndryshimin në kamatëvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.

### **Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale, objekt legalizimi.**

**Titulli i Gjetjes:** Keqmenaxhimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale.

**Situata:** Në lidhje me realizimin e të ardhurave të bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga Drejtoria Vendore e ASHK Fier dhe Drejtoria e Vendore e ASHK Mallakastër, u auditua dokumentacioni për periudhën e vitit 2022, i paraqitur nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Mallakastër. Nga DVASHK Fier dhe DVASHK Mallakastër, janë dërguar dokumentet për çdo person që është pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale, me qëllim përlllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI).

Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria e Urbanistikës nuk është zbatuar pika 4 në paketën fiskale të Bashkisë Mallakastër për vitin 2022, pasi për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga subjektet e pajisur me leje legalizimi përgjatë vitit 2022, nuk janë marrë masa për njoftimin e tyre me qëllim kryerjen e pagesës përkatëse. Veç sa më sipër situata ku nuk janë marrë masa në mënyrë shteruese për arkëtimin e TNI, konstatohet edhe sa i përket arkëtimin të TNI për debitorët e rezultuar deri në datë 31.12.2021, për të cilët administrohet vetëm njoftimi për arkëtim. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe DAV Bashkia Mallakastër, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, t'i përcillen sektorit të mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale.

Në vijim paraqitet në mënyrë të përmbledhur pasqyra e personave të cilët janë pajisur me leje legalizimi, si dhe vlera debitoare progresive dhe e ndarë sipas viteve<sup>14</sup>.

TNI për legalizimin e objekteve informale - Viti 2022

Debitor TNI	Subjekte	Vlera
<b>Gjithësej progresive</b>	<b>423</b>	<b>12,874,096</b>
Nga të cilat në 2022	42	1,339,017
Nga të cilat progresive deri në 2021	381	11,535,079

Burimi: Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Bazuar në të dhënat e marra nga Bashkia Mallakastër konstatohet se:

-Vlera debitoare progresive është 12,874,096 lekë për 423 subjekte (nga të cilat 42 subjekte për vlerën 1,339,017 lekë krijuar në vitin 2022).

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi z. M.M, Drejtor i Administrimit dhe Zhvillimit të Territorit, dhe z.B.J, përgjegjësi i sektorit të tatim taksave.

**Kriteri:** Ligji nr. 9482 datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e

<sup>14</sup> Tabela analitike, subjekt, sipërfaqe, objekt, vlera e detyrimit, bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, Paketa Fiskale 2022, Pika 4.

**Ndikimi/Efekti:** Të ardhura të munguara në vlerën 12,874,096 lekë.

**Shkaku:** Mungesa e marrjes së masave shtrënguese në mënyrë shteruese për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit t’i përcjellë sektorit të tatim taksave listën me subjektet debitore për taksën e ndikimit në infrastrukturë, Sektori i tatim taksave Bashkia Mallakastër të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore, për arkëtimin e vlerës debitore prej 12,874 mijë lekë.

### **Për tarifën e lëshimit të licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Mallakastër.**

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Mallakastër mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

-Ligj Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;

-VKM nr.212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”

-VKB për miratimin e paketës fiskale;

-Dosjet e licencimit të subjekteve, me përmbajtje: Licenca e dhënë për ushtrim aktiviteti, Ekstrakti i regjistrimit në QKB (në të cilin pasqyrohet lloji aktivitetit dhe vendet e ushtrimit të aktivitetit nga subjekti në Bashkinë Mallakastër dhe NJA, që korrespondon me periudhën 01.01.2022-31.12.2022), Akti teknik i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial; Leje mjedisore për ushtrim aktiviteti, Raporti teknik i lëshuar nga shërbimi i zjarrëfikses, Projekti teknik i vendit ku do të ushtrohet aktiviteti, vendosja e depozitave, Autorizimet për pagesë, Faturat e arkëtimin dhe pagesa e kryer nga subjekti;

-Paketa Fiskale e vitit 2022 dhe Rregullore e brendshme e Bashkisë Mallakastër.

-Gjithashtu u kryqëzua informacioni me databasat e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, institucioni që inspekton subjektet e tregtimit të karburanteve.

**Titulli i Gjetjes:** Menaxhimi i të ardhurave nga tarifa e licencimit të subjekteve që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, si dhe mangësi në përditësimin e regjistrimit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregëtimin e karburanteve në Bashkinë Mallakastër.

**Situata:** Në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Mallakastër dhe në Njësitë Administrative, Sektori i të Ardhurave në Bashkinë Mallakastër, struktura e cila lëshon autorizimet për tregtimin e karburantit me pakicë/të njërive të shitjes së lëndëve djegëse, vendosi në dispozicion të grupit të auditimit, dosjet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, pasqyruar si më poshtë vijon:

Subjektet për të cilat administrohet dosje fizike dhe që kanë ushtruar aktivitet në vitin 2022 në Bashkinë Mallakastër

Nr.	Karburanti	Vendi ku është ndërtuar
1	“N” shpk	Ballsh, Mallakastër
2	“N” shpk	Klos, Mallakastër
3	“L-04” shpk	L. Gllavenicë Ballsh, Mallakastër



4	“K” shpk	Rr.Nacionale Ballsh-Fier km,3
5	“B 03” shpk	Visokë, Mallakastër
6	“B 2003” shpk	Hekal, Mallakastër
7	“SH 07” shpk	Belishovë, Rruga Nacionale “Ballash-Fier”
8	“B P” shpk	L. Povel-Damës Mallakastër
9	“A 2013” shpk	Dukas
10	“O” shpk	Bejar Fratar, Mallakastër
11	“E” shpk	Belishovë
12	“I” shpk	Dukas

Burimi: Drejtoria e Transportit, Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sipas të dhënave të paraqitura në Bashkinë Mallakastër, për vitin 2022 ushtrojnë këtë aktivitet 12 subjekte. Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2022, janë debitorë 8 subjekte për vlerën 1,116,730 lekë gjithësej. Konkretisht subjektet janë:

**1.”N.” Sh.P.K** me adresë Ballsh, Mallakastër, subjekt i cili ka qënë i pajisur me autorizim 5 vjeçar të cilit i ka mbaruar afati në datë 13.08.2022. Subjekti “N” shpk kosntatohet se ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 13.08.2022-31.12.2022 duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithësej 83,350 lekë<sup>15</sup>. Për këtë subjekt nuk është marrë asnjë masë nga Bashkia Mallakastër e cila duhet t’i drejtohej ISHTI-t për bllokim të aktivitetit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për marrje masash si rrjedhojë e mosveprimit të strukturës në varësi të saj. Gjithashtu Sektori i të Ardhurave Vendore dhe Policia Bashkiake nuk ka marrë masa shtrënguese, ndaj subjektit të mësipërm.

**2.”B.P” Sh.P.K** me adresë L.Povel-Damës, Mallakastër, subjekt i cili ka qënë i pajisur me autorizim 5 vjeçar të cilit i ka mbaruar afati në datë 19.09.2022. Subjekti “B.P” shpk kosntatohet se ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 19.09.2022-31.12.2022 duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithësej 66,680 lekë. Për këtë subjekt nuk është marrë asnjë masë nga ana e Bashkisë Mallakastër e cila duhet t’i drejtohej ISHTI-t për bllokim të aktivitetit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për marrje masash si rrjedhojë e mosveprimit të strukturës në varësi të saj. Gjithashtu Sektori i të Ardhurave Vendore dhe Policia Bashkiake nuk ka marrë masa shtrënguese, ndaj subjektit të mësipërm.

**3.”B. 2003” Sh.P.K** me adresë Hekal, Mallakastër, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithësej 200,000 lekë. Për licencimin e këtij subjekti, i cili ka ushtruar aktivitet pa licencë nuk është marrë asnjë masë nga Bashkia Mallakastër e cila duhet t’i drejtohej ISHTI-t për bllokim të aktivitetit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për marrje masash si rrjedhojë e mosveprimit të strukturës në varësi të saj. Gjithashtu Sektori i të Ardhurave Vendore dhe Policia Bashkiake nuk kanë marrë masa shtrënguese ndaj subjektit të mësipërm.

**4.”A.” 2013 Sh.P.K** me adresë Dukas, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithësej 200,000 lekë. Për licencimin e këtij subjekti, i cili ka ushtruar aktivitet pa licencë nuk është marrë asnjë masë nga Bashkia Mallakastër e cila duhet t’i drejtohej ISHTI-t për bllokim të aktivitetit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për marrje masash si rrjedhojë e mosveprimit të strukturës në varësi të saj. Gjithashtu Sektori i të Ardhurave Vendore dhe Policia Bashkiake nuk kanë marrë masa shtrënguese ndaj subjektit të mësipërm.

**5.”E.” Sh.P.K** me adresë Belishovë, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithësej 200,000 lekë. Për licencimin e këtij subjekti, i cili ka ushtruar aktivitet pa licencë nuk është marrë asnjë masë nga Bashkia Mallakastër e cila duhet t’i drejtohej ISHTI-t për bllokim të aktivitetit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për marrje masash si rrjedhojë e mosveprimit të strukturës në varësi të saj. Gjithashtu Sektori i të Ardhurave Vendore dhe Policia Bashkiake nuk kanë marrë masa shtrënguese ndaj subjektit të mësipërm.

**6.”I.” Sh.P.K** me adresë Dukas, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithësej 200,000 lekë. Për licencimin e këtij subjekti, i cili ka ushtruar aktivitet pa licencë nuk është marrë asnjë masë nga Bashkia Mallakastër e cila duhet t’i drejtohej ISHTI-t për bllokim të aktivitetit,

<sup>15</sup> 1,000,000 lekë për 5 vite/200,000 lekë për 1 vit/16,666 lekë për 1 muaj.

Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për marrje masash si rrjedhojë e mosveprimit të strukturës në varësi të saj. Gjithashtu Sektori i të Ardhurave Vendore dhe Policia Bashkiake nuk kanë marrë masa shtrënguese ndaj subjektit të mësipërm.

7.”B” Sh.P.K me adresë Visokë Mallakastër, ka ushtruar aktivitetet pa licencë për periudhën 01.01.2022-17.03.2022, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithësej 50,000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe nga verifikimi në QKB ky subjekt në datë 17.03.2022 ka pezulluar aktivitetin.

8.”SH. 07” Sh.P.K me adresë Fshati Belishovë, Rr.Nacionale “Ballsh-Fier, ka ushtruar aktivitetet pa licencë për periudhën 22.05.2022-31.12.2022, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithësej 116,700 lekë. Për licencimin e këtij subjekti, i cili ka ushtruar aktivitetet pa licencë nuk është marrë asnjë masë nga Bashkia Mallakastër e cila duhet t’i drejtohej ISHTI-t për bllokim të aktivitetit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për marrje masash si rrjedhojë e mosveprimit të strukturës në varësi të saj. Gjithashtu Sektori i të Ardhurave Vendore dhe Policia Bashkiake nuk kanë marrë masa shtrënguese ndaj subjektit të mësipërm.

*Sa më sipër mbanë përgjegjësi B.J, Përgjegjës Sektori i Tatim -Taksave.*

-Në mënyrë të përmbledhur si rrjedhojë e mosmarrjes e masave shtrënguese deri në kallëzimin penal (në vitin 2022) në mënyrë shteruese për arkëtimin e tarifës së licencimit, konstatohet se 8 subjekte për 8 stacione shitje të karburantit nuk kanë aplikuar për rilicencim/nuk kanë kryer pagesën e tarifës së licencimit dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Mallakastër në vlerën 1,116,730 mijë lekë.

-Në mënyrë të përmbledhur, janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin Bashkisë Mallakastër, gjithësej 1,116,730 lekë.

**Kriteri:** Pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017.

Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja “b” në pikën 1 në nenin 131 “...nuk i paguan ato në buxhet” të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar.

Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.

Rregullore e brendshme e Bashkisë Mallakastër “Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit”, pika 1, si dhe shkronja “d”, si dhe “Policia Bashkiake”, neni 5 dhe neni 8.

Pika 10 në Paketën Fiskale të Bashkisë Mallakastër, për vitin 2022.

**Ndikimi/Efekt:** Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër në vlerën 1,116,730 lekë.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në tregtimin e karburanteve, me qëllim licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t’i drejtohet me shpresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial, për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregëtimit me pakicë të karburanteve.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit Bashkia Mallakastër në bashkëpunim me Sektorin e tatim taksave, të marrë masat e nevojshme për ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 1,116 mijë lekë.

**Për realizimin e të ardhurave nga tarifave vendore, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Mallakastër.**

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Mallakastër mbi arkëtimin e tarifës së ndotjes së mjedisit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike/private në Bashkinë Mallakastër, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Paketa fiskale e vitit 2022;



- Evidenca e prokurimeve me fonde publike 01.01.2022 - 31.12.2022;
- Leje ndërtimi, njoftim i fillimit dhe përfundimit të punimeve;
- Faturimi i detyrimit dhe pagesa, sipas regjistrimit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022.

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:***

**1.Përshkrimi i situatës.**

Bashkia Mallakastër në paketën fiskale të vitit 2022, ka përcaktuar tarifën e përkohshme të ndotjes së mjedisit, duke bërë dy kategorizime, si më poshtë vijon:

1.Tarifa për ndotjen e mjedisit, do të zbatohet për subjektet fizike e juridike që me veprimtarinë e tyre ndotin dhe dëmtojnë mjedisin, duke aplikuar tarifën 100,000 lekë për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e shfrytëzimit të inerteve. Për faturimin dhe arkëtimin e kësaj tarife, është ngarkuar Sektori i Tatim-Taksave.

2.Tarifë për subjektet e ndërtimit person juridik duke aplikuar tarifë ndriçimi 10,000 lekë, tarifë gjelbërimi 15,000 lekë dhe tarifë pastrimi 60,000 lekë. Për arkëtimin e kësaj tarife, është ngarkuar Sektori i Tatim-Taksave.

3.Taksa mbi truallin për bizneset aplikohet tarifa 15 lekë/m<sup>2</sup>/vit.

Me qëllim auditimin e veprimtarisë së strukturave të mësipërme në faturimin dhe arkëtimin e tarifës së ndotjes, pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe taksën mbi truallin u kryqëzua informacioni i marrë nga Njësia e Prokurimit (procedurat e prokurimit për punime ndërtimi dhe subjektet fitues), Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për njoftimin e fillimit dhe përfundimit të punimeve, lejeve të ndërtimit të dhëna, si dhe Drejtoria e të Ardhurave, për regjistrin e taksave dhe tarifave vendore, viti 2022, për kategorinë “biznes”.

Nga auditimi u konstatua se përgjatë periudhës 2022, (përfshirë edhe subjekte të cilat kanë nisur punimet në vitin 2021, por kanë përfunduar në vitin 2022 apo janë në proces) nuk janë tarifuar 10 subjekte që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Mallakastër, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër në vlerën 986,696 lekë, pasqyruar si më poshtë vijon:

Tarifa e ndotjes së mjedisit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike/private<sup>16</sup>, për 2022

Nr	Objekti i Prokurimit/Leja e Ndërtimit	Vlera e tenderit/Sip e punimeve	Zhvilluesi	OE/Subjekti ndërtues	Kohëzgjatja e punimeve		Tarifa Ndotjes, Pastr,Gjelb,Nd
					Statusi 31.12.2022		
					Filluar	Mbaruar	(Lekë)
1	Ndërtim linje transmetimi rrjeti i jashtëm ujisjellesi Rajonal (Nga burimi i Pocemit)	568,485,332	Bashkia Mallakastër	BOE “A” –“E K” – “K” shpk	12.07.2021	Proces	298,498
2	Rikonstruksion Rruga Bejar-Kutë-Corrush	109,498,856	Bashkia Mallakastër	“C” shpk	01.10.2022	Proces	49,749
3	Rikonstruksion i Rrugeve ne fshatrat Dukas,Visok,Greshic,Mollaj	129,202,020	Bashkia Mallakastër	“S” shpk	24.10.2022	Proces	33,166
4	Permiresimi i kushteve te banimit ne ndertesa, per komunitetet e pafavorizuara	27,891,507	Bashkia Mallakastër	BOE “V K” & “Z” shpk	01.11.2022	Proces	33,166
5	Rikonstruksion I pjesshem I zyrave të njësies Administrative Fratar	27,891,507	Bashkia Mallakastër	“C” shpk	21.02.2022	13.06.2022	82,915
6	Ndërtim objekti për grumbullim dhe tharje produktesh bujqësore	7,447,886	B.H	“6- P” shpk	26.03.2021	20.09.2022	116,081
7	Objekt banimi 1 dhe 2 kat me 1 kat podrum, pishinë dhe mur rrethues	65,658,087	C.F shpk	“B-O” shpk	08.09.2021	Proces	265,332
8	Banesë 2 kate me podrum	65,658,087	GJ.Y	“N K” shpk	04.10.2022	Proces	49,749
9	Banesë 1-kat	7,706,322	N.K	“G 001” shpk	15.11.2022	Proces	24,874
10	Ndërtim godine shërbimi 1 kat (+1 kat nëntok)	57,372,054	SH.S 24 shpk"	"T" shpk	01.11.2022	Proces	33,166
	<b>Total</b>	<b>1,066,811,658</b>					<b>986,696</b>

<sup>16</sup> Subjektet që kanë kryer punime ndërtimi për llogari të investitorit privat.

Burimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sektori i taksave dhe tarifave dhe Njësia e Prokurimit, Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Sektori i tatim-taksave për mostarifimin e 10 subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi.

*-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z.M.M, Drejtor i Administrimit dhe Zhvillimit të Territorit, z. B.J, ish Përgjegjës Sektori i Tatim-Taksave dhe A.M Përgjegjës Sektori i Tatim-Taksave, për rastet nga 25.11.2022 – vijim.*

**Kriteri:** Kreu II, pika 20 në Paketën Fiskale të Bashkisë Mallakastër.

**Ndikimi/Efekti:** Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër në vlerën 986,696 lekë.

**Shkaku:** Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të Bashkisë Mallakastër (shkëmbimi informacionit ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Drejtorisë së të Ardhurave), si dhe puna e pamjaftueshme e inspektimit në terren nga inspektorët e Drejtorisë së të Ardhurave.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Sektori i tatim taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Drejtorinë Mjedisit, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë 986,696 lekë.

### III.2.Familjet.

**Titulli i Gjetjes:** Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”.

**Situata:** Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Mallakastër dhe NJA, për vitin 2022 janë taksuar 9455 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”. Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NJA, pasqyrohen si më poshtë:

NJA	Familje të taksuara	Familje sipas Gj.Civile
Qendër	2019	2444
Ballsh - Ngreçan	2460	3664
Kutë	761	912
Fratar- Selit	1646	1937
Hekal	1075	1337
Greshicë	445	567
Aranitas	1049	1175
<b>Total</b>	<b>9455</b>	<b>12036</b>

Burimi: Sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Me qëllim vlerësimin nëse nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Mallakastër është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga Sektori i tatim-taksave Bashkia Mallakastër me informacionin e administruar nga Gjendja Civile.

-Sipas gjëndjes civile në Bashkinë Mallakastër dhe NJA janë 12036 familje, pra ndërkohë në vitin 2022 janë taksuar 9455 familje.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Mallakastër nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përllogaritjet vetëm për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe pastrimit (duke aplikuar tarifën më të ulët në vlerë), për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 1,750 lekë \* 2581 familje mesatarisht taksuar më pak = 4,516,750 lekë planifikuar më pak.

-Gjithashtu situata e mësipërme tregon se Sektori i Tatim Taksave Bashkia Mallakastër nuk ka një regjistrë të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që

përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018<sup>17</sup>, e ndryshuar, detyrim për t'u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "Familjar". Në këtë drejtim kërkohet më tepër përkushtim nga Bashkia Mallakastër duke ngritur grup pune, për evidentimin e saktë dhe të plotë të familjeve që jetojnë në Bashkinë Mallakastër dhe NJA.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. B.J, Përgjegjësi i Sektorit të Tatim Taksave, z.A.XH, z.E.G, z.A.M agjent tatimor pranë NJA-ve.

-Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezulton se për arkëtimin e taksave të familjeve të qytetit Mallakastër, është marrëveshje bashkëpunimi me Ujësjiellës-Kanalizime Sh.A Fier-Mallakastër, i cili vepron si agjent tatimor për llogari të Bashkisë Mallakastër. Përfunduar familjet e qytetit, në NJA taksimi dhe tarifimi i familjeve bëhet fizikisht, pra lëshohet faturë kur familjari paraqitet pranë zyrave të bashkisë për të përfituar shërbim, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të "Njoftim Vlerësimit", apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

**Kriteri:** Pika 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore";

Kreu II në Paketën Fiskale të Bashkisë Mallakastër.

**Ndikimi/Efekt:** Mos evidentimi i saktë i numrit të familjeve për efekt taksimi të tyre ndikon negativisht në fondet që mund të arkëtojnë Bashkia Mallakastër nga kategoria "Familjar".

**Shkaku:** Mungesa e përditësimit të regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë familjar, si dhe mungesa e kryerjes së verifikimeve në terren nga sektori i tatim taksave Bashkia Mallakastër.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Sektori i tatim taksave në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë "Familje", ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së ndriçimit, gjelbërimit dhe arsimit për vitin 2022, rezultojnë 4,516,750 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.

**Titulli i gjetjes:** Debitorët "Familjar" të cilët nuk kanë likuaduar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Mallakastër.

**Situata:** Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për tarifën e ndriçimit, pastrimit, taksën e ndërtesës, truallit, si dhe taksën e tokës bujqësore.

Nr	Debitorët "Familje" NJA	Progressive deri në 2021		Krijuar 2022		Progressive 31.12.2022	
		Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë
1	Qendër	1111	12,778,985		-	1091	10,209,822
2	Greshicë	194	6,129,034	88	809,436	282	6,938,470
3	Aranitas	717	12,786,613		1,914,050	602	14,700,663
4	Hekal	583	8,315,315	96	3,133,206	679	11,448,521
5	Ngreçan	143	2,554,949	3	369,327	146	2,924,276
6	Kutë	408	12,618,460	16	1,639,988	424	14,258,448
7	Fratar	742	8,430,025		1,966,377	728	10,396,402
8	Selitë	317	4,559,518	49	807,115	366	5,366,633
9	Ballsh	665	10,048,155	1549	8,020,624	2214	22,706,801
	<b>TOTAL</b>	<b>4880</b>	<b>78,221,054</b>	<b>1652</b>	<b>18,660,123</b>	<b>6532</b>	<b>98,950,036</b>

Burimi: Sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive janë 4880 familje debitorë për vlerën 78,221,054 lekë dhe në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 6532 familje debitorë për vlerën 98,950,036 lekë, nga të cilat, në vitin 2022 është krijuar 18,660,123 lekë debi. Pra në krahasim me vitin 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitorë për

<sup>17</sup> Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

taksat dhe tarifate për kategorinë “familje”, ç’ka tregon për performancë të dobët të Bashkisë Mallakastër në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme.

-Sa i përket familjeve debitore, rezulton se nuk janë marrë masa ligjore (njoftimin e vlerësimit të detyrimit tatimor, bllokimin e llogarive bankare, etj) për arkëtimin e vlerës debitore.

➤ Gjithashtu ndaj Bashkisë Mallakastër rezulton të jetë debitor edhe UK Sh.A për vitin 2022 në rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj kategorisë “Familjar”. Detyrimi që ka UK. Sh.A Mallakastër në fund të vitit 2022 (në rolin e agjentit tatimor) ndaj Bashkisë Mallakastër është në vlerën prej 811,920 lekë. *Nga sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Mallakastër për këtë situatë nuk janë marrë masat ligjore (aplikimin e gjobave) ndaj agjentit tatimor UK Sh.A Mallakastër, i ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj kategorisë “Familjar”.*

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. B.J, Përgjegjës i Sektorit Tatim-Taksave .*

**Kriteri:** Pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4, nenet 20-24 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;

Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

**Ndikimi/Efekti:** Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër në vlerën 98,950,036 lekë.

**Shkaku:** Mos zbatim i kuadrit rregullator të fushës.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për përfshirjen e taksave dhe tarifave vendore që aplikohen në NJA, në faturën e ujit të pijshëm, duke përdorur si agjent tatimor UK Sh.A Fier – Mallakastër, për arkëtimin e tyre.

**Rekomandimi:** Sektori i tatim taksave të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga taksat familjare prej 98,950 mijë lekë.

**Titulli i Gjetjes:** Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit të taksës së tokës bujqësore.

**Situata:** Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, gjithësej tokë bujqësore sipas Sektorit i Tatim- Taksave Bashkia Mallakastër janë 10270.2 Ha, sipërfaqe e ndarë me AMTP. Kjo sipërfaqe duhet të shërbejë për Bashkinë Mallakastër për planifikimin e taksës së tokës bujqësore. Ndarja e tokës bujqësore me AMTP, sipas Njësive Administrative të Bashkisë Mallakastër, pasqyrohet si me poshtë:

Nr	NJA	Sipërfaqja e tokës, ndarë me AMTP
1	Qyteti Ballsh	65.2
2	Nj.A. Dukas	1967.5
3	Nj.A. Greshicë	699
4	Nj.A. Aranitas	1619
5	Nj.A. Hekal	1845
6	Nj.A. Ngraçan	307
7	Nj.A. Kutë	1442
8	Nj.A. Fratar	1683.6
9	Nj.A. Selitë	641.9
	<b>Shuma</b>	<b>10270.2</b>

Burimi: Sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Konkretisht planifikimi i taksës së tokës bujqësore nga Sektori i Tatim-Taksave Bashkia Mallakastër, pasqyrohet në tabelën si më poshtë vijon:

#### Planifikimi i taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Mallakastër

Kategoria e tokës	Sip/HA	Sip/HA	Sip/HA	Sip/HA	Sip/HA	Sip/HA	Sip/HA	Sip/HA	Sip/HA	Vlera/ Ha	Plani/Lekë
	Qendër-Dukas	Nj.A. KUTË	Nj.A. HEKAL	Nj.A. NGRAÇAN	Nj.A. GRESHICË	Nj.A. ARANITAS	Nj.A. FRATAR	Nj.A. SELITË	Nj.A.		
Kategoria II	-	308	75	-	-	44	-	-	427	2,100	896,700
Kategoria III	23.57	752	1013	-	-	175	-	-	1963.57	1,400	2,748,998

Kategoria IV	424.48	305	747	41	-	374	586	297.1	2774.58	1,350	3,745,683
Kategoria V	709.51	74	12	161	285	763	481	-	2485.51	1,250	3,106,887
Kategoria VI	692.31	-	-	103	395	183	320	-	1630.31	1,200	1,956,372
Kategoria VII-X	123.89	-	-	-	20	83	152	346.93	725.82	1,100	798,402
<b>Totali sip. ha sipas planifikimit</b>	<b>1973.76</b>	<b>1439</b>	<b>1847</b>	<b>305</b>	<b>700</b>	<b>1622</b>	<b>1539</b>	<b>644</b>	<b>10006.79</b>		<b>13,253,042</b>

Sa më sipër konstatohet se në NJA Fratar, kemi keqplanifikim të taksës së tokës bujqësore, për arsye se sipërfaqja e cila përdoret për përllogaritjen e planit, është 144.6 Ha më pak, ku nëse do ta kthenim në vlerë monetare (çmimi mesatar 2,100 lekë + 1,400 lekë + 1,350 lekë + 1,250 + 1,100 lekë /5) = 208,224 lekë më pak duhet të ishte planifikimi i taksës së tokës bujqësore për NJA Fratar.

Situata e mësipërme tregon gjithashtu se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. AH.K, Administrator i NJA Fratar.*

**Kriteri:** Pika 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

**Ndikimi/Efekti:** Mos evidentimi i saktë i sipërfaqes së tokës bujqësore, çon në mos planifikimin e saktë të kësaj, duke rritur shpresat për më tepër të ardhura dhe për rrjedhojë ndikon negativisht në planifikimin e shpenzimeve të Bashkisë Mallakastër.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Sektori i tatim taksave në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore.

### **Përdorimi i të ardhurave.**

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2022 është realizuar përkatësisht në vlerën 165,025 mijë lekë, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për investime.

Përdorimi i të ardhurave – viti 2022 (000 lekë)

Nr.	Përshkrimi Shpenzimeve	Nga të ardhurat e veta
1	Paga 600	15,616
2	Sigurime shoqërore 601	2,894
3	Shp. Operat 602	18,125
4	Subvencion 603	4,000
5	Transferata per familje dhe individe 606	759
6	Investime 230-231	123,631
	<b>Totali</b>	<b>165,025</b>

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

### **III.2.3. Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

Për të arritur në opinionin, nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2022, konkretisht:

#### **Pasqyrat Financiare të vitit 2022.**

▪ Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2022 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat financiare të vitit 2022;



- Ditari i Bankës;
- Ditari i Arkës;
- Ditari i Magazinës;
- Ditari i Pagesave;
- Ditari i Veprimeve të ndryshme;
- Aktrakordimet me Degën e Thesarit Mallakastër;
- Situacionet dhe akt-marrjet në dorëzim të investimeve të kryera;
- Inventarët etj.

### **Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare.**

#### ▪ **Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2022 janë:**

- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
- Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasyrat financiare (F5);

Pasqyrat statistikore:

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);

#### ▪ Gjithashtu është dhënë informacion mbi:

Emrin e njësisë ekonomike raportuese, Bashkia Mallakastër me NIPT K47605816N; Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2022-31.12.2022;

- Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
- Përgatitur nga z. A.R;
- Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Mallakastër me shkresën nr.1581 prot., datë 31.03.2022, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër z. Q.I.

Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Aktrakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Mallakastër të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Mallakastër, si dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Mallakastër.

-Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike. Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, që e bën me risk të lart për sa i përket sigurisë në saktësinë informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

### **Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.**

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

b. Kontrolle të llogarive dhe dokumenteve.

### **Nga auditimi i disa prej llogarive të pasqyrave financiare u konstatua se:**

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”.

**Situata:** Llogaria nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2022 pasqyrohet në vlerën 61.111.859 lekë. Lëvizjet debitore dhe kreditore të kësaj llogarie përgjatë vitit 2022 pasqyrohet si më poshtë:

Levizja e llogarisë 468 Sintetike				Viti 2022		
Viti	Bashkia Mallakastër dhe NJA	Përshkrimi	Gjendja 31.12.2021	Debi	Kredi	Mbetja
2022		Debitorë të ndryshëm	60,528,690	66,831	650,000	61,111,859

Ndërkohë sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit, bazuar në të dhënat e vendosura nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, lëvizjet debitore dhe kreditore të llogarive përkatëse,

rezultoi se vlera e llogarisë nr.468 në fund të vitit 2022 është kontabilizuar më pak për vlerën **257,264,483 lekë**, si më poshtë vijon:

Emërtimi	Vlera debitoare
Qira tokë bujqësore	3,230,447
Nipt sekondar për punime ndërtimi	225,520
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	96,881,177
Institucione	11,703,580
Taksa e legalizimit	12,874,096
Biznesi vip (kompanitë e naftës)	123,121,013
Tarifa e licencimit për karburantet	1,116,730
Detyrimi i Ujësllësit për taksat dhe tarifat familjare	8,111,920
<b>Total</b>	<b>257,264,483</b>

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Situata e mësipërme ka ardhur si rrjedhojë e mosraportimit të plotë dhe të saktë të vlerës debitoare nga Drejtoria e Urbanistikës, Sektori i Tatim-Taksave, për Drejtorinë e Financës.

-Gjithashtu konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Pra pasqyrat financiare të Bashkisë Mallakastër për vitin 2022 nuk janë sipas formatit të përcaktuar pikën 10 të Udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

*Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, z.M.M, Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës, z. A.M, Përgjegjës i Sektorit të Tatim-Taksave dhe z.A.R, Drejtor i Financës.*

**Kriteri:** Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkronja “ë”, pika 3, neni 12;

Ligji nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, pika 1, neni 11.

Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c”.

Pikën 10 të Udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

**Ndikimi/Efekti:** Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë të përbërjes së debitorëve të Bashkisë Mallakastër në fund të vitit 2022. Pasqyrat financiare nuk janë sipas formatit të miratuar dhe për rrjedhojë nuk japin informacion të plotë dhe të saktë.

**Shkak:** Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.470 “Të ardhura për t’u marrë”.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimi e Llogarisë nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, vlera kontabël paraqitet në shumën 0 lekë.

**Situata:** Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Ujësllës Kanalizime Mallakastër Sh.A” me NIPT K47605804N, u konstatua se Bashkia Mallakastër zotëron 100% të aksioneve të kësaj shoqërie ose 1 aksion me vlerë nominale 1.000 lekë, në total 621,858,000 lekë.

Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Shoqëria Rajonale Ujësllës Kanalizime Fier” me NIPT M23315402G, u konstatua se Bashkia Mallakastër zotëron 5.49% të aksioneve të kësaj shoqërie ose 1 aksion me vlerë nominale 100 lekë, në total 549,000 lekë.

Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “B Sh.A” me NIPT L18407801Q, u konstatua se Bashkia Mallakastër zotëron 25% të aksioneve të kësaj shoqërie ose 1 aksion me vlerë nominale 20.000 lekë, në total 500,000 lekë.

-Pra sa më sipër llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është nënvlerësuar me **622,907,000 lekë**.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z.A.R, Drejtor i Financës.*

**Kriteri:** Urdhri i Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

VKM nr.660, datë 12.9.2007 “për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve Njësive të Qeverisjes Vendore”.

VKM nr.63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu 3.1, pika 31, shkronja “b”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2022.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”.

**Situata:** Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Mallakastër, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 59,909,224 lekë. Llogaria nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Lëvizja e kësaj llogarie përgjatë vitit 2022 pasqyrohet si më poshtë:

Llogaria 466 levizjet dhe gjendja në fund të vitit 2022				
Emertimi	Celja 01.01.2022	Kreditim	Debitim	Mbetja 31.12.2022
Kreditorë për mjete nën ruajtje	48,822,037	11,087,187	0	59,909,224

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2022, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Në mënyrë analitike, garancitë të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes, si dhe objekti për të cilën është mbajtur kjo garanci ka përfunduar, paraqiten kapitullin Anekse – Aneksi nr. 4 në Projektraportin e Auditimit.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” është mbivlerësuar për 33,059,961 lekë për vitin 2021.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z.A.R, Drejtor i Financës.*

**Kriteri:** Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”.

**Ndikimi/Efekti:** Llogaria nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2022.

**Shkaku:** Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, në bashkëpunim me Drejtorin e Urbanistikës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave i’u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.



**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 202 “Studime dhe kërkime”.

**Situata:** Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llogaria nr. 202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 60,557,883 lekë në fund të vitit 2022.

Në fund të vitit 2021 sipas formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” llogaria nr.202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në vlerën 34,761,918 lekë, dhe në fund të vitit 2022 (kosto historike) në vlerën 60,557,883 lekë, si rrjedhojë e shtesave gjatë vitit në vlerën 25,795,965 lekë.

Nga shqyrtimi i pasqyrës së aktiviteve afatgjata F7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, rezulton se nuk është kryer amortizimi i llogarisë nr.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 9,083,682 lekë (kosto historike + shtesa – pakësime \* 15%) sipas normës 15% për aktivet afatgjata jomateriale.

**Kriteri:** Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, klasa 2 “Aktivet Afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël).

**Ndikimi/Efekt:** Llogaria nr. 202 “Studime dhe Kërkime”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2022.

**Shkaku:** Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”, për vlerën 9,083,682 lekë.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 231 “Investime në proces”.

**Situata:** Llogaria nr.231 “Investime në proces”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën kontabël 213,850,186 lekë. Nga auditimi i ditarit të bankës, njoftimit të fillimeve dhe përfundimit të punimeve, faturave të mbërritura për investime dhe të palikujduara në fund të vitit 2021, konstatohet se llogaria 231 është mbivlerësuar për shumën 38,170,024 lekë, si rrjedhojë e kontabilizimit të investimeve për aktive të marra në dorëzim dhe të kapitalizuara si AQT, si më poshtë vijon:

	Emërtimi	Vlera
1	Rkonstruksion i rruges Bejar - diga e Rezervuarit	32,251,740
2	Rikonstrksion i rruges Gani Malasi Ballsh	2,197,476
3	Mbikqyrje punimesh:Rikonstrksion I rruges Gani Malasi Ballsh	48,851
4	Rikonstruksion i pjesshem i zyrave te Njesise Administrative Fratar	3,423,089
5	Mbikqyrje Objekti:Rikonstruksion i pjesshem i zyrave te Njesise Administrative Fratar	95,066
6	Mbikqyrje:Ndertim shetitore nga shkolla Odisea deri te varrezat e qytetit	153,802
	Totali	<b>38,170,024</b>

**Kriteri:** Klasa 2 “Aktivet afatgjata”<sup>18</sup> në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekt:** Llogaria nr. 231 “Investime në proces”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2022.

**Shkaku:** Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr.231 “Investime në proces” dhe llogarive nr. 213/212 sipas rastit, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitetit afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.467 “Kreditor të tjerë” me kundërparti llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

<sup>18</sup> Hyrjet e AAGJM dokumentohen: Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme). Për rrjedhim, Aktivet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”.

**Situata:** Llogaria 467 në fund të vitit 2022 paraqitet me vlerën 10,419,769 lekë. Nga auditimi i llogarisë analitike, konstatohet se nuk janë kontabilizuar detyrimet për:  
-detyrimet për shpronësim në vlerën 3,977,574 lekë.

Analitikisht pasqyruar si më poshtë vijon:

Nr	Pronari	Vlera e mbetur e palikujduar deri në 31.12.2022
1	I.H	449,920
2	V.M	1,337,106
3	V.M	1,581,750
4	V.M	608,798
Total		3,977,574

**Kriteri:** Funksionimi kontabël i llogarive të klasës 4, në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Llogaria nr. 467 “Kreditor të tjerë”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2022.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Në përfundim të merren masa për raportimin e detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”.

**Situata:** Llogaria 401-408 në fund të vitit 2022 paraqitet me vlerën 674,453 lekë. Nga shqyrtimi i llogarisë analitike për fatura të mbërritura por të palikujduara, konstatohet se në llogarinë 404 “Furnitorë për investime” nuk është kontabilizuar:

-fatura në vlerën 1,083,608 lekë, e subjektit V.K Sh.P.K, për punime në objektin “Përmirësimi i kushteve të banimit në ndërtesa, për komunitetet e pafavorizuara”.

Fatura në vlerën 4,242,352 lekë (detyrim i ngelur - 5% garanci), e subjektit G. Sh.P.K, për punime në objektin “Përmirësimi i kushteve të banimit në ndërtesa, për komunitetet e pafavorizuara”.

Për vlerat e mësipërme në PF duhet të ishin pasqyruar si detyrime, duke kredituar llogarinë 404, si dhe paralelisht duke debituar llogarinë 4342, për pjesën takuese të financimit nga MFE.

**Kriteri:** Funksionimi kontabël i llogarive të klasës 4, në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Llogaria nr. 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2022.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 404 “Furnitorë për investime”.

**Titulli i gjetjes:** Mbi inventarizimin, kontabilizimin si AQT dhe regjistrimin në kadastër të aseteve në pronësi të Bashkisë Mallakastër.

**Situata:** Si çdo institucion publik, edhe Bashkia Mallakastër, ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: Pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Mallakastër i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve, si dhe një pjesë të tyre nga shkrirja e ish komunave, aktualisht NJA të Bashkisë Mallakastër. Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Mallakastër duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin

e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit, bëhet regjistrimi i tyre në regjistrat publik të pronës dhe në kontabilitet, duke vijuar me përditësimin periodik të tyre, sa herë që ka ndryshime në statusin juridik/fizik/monetar të saj. Për kryerjen e detyrave të mësipërme Bashkia Mallakastër ka detyrimin që të krijoj ose të ngarkoj një strukturë të posaçme, e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj vetëm inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për çdo pasuri.

Të gjitha sa më sipër përcaktohen në kuadrin rregullator, si: Ligji nr. 20/2020 datë 5.3.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar; Ligji nr.111/2018 “Për Kadastrën”; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala për zbatimin e tyre.

-Sa më sipër grupi i auditimit kërkoi regjistrin e pronave, tokave dhe pasurive natyrore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Mallakastër. Gjithashtu referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Mallakastër, në mënyrë të përgjithshme përcaktohen detyrat për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve, pra nuk ka një sektor/strukturë të posaçme, për inventarizimin e pronave, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar dhe më pas regjistrimin në kadastrë.

Nga verifikimi i llogarisë 210, 211, 212 dhe 215, për pasuritë e paluajtshme të aseteve, nuk rezulton të jetë kryer plotësisht detyra e mësipërme.

Për ta ilustruar situatën e mësipërme dhe nëse është zbatuar plotësisht kuadri rregullator, kemi analizuar pasqyrimin e llogarive kontabël, përkatësisht llogarinë nr.210 “Toka, Troje, Terrene”, e cila në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën 309,970 lekë, e pa ndryshuar dhe në fund të vitit 2022, llogarisë nr.211 “Pyje, plantacione”, e cila paraqitet në vlerën 8,560,400 lekë, e pa ndryshuar dhe në fund të vitit 2022 dhe të llogarisë nr.212 “Ndërtesa e konstruksione”.

Referuar VKM të ndryshme për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme, si ndërtesa, terrene sportive, troje të ndryshme, pyje, kullota, toka bujqësore, rezulton situata si më poshtë vijon:

Vendndodhja	Nr., i pasurive <sup>19</sup>	Llogaria në PF	Evidentohet në Bilanc	Nr., i pronave të regjistruara
Bashkia Mallakastër dhe NJA	638	211 (Ekonomi Pyjore)	Jo	0
NJA Fratar	236	210 dhe 212	9 prona të NJA Fratar pasqyrohen	0
NJA Kutë	182	210 dhe 212	9 prona të NJA Fratar pasqyrohen	0
NJA Qendër	277	210 dhe 212	Pasqyrohen vetëm shkollat, zyrat e komunës, stadiumi dhe varrezat	0
Visok, Corrush, Greshic, Bejar, Gjinoqar, Cyceni, Lumar, Gadurova, Marush, Gjerbsi, Aranitas, Hekal, Kutë	18	213 (Rezervuar dhe stacione pompimi)	3 prej tyre (Corrush, Greshic, Kutë)	0
Zyra të bordit të kullimit	1	212	Jo	0
Eskavator, marka benat me goma	1	215	Jo	
Bashkia Mallakastër dhe NJA	12	210 (Terrene sportive)	2 prej tyre (Stadium dhe kalçeto)	0
<b>Total</b>				<b>0</b>

Gjithashtu, nga auditimi i pasqyrave financiare, në inventarin e aktiveve të qëndrueshme (llogaritë 212 dhe 213) janë rreth 307 pasuri të paluajtshme, nga të cilat nuk është asnjë e regjistruar në kadastrë (theksojmë këtu se edhe godina e zyrave të bashkisë nuk është e pajisur me certifikatë pronësie).

<sup>19</sup> VKM nr.31, datë 24.01.2007; VKM nr.417, datë 11.07.2007; VKM nr.71, datë 02.02.2011; VKM nr.1108, datë 30.12.2015; VKM nr.458, datë 26.07.2018

Veç sa më sipër, nga analiza e llogarisë nr.210, konstatohet se:

1. Nuk është kryer inventarizimi i tyre;
2. Objektet e kontabilizuara nuk pasqyrohen me emërtimet e tyre, por vetëm me mbishkrimin “Toka, troje dhe terrene”, pra nuk identifikohet përbërja e kësaj llogarie dhe saktësia e veprimeve kontabël;
3. Rregjistri që mbahet nga Drejtoria e Financës për këtë llogari, nuk është i plotë me informacion, pasi mungon informacioni për datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës etj.
4. Nuk është kryer kontabilizimi i trojeve të lira dhe ato të zëna me ndërtesat, që sipas rastit i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Mallakastër, nëpërmjet akteve ligjore/nënligjore. Sipas informacionit që pasqyrohet në VKM nr.1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”, i ndryshuar, sa i përket pronës së zyrave të bordit të kullimit, me sipërfaqe 148 m<sup>2</sup> ndërtim (gjurma e ndërtimit/trualli poshtë objektit 148 m<sup>2</sup>) \* 1406<sup>20</sup> lekë/m<sup>2</sup> = 208,088 lekë vlera e truallit nënobjekt që duhet të kontabilizohet në llogarinë 210. -Sa më sipër llogaria nr.210 është nënvlerësuar me vlerën **208,088 lekë**, vlerë e matshme.

-Nga analiza e llogarisë nr.211, konstatohet se:

1. Nuk është kryer inventarizimi i tyre;
2. Objektet e kontabilizuara nuk pasqyrohen me emërtimet e tyre, por vetëm me mbishkrimin “Pyje, plantacione”, pra nuk identifikohet përbërja e kësaj llogarie dhe saktësia e veprimeve kontabël;
3. Rregjistri që mbahet nga Drejtoria e Financës për këtë llogari, nuk është i plotë me informacion, pasi mungon informacioni për datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës etj.
4. Në llogarinë nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Mallakastër, të transferuara me VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, e ndryshuar, shtojca nr.25, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Mallakastër, me numër rendor nga 1 deri 638, ilustruar për:  
-Ekonominë Povel, me sipërfaqe 311.15 Ha/3.111.500 m<sup>2</sup> \* 100 lekë<sup>21</sup>/m<sup>2</sup> = 311,150,000 lekë.  
-Sa më sipër llogaria nr.211 është nënvlerësuar me vlerën **311,150,000 lekë**, vlerë e matshme.  
*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z.Q.I, Kryetar i Bashkisë Mallakastër dhe z.A.R, Drejtor i Financës.*

**Kriteri:** Nenin 35, nenin 37, nenin 41 dhe nenin 44 në Ligjin nr. 20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 6 në Ligjin nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar; Nenin 62 në Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; Nenin 9 dhe nenin 12 në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM Nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Kapitulli III, pika 30 dhe paragrafi 104 në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

<sup>20</sup> Përcaktuar në VKM nr.89, datë 03.0.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH”.

<sup>21</sup> Përcaktuar në VKM nr.89, datë 03.0.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH”.

**Ndikimi/Efekti:** Llogaritë nr. 210 “Toka, troje, terrene”, nr. 211 “Pyje Plantacione” nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione” nuk paraqesin situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2022.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me Drejtorin e Financës të planifikojë në buxhet një fond të detajuar për kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve nga ekspertë vlerësues të licencuar.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër të nxjerrë urdhër të brendshëm, për përcaktimin e afatit konkret si dhe ngritjen e një strukture të posaçme, me objekt vetëm inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për çdo pasuri.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, për:

- Kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene”, nr.211 “Pyje, kullota, plantacione” dhe nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione”.

- Hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”.

**Situata:** Gjendja e llogarisë nr.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në fund të vitit 2022, paraqitet në vlerën kontabël 61,111,859 lekë. Llogaria 4341 ”Operacione me shtetin (detyrime)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Nga analiza e llogarisë analitike, rezulton se në llogarinë 4341, janë kontabilizuar debitorët (llogaria 468) ndaj Bashkisë Mallakastër, për taksa dhe tarifa vendore, gjoba.

-Sa më sipër konstatohet se në llogarinë 4341 është bërë kontabilizim i gabuar i vlerës së debitorëve për taksa dhe tarifa vendore, gjoba. Konkretisht nga analizimi i përbërjes së debitorëve, Bashkia Mallakastër nuk ka detyrimin që t’i arkëtojë ato për llogari të buxhetit të shtetit, pasi nuk janë taksa të ndara apo Bashkia Mallakastër të veprojnë si agjent tatimor për llogari të një institucioni qendror. Në këtë rast kemi të bëjmë me taksa dhe tarifa vendore, si dhe gjoba, të cilat kalojnë direkt në buxhetin e Bashkisë Mallakastër.

-Sa më sipër llogaria nr.4341 është mbivlerësuar me vlerën 61,111,859 lekë.

**Kriteri:** Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, klasa 4 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve”.

**Ndikimi/Efekti:** Llogaria nr. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2022.

**Shkaku:** Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër të marrë masat e nevojshme, që të kryhet kontabilizimi i saktë i llogarisë nr.4341, duke pasqyruar në këtë llogari detyrime të Bashkisë Mallakastër ndaj buxhetit të shtetit.

### **III.2.4. Mbi planifikimin dhe zbatimin procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për investime në punë publike.**

#### 4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësi vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

#### 4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

-Për periudhën **01.01.2022 – 31.12.2022**, Bashkia Mallakastër referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **33** procedura prokurimi me fond limit **366,352,752 lekë pa TVSH**, me vlerë kontrate **325,880,328 lekë pa TVSH**, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **40,472,424 lekë pa TVSH**, ose 11%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2022 – 31.12.2022	Nr.	Vl.Fond Limit pa TVSH	Vl.Kontrate pa TVSH
<b>GJITHESEJ</b>	<b>33</b>	<b>366,352,752</b>	<b>325,880,328</b>
Të hapura	7	324,312,587.50	290,155,703
E hapur e thjeshtuar	8	32,460,963.50	28,434,091
Me vlerë të vogël	18	9,579,201	7,290,535
<i>Sipas objekteve</i>			
-Objekte në fushën e punëve publike	3	246,484,312	222,160,320
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	30	119,868,440	103,720,008

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **294 OE/BOE**, nga të cilat janë s'kualifikuar **136 OE/BOE**. Procedura me **1 (një) OE** janë 4 procedura, ose 12% e procedurave të zhvilluara.

#### 4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura<sup>22</sup>.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjedhi për auditim:

-Për vitin 2022, gjithësej 8 procedura me fond limit 275,745,558 lekë, ose 92% të totalit.

*Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatuan mangësi në procedurat si më poshtë vijon<sup>23</sup>:*

#### **1. “Tenderi me objekt: “Rikonstruktion i rrugëve në fshatrat Dukas, Visokë, Greshicë, Mollaj”.**

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruktion i rrugëve në fshatrat Dukas, Visokë, Greshicë, Mollaj”		
<b>1. Urdhër Prokurimi:</b> Nr.17, datë 04.07.2022	<b>2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:</b> Urdhër Prokurimi Nr.17, datë 04.07.2022 1. B.F – (Jurist-PPP) 2. M.M – (Ing.Nd.-Specialist fushe) 3. F.A – (Ekonomist-Anëtar)	<b>3. Komisioni Vlerësimi Ofertave:</b> Urdhër Nr.181, Datë 06.07.2022 1. E.B (Kryetar) 2. A.X (Anëtar) 3. N.S (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E hapur”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSH)</b> 116,565,167 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSH):</b> “S” Sh.P.K - 107,668,350 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH):</b> 8,896,817 lekë

<sup>22</sup> Observacionet e paraqitura për projekt raportin dhe qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH-së, pasqyrohen në kapitullin Anekse – Aneksi nr.5 në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

<sup>23</sup> Ndikimi, kriteri, shkaku dhe rekomandimi janë dhënë në fund të trajtimit të procedurave të prokurimit në mënyrë të përmbledhur, me qëllim eliminimin e përsëritjes.

<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> 27.07.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i Bashkisë Mallakastër	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> a) Pjesëmarrës në tender 10 OE b) S'kualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 6 OE
<b>11. Ankimime</b> Ankesë e paplotë e paraqitur vetëm në AK nga OE "SH 07" në dt.09.09.2022. Ankesa nuk është shoqëruar me dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë KPP	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK</b> Njoftim për plotësimin e ankesës nr.4414/1 prot, datë 12.09.2022 drejtuar "SH 07".	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP</b> S'ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Datë 05.10.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 129,202,020 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës</b> 20,027,813 lekë
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë/muaj</b> 7 Muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës – me ditë/muaj</b>

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara plotësisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 06.07.2022, i ndryshuar, nga NJP, nëpërmjet shtojcës nr.s'ka prot., datë 14.07.2022, si dhe procesverbali i specifikimeve teknike nga specialisti i fushës.**

**AK për ekonomik dhe financiar ka kërkuar:**

**Pika 2.2.1.** AK ka kërkuar që për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit) – Për këtë kërkesë nga NJP (përfunduar specialistin e fushës) është pasqyruar vetëm baza ligjore, pa dhënë argumentimin se si ndikon ky marzh në përmbushjen e kontratës së prokurimit. Gjithashtu përcaktimi në pikën 2.2.1 nuk është në përputhje shkronjën "b", pika 2 në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë **nuk mund të tejkalojë** vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: "Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të **argumentojnë** vlerën e kërkuar të xhiros **brenda** këtij marzhi", pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-deri në vlerën e kontratës, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 80% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3.

*Për këtë kriter mbajnë përgjegjësi B.F dhe F.A, përjashtuar anëtarin tjetër M.M, detyra e të cilit është hartimi dhe argumentimi i kriterëve për kapacitetin teknik.*

**AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:**

**2.3.1.** AK ka kërkuar përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 5 në nenin 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, përcaktohet se për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “*Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi*”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-50%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 40% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.7998 prot., datë 24.12.2021, pika 8, paragrafi 3.

**Pika 2.3.2** AK ka kërkuar që OE duhet të disponojë dhe të paraqesë licencën profesionale të shoqërise për realizimin e punimeve objekt kontrate, e cila duhet të përmbajë së paku kategoritë e mëposhtëme:

N.P-1 A, N.P-4 C, N.P-5 A, N.S-18 A – Në procesverbal nuk argumentohet dhe të pasqyrohet lloji i punimeve që do të kryhet me llojin e licencës dhe kategorinë e saj të kërkuar. Në veçanti nuk argumentohet kërkesa për licencën N.P-5 A, si dhe kërkesa për kategorinë N.P-4 C (e cila është rrjedhojë e vlerës së punimeve që kërkojnë licencën N.P 4 C), pra cilat janë zërat e punimeve në preventiv që kërkojnë disponimin e llojit të licencës N.P 4, dhe sa është vlera e tyre në preventiv që kërkohet kategoria C. Kjo analizë mungon në procesverbalin e përcaktimit të kriterëve të teknike.

**Pika 2.3.3** AK ka kërkuar që OE duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 70 (shtatëdhjetë) punonjës të siguar, për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave – Në kërkesën e mësipërme nuk përcaktohet lloji i formimit profesional për punonjësit e kërkuar, pasi OE mund të ketë 70 të punësuar me formimin profesional hidraulik, karpentier, ndërkohë këta punonjës nuk duhen për zbatimin e kontratës përkatëse, ç’ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “*Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin*”.

-Për numrin e mësipërm të punonjësve, në procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të kriterëve, nuk pasqyrohet analiza teknike, e cila shërben për vlerësimin e numrit minimal të punonjësve. Për më tepër që në kërkesën **2.3.6** është përcaktuar përsëri numri i punonjësve dhe formimi profesional që kërkohet për zbatimin e kontratës. Në pikën 2.3.6 kërkohen gjithësej 10 punonjës dhe në këto kushte kur është përcaktuar numri dhe profesioni për zbatimin e kontratës, atëherë s’ka arsye të kërkohen edhe 60 punonjës të tjerë.

Nuk argumentohet periudha prej 3 muajsh, se si ndikon në përmbushjen e kapaciteteve teknike. Për AK, sa i përket përmbushjes së kapaciteteve teknike, është e rëndësishme që në momentin kur OE merr pjesë në procedurë, të ketë numrin e nevojshëm për realizimin e kontratës. Vendosja e periudhës së mësipërme tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, por jo përmbushjen e kapaciteteve teknike.



**Pika 2.3.7.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton	Në pronësi ose me qira	5
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton	Në pronësi ose me qira	2
3	Fadromë	Në pronësi ose me qira	1
4	Grejder	Në pronësi ose me qira	2
5	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	2
6	Autopompë betoni	Në pronësi ose me qira	1
7	Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	1
8	Eskavator	Në pronësi ose me qira	4
9	Buldozer	Në pronësi ose me qira	1
10	Autobitumatriçe	Në pronësi ose me qira	1
11	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	1
12	Rimorkiator	Në pronësi ose me qira ose me kontratë bashkëpunimi	1
13	Fabrikë për prodhim asfalti	Në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi	1
14	Impiant për prodhim betoni dhe inerte	Në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi	1
15	Rrul me peshë mbi 15 ton	Në pronësi ose me qira	2
16	Rrul me peshë mbi 10 ton	Në pronësi ose me qira	2

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri dhe lloji i mjeteve që kërkohet, në përputhje me punën që do të kryejnë, volumin dhe grafikun e punimeve.

Sa më sipër është kërkuar kamion me kapacitet mbajtës mbi 18 ton (5 cop) dhe mbi 10 ton (2 cop), numër i paargumentuar me analizë teknike, si dhe për cilin qëllim do të përdoret në zbatimin e kontratës.

Janë kërkuar 4 eskavator, por në asnjë rast nuk argumentohet me analizë teknike. Pra sasia e dheut që do të gërmohet në një ditë pune (8 orë) dhe më pas në 352 orë pune gjithësej (2 muaj), për të arritur në përcaktimin e numrit të eskavatorëve.

Nuk analizohet kërkesa për fadrom dhe buldozer njëkohësisht, pasi të dy mjetet kryejnë zbankimin dhe rafshimin e dheut. Për më tepër që sipas zërave të punimeve, shoqëruar me analizë teknike, nuk parashikohet në asnjë rast përdorimi i buldozerit.

Është kërkuar rul me peshë mbi 15 ton, kërkesë e paargumentuar, për më tepër që në specifikimet teknike të projektit, është përcaktuar se rulat mund të jenë me peshë 10-12 ton.

Veç sa më sipër janë kërkuar makineri ndërtimi, por në asnjë rast nuk është kërkuar edhe disponimi i manovratorit. Mungesa e manovratorëve sjellë pamundësinë e përdorimit të mjeteve të ndërtimit dhe realizimin e punimeve të gërmimit dhe shtrimit të rrugës.

**Pika 2.3.8** kërkohet që OE ofertues duhet të ketë licencë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, Kodi III.2.B – Në preventivin e punimeve nuk ka zë pune që të kërkojë disponimin e kësaj licence. Subjekti mund të lidhë kontratë shërbimi me një subjekt tjetër që ofron shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, pa qenë e nevojshme që të kryejë vetë këtë shërbim. Gjithashtu sipas paketës fiskale të vitit 2022 Bashkia Mallakastër aplikon tarifën e grumbullimit dhe pastrimit nga mbetjet, tarifën e ndotjes, pra në kushtet kur bashkia e siguron shërbimin e pastrimit si dhe e tarifon subjektin për kohëzgjatjen e kantierit, është e panevojshme vendosja e kërkesës për disponimin e licencës së mësipërme.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi M.M, anëtar i NJP, specialisti i fushës.*

### **Vlerësimi i ofertave.**

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me nr. 181, datë 06.07.2022 është ngritur KVO i cili përbëhet nga E.B (Kryetar), A.X dhe N.S (Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 27.07.2022 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 24.08.2022 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nëpërmjet kërkesës në SPE, datë 24.08.2022, KVO i është drejtuar OE S për dorëzimin e dokumentacionit. Me shkresën nr.4189 prot., datë 26.08.2022 nga OE S është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Mallakastër. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 02.09.2022 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 10 OE/BOE, përkatësisht:*

OE "SH 07" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 82,562,400 lekë pa TVSH.

OE "2" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 114,419,500 lekë pa TVSH.

OE "A-S" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 114,383,510.08 lekë pa TVSH.  
 BOE "A" & "U" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 84,801,500 lekë pa TVSH.  
 BOE "A" & "V E" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 102,106,500 lekë pa TVSH.  
 OE "C" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 108,433,878 lekë pa TVSH.  
 OE "C.R" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 116,530,833 lekë pa TVSH.  
 BOE "K" & "C M" & "S AB" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 97,745,100 lekë pa TVSH.  
 OE "S" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 107,668,350 lekë pa TVSH.  
 BOE "SH" & "M" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 108,963,400 lekë pa TVSH.  
 -Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s'kualifikuar 4 OE/BOE, si më poshtë:

OE/BOE	Arsyet e s'kualifikimit						
1. OE "SH 07"	<p>1.OE "SH 07" shpk, me ofertë ekonomike në shumën prej 82,562,400 (tetëdhjetë e dymilion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e katërqind) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit "oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim", pasi oferta e paraqitur ka rezultuar anomalisht e ulët dhe pas korespondencës së zhvilluar dhe pas shqyrtimit të provave dhe argumentimeve të dhëna nga ofertuesi, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2, të nenit 93 të LPP. Konkretisht, ka rezultuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•Gjatë procesit të shqyrtimit të ofertave, KVO në zbatim të pikës 4, të nenit 82, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, ka konstatuar se nga përlogaritja sipas formulës së përcaktuar, rezultoi se oferta e paraqitur nga OE "SH 07" shpk, në shumën 82,562,400 (tetëdhjetë e dymilion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e katërqind) lekë pa TVSH, është anomalisht të ulët, pasi vlera e saj është më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme (Reflektuar në Procesverbalin e datës 03.08.2022 "Mbi konstatimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik (OE) "SH 07" shpk, si ofertë anomalisht e ulët").</li> <li>•Në zbatim të përcaktimeve vijuese të pikës 4, të nenit 82, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, KVO përpara se të marrë vendimin për kualifikim ose jo, i kërkoi OE "SH 07" shpk të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të cilat duhet të paraqiten me shkrim brenda 3 (tre) ditëve pune. Në vijim, KVO përgatiti shkresën me nr.3486/4 prot, datë 03.08.2022, me lëndë "Kërkesë për argumentim dhe dokumentim me prova shkresore dhe dhënien e sqarimeve për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dërguar OE "SH 07" shpk nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (SPE) dhe me shërbim postar.</li> <li>•Brenda afatit kohor të përcaktuar (3 ditë pune), me shkresën Nr.129/1 Prot, Datë 05.08.2022 "Argumentim oferte" ardhur përmes SPE, regjistruar gjithashtu edhe në protokollin hyrës të AK me nr.3486/5 regi, datë 08.08.2022, OE "SH 07" shpk ka paraqitur analizën teknike të çmimeve, fatura tatimore blerje për gjendjen e materialeve/mallrave komponent të ofertës ekonomike, si dhe ka dhënë sqarimet dhe argumentimet e veta, ku ndër të tjera, në pikën 5 të argumentimit ka deklaruar se: "... disponon gjendje bitumi për përgatitjen e asfaltit dhe të binderit...".</li> <li>•Referuar faturës elektronike nr.1855/2021, datë 24.12.2021 (bashkëlidhur argumentimit të dhënë nga "SH 07" shpk), me shitës "AL.G O" sha, rezulton "SH 07" shpk ka blerë artikullin bitum me çmim 60.83 lekë/kg.</li> <li>•Referuar analizës teknike të çmimeve të ofruara në argumentimin e dhënë nga "SH 07" shpk, rezulton se në zërin "Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm, me makineri", ndër komponentët e tjerë, e ka përlogaritur artikullin komponent bitum me çmimin 6.5 lekë/kg, ndërkohë që referuar faturës elektronike nr.1855/2021, datë 24.12.2021, me shitës "AL.G O" sha, rezulton se "SH 07" shpk e ka blerë artikullin bitum me çmim 60.83 lekë/kg, çka faktin mospërputhje të çmimit të blerjes dhe atij të deklaruar në analizë. Në bazë të llogaritjeve të bëra nga KVO, duke marrë në konsideratë çmimin e blerjes së artikullit bitum nga vet OE "SH 07" shpk, del që 1 m<sup>2</sup> "Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm, me makineri", nga 700 lekë/m<sup>2</sup> shkon në 727 lekë/m<sup>2</sup>, pra 27 lekë/m<sup>2</sup> më shumë se çmimi i dhënë në ofertë.</li> <li>Gjithashtu, rezulton se edhe në zërin "Shtresë asfaltobetonit me granil gur kave, 4 cm, me makineri", ndër komponentët e tjerë, e ka përlogaritur sërish artikullin bitum me çmimin 6.5 lekë/kg, ndërkohë që referuar faturës elektronike nr.1855/2021, datë 24.12.2021, me shitës "AL.G O" sha, rezulton se "SH 07" shpk e ka blerë artikullin bitum me çmim 60.83 lekë/kg, çka faktin mospërputhje të çmimit të blerjes dhe atij të deklaruar në analizë. Në bazë të llogaritjeve të bëra nga KVO, duke marrë në konsideratë çmimin e blerjes së artikullit bitum nga vet OE "SH 07" shpk, del që 1 m<sup>2</sup> "Shtresë asfaltobetonit me granil gur kave, 4 cm, me makineri", nga 610 lekë/m<sup>2</sup> shkon në 645 lekë/m<sup>2</sup>, pra 35 lekë/m<sup>2</sup> më shumë se çmimi i dhënë në ofertë.</li> <li>Duke u fokusuar në diferencat/çmim për zërat e mësipërm dhe duke i llogaritur për sasinë e preventivuar rezulton:             <table border="0" style="width: 100%; margin-left: 20px;"> <tr> <td>"Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm, me makineri"</td> <td style="text-align: right;">35413 m<sup>2</sup> * 27 lekë =</td> <td style="text-align: right;">956,151</td> </tr> <tr> <td>"Shtresë asfaltobetonit me granil gur kave, 6 cm, me makineri"</td> <td style="text-align: right;">35414 m<sup>2</sup> * 35 lekë =</td> <td style="text-align: right;">1,239,490</td> </tr> </table>             Nga sa shihet, rezulton se totali i ndryshimit/diferencës është 2,195,641 lekë, pra më shumë se 2% e vlerës së ofertës së dhënë nga OE "SH 07" shpk.         </li> <li>Duke parë pasaktësinë në argumentimin dhe analizën e dhënë nga OE "SH 07" shpk, KVO nuk krijon bindjen e duhur për realizimin e punimeve sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.</li> <li>•Sa i përket analizës së transportit, KVO, referuar dokumentacionit të paraqitur nga OE "SH 07" shpk, sërish nuk krijon bindjen e duhur për kalkulimin korrekt të kësaj analize, pasi përlogaritja është bërë me karburantin (naftë) e blerë sipas faturës elektronike nr.2953/2021, datë 22.11.2021 (bashkëlidhur argumentimit të dhënë nga "SH 07" shpk), me shitës "B O" sha, me çmim 133.33 lekë/litër, ndërkohë që referuar çmimit të tregtuar në tregun vendas rezulton se artikulli karburant (naftë) tregëtohet afërsisht 200 lekë/litër. Ky fakt ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e kostos së transportit dhe rrjedhimisht krijon edhe diferencë në çmimin real të ofertës së dhënë. Në vëzhgim të argumentimit të dhënë, rezulton se shoqëria nuk është shprehur se disponon gjendje karburanti (naftë) për mjetet, pasi në fakt, edhe sasia e karburantit të furizuar sipas faturës elektronike nr.2953/2021, datë 22.11.2021 është realtivisht e vogël dhe me distancë kohore të konsiderueshme nga data e zhvillimit të procedurës. Pra, me sa kuptohet, aplikimi i çmimeve koherente të karburantit (naftë) do të sjellë rritje të kostos së transportit, çka passjell rritjen e të gjitha çmimeve të dhëna në preventiv-ofertë dhe duke marrë në analizë këtë fakt, KVO nuk krijon bindjen e duhur për realizimin e punimeve sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.</li> </ul>	"Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm, me makineri"	35413 m <sup>2</sup> * 27 lekë =	956,151	"Shtresë asfaltobetonit me granil gur kave, 6 cm, me makineri"	35414 m <sup>2</sup> * 35 lekë =	1,239,490
"Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm, me makineri"	35413 m <sup>2</sup> * 27 lekë =	956,151					
"Shtresë asfaltobetonit me granil gur kave, 6 cm, me makineri"	35414 m <sup>2</sup> * 35 lekë =	1,239,490					

	<p>•Gjithashtu, referuar analizës së paraqitur, rezulton se disa prej zërave të punimeve kanë pasaktësi në rubrikën e shpenzimeve plotësuese (Sh pl 8%), pasi vlerat e dala nuk janë korrekte në bazë të përqindjes (Sh pl 8%), gjë e cila ndryshon edhe çmimin e dhënë në preventiv-ofertë dhe duke marrë në analizë këtë fakt, KVO nuk krijon bindjen e duhur për realizimin e punimeve sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.</p> <p>•Në interpretim të nenit 93 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson se barra e provës mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët dhe paraqitja e provave mbështetëse, i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar si e tillë. Argumentimi i ofertës anomalisht të ulët duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në nenin 93 të LPP, për ti dhënë garanci dhe bindje autoritetit kontraktor.</p> <p>Lidhur me sa më sipër, KVO pasi shqyrtoi informacionin, dokumentacionin dhe argumentimet e dhëna, e refuzon dhe skualifikon ofertën dhënë nga OE “SH 07” shpk si një ofertë anomalisht e ulët, pasi nuk krijoi bindjen e nevojshme për rregullsinë në të gjitha elementet e saj dhe nuk merr garancinë e duhur për realizimin e punimeve objekt prokurimi sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.</p>
<p>2. BOE “A” shpk &amp; “U” shpk</p>	<p>•Anëtari lider i “A” shpk &amp; “U” shpk, (pjesëmarrës në raportin 60%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me punët e ngjashme të mëparshme, pasi kontratat e paraqitura me objekt: 1. “Mbrojtja nga lumi i Kalasës”, me vlerë 7,535,778 lekë pa TVSH, në të cilën “A” shpk merr pjesë në raportin 80 %, me vlerë takuese 6,028,622 lekë pa TVSH; 2. “Mbingritje emergjente Argjinatura e lumit Shkumbin”, me vlerë 4,956,634 lekë pa TVSH, në të cilën “A” shpk merr pjesë në raportin 80 %, me vlerë takuese 3,965,307 lekë pa TVSH; 3. “Mbrojtja nga lumi Seman, Suk Agacaj Fier”, me vlerë 23,955,956 lekë pa TVSH, në të cilën “A” shpk merr pjesë në raportin 50 %, me vlerë takuese 11,977,978 lekë pa TVSH, nuk konsiderohen kontrata të ngjashme me kontratën objekt prokurimi. Gjithashtu, edhe në rastin sikur do të konsideroheshin të ngjashme, të treja kontratat e paraqitura nga lideri i BOE “A” shpk, nuk përmbushin asnjë prej kushteve të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës “2.3.1.”, sa i përket vlerës së kontratave të ngjashme të mëparshme, pasi kushti sipas shkronjës “a” kërkon punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, me vlerë të barazvlefshme prej 58,282,583 lekë pa TVSH, ndërsa kushti sipas shkronjës “b” kërkon “punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet, me vlerë të barazvlefshme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes prej 139,878,200 lekë pa TVSH (116,565,167 * 2 * 60%).</p> <p>Në nenin 83, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. [...]”.</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “A” shpk &amp; “U” shpk nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p> <p>•Anëtari lider i BOE “A” shpk, (pjesëmarrës në raportin 60%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.6. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me stafin mbështetës të kualifikuar, pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë murator dhe asnjë punonjës për shtrim asfalti, nderkohë që ka marrë përsipër të kryejë punimet për 60% të zërave të gjithë preventivit.</p> <p>Në nenin 83, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. [...]”.</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “A” shpk &amp; “U” shpk nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.6. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p>
<p>3. BOE “A” shpk &amp; “V E.” shpk</p>	<p>•Anëtari lider i BOE “V E.” shpk, (pjesëmarrës në raportin 65.9%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me punët e ngjashme të mëparshme, pasi kontratat e paraqitura me objekt: 1. “Rik rruga Adem Jashari”, me vlerë 21,881,633 lekë pa TVSH, në të cilën “V E.” shpk merr pjesë në raportin 94%, me vlerë takuese 20,568,735 lekë pa TVSH; 2. “Ndërtim rruga Drini”, me vlerë 29,095,000 lekë pa TVSH, nuk përmbushin asnjë prej kushteve të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës “2.3.1.”, sa i përket vlerës së kontratave të ngjashme të mëparshme, pasi kushti sipas shkronjës “a” kërkon punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, me vlerë të barazvlefshme prej 58,282,583 lekë pa TVSH, ndërsa kushti sipas shkronjës “b” kërkon “punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet, me vlerë të barazvlefshme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes prej 153,632,890 lekë pa TVSH (116,565,167 * 2 * 65.9%).</p> <p>Në nenin 83, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. [...]”.</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “A” shpk &amp; “V E.” shpk nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p> <p>•Anëtari lider i BOE “V E.” shpk, (pjesëmarrës në raportin 65.9%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.6. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me stafin mbështetës të kualifikuar, pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë punonjës për shtrim asfalti, nderkohë që ka marrë përsipër të kryejë të gjitha punimet që i përkasin zërave të preventivit për shtresat e binderit dhe asfaltit.</p> <p>Në nenin 83, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. [...]”.</p>

	<p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE "A" shpk &amp; "V E." shpk nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p>
<p>4. BOE "K" shpk, &amp; "C M" shpk &amp; "S AB" shpk</p>	<p>•Anëtarë lideri i BOE "K" shpk, (pjesëmarrës në raportin 71.15%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me punët e ngjashme të mëparshme, pasi nuk ka paraqitur punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurrohet, me vlerë të barazvlefshme prej 58,282,583 lekë pa TVSH, sipas kushtit të përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 2.3.1. Gjithashtu, lidhur me punët e ngjashme të mëparshme, BOE nuk përmbush as kushtin sipas shkronjës "b", të pikës 2.3.1, pasi nuk ka paraqitur punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurrohet, e që llogaritet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim. Konkretisht, referuar raportit (përqindjes) të pjesëmarrjes në bashkim, anëtarët e BOE duhet të plotësonin punët e ngjashme, në vlerat si më poshtë:</p> <p>"K" shpk <math>71.15\% * 116,565,167 * 2 = 165,872,232</math> lekë pa TVSH  "C M" shpk <math>17.42\% * 116,565,167 * 2 = 40,611,304</math> lekë pa TVSH  "S AB" shpk <math>11.43\% * 116,565,167 * 2 = 26,646,797</math> lekë pa TVSH</p> <p>Anëtarë lideri i BOE "K" shpk, ka paraqitur kontrata të mëparshme që konsiderohen punë të ngjashme, si më poshtë:</p> <p>-"Rikonstruksion i disa rrugëve në territorin e NjA Novoselë, Bashkia Vlorë", me vlerë 7,006,650 lekë pa TVSH;  -"Rikonstruksion rruga Taulantia...", me vlerë 12,072,290 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 71.89%, me vlerë takuese 8,678,769 lekë pa TVSH;  -"Rikonstruksion rruga Pjetër Bogdani", me vlerë 9,142,898 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 84.36%, me vlerë takuese 7,712,949 lekë pa TVSH;  -"Rikonstruksion rruga Shqipja Arbnore", me vlerë 7,273,757 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 50%, me vlerë takuese 3,636,879 lekë pa TVSH;  -"Parkim për biçikletat në qytet", me vlerë 1,710,512 lekë pa TVSH;  -"Rikonstruksion rruga Bisht Kamza", me vlerë 25,194,727 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 34.65%, me vlerë takuese 8,729,973 lekë pa TVSH;  -"Rikonstruksion rruga Bllaka", me vlerë 3,026,140 lekë pa TVSH;  -"Rikonstruksion rruga Dituria", me vlerë 3,285,649 lekë pa TVSH;  -"Rikonstruksion rrugët "Gjeneral Tetini" "Tahir Beshiri" "Vëllezërit Frashëri", me vlerë 12,197,445 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 34.24%, me vlerë takuese 4,176,405 lekë pa TVSH;  -"Rikonstruksion rruga Kodra Arapaj", me vlerë 3,500,507 lekë pa TVSH;  -"Rikonstruksion rruga Kont Urani", me vlerë 2,719,365 lekë pa TVSH;  - "Rivitalizim i qendrës administrative Luz i Vogël...", me vlerë 14,442,540 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 31.02%, me vlerë takuese 4,480,076 lekë pa TVSH;  -"Ndërtim rruga "Konferenca e Mukjes", me vlerë 11,671,982 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 49%, me vlerë takuese 5,719,271 lekë pa TVSH;  -"Rikonstruksion i rrugës Principata e Arbërit", me vlerë 23,301,978 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 34.27%, me vlerë takuese 7,985,588 lekë pa TVSH;  -"Rikonstruksion rruga Prishtina, Shkozet", me vlerë 4,673,728 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 60%, me vlerë takuese 2,804,237 lekë pa TVSH;  -"Rikualifikim i rrugës kryesore të fshatit Qerret, Kavajë", me vlerë 11,235,926 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 82.56%, me vlerë takuese 9,276,381 lekë pa TVSH;  -"Rikonstruksion rruga Sirius...", me vlerë 3,916,300 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 50%, me vlerë takuese 1,958,150 lekë pa TVSH;  -"Rikonstruksion i rrugëve Rrakull, Synej", me vlerë 1,252,700 lekë pa TVSH;  -"Rikonstruksion rruga Vesa", me vlerë 4,688,045 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 59%, me vlerë takuese 2,765,947 lekë pa TVSH;  -"Rikonstruksion rruga "Tropoja" dhe "Vojsava", me vlerë 3,688,020 lekë pa TVSH;</p> <p>Ndërsa kontratat e paraqitura me objekt "Vendosje impiante gazi në kuzhinat e kopshteve, çerdheve e shkollave", "Rikonstruksion dhe mirëmbajtje e kanaleve ujitëse Bashkia Dibër 2019", "Ndërtimi i kabinës së re Box i ri SHIM linja e furnizimit 20 kv nga Fideri A 11 N/Stacioni Rajonal dhe rrjeti TU me kabëll ABC si dhe rrjeti TU me kabëll ABC i kabinës Kenedi", "Eliminimi i rrjetit dhe kabinave 6 kv Nenstacioni Kinostudio dhe kalimi i tyre në parametra 20 kv", "Rehabilitim i kanalit ujitës Çorrush", "Ndërtim publik në hyrje të qytetit Memaliaj dhe në qendrat e fshatrave Lulzim, Qesarat, Iliras dhe Izvor", "Ndërtim i nyjeve sanitare përgjatë plazhit", "Rehabilitimi i kanalit KUL F.I", "Ndërtim i linjave shpërndarëse dhe riparime rrjeti", "Vënie në punë e rrjetit të ri të ujësjellësit në zonën e vilave Selitë dhe rikonstruksion rrjet ujesjellësi në rrugët V.Hobdari, F.Bodinaku dhe në zonën e kufizuar nga Rr.S.Delvina dhe J.Vrioni", "Ndërtim impianti klorinimi në ujësjellësat rajonal dhe vendosje matësash në depo", nuk janë kontrata të ngjashme me kontratën objekt prokurimi.</p> <p>Nga përlogaritja e kontratave të ngjashme të mëparshme, të paraqitura nga lideri i BOE "K" shpk rezulton se vlera e përgjithshme e këtyre kontratave është 94,114,168 lekë pa TVSH, ndërkohë që referuar pjesëmarrjes në BOE në raportin 71.15% , vlera e këtyre kontratave duhet të ishte 165,872,232 lekë pa TVSH, gjë e cila passjell mospërmbushjen e kërkesës së përcaktuar në DST.</p> <p>Gjithashtu, edhe anëtarët e tjerë të BOE "C M" shpk (pjesëmarrës në raportin 17.42%) dhe "S AB" shpk (pjesëmarrës në raportin 11.43%), nuk plotësojnë kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me punët e ngjashme të mëparshme, pasi vlerat e përgjithshme të kontratave të ngjashme të paraqitura nga secili prej tyre nuk kap vlerën e kërkuar në raport me pjesëmarrjen në BOE.</p> <p>Në nenin 83, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcaktohet se: "Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. [...]".</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE "K" shpk &amp; "C M" shpk &amp; "S AB" shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p> <p>•Anëtarë i BOE "C M" shpk, (pjesëmarrës në raportin 17.42%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.2. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi në licencën e shoqërisë nuk ka të përfshirë kategorinë N.S-18A, ndërkohë që kjo kategori e licencës është e domosdoshme për realizimin e punimeve që ka marrë përsipër të kryejë sipas kontratës së bashkëpunimit.</p>

	<p>•Anëtari i BOE “S AB” shpk, (pjesëmarrës në raportin 11.43%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.7. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me mjetet e kërkuara, pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nuk ka deklaruar se disponon në njërin prej formave të kërkuara asnjë kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton ose me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton, e që në ndërkohë ka marrë përsipër të kryejë punimet “Mbushje me cakëll e gur gurorë .... 10800 m<sup>3</sup> të sasisë së preventivuar” dhe “FV hekur betoni periodik ... 3.7 ton të sasisë së preventivuar”, punime të cilat janë të lidhura ngushtësisht me mjetet e kërkuara të transportit.</p> <p>Në nenin 83, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. [...]”.</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “K” shpk &amp; “C M” shpk &amp; “S AB” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.7. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p> <p>•Nga BOE “K” shpk &amp; “C M” shpk &amp; “S AB” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.8. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi asnjë prej pjesëtarëve të BOE nuk ka paraqitur dokument që të vërtetojë se është i pajisur me leje/licencë të lëshuar nga QKL/QKB, Kodë III.2.B, lidhur me transportimin e mbetjeve që kanë ndikim në mjedis.</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “K” shpk &amp; “C M” shpk &amp; “S AB” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.8. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p> <p>•Anëtari i BOE “S AB” shpk, (pjesëmarrës në raportin 11.43%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.9. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi nuk ka paraqitur “Certifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 ose ekuivalente”, certifikatë e cila përfshin natyrën e punimeve të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit.</p> <p>Në nenin 83, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. [...]”.</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “K” shpk &amp; “C M” shpk &amp; “S AB” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.9. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p>
--	---

## **Ankesa**

Në lidhje me vlerësimin e ofertave të dorëzuara, nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 03.08.2022, për shpalljen e ofertës së OE SH 07, si ofertë anomalisht e ulët, sipas formulës së përcaktuar në DST, mesatarja aritmetike e ofertave të vlefshme dhe nëse oferta e OE, është nën 85% të mesatares aritmetike.

Me shkresën nr.3486/4 prot., datë 03.08.2022, KVO i është drejtuar OE “Sh. 07”, për argumentimin e ofertës ekonomike.

Me shkresën nr.3486/5 prot., datë 08.08.2022 është dorëzuar argumentimi i ofertës së OE “Sh. 07”, si dhe në SPE më datë 05.08.2022.

Më datë 24.08.2022 në SPE është njoftuar OE për refuzimin e ofertës së tij dhe mospranimin e argumentimit të dhënë për përgatitjen e ofertës ekonomike.

Me shkresën nr.4414 prot., datë 09.09.2022 është bërë ankesë nga OE “Sh. 07” ShPK, për vlerësimin e ofertës.

-Me urdhrin nr.248, datë 12.09.2022 të titullarit të AK, është vendosur pezullimi i procedurës dhe ngritja e KSHA e cila përbëhet nga z. A.E (kryetar), z. P.K dhe z. G.B (anëtar).

-Me urdhrin nr.267, datë 29.09.2022 të titullarit të AK, është hequr pezullimi i procedurës.

-Ankesa është refuzuar të shqyrtohet për shkak të mangësive në dokumentacion, konkretisht të mandat-pagesës së tarifës së shërbimit administrativ të shqyrtimit të ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, si dhe mosadministrimit e ankesës në regjistrin e ankesave pranë KPP.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE “S” Sh.P.K, me ofertën ekonomike me vlerë 107,668,350 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 8,896,817 lekë/7.6% më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

**Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>24</sup>, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:**

24 Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

-Nuk është plotësuar pika 2.3.7, pasi sipas shtojcës 8 është deklaruar vetëm disponimi i 1 grejderi dhe jo 2 të kërkuar në DST.

-Nuk është plotësuar pika 2.3.3; 2.3.4; 2.3.5 dhe 2.3.6 në DST sa i përket respektimit të detyrimit të dorëzimit të listë-pagesës. Konkretisht listë-pagesat e dorëzuara përfshijnë periudhën deri në muajin Maj të vitit 2022, ndërkohë duhet të ishte dorëzuar edhe listë pagesa e muajit Qershor.

## **2.Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i rrugës: Diga e Rezervuarit – Anëbreg, Kutë, Corrush”.**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës: Diga e Rezervuarit – Anëbreg, Kutë, Corrush”</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi:</b> Nr.15, datë 27.06.2022	<b>2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:</b> Urdhër Prokurimi Nr.15, datë 27.06.2022 1. B.F – (Jurist-PPP <sup>25</sup> ) 2. M.M – (Ing.Nd.-Specialist fushe) 3. F.A – (Ekonomist-Anëtar)	<b>3. Komisioni Vlerësimi Ofertave:</b> Urdhër Nr.168, Datë 28.06.2022 1. E.B (Kryetar) 2. A.X (Anëtar) 3. N.S (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E hapur”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSH)</b> 98,676,442 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSH):</b> “C” Sh.P.K - 91,249,046.4 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH):</b> 7,427,395 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> 27.07.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i Bashkisë Mallakastër	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> a) Pjesëmarrës në tender 8 OE b) S’kualifikuar 3 OE c) Kualifikuar 5 OE
<b>11. Ankimime</b> AK- s’ka; APP- s’ka; KPP- s’ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> S’ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP</b> S’ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Datë 27.09.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 109,498,855.68 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës</b> 56,973,600 lekë
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë/muaj</b> 7 Muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës – me ditë/muaj</b>

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara plotësisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të vecanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të vecanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

### **Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 28.06.2022, i ndryshuar, nga NJP, nëpërmjet shtojcës nr.s’ka prot., datë 14.07.2022, si dhe procesverbali i specifikimeve teknike nga specialisti i fushës.**

#### **AK për ekonomik dhe financiar ka kërkuar:**

**Pika 2.2.1.** AK ka kërkuar që për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit) – Për këtë kërkesë nga NJP (përfshijtur specialistin e fushës) është pasqyruar vetëm baza ligjore, pa dhënë argumentimin se si ndikon ky marzh në përmbushjen e kontratës së prokurimit. Gjithashtu përcaktimi në pikën 2.2.1 nuk është në përputhje shkronjën “b”, pika 2 në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë **nuk mund të tejkalojë** vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për

<sup>25</sup> Personi përgjegjës për administrimin e procedurës së prokurimit.

vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të **argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi**”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-deri në vlerën e kontratës, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 80% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3.

*Për këtë kriter mbajnë përgjegjësi B.F dhe F.A, përjashtuar anëtarin tjetër M.M, detyra e të cilit është hartimi dhe argumentimi i kriterëve për kapacitetin teknik.*

### **AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:**

**2.3.1.** AK ka kërkuar përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a.Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b.Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 5 në nenin 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, përcaktohet se për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “*Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi*”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-50%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 40% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.7998 prot., datë 24.12.2021, pika 8, paragrafi 3.

**Pika 2.3.2** AK ka kërkuar që OE duhet të disponojë dhe të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve objekt kontrate, e cila duhet të përmbajë së paku kategoritë e mëposhtëme:

N.P-1 A, N.P-4 C, N.P-5 A, N.S-18 A – Në procesverbal nuk argumentohet dhe të pasqyrohet lloji i punimeve që do të kryhet me llojin e licencës dhe kategorinë e saj të kërkuar. Në veçanti nuk argumentohet kërkesa për licencën N.P-5 A, si dhe kërkesa për kategorinë N.P-4 C (e cila është rrjedhojë e vlerës së punimeve që kërkojnë licencën N.P 4 C), pra cilat janë zërat e punimeve në preventiv që kërkojnë disponimin e llojit të licencës N.P 4, dhe sa është vlera e tyre në preventiv që kërkohet kategoria C. Kjo analizë mungon në procesverbalin e përcaktimit të kriterëve të teknike.

**Pika 2.3.3** AK ka kërkuar që OE duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 70 (shtatëdhjetë) punonjës të siguar, për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave – Në kërkesën e mësipërme nuk përcaktohet lloji i formimit profesional për punonjësit e kërkuar, pasi OE mund të ketë 70 të punësuar me formimin profesional teknik hidraulik, karpentier, ndërkohë këta punonjës nuk duhen për zbatimin e kontratës përkatëse, ç’ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “*Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin*”.

-Për numrin e mësipërm të punonjësve, në procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të kriterëve, nuk pasqyrohet analiza teknike, e cila shërben për vlerësimin e numrit minimal të punonjësve. Për më tepër që në kërkesën 2.3.6 është përcaktuar përsëri numri i punonjësve dhe formimi profesional që kërkohet për zbatimin e kontratës. Në pikën 2.3.6 kërkohen gjithësej 10 punonjës dhe në këto kushte kur është përcaktuar numri dhe profesioni për zbatimin e kontratës, atëherë s'ka arsye të kërkohen edhe 60 punonjës të tjerë.

Nuk argumentohet periudha prej 3 muajsh, se si ndikon në përmbushjen e kapaciteteve teknike. Për AK, sa i përket përmbushjes së kapaciteteve teknike, është e rëndësishme që në momentin kur OE merrë pjesë në procedurë, të ketë numrin e nevojshëm për realizimin e kontratës. Vendosija e periudhës së mësipërme tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, por jo përmbushjen e kapaciteteve teknike.

**Pika 2.3.7.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton	Në pronësi ose me qira	5
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton	Në pronësi ose me qira	2
3	Fadromë	Në pronësi ose me qira	1
4	Grejder	Në pronësi ose me qira	2
5	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	2
6	Autopompë betoni	Në pronësi ose me qira	1
7	Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	1
8	Eskavator	Në pronësi ose me qira	4
9	Buldozer	Në pronësi ose me qira	1
10	Autobitumatriçe	Në pronësi ose me qira	1
11	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	1
12	Rimorkiator	Në pronësi ose me qira ose me kontratë bashkëpunimi	1
13	Fabrikë për prodhim asfalti	Në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi	1
14	Impiant për prodhim betoni dhe inerte	Në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi	1
15	Rrul me peshë mbi 15 ton	Në pronësi ose me qira	2
16	Rrul me peshë mbi 10 ton	Në pronësi ose me qira	2

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri dhe lloji i mjeteve që kërkohet, në përputhje me punën që do të kryejnë, volumin dhe grafikun e punimeve.

Sa më sipër është kërkuar kamion me kapacitet mbajtës mbi 18 ton (5 cop) dhe mbi 10 ton (2 cop), numër i paargumentuar me analizë teknike, si dhe për cilin qëllim do të përdoret në zbatimin e kontratës.

Janë kërkuar 4 eskavator, por në asnjë rast nuk argumentohet me analizë teknike. Pra sasia e dheut që do të gërmohet në një ditë pune (8 orë) dhe më pas në 352 orë pune gjithësej (2 muaj), për të arritur në përcaktimin e numrit të eskavatorëve.

Nuk analizohet kërkesa për fadrom dhe buldozer njëkohësisht, pasi të dy mjetet kryejnë zbankimin dhe rafshimin e dheut. Për më tepër që sipas zërave të punimeve, shoqëruar me analizë teknike, nuk parashikohet në asnjë rast përdorimi i buldozerit.

Është kërkuar rul me peshë mbi 15 ton, kërkesë e paargumentuar, për më tepër që në specifikimet teknike të projektit, është përcaktuar se rulat mund të jenë me peshë 10-12 ton.

Veç sa më sipër janë kërkuar makineri ndërtimi, por në asnjë rast nuk është kërkuar edhe disponimi i manovratorit. Mungesa e manovratorëve sjellë pamundësinë e përdorimit të mjeteve të ndërtimit dhe realizimin e punimeve të gërmimit dhe shtrimit të rrugës.

**Pika 2.3.8** kërkohet që OE ofertues duhet të ketë licencë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, Kodi III.2.B – Në preventivin e punimeve nuk ka zë pune që të kërkojë disponimin e kësaj licence. Subjekti mund të lidhë kontratë shërbimi me një subjekt tjetër që ofron shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, pa qenë e nevojshme që të kryejë vetë këtë shërbim. Gjithashtu sipas paketës fiskale të vitit 2022 Bashkia Mallakastër aplikon tarifën e grumbullimit dhe pastrimit nga mbetjet, tarifën e ndotjes, pra në kushtet kur bashkia e siguron shërbimin e pastrimit si dhe e tarifon subjektin për kohëzgjatjen e kantierit, është e panevojshme vendosja e kërkesës për disponimin e licencës së mësipërme.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi M.M, anëtar i NJP, specialisti i fushës.*



## Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me nr. 168, datë 28.06.2022 është ngritur KVO i cili përbëhet nga E.B (Kryetar), A.X dhe N.S (Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 27.07.2022 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 16.08.2022 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nëpërmjet kërkesës në SPE, datë 16.08.2022, KVO i është drejtuar OE C për dorëzimin e dokumentacionit. Me shkresën nr.4082 prot., datë 18.08.2022 nga OE C është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Mallakastër. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 24.08.2022 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 8 OE, përkatësisht:*

1. BOE "M" & "SH" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 93,896,576 lekë pa TVSH.
2. OE "2" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 96,143,225 lekë pa TVSH.
3. OE "A" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 92,976,452.74 lekë pa TVSH.
4. BOE "A" & "U" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 69,949,275 lekë pa TVSH.
5. OE "C" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 91,249,046.4 lekë pa TVSH.
6. OE "C R 2008" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 98,645,367 lekë pa TVSH.
7. BOE "G.K M" & "SH 07" & "F" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 63,928,525 lekë pa TVSH.
8. BOE "K" & "C M" & "S" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 76,036,365 lekë pa TVSH.

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s'kualifikuar 3 OE/BOE, si më poshtë:

OE/BOE	Arsye e s'kualifikimit
1. BOE "a" Sh.P.K, & "u" Sh.P.K	<p>• Anëtar i lider i BOE "A" Sh.P.K, (pjesëmarrës në raportin 70%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me punët e ngjashme të mëparshme, pasi kontratat e paraqitura me objekt: 1. "Mbrojtja nga lumi i Kalasës", me vlerë 7,535,778 lekë pa TVSH, në të cilën "A" Sh.P.K merr pjesë në raportin 80 %, me vlerë takuese 6,028,622 lekë pa TVSH; 2. "Mbingritje emergjente Argjinatura e lumit Shkumbin", me vlerë 4,956,634 lekë pa TVSH, në të cilën "A" Sh.P.K merr pjesë në raportin 80 %, me vlerë takuese 3,965,307 lekë pa TVSH; 3. "Mbrojtja nga lumi Seman, Suk Agacaj Fier", me vlerë 23,955,956 lekë pa TVSH, në të cilën "A" Sh.P.K merr pjesë në raportin 50 %, me vlerë takuese 11,977,978 lekë pa TVSH, nuk konsiderohen kontrata të ngjashme me kontratën objekt prokurimi. Gjithashtu, edhe në rastin sikur do të konsideroheshin të ngjashme, të treja kontratat e paraqitura nga lideri i BOE "A" Sh.P.K, nuk përmbushin asnjë prej kushteve të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës "2.3.1.", sa i përket vlerës së kontratave të ngjashme të mëparshme, pasi kushti sipas shkronjës "a" kërkon punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, me vlerë të barazvlefshme prej 49,338,221 lekë pa TVSH, ndërsa kushti sipas shkronjës "b" kërkon "punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, me vlerë të barazvlefshme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes prej 138,147,018 lekë pa TVSH (98,676,442 * 2 * 70%).</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE "A" Sh.P.K &amp; "U" Sh.P.K nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p> <p>• Anëtar i lider i BOE "A" Sh.P.K, (pjesëmarrës në raportin 70%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.6. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me stafin mbështetës të kualifikuar, pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë murator dhe asnjë punonjës për shtrim asfalti, nderkohë që ka marrë përsipër të kryejë punimet për 70% të zërave të gjithë preventivit.</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE "A" Sh.P.K &amp; "U" Sh.P.K nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.6. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p>
2. BOE "G.K M" Sh.P.K, & "SH 07" Sh.P.K, & "F" Sh.P.K	<p>• Anëtar i BOE "G.K M" Sh.P.K, (pjesëmarrës në raportin 25%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.2. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi në licencën e shoqërisë nuk ka të përfshirë kategorinë N.S-18A, ndërkohë që kjo kategori e licencës është e domosdoshme për realizimin e punimeve që ka marrë përsipër të kryejë sipas kontratës së bashkëpunimit (preventiv ndarje midis BOE).</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE "G.K M" Sh.P.K &amp; "SH 07" Sh.P.K &amp; "F" Sh.P.K nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.2. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p> <p>• Anëtar i lider i BOE "SH 07" Sh.P.K, (pjesëmarrës në raportin 61%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.3. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me numrin mesatar të personave të punësuar për tre muajt e fundit, pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezulton se "SH 07" Sh.P.K ka deklaruar 40 punonjës, ndërkohë që referuar pjesëmarrjes në BOE duhet të deklaronte 43 punonjës (70*61%).</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE "G.K" Sh.P.K &amp; "SH 07" Sh.P.K &amp; "F" Sh.P.K nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.3. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p> <p>• Anëtar i lider i BOE "SH 07" Sh.P.K, (pjesëmarrës në raportin 61%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.4. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me stafin e drejtuesve teknik të kërkuar, pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit</p>

	<p>rezulton se “SH 07” Sh.P.K nuk ka deklaruar asnjë drejtues teknik sipas formimit dhe profileve të kërkuara në DST, ndërkohë që ka marrë përsipër 61% të punimeve.</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “G.K M” Sh.P.K &amp; “SH 07” Sh.P.K &amp; “F” Sh.P.K nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.4. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p> <p>•Nga BOE “G.K M” Sh.P.K &amp; “SH 07” Sh.P.K &amp; “F” Sh.P.K, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.6. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me stafin mbështetës të kualifikuar, pasi: (i) Referuar Formularëve Përmbledhës të Vetëdeklarimit, rezulton se asnjë prej anëtarëve të BOE nuk ka deklaruar se ka të punësuar 1 teknik topograf; (ii) Referuar Formularëve Përmbledhës të Vetëdeklarimit të anëtarëve të BOE “G.K M” Sh.P.K dhe “F” Sh.P.K, rezulton se asnjë prej tyre nuk ka deklaruar se ka të punësuar 2 muratorë, ndërkohë që referuar punimeve që kanë marrë përsipër të kryejnë sipas kontratës së bashkëpunimit, për kategorinë 3, Veprat e Artit (preventiv ndarje midis BOE) është i nevojshëm disponimi i muratorëve; (iii) Referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të liderit të BOE “SH 07” Sh.P.K, rezulton se ka deklaruar vetëm 1 punonjës për shtrim asfalti, ndërkohë që referuar punimeve që ka marrë përsipër të kryejë (sipas preventiv ndarje midis BOE), ka peshën më të madhe në zërat “shtresë binderi...” dhe “shtresë asfaltbetoni...” që korespondojnë me rreth 90% të peshës/volumit të përgjithshëm të këtyre zërave, dhe që referuar pjesëmarrjes në bashkim (në raportin 61%), minimalisht duhet të kishte dhe deklaruar të punonjës për shtrim asfalti.</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “G.K M” Sh.P.K &amp; “SH 07” Sh.P.K &amp; “F” Sh.P.K nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.6. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p> <p>•Nga anëtarët e BOE “G.K M” Sh.P.K &amp; “F” Sh.P.K, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.8. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se asnjë prej tyre nuk është i pajisur me leje/licencë të lëshuar nga QKL/QKB, Kodi III.2.B, lidhur me transportimin e mbetjeve që kanë ndikim në mjedis, ndërkohë që referuar natyrës së punimeve që kanë marrë përsipër të kryejnë sipas kontratës së bashkëpunimit (preventiv ndarje midis BOE), duhej të ishin të pajisur me këtë leje/licencë.</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “G.K M” Sh.P.K &amp; “SH 07” Sh.P.K &amp; “F” Sh.P.K nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.8. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p>
<p>3. BOE “K” Sh.P.K &amp; “C M” Sh.P.K &amp; “S AB” Sh.P.K</p>	<p>•Anëtar i lider i BOE “K” Sh.P.K, (pjesëmarrës në raportin 68.23%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me punët e ngjashme të mëparshme, pasi nuk ka paraqitur punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritit të kontratës që prokurohet, me vlerë të barazvlefshme prej 49,338,221 lekë pa TVSH, sipas kushtit të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2.3.1. Gjithashtu, lidhur me punët e ngjashme të mëparshme, BOE nuk përmbush as kushtin sipas shkronjës “b”, të pikës 2.3.1, pasi nuk ka paraqitur punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limitit e kontratës që prokurohet, e që llogaritet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim. Konkretisht, referuar raportit (përqindjes) të pjesëmarrjes në bashkim, anëtarët e BOE duhet të plotësonin punët e ngjashme, në vlerat si më poshtë:</p> <p>“K” Sh.P.K <math>68.23\% * 98,676,442 * 2 = 134,653,872</math> lekë pa TVSH  “C M” Sh.P.K <math>20.34\% * 98,676,442 * 2 = 40,141,576</math> lekë pa TVSH  “S AB” Sh.P.K <math>11.43\% * 98,676,442 * 2 = 22,557,434</math> lekë pa TVSH</p> <p>Anëtar i lider i BOE “K” Sh.P.K, ka paraqitur kontrata të mëparshme që konsiderohen punë të ngjashme, si më poshtë:</p> <p>–“Rikonstruksion i disa rrugëve në territorin e NjA Novoselë, Bashkia Vlorë”, me vlerë 7,006,650 lekë pa TVSH;  –“Rikonstruksion rruga Taulantia...”, me vlerë 12,072,290 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 71.89%, me vlerë takuese 8,678,769 lekë pa TVSH;  –“Rikonstruksion rruga Pjetër Bogdani”, me vlerë 9,142,898 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 84.36%, me vlerë takuese 7,712,949 lekë pa TVSH;  –“Rikonstruksion rruga Shqipja Arbnore”, me vlerë 7,273,757 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 50%, me vlerë takuese 3,636,879 lekë pa TVSH;  –“Parkim për biçikletat në qytet”, me vlerë 1,710,512 lekë pa TVSH;  –“Rikonstruksion rruga Bisht Kamza”, me vlerë 25,194,727 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 34.65%, me vlerë takuese 8,729,973 lekë pa TVSH;  –“Rikonstruksion rruga Bllaka”, me vlerë 3,026,140 lekë pa TVSH;  –“Rikonstruksion rruga Dituria”, me vlerë 3,285,649 lekë pa TVSH;  –“Rikonstruksion rrugët “Gjeneral Tetini” “Tahir Beshiri” “Vëllezërit Frashëri”, me vlerë 12,197,445 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 34.24%, me vlerë takuese 4,176,405 lekë pa TVSH;  –“Rikonstruksion rruga Kodra Arapaj”, me vlerë 3,500,507 lekë pa TVSH;  –“Rikonstruksion rruga Kont Urani”, me vlerë 2,719,365 lekë pa TVSH;  –“Rivitaizim i qendrës administrative Luz i Vogël...”, me vlerë 14,442,540 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 31.02%, me vlerë takuese 4,480,076 lekë pa TVSH;  –“Ndërtimi rruga “Konferenca e Mukjes”, me vlerë 11,671,982 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 49%, me vlerë takuese 5,719,271 lekë pa TVSH;  –“Rikonstruksion i rrugës Principata e Arbërit”, me vlerë 23,301,978 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 34.27%, me vlerë takuese 7,985,588 lekë pa TVSH;  –“Rikonstruksion rruga Prishtina, Shkozë”, me vlerë 4,673,728 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 60%, me vlerë takuese 2,804,237 lekë pa TVSH;  –“Rikualifikim i rrugës kryesore të fshatit Qerret, Kavajë”, me vlerë 11,235,926 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 82.56%, me vlerë takuese 9,276,381 lekë pa TVSH;  –“Rikonstruksion rruga Sirius...”, me vlerë 3,916,300 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 50%, me vlerë takuese 1,958,150 lekë pa TVSH;  –“Rikonstruksion i rrugëve Rrakull, Synej”, me vlerë 1,252,700 lekë pa TVSH;  –“Rikonstruksion rruga Vesa”, me vlerë 4,688,045 lekë pa TVSH, në të cilën merr pjesë në raportin 59%, me vlerë takuese 2,765,947 lekë pa TVSH;  –“Rikonstruksion rruga “Tropoja” dhe “Vojsava”, me vlerë 3,688,020 lekë pa TVSH;</p> <p>Ndërsa kontratat e paraqitura me objekt “Vendosje impiante gazi në kuzhinat e kopshteve, çerdheve e shkollave”, “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje e kanaleve ujitëse Bashkia Dibër 2019”, “Ndërtimi i kabinës së re Box i ri SHIM linja e furnizimit 20 kv nga Fideri A 11 N/Stacioni Rajonal dhe rrjeti TU me kabllë ABC si dhe rrjeti TU me kabllë ABC i kabinës Kenedi”, “Eliminimi i rrjetit dhe kabinave 6 kv Nenstacioni Kinostudio dhe kalimi i tyre në</p>

	<p>parametra 20 kv”, “Rehabilitimi i kanalit ujëtës Çorrush”, “Ndriçim publik në hyrje të qytetit Memaliaj dhe në qendrat e fshatrave Lulzim, Qesarat, Iliras dhe Izvor”, “Ndërtim i nyjeve sanitare përgjatë plazhit”, “Rehabilitimi i kanalit KUL F.I”, “Ndërtim i linjave shpërndarëse dhe riparime rrjeti”, “Vënie në punë e rrjetit të ri të ujësjellësit në zonën e vilave Selitë dhe rikonstruksion rrjetit ujësjellësi në rrugët V.Hobdari, F.Bodinaku dhe në zonën e kufizuar nga Rr.S.Delvina dhe J.Vrioni”, “Ndërtim impianti klorinimi në ujësjellësat rajonal dhe vendosje matësash në depo”, nuk janë kontrata të ngjashme me kontratën objekt prokurimi.</p> <p>Nga përllogaritja e kontratave të ngjashme të mëparshme, të paraqitura nga lideri i BOE “K.” Sh.P.K rezulton se vlera e përgjithshme e këtyre kontratave është 94,114,168 lekë pa TVSH, ndërkohë që referuar pjesëmarrjes në BOE në raportin 68.23%, vlera e këtyre kontratave duhet të ishte 134,653,872 lekë pa TVSH, gjë e cila passjell mospërbushjen e kërkesës së përcaktuar në DST.</p> <p>Gjithashtu, edhe anëtarët e tjerë të BOE “C M” Sh.P.K (pjesëmarrës në raportin 20.34%) dhe “S AB” Sh.P.K (pjesëmarrës në raportin 11.43%), nuk plotësojnë kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me punët e ngjashme të mëparshme, pasi vlerat e përgjithshme të kontratave të ngjashme të paraqitura nga secili prej tyre nuk kap vlerën e kërkuar në raport me pjesëmarrjen në BOE.</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “K” Sh.P.K &amp; “C M” Sh.P.K &amp; “S AB” Sh.P.K, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•Anëtar i BOE “C M” Sh.P.K, (pjesëmarrës në raportin 20.34%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.2. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi në licencën e shoqërisë nuk ka të përfshirë kategorinë N.S-18A, ndërkohë që kjo kategori e licencës është e domosdoshme për realizimin e punimeve që ka marrë përsipër të kryejë sipas kontratës së bashkëpunimit.</li> <li>•Anëtar i BOE “S AB” Sh.P.K, (pjesëmarrës në raportin 11.43%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.7. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me mjetet e kërkuara, pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nuk ka deklaruar se disponon në njërin prej formave të kërkuara asnjë kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton ose me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton, e që në ndërkohë ka marrë përsipër të kryejë punimet “Mbushje me cakëll e gur gurorë .... 5510 m3 të sasisë së preventivuar”, “Shtresë stabilizant ... 3242.5 m2 të sasisë së preventivuar”, “Shtresë stabilizant ... 12427.5 m2 të sasisë së preventivuar”, etj, punime të cilat janë të lidhura ngushtësisht me mjetet e kërkuara të transportit.</li> </ul> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “K” Sh.P.K &amp; “C M” Sh.P.K &amp; “S AB” Sh.P.K, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.7. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•Nga BOE “K” Sh.P.K &amp; “C M” Sh.P.K &amp; “S AB” Sh.P.K, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.8. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi asnjë prej pjesëtarëve të BOE nuk ka paraqitur dokument që të vërtetojë se është i pajisur me leje/licencë të lëshuar nga QKL/QKB, Kodi III.2.B, lidhur me transportimin e mbetjeve që kanë ndikim në mjedis.</li> </ul> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “K” Sh.P.K &amp; “C M” Sh.P.K &amp; “S AB” Sh.P.K, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.8. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•Anëtar i BOE “S AB” Sh.P.K, (pjesëmarrës në raportin 11.43%), nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.9. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi nuk ka paraqitur “Certifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 ose ekuivalente”, certifikatë e cila përfshin natyrën e punimeve të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit.</li> </ul> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “K” Sh.P.K &amp; “C M” Sh.P.K &amp; “S AB” Sh.P.K, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.9. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.</p>
--	--

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE C. Sh.P.K, me ofertën ekonomike me vlerë 91,249,046 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 7,427,395 lekë/7.5% më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

### **Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>26</sup>, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:**

-Nuk është plotësuar **pika 2.3.1 e DST**, lidhur me dorëzimin e dokumentacionit për punë të ngjashme. OE shpallur fitues ka dorëzuar kontratë për punë të ngjashme të lidhur me Autoritetin Rrugor Shqiptar, bashkëlidhur së cilës është formulari i vlerësimit, akt-kolaudimi, situacion përfundimtar, por jo edhe certifikatën e marrjes në dorëzim (të përkohëshme/përfundimtare).

-Nuk është plotësuar **pika 2.3.7 e DST**, dokumentacioni për kamion mbi 18 ton. Konkretisht janë kërkuar 5 kamiona me kapacitet mbajtës mbi 18 ton. OE shpallur fitues ka deklaruar disponimin e 5 kamionave, ndër të cilët është edhe kamioni me targë TP1768B, të cilit i ka përfunduar afati i vlefshmërisë së kontrollit teknik më datë 04.08.2022, periudhë në të cilën KVO ka qenë duke bërë vlerësimin e ofertave. Në referim të DST, dokumentacioni i mjeteve do të dorëzohet nga OE i suksesshëm, për vërtetimin e deklaratave të dhëna në shtojcën 8.

<sup>26</sup> Për përbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

Dokumentacioni është dorëzuar më datë 16.08.2022 dhe nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 24.08.2022, për verifikimin e saktësisë dhe plotësisë të dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues në përputhje me deklaratat e dhëna. Në këtë procesverbal është vendosur se OE duhet të shpallet fitues dhe për këtë duhet të përgatitet njoftimi paraprak i fituesit.

### **3. Tenderi me objekt: “Blerje materiale të ndryshme, çakull, stabilizant dhe rërë bituminoze, për mirëmbajtje rrugësh”.**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale të ndryshme, çakull, stabilizant dhe rërë bituminoze, për mirëmbajtje rrugësh”</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi:</b> Nr.06, datë 29.04.2022	<b>2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:</b> Urdhër Prokurimi Nr.06, datë 29.04.2022 1. B.F – (Jurist-PPP) 2. M.M – (Ing.Nd.-Specialist fushe) 3. F.A – (Ekonomist-Anëtar)	<b>3. Komisioni Vlerësimi Ofertave:</b> Urdhër Nr.107, Datë 04.05.2022 1. E.B (Kryetar) 2. A.X (Anëtar) 3. L.S (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E hapur”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSH)</b> 31,666,273 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSH):</b> “E.K” Shpk- 24,990,890 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH):</b> 6,675,383 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> 20.05.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallkastër	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) S'kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 3 OE
<b>11. Ankimime</b> AK- s'ka; APP- s'ka; KPP- s'ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> S'ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP</b> S'ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> NSHP dt.27.06.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> NSHP – 29,989,068 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës</b> Po
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë/muaj</b> 3 Muaj – marrë në dorëzim brenda afatit	<b>19. Zgjatja e kontratës – me ditë/muaj</b>

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e dokumentimit dhe argumentimit të fondit limit, vendosja e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara plotësisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se përlllogaritja e fondit limit nuk është argumentuar dhe dokumentuar plotësisht, si dhe në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

#### **Preventivi**

Fondi limit, afati i lëvrimit dhe specifikimet teknike, janë hartuar nga komisioni i posaçëm ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Mallkastër nr.19, datë 21.04.2022, me përbërje si vijon: A.S (Inxhinier ndërtimi), F.B (Teknik i mesëm) dhe K.S (Teknik i mesëm). Mallrat e kërkuar nga Ndërmarrja Komunale, Bashkia Mallkastër, institucion në varësi të Bashkisë Mallkastër, janë:

- Çakull gurore
- Stabilizant
- Rërë bituminoze

-Nga komisioni i mësipërm, është mbajtur akti-teknik me shkresën nr.58/1 prot., datë 27.04.2022, mbi përlllogaritjen e fondit limit, afatin e lëvrimit dhe specifikimet teknike.

Fondi limit është përlllogaritur duke nxjerrë koston e materialeve të ndërtimit + kosto transporti. Për çmimin për njësi të materialeve çakull gurore dhe stabilizant i është referuar çmimit të përcaktuar në manualin e ndërtimit.

Për koston e transportit për dy materialet e mësipërme, është marrë në konsideratë pika më e afërt e inerteve në distancën 6 km nga dy vendgrumbullimet e materialeve të ndërtimit, duke marrë çmimin që është 356.8 lekë m<sup>3</sup> deri në 6 km.

Për çmimin për njësi për materialin rërë bituminoze janë marrë 3 oferta nga 3 subjekte të ndryshëm.

Për koston e transportit për rërë bituminoze është marrë distanca e subjektit me ofertën më të ulët për rërën bituminoze, duke kryer analizën teknike përkatëse.

-Sa më sipër konstatohet se për përcaktimin e çmimit të transportit për m<sup>3</sup> material ndërtimi, komisioni nuk ka testuar tregun duke marrë 2 ose më shumë oferta, me qëllim nxjerrjen e mesatares së çmimit të transportit për m<sup>3</sup>, për të përcaktuar çmim sa më real. Në argumentimin e komisionit se ka marrë distancën më të afërt të pikës së inerteve, nuk pasqyrohet emri i pikës së inerteve dhe vendndodhja e saj në raport me 2 vendgrumbullimet, si dhe nuk ka mbështetje ligjore për përzgjedhjen e këtij çmimi, pasi edhe në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është vendosur që pika e inerteve të jetë një një distancë jo më të madhe se 6 km.

-Është vepruar me dy standarde, pasi për materialet çakull dhe stabilizant, çmimi i transportit është llogaritur për distancën deri në 6 km, ndërsa për rërë bituminoze është përllogaritur duke marrë distancën e subjektit që ka dhënë ofertën më të ulët gjatë testimit të tregut për përllogaritjen e fondit limit, ndërkohë që të tre ofertuesit në asnjë rast nuk janë ftuar që të ofrojnë edhe çmimin e transportit të materialeve të ndërtimit, me qëllim që çmimi i transportit t'i referohet subjektit me ofertën më të ulët/mesatarizimit të ofertave.

-Në rastin e mësipërm, në kushtet e mungesës së përcaktimit të distancës maksimale në DST, komisioni duhet t'i ishte referuar mesatares së çmimit të transportit të përcaktuar në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre.

Përshkrimi	Njësia	Çmimi
Transport materiale ndërtim, dheu me auto deri 1.0 km	m3	106
Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 2.0 km	m3	191
Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3.0 km	m3	255
Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 4.0 km	m3	297
Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	319
Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 6.0 km	m3	357
Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 7.0 km	m3	431
Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 8.0 km	m3	425
Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 9.0 km	m3	440
Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	467

-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 12, pikën 4 të nenit 13, shkronjat “a-ç” në pikën 1 dhe pikën 2 në nenin 76 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, A.S (Inxhinier ndërtimi), F.B (Teknik i mesëm) dhe K.S (Teknik i mesëm).*

### **Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 04.05.2022, nga NJP, nga specialisti i fushës më datë 04.05.2022, i ndryshuar.**

#### **AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:**

**Pika 3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës - Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 4 në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, përcaktohet se për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të **argumentojnë** vlerën e kërkuar të xhiros **brenda** këtij

marzhi”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-40%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 30% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.7998 prot., datë 24.12.2021, pika 8, paragrafi 3.

**Pika 3.1** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht:

- 4 (katër) Eskavatoristë, për të cilët duhet të paraqiten kontratat përkatëse të punës (të vlefshme), dëshmitë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR - Në proces verbalin përkatës nuk argumentohet me analizë teknike numri i eskavatoristëve. Cili është kapaciteti ngritës i eskavatorit, sa peshë mund të ngarkojë në një kamion në ditë, duke arritur në përfundimin se për ngarkimin e 10 kamionave me 360 ton në ditë material, duhen 4 eskavator. Kjo analizë mungon në procesverbalin përkatës. Gjithashtu nuk është lënë mundësia që shërbimi i manovratorëve të mësipërm të jetë i kontraktuar me qira, pa qenë e nevojshme të figurojnë të punësuar pranë OE.

- I njëjti arsyetim vlenë edhe për numrin e 10 shoferave.

Në kushtet kur është lënë mundësia që mjetet e transportit dhe eskavatorët të disponohen edhe me qira, atëherë duhet të ishte lënë mundësia që shërbimi i drejtimit të kamionave dhe eskavatorëve të jetë edhe me qira.

*Theksojmë se kërkesa e mësipërme është kërkuar që të modifikohet edhe nga APP nëpërmjet email-it drejtuar z. B.F, personi përgjegjës për administrimin e procedurës së prokurimit. Ky email i është përcjellë specialistit të fushës z.M.M, anëtar i NJP, për njohje dhe veprim.*

**Pika 3.5.** Me qëllim realizimin e objektit të kontratës, Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me qira:

- minimalisht 4 (katër) eskavatorë – Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet me analizë teknike numri i eskavatorëve.

- minimalisht 10 (dhjetë) kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton – Argumenti teknik i bërë për numrin e kamionave, nuk është i saktë. Konkretisht, janë gjithësej 30,000 ton materiale ndërtimi të cilat duhet të lëvrohen për 66 (22 ditë pune/1 muaj \* 3 muaj) ditë pune. Janë kërkuar 10 kamiona me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton, ku secili kamion në ditë të bëjë 2 rrugë me ngarkesë, pra 1 kamion do të transportojë 36 ton materiale ndërtimi në ditë, ose 10 kamiona do të transportojnë 360 ton në ditë materiale, ose 23,760 ton materiale ndërtimi për 3 muaj, pra nuk sigurohet furnizimi i 6,240 ton materiale sipas grafikut të lëvrimin. Kjo situatë tregon për analizë jo plotësisht të saktë të numrit të kamionave, si dhe numër të lartë të tyre, pasi NJP, përfaqësuar nga specialisti i fushës, duhet të kishte kërkuar një numër të ulët kamionash, por me kapacitet mbajtës më të lartë, duke siguruar ekonominë e shkallës dhe rrjedhimisht reduktuar kostot e transportit.

*Theksojmë se kërkesa e mësipërme është kërkuar që të modifikohet edhe nga APP nëpërmjet email-it drejtuar z. B.F, personi përgjegjës për administrimin e procedurës së prokurimit. Ky email i është përcjellë specialistit të fushës z.M.M, anëtar i NJP, për njohje dhe veprim.*

**Pika 3.3.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë në një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi noteriale, të paktën 1 (një) karrierë guri gëlqeror. Për këtë duhet të paraqitet:

- Në rastin kur karriera është në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni i pronësisë, shoqëruar me Leje Shfrytëzimi Minerare të gurit gëlqeror lëshuar nga institucioni kompetent i autorizuar, si dhe me Leje Mjedisi të tipit B, kodi III.1.B për “Karrierë guri gëlqeror”, të lëshuar nga QKL.

- Në rastin kur karriera është marrë me qira, duhet të paraqitet kontratë noteriale qiraje (e vlefshme), shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë së qiradhënësit, shoqëruar gjithashtu me Leje Shfrytëzimi Minerare të gurit gëlqeror lëshuar nga institucioni kompetent i autorizuar, si dhe me Leje Mjedisi të tipit B, kodi III.1.B për “Karrierë guri gëlqeror”, të lëshuar nga QKL.

- Në rast se Operatori Ekonomik ofertues ka kontratë furnizimi noteriale, duhet të paraqitet kontrata noteriale e furnizimit (e vlefshme), shoqëruar me dokumentacionin ligjor të furnizuesit, që përfshin Leje Shfrytëzimi Minerare të gurit gëlqeror lëshuar nga institucioni kompetent i autorizuar, si dhe Leje Mjedisi të tipit B, kodi III.1.B për “Karrierë guri gëlqeror”,

të lëshuar nga QKL – Sa më sipër kërkohet që OE ofertues duhet të disponojë në pronësi/me qira/kontratë furnizimi me subjekt shfrytëzim gurore, për furnizimin me materiale inerte. Vendosja e këtij kriteri, pra në rastin kur ka kontratë furnizimi, nënkupton që kur OE nuk ushtron vetë një aktivitet të tillë, duhet me patjetër kontratë e lidhur me prodhuesin e materialeve inerte, ndërkohë që OE mund të kenë kontratë furnizimi edhe me distributorin e autorizuar nga prodhuesi për furnizimin me këto materiale<sup>27</sup> dhe qëllimi i realizimit të kontratës, pra furnizimit me materialet e mësipërme realizohet dhe distributori nuk ka detyrim të disponojë leje shfrytëzimi minerare të gurit gëlqeror lëshuar nga institucioni kompetent i autorizuar, si dhe leje mjedisi të tipit B, kodi III.1.B për “Karrierë guri gëlqeror” dhe për rrjedhojë OE kushtëzohet të marrë pjesë në procedurë, pasi i duhet me patjetër kontratë furnizimi me prodhuesin, që në këtë mënyrë të sigurojë edhe disponimin e dokumentacionit të mësipërm. Kërkesa për dokumentacionin e mësipërm në rastin kur OE disponon kontratë furnizimi, i adresohet palëve të treta dhe jo OE, pasi në asnjë rast një prodhues nuk ka detyrim që një të furnizuarit t’i vendosi në dispozicion dokumentacionin e tij ligjor, përveç certifikatë analize të cilësisë së materialit, faturë tatimore.

-I njëjti arsytim vlenë edhe për **pikën 3.4**, lidhur me kërkesën për impiantin e rërës bituminoze.

*Theksojmë se kërkesa e mësipërme është kërkuar që të modifikohet edhe nga APP nëpërmjet email-it drejtuar z. B.F, personi përgjegjës për administrimin e procedurës së prokurimit. Ky email i është përcjellë specialistit të fushës z.M.M, anëtar i NJP, për njohje dhe veprim. Për sa më sipër mbanë përgjegjësi M.M, anëtar i NJP, specialisti i fushës.*

### **Vlerësimi i ofertave.**

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me nr. 107, datë 04.05.2022 është ngritur KVO i cili përbëhet nga E.B (Kryetar), A.X dhe L.S (Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 20.05.2022 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s’ka, datë 08.06.2022 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim.

Me shkresën nr. 2333/6 prot., datë 10.06.2022 nga OE E është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Mallakastër. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 13.06.2022 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 4 OE, përkatësisht:*

1. Operatori Ekonomik “SH 07” Sh.P.K, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej 27,690,284 lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “A” Sh.P.K, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej 29,970,387 lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik “E.K” Sh.P.K, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej 24,990,890 lekë pa TVSH.
4. Operatori Ekonomik “SH” Sh.P.K, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej 30,946,434 lekë pa TVSH.

-Nga OE të mësipërm, janë s’kualifikuar, si më poshtë:

OE/BOE	Arsye e s’kualifikimit
“OE “A” Sh.P.K	- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën “3.1.”, të kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me kontratat e mëparshme të realizuara, pasi kontrata e paraqitur nr.3648/6 prot, datë 13.06.2018, me vlerë 9,748,453 lekë pa TVSH e lidhur me Bashkia Fier, është realizuar jashtë afatit të kërkuar, pra, nuk është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (shpallja e njoftimit të kontratës objekt prokurimi datë 05.05.2022). Për këtë kontratë, nuk është paraqitur as vërtetimi për realizimin e suksesshëm të kontratës nga enti publik, si dhe vlera e saj është më e vogël se 40% e vlerës së përlogarit të kontratës që prokurohet. E njëjta situatë është edhe për kontratën e paraqitur nr.220/9 prot, datë 16.04.2018, me vlerë 1,706,083 lekë pa TVSH e lidhur me Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Fier. Po ashtu, kontrata në sektorin privat me subjektin “Z” shpk nuk merret në konsideratë, pasi nuk janë paraqitur fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Rrjedhimisht nga OE “A” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

<sup>27</sup> Pikat 5-9 në nenin 3 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar.

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën “3.5.” të kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të dorëzuar nga OE “A” shpk, në rubrikën “B. DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme”, rezulton se nuk figurojnë të listuar 4 (katër) eskavatorë të kërkuar. Rrjedhimisht nga OE “A” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE E Sh.P.K, me ofertën ekonomike me vlerë 24,990,890 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 6,675,383 lekë/21% më pak. Është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

#### **Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>28</sup>, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:**

-Nuk plotësohet **pika 3.2 në DST**, mbi dokumentacionin për shoferat e drejtimit të kamionëve. Konkretisht shoferit K.T, të deklaruar në shtojcën 8 për drejtim kamioni, i ka përfunduar afati i lejes së drejtimit (kategoria C) dhe certifikatës së aftësisimit profesional, më datë 09.02.2022.

-Nuk plotësohet **pika 3.5 në DST**, mbi dokumentacionin tekniko-ligjor për kamionat. Konkretisht për 4 kamiona me targë AB157CS; AB215CS; AB352CS; AB385CS nuk është dorëzuar certifikata e kontrollit teknik. Në dosjen e procedurës përkatëse, administrohet një deklaratë e dhënë nga OE E, se 10 kamionat janë mjete të reja, për të cilat kontrolli teknik kryhet brenda 3 viteve nga data e regjistrimit të parë. Sa më sipër parashtrojmë:

-Për 4 kamionat të cituar, në lejen e qarkullimit nuk pasqyrohet shënimi që ky mjet është regjistruar për herë të parë dhe është mjet i ri ose ndryshe mjet me 0 km;

-Kamionat e mësipërm janë mjete të kategorisë N3: Mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 12 tonë<sup>29</sup>;

-Në pikën 3 të nenit 79 të Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të detyruara të kalojnë në kontroll teknik. Për mjetet e reja me motor kontrolli teknik do të kryhet brenda tre vjetëve nga data e regjistrimit të parë. Pas kësaj periudhe ky kontroll kryhet për çdo dy vjet. Mjetet e kategorisë M1, të përdorura si taksi dhe ambulanca, si dhe mjetet e kategorive M2, M3, N2, N3, O3, dhe O4 kryejnë kontroll teknik çdo vit. Mjetet e reja të kategorisë M1, të përdorura si taksi dhe ambulanca, si dhe mjetet e kategorive M2, M3, N2, N3, O3 dhe O4 kryejnë kontroll teknik brenda një viti nga data e regjistrimit të parë dhe më pas çdo vit”*. Pra edhe sikur të ishin mjete të reja, data e regjistrimit të tyre është 06.04.2021, ç’ka do të thotë se deri më datë 06.04.2021 këto mjete mund të qarkullojnë pa certifikatën e kontrollit teknik, më pas pra në datën 17.04.2022 (duke përfshirë edhe 10 ditë tolerancë ligjore) duhet të kryejë kontroll teknik.

#### **4.Tenderi me objekt: “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit viti 2022 (për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe NSHP)”.**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi:</b> Nr.32, datë 31.10.2022	<b>2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:</b> Urdhër Prokurimi Nr.32, datë 31.10.2022 1. B.F – (Jurist-PPP) 2. E.Y – (Specialist fushë - NSHP) 3. F.A – (Ekonomist-Anëtar)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhër Nr.298, Datë 31.10.2022 1. E.B (Kryetar) 2. A.X (Anëtar) 3. N.S (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E hapur e thjeshtuar”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSH)</b> 7,156,157.5 lekë nga të cilat: 5,915,697.5 lekë – NSHP 1,240,460 lekë – Bashkia	<b>6. Oferta fituese (pa TVSH):</b> “F 06” Shpk – 6,900,025 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH):</b> 256,132.5 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> 02.12.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i Bashkisë dhe Buxheti i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> a) Pjesëmarrës në tender I OE b) S’kualifikuar -, c) Kualifikuar I OE
<b>11. Ankimime</b> AK- s’ka; APP- s’ka; KPP- s’ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> S’ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP</b> S’ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>		

<sup>28</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

<sup>29</sup> Neni 47, pika 2, shkronja “c” në Ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.



<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr.152/6 NSHP dt.29.12.2022 Nr.5325/8 Bashkia dt. 28.12.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> NSHP – 6,860,490 lekë Bashkia – 1,419,540 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës</b> 679,200 lekë
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë/muaj</b> 12 Muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës – me ditë</b>

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e dokumentimit dhe argumentimit të fondit limit dhe vendosja e kritereve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara plotësisht.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se përlllogaritja e fondit limit nuk është argumentuar dhe dokumentuar plotësisht, si dhe në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

#### **Preventivi**

Fondi limit, afati i lëvrimin dhe specifikimet teknike, janë hartuar nga komisioni i posaçëm ngritur me Urdhrin e Drejtorit të NSHP Bashkia Mallakastër nr.54, datë 10.10.2022, me përbërje si vijon: E.Y, Kryetar (Inxhinier), E.H (Mekanik), F.A (Përgjegjës Finance) A.B (Shofer) dhe Q.L (Shofer NSHP).

-Nga komisioni i mësipërm, është mbajtur akti-teknik me shkresën nr.152/1 prot., datë 10.10.2022, mbi evidentimin e nevojave për pjesë këmbimi, përlllogaritjen e fondit limit, afatin e lëvrimin dhe specifikimet teknike.

-Për përlllogaritjen e fondit limit (çmim për njësi produkti, shërbimi) është bërë mesatarizimi i 3 ofertave nga 3 subjekte, përkatësisht: E O Sh.P.K; A Sh.P.K dhe O.D, person fizik.

#### **Nga auditimi i veprimtarisë së komisionit të mësipërm konstatohet se:**

-Komisioni ka bërë edhe identifikimin e nevojave që mund të ketë bashkia/NSHP për pjesë këmbimi dhe shërbime gjatë vitit 2023. Këtë veprim e ka bërë në tejkallim të kompetencës që i është dhënë me Urdhrin nr.54, datë 10.10.2022, pasi ky komision nuk ka qenë i autorizuar për të kryer edhe këtë detyrë.

-Identifikimi i nevojave për pjesë këmbimi/shërbim riparimi nuk është bërë nga persona të licencuar, të cilat kanë kapacitetet e nevojshme dhe zotërojnë kualifikimet për kontrollin e mjetit dhe më pas identifikimin e nevojës për pjesë këmbimi/shërbim riparimi<sup>30</sup>.

-Nuk administrohen kërkesat për pjesë këmbimi/shërbim nga sektorët përkatës që kanë në përdorim automjete/mjete punimi, kërkesa të cilat shërbejnë për përlllogaritjen e fondit limit, me qëllim dokumentimin e tij.

-Nuk administrohen kërkesat/informimi drejtuar subjekteve për dhënien e ofertave, me qëllim dokumentimin e mënyrës së përzgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e mësipërme.

-Ofertat nga 3 subjektet e mësipërme, nuk janë protokolluar, pra nuk vërtetohet nëse këto oferta i adresohen Bashkisë Mallakastër.

-Në specifikimet teknike për produktin “Bateri”, konstatohet pasaktësi në përcaktimin e periudhës së garancisë, pasi për të njëjtin produkt kërkohen dy periudha të ndryshme mbulimi me garanci. Konkretisht është kërkuar 24 muaj dhe 12 muaj. Kjo pasaktësi ndikon negativisht në përgatitjen e ofertës nga OE, si dhe automatikisht në vlerësimin e saj nga KVO.

-Në specifikimet teknike për metodat e testimit (ISO) për produktin “Vaj hidrauliku” nuk janë shoqëruar nga fjala “ekuivalent”, me qëllim shmangien edhe të kufizimit të konkurrencës.

-Nga 3 subjekte prej të cilëve janë marrë ofertat për përlllogaritjen e fondit limit, dy prej tyre, E. O. dhe O. Dh. nuk janë të licencuar<sup>31</sup> për shërbimin e autoriparimit të mjeteve me motor si dhe të tregtimit të pjesëve të këmbimit. Marrja e ofertës ekonomike për një mall/shërbim të caktuar nga një subjekt i palicencuar për shitjen e këtij malli/ofrimin e këtij shërbimi, mund të

<sup>30</sup> Neni 234 në VKM nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 6, datë 12.11.2021 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”.

<sup>31</sup> Udhëzim nr. 1548, datë 29.3.2016 “Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove”. Udhëzim nr. 1546, datë 29.3.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

ndikojë negativisht në çmimin real të ofruar nga ky subjekt dhe për pasojë edhe në fondin limit, bazë e të cilit, është edhe çmimi i marrë nga 2 subjektet e mësipërme.

-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “ç” të pikës 3 në nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”; Pikën 1, shkronjat “a” dhe “ç” në pikën 2 të nenit 2, pikën 1 të nenit 13, pikën 2 në nenin 76 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Urdhri nr.57, datë 12.06.2014 të MFE “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimet me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSH dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSH.

*Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, E.Y, Kryetar (Inxhinier), E.H (Mekanik), F.A (Përgjegjës Finance) A.B (Shofer) dhe Q.L (Shofer NSHP).*

### **Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 21.11.2022, nga NJP, nga specialisti i fushës më datë 21.11.2022.**

#### **Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

**Pika 2.2.1** OE ofertues duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të tre viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021), lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet - Për këtë kërkesë nga NJP (përfshijë specialistin e fushës) është pasqyruar vetëm baza ligjore, pa dhënë argumentimin se si ndikon ky marzh në përmbushjen e kontratës së prokurimit. Gjithashtu përcaktimi në pikën 2.2.1 nuk është në përputhje shkronjën pikën 4 në nenin 55 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë **nuk mund të tejkalojë** 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit e hapur e thjeshtuar (për kontrata nën kufirin e ulët monetar);

Për më tepër që edhe në shkresën e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: *“Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të **argumentojnë** vlerën e kërkuar të xhiros **brenda** këtij marzhi”*, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-40%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 30% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3. *Për këtë kriter mbajnë përgjegjësi B.F dhe F.A, përfshijë anëtarin tjetër E.Y, detyra e të cilit është hartimi dhe argumentimi i kriterëve për kapacitetin teknik.*

#### **AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:**

**Pika 2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme të suksesshme, kërkohen dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet - Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën “b” të në pikën 4 në nenin 55 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: *“Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të **argumentojnë** vlerën e kërkuar të xhiros **brenda** këtij marzhi”*, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-20%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 15% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me

shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3, si dhe pikën 8 në rekomandimin e APP nr.7998 prot., datë 24.12.2021.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi E.Y, anëtar i NJP, specialisti i fushës.*

### **Vlerësimi i ofertave.**

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me nr. 298, datë 31.10.2022 është ngritur KVO i cili përbëhet nga E.B (Kryetar), A.X dhe N.S (Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 02.12.2022 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 09.12.2022 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nëpërmjet SPE, KVO më datë 09.12.2022 i është drejtuar OE të shpallur fitues për dorëzimin e dokumentacionit provues të formularit 8.

Me shkresën nr. 6189 prot., datë 14.12.2022 nga OE shpallur fitues është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Mallakastër. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 15.12.2022 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, përkatësisht:*

1. OE “F 06” Sh.P.K, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej 6,900,025 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 256,132 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>32</sup>, nga OE shpallur fitues, plotësohen kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

### **5.Tenderi me objekt: “Blerje kontenierë për mbetjet urbane”.**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje kontenierë për mbetjet urbane”</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi:</b> Nr.26, datë 06.09.2022	<b>2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:</b> Urdhër Prokurimi Nr. 26, datë 06.09.2022 1. B.F – (Jurist-PPP) 2. E.Y – (Specialist fushe - NSHP) 3. F.A – (Ekonomist-Anëtar)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhër Nr.236, Datë 06.09.2022 1. E.B (Kryetar) 2. A.X (Anëtar) 3. N.S (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E hapur e theshtuar”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSH)</b> 6,666,516 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSH):</b> “Z” Sh.P.K - 5,691,600 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH):</b> 974,916 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> 03.10.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) S'kualifikuar – 1 OE, c) Kualifikuar 3 OE
<b>11. Ankimime</b> AK- s'ka; APP- s'ka; KPP- s'ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> S'ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP</b> S'ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> NSHP dt.26.10.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> NSHP – 6,829,920 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës</b> 6,829,920 lekë
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë/muaj</b> 15 ditë – marrë në dorëzim brenda afatit	<b>19. Zgjatja e kontratës – me ditë/muaj</b>

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e dokumentimit dhe argumentimit të fondit limit, si dhe vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara plotësisht.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se përlllogaritja e fondit limit nuk është argumentuar dhe dokumentuar plotësisht, si dhe në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

### **Preventivi**

Fondi limit, afati i lëvrimin, sasia dhe specifikimet teknike, janë hartuar nga komisioni i posaçëm ngritur me Urdhrin e Drejtorit të NSHP Bashkia Mallakastër nr.47, datë 25.08.2022, me përbërje si vijon: A.S, Kryetar (Inxhinier), B.Y (Agronom), P.G (Specialist pastrim gjelbërimi) Q.L (Shofer) dhe E.B (Teknik i mesëm).

<sup>32</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

-Nga komisioni i mësipërm, është mbajtur akti-teknik me shkresën nr.136/2 prot., datë 29.08.2022, mbi evidentimin e sasisë, përlllogaritjen e fondit limit, afatin e lëvrimet dhe specifikimet teknike.

-Për përlllogaritjen e fondit limit (çmim për njësi produkti 43,572 lekë/cop) është bërë mesatarizimi i 3 ofertave nga 3 subjekte, përkatësisht: Z Sh.P.K; C Sh.P.K dhe K Sh.P.K.

### **Nga auditimi i veprimtarisë së komisionit të mësipërm konstatohet se:**

-Nuk administrohen kërkesat/informimi drejtuar subjekteve për dhënien e ofertave, me qëllim dokumentimin e mënyrës së përzgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e mësipërme.

-Ofertat nga 3 subjektet e mësipërme, nuk janë protokolluar.

-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 1, shkronjën “ç” në pikën 2 të nenit 2, pikën 1 të nenit 13, pikën 2 në nenin 76 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Urdhri nr.57, datë 12.06.2014 të MFE “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimet me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSH dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSH.

*Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, A.S, Kryetar (Inxhinier), B.Y (Agronom), P.G (Specialist pastrim gjelbërimi) Q.L (Shofer) dhe E.B (Teknik i mesëm).*

### **Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 21.09.2022, nga NJP, nga specialisti i fushës më datë 20.09.2022.**

#### **Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

**Pika 2.2.1** OE ofertues duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të tre viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021), lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet - Për këtë kërkesë nga NJP (përfshijë specialistin e fushës) është pasqyruar vetëm baza ligjore, pa dhënë argumentimin se si ndikon ky marzh në përmbushjen e kontratës së prokurimit. Gjithashtu përcaktimi në pikën 2.2.1 nuk është në përputhje shkronjën pikën 4 në nenin 55 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë **nuk mund të tejkalojë** 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit e hapur e thjeshtuar (për kontrata nën kufirin e ulët monetar);

Për më tepër që edhe në shkresën e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “*Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi*”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-40%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 30% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3. *Për këtë kriter mbajnë përgjegjësi B.F dhe F.A, përfshijë anëtarin tjetër E.Y, detyra e të cilit është hartimi dhe argumentimi i kriterëve për kapacitetin teknik.*

#### **AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:**

**Pika 2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme të suksesshme, kërkohen dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet - Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën “b” të në pikën 4 në nenin 55 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 20%** të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin

e kritereve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të **argumentojnë** vlerën e kërkuar të xhiros **brenda** këtij marzhi”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-20%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 15% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3, si dhe pikën 8 në rekomandimin e APP nr.7998 prot., datë 24.12.2021.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi E.Y, anëtar i NJP, specialisti i fushës.*

### **Vlerësimi i ofertave.**

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me nr.236, datë 06.09.2022 është ngritur KVO i cili përbëhet nga E.B (Kryetar), A.X dhe N.S (Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 03.10.2022 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s’ka, datë 0.10.2022 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nëpërmjet SPE, KVO më datë 04.10.2022 i është drejtuar OE të shpallur fitues për dorëzimin e dokumentacionit provues të formularit 8.

Me shkresën nr. 4901 prot., datë 07.10.2022 nga OE shpallur fitues është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Mallakastër. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 10.10.2022 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender ka marrë pjesë 4 OE, përkatësisht:*

- 1.OE “L.B” Sh.K.P, me ofertë ekonomike në shumën prej 5,866,020 lekë pa TVSH.
- 2.OE “N” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 6,181,200 lekë pa TVSH.
- 3.OE “S” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 6,273,000 lekë pa TVSH.
- 4.OE “Z” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 5,691,600 lekë pa TVSH.

-Nga OE të mësipërm, janë s’kualifikuar, si më poshtë:

OE/BOE	Arsye e s’kualifikimit
“OE “S” Sh.P.K	OE “S” Shpk, me ofertë ekonomike në shumën prej 6,273,000 (gjashtëmilion e dyqind e shtatëdhjetë e tremijë) lekë pa TVSH, skualifikohet nga kjo procedurë pasi është në kushtet detyruese për skualifikim, parashikuar nga neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”. Konkretisht, në pikën 3, gërma “dh”, të nenit 76, parashikohet se: “3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;”. Në interpretim të dispozitës së mësipërme, KVO i referohet procedurës së prokurimit me objekt “Blerje kontenierë për mbetjet urbane”, me numër reference REF-07189-10-05-2021, procedurë në të cilën “S” shpk është shpallur fitues, por në datë 02.11.2021 ka njoftuar në sistemin e prokurimit elektronik se tërhiqet nga nënshkrimi i kontratës.

-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>33</sup>, nga OE Z shpallur fitues, konstatohet se OE plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

### **6.Tenderi me objekt: “Studim projektim të objektit: “Ndërtim i ujësjellësit të fshatrave Drenovë, Belishovë, Belistan dhe Visokë”.**

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit		
<b>1. Urdhër Prokurimi:</b> Nr.24, datë 25.08.2022	<b>2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:</b> Urdhër Prokurimi Nr.24, datë 25.08.2022 1. B.F – (Jurist-PPP) 2. M.M – (Ing.Nd.-Specialist fushe) 3. F.A – (Ekonomist-Anëtar)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhër Nr.224, Datë 25.08.2022 1. E.B (Kryetar) 2. A.X (Anëtar) 3. N.S (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E hapur”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSH)</b> 12,835,000 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSH):</b> “I.D - Alb” Sh.P.K-11,166,450 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH):</b> 1,668,550 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> 12.09.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i Shtetit	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> a) Pjesëmarrës në tender 7 OE b) S’kualifikuar 5 OE, c) Kualifikuar 2 OE

33 Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

11. Ankimime AK- s'ka; APP- s'ka; KPP- s'ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, S'ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Datë 17.10.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 13,399,740	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës 3,157,056 lekë
17. Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë/muaj 3 Muaj	19. Zgjatja e kontratës – me ditë/muaj

*Sa më sipër u konstatua:*

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara plotësisht.  
**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 25.08.2022, nga specialisti i fushës.**

**AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:**

**Pika 2.3.2** OE duhet të zotërojë liçencat e nevojshme për ekzekutimin e shërbimit objekt kontrate, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme:

3.d - Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe matalike

4.a - Projektim të instalimeve hidro-termosanitare

4.c - Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale

4.j - Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, accecc kontrolli, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile e industriale

5.b - Projektim furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi

5.c - Projektim ujësjellës kanalizime ubane - rurale

5.f - Projektim vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi - shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse

8.a - Rilevime inxhinierike

8.d - Bazamente gjeodezike

9.a - Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike deri 5 kate

9.d - Studim/Vlerësim gjeologo inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët

9.e - Studime e projekte hidrogjeologjike

- Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, kategoritë e mësipërme të licencave nuk janë argumentuar teknikisht në përputhje me nënobjektet e veprës që do të projektohet.

**Pika 2.3.3.** OE duhet të ketë pjesë të stafit dhe të figurojnë në licencën e shoqërisë, me pozicionin Drejtues Teknik, si më poshtë:

Inxhinier Ndërtimi

Inxhinier Mekanik

Inxhinier Elektrik

Inxhinier Gjeolog

Inxhinier Gjeodet / Topograf / Markshajder

Inxhinier Hidroteknik

- Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, nuk argumentohet kërkesa për llojin e inxhinierëve të kërkuar. Kërkesa për inxhinier gjeodet është e panevojshme, pasi detyrat e këtij inxhinieri realizohen edhe nga inxhinieri gjeolog<sup>34</sup>.

**Pika 2.3.5.** OE duhet të ketë të punësuar gjithashtu staf mbështetës të kualifikuar si më poshtë:

1 (një) inxhinier topograf

34 VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", i ndryshuar, kodi i profesionit 2114.

1 (një) inxhinier hidroteknik

1 (një) inxhinier mjedisi

1 (një) inxhinier ndërtimi

Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, nuk argumentohet kërkesa për llojin e inxhinierëve të kërkuar si staf mbështetës. Kërkesa për inxhinier topograf është e panevojshme, pasi detyrat e këtij inxhinieri realizohen edhe nga inxhinieri gjeolog<sup>35</sup>.

**Pika 2.3.6.** Për ekzekutimin e shërbimeve objekt kontrate, Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht, të paktën 10 (dhjetë) punonjës të siguruar, për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave – Për këtë kriter nuk argumentohet periudha e vendosur, nuk përcaktohet qartë se ky numër është veç numri të inxhinierëve të kërkuar dhe nëse është kështu çfarë formimi profesional duhet të kenë, si dhe cili do të jetë roli i tyre.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi M.M, anëtar i NJP, specialisti i fushës.*

### **Vlerësimi i ofertave.**

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me nr.224, datë 25.08.2022 është ngritur KVO i cili përbëhet nga E.B (Kryetar), A.X dhe N.S (Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 12.09.2022 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 20.09.2022 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nëpërmjet SPE, KVO më datë 20.09.2022 i është drejtuar OE të shpallur fitues për dorëzimin e dokumentacionit provues të formularit 8.

Me shkresën nr. 4688 prot., datë 23.09.2022 nga OE shpallur fitues është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Mallakastër. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 26.09.2022 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender ka marrë pjesë 7 OE, përkatësisht:*

BOE "E" Sh.P.K & "T" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 10,890,000 lekë pa TVSH.

BOE "E/M" Sh.P.K & "A" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 11,085,730.706 lekë pa TVSH.

BOE "G.B" Sh.P.K, & "A" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 11,087,740 lekë pa TVSH.

BOE "H" Sh.P.K, & "H.C" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 11,192,145.67 lekë pa TVSH.

BOE "H.A" Sh.P.K, & "S.R" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 11,188,489.58 lekë pa TVSH.

OE "I.D" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 11,166,450 lekë pa TVSH.

BOE "T" Sh.P.K, & "A" Sh.P.K, & "H.C" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 11,046,000 lekë pa TVSH.

-Nga OE/BOE të mësipërm, janë s'kualifikuar, si më poshtë:

<b>OE/BOE</b>	<b>Arsye e s'kualifikimit</b>
BOE "E", & "T"	<p>1. BOE "E" shpk, "T" shpk, me ofertë ekonomike në shumën prej 10,890,000 (dhjetëmilion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit "oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim", pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 1/a, të Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) nga të dy anëtarët e BOE, janë në kundërshtim me njëri tjetrin. Konkretisht, në rubrikën "B. DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura", pikat 6 dhe 7 janë plotësuar në mënyrë kundërshtuese nga të dy anëtarët e BOE. Në pikën 6, me përmbajtje "Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;," "T" shpk deklaron me "JO" ndërsa "E" shpk deklaron me "PO". Në pikën 7, me përmbajtje "Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).," "T" shpk deklaron me "PO" ndërsa "E" shpk deklaron me "JO".</li></ul>

35 VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", i ndryshuar, kodi i profesionit 2114.

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 1/b, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi Formulari i Sigurimit të Ofertës i paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) nga BOE, nuk përputhet as me numrin e referencës së procedurës objekt prokurimi, as me shumën e kërkuar të sigurimit dhe as me objektin e procedurës objekt prokurimi.</li> <li>Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.7. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi oferta e paraqitur është në një vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar, e përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor sipas dokumentit nr.3861/2 prot, datë 24.08.2022 “Përlogaritja e fondit limit (vlerës maksimale të lejuar), dhe vlerës minimale të lejuar...”</li> </ul>
BOE “E”, & “A”	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 1/b, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi Formulari i Sigurimit të Ofertës i paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) nga BOE, nuk plotëson kushtin e periudhës së vlefshmërisë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë, siç është përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit (DST). Formulari i Sigurimit të Ofertës që është paraqitur në SPE, është me periudhë vlefshmërie 90 (nëntëdhjetë) ditë, pra më e shkurtër se periudha e vlefshmërisë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë, që është përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit. Në DST, në Seksionin I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, rubrika B. PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 9 Periudha e vlefshmërisë së Ofertës, përcaktohet se: “1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontratës pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.”</li> <li>Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.7. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi oferta e paraqitur është në një vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar, e përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor sipas dokumentit nr.3861/2 prot, datë 24.08.2022 “Përlogaritja e fondit limit (vlerës maksimale të lejuar), dhe vlerës minimale të lejuar...”</li> </ul>
BOE “G.B”, & “A”	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.2.1. të Kapacitetit ekonomik dhe financiar, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi për anëtarin e BOE “A” shpk nuk është paraqitur vërtetimi i xhros vjetore të tre viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021), lëshuar nga Administrata Tatimore.</li> <li>Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.2.2. të Kapacitetit ekonomik dhe financiar, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi për anëtarin e BOE “A” shpk nuk janë paraqitur bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021), të konfirmuara nga Administrata Tatimore.</li> <li>Anëtari i bashkimit “G.B” shpk, nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi kontrata e shërbimit nr.790 prot, datë 22.10.2020, me vlerë 685,631 lekë pa TVSH, e lidhur me “Ujësjellës Gramsh” sha, nuk përmbush kushtin e vlerës së kërkuar. Referuar kontratës së bashkëpunimit, “G.B” shpk ka marrë përsipër 49% të shërbimeve objekt kontrate dhe referuar raportit të pjesëmarrjes në BOE, duhet të paraqiste kontratë për shërbime të ngjashme në vlerën 49% të 40% të fondit limit, e zbrërthyer në vlerë absolute prej 2,515,660 lekë pa TVSH (12,835,000 * 40% * 49%). Në pikën 3, të nenit 88, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”</li> </ul>
BOE “H.A”, & “S.R”	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 1/b, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi Formulari i Sigurimit të Ofertës i paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) nga BOE, nuk plotëson kushtin e periudhës së vlefshmërisë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë, siç është përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit (DST). Formulari i Sigurimit të Ofertës që është paraqitur në SPE, është me periudhë vlefshmërie duke filluar nga data 12.09.2022 deri në datën 12.12.2022, pra më e shkurtër se periudha e vlefshmërisë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë, që është përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit. Në DST, në Seksionin I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, rubrika B. PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 9 Periudha e vlefshmërisë së Ofertës, përcaktohet se: “1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontratës pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.”</li> <li>Duke qenë se në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, anëtari lider i BOE “H.A” shpk, nuk ka deklaruar dhe përcaktuar në mënyrë të detajuar se cilët nga punonjësit e kërkuar janë drejtues teknik dhe cilët janë pjesë e stafit mbështetës të kualifikuar, sipas përcaktimeve të bëra në kërkesat e përcaktuara sipas pikave 2.3.3 dhe 2.3.5, të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), duke i harmonizuar të dyja këto pika për sa i përket numrit total të punonjësve sipas profilit dhe formimit të kërkuar (drejtues teknik dhe staf mbështetës), konstaton se nuk plotësohet numri i tyre sipas përqindjes së shërbimit që “H.A” shpk ka marrë përsipër të realizojë. Kjo pasi, referuar kontratës së bashkëpunimit që është paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, “H.A” shpk ka marrë përsipër të kryejë 70% të shërbimeve objekt kontrate. Referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, “H.A” shpk, ka deklaruar gjithësej 6 punonjës sipas profileve dhe formimit të kërkuar në pikat 2.3.3 dhe 2.3.5, të Kapacitetit teknik dhe konkretisht: Inxhinier Hidroteknike, Inxhinier Gjeolog, Inxhinier Gjeodet, Inxhinier Mekanik, Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Ndërtimi, ndërsa Arkitekti nuk është profil dhe formim i kërkuar në asnjë nga pikat e mësipërme. Në total, numri i punonjësve të kërkuar në pikat 2.3.3 dhe 2.3.5 të Kapacitetit teknik, sipas profilit dhe formimit të kërkuar (drejtues teknik dhe staf mbështetës) është 10, ndërkohë që numri i deklaruar nga “H.A” shpk në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit është 6, pasi Arkitekti nuk është profil dhe formim i kërkuar në asnjë nga këto pika. Sipas përqindjes (70%) që “H.A” shpk ka marrë përsipër të kryejë në kontratën e bashkëpunimit të BOE, numri i punonjësve sipas profilit dhe formimit të kërkuar (drejtues teknik dhe staf mbështetës) duhej të ishte 7. Në pikën 3, të nenit 88, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”</li> </ul>
BOE “T”, & “A”	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk plotëson dhe nuk është në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 1. Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, përcaktuar sipas Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi anëtari lider i bashkimit “T” shpk, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9, ka deklaruar subjektin “B.B” PF, si një subjekt mbi kapacitetet e të cilit do të mbështet, por për këtë subjekt nuk është paraqitur Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Në pikën 1. Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, ndër të tjera përcaktohet se: “Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”. Gjithashtu, edhe vetë seti i Dokumentave Standarte të Tenderit, miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, në formatin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9, ka të përcaktuar se: “Ju lutemi sigurohuni që: -Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.”</li> </ul>



	<p>-Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.”</p> <p>•Anëtari i bashkimit “H.C” shpk, nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas 2.3.1, të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi kontrata e shërbimit datë 22.06.2021, me objekt “Hartimi i studimprojektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto - Romanos - Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit”, e lidhur me shoqërinë “T” shpk dhe faturat e shitjes të lëshuara në drejtim të kësaj shoqërie, nuk konsiderohen në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, pasi rezultojnë se kemi të bëjmë me një nënkontraktim, për të cilin nuk është paraqitur miratimi i nënkontraktimit nga Autoriteti Kontraktor që ka zhvilluar procedurën e prokurimit, Bashkia Durrës. Për më tepër, referuar dokumentacionit të aksesueshëm në sistemet publike, rezultojnë se AK Bashkia Durrës ka shpallur dhe zhvilluar procedurën e prokurimit publik me numër reference REF-94911-05-08-2021, me objekt “Hartimi i studimprojektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto - Romanos - Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit”, me fond limit 87.006.741 (tetëdhjetë e shtatë milion e gjashtë mijë e shtatëqind e dyzet e një) lekë, procedurë e cila është finalizuar me lidhjen e kontratës ndërmjet AK Bashkia Durrës dhe BOE “T” shpk &amp; “A” shpk &amp; “T” shpk. Referuar Dokumentave Standarte të Tenderit, rezultojnë se AK Bashkia Durrës nuk e ka lejuar nënkontraktimin për këtë procedurë, gjë e cila gjën pasqyrim edhe në Formularin e Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar, publikuar në Buletinin e Posaçëm Nr.103, Datë 02.07.2021, ku është pasqyruar vetëm emri i kontraktorit BOE “T” shpk &amp; “A” shpk &amp; “T” shpk, duke mos pasur asnjë nënkontraktor, pasi AK Bashkia Durrës nuk e ka lejuar nënkontraktimin që në fazën e ofertimit.</p> <p>• Anëtari lider i bashkimit “T” shpk, nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas 2.3.5, të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi nuk ka deklaruar asnjë punonjës lidhur me stafin mbështetës të kualifikuar, ndërkohë që referuar kontratës së bashkëpunimit që është paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, “T” shpk ka marrë përsipër të kryejë 34% të shërbimeve objekt kontrate dhe duke qenë se është subjekt lider i BOE duhet të deklaronte të paktën 2 inxhinierë të stafit mbështetës të kualifikuar, sipas formimit dhe profileve të kërkuara. Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9, sa i përket profilit të punonjësve të kërkuar, “T” shpk ka deklaruar Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Mjedisi dhe Inxhinier Ndërtimi (Arkitecti nuk është profil dhe formim i kërkuar në asnjë nga kërkesat e DST), të cilët referuar Licencës së shoqërisë në projektim N.6708/5, supozohet të jenë drejtues teknik. Në pikën 3, të nenit 88, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”</p> <p>•Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.7. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi oferta e paraqitur është në një vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar, e përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor sipas dokumentit nr.3861/2 prot, datë 24.08.2022 “Përlogaritja e fondit limit (vlerës maksimale të lejuar), dhe vlerës minimale të lejuar...”.</p>
--	---

-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>36</sup>, nga OE Instituti Dekliada-ALB shpallur fitues, konstatohet se OE plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

## 7.Tenderi me objekt: “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara”, me këto të dhëna:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit		
1. Urdhër Prokurimi Nr.23, nr.4050 prot., datë 17.08.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr.23 datë 17.08.2022 1. B.F (Jurist) 2. M.M (Inxhinier ndërtimi) 3. F.A (Ekonomist)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.223, nr.4050/1 datë 24.08.2022 1. E.B, Kryetar (Drejt. Kabineti) 2. A.X, Anëtar (Kryeinspekt i IVMT) 3. N.S, Anëtar (Përgj. Sekt. Juridik)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur- Punë Publike	6. Oferta fituese (pa TVSH) BOE V.K dhe Z.Sh.P.K me ofertë ekonomike në vlerën 23,242,924 lekë,	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 7,999,779 lekë
5. Fondi Limit (pa TVSH) 31,242,703 lekë	9. Burimi Financimit Të vëna në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë (30% të vlerës) dhe nga Buxheti i Shtetit (70%)	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 9 OE b) S’kualifikuar 5 OE, c) Kualifikuar 4 OE
8. Data e hapjes së tenderit 12.09.2022	12. Përgjigje nga AK-s’ka	13. Përgjigje nga APP apo AKKP S’ka
11. Ankimime AK-; APP-KPP- s’ka		
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 4050/10, datë 26.10.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 27,891,508 lekë	16. Likuiduar deri në 31.12.2022 11,444,873 lekë
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë 6 (gjashtë) muaj	19. Zgjatja e kontratës

Sa më sipër u konstatua:

**Titulli i gjetjes:** Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara plotësisht, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

36 Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 25.08.2022, i ndryshuar, nga NJP, nëpërmjet shtojcës nr.s'ka, datë 02.09.2022.**

**AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:**

**-Pika 2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi puntore mesatare prej të paktën 30 (tridhjetë) punonjës të siguruar për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave – Ndërkohë që numri i punonjësve për të cilët është përcaktuar edhe profesioni i tyre, është 16 punonjës (2 inxhinier dhe 14 staf teknik), pra ngelen edhe 14 punonjës për të cilët nuk argumentohet numri si dhe nuk përcaktohet profesioni, ç'ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “*Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin*”.

**-Pika 2.3.5.** Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, për 3 (tre) muajt e fundit duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit si staf teknik punonjësit si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Sasia
1	Teknik Ndërtimi	( 1 person )
2	Bojaxhinj	( 2 persona )
3	Karpentier	( 2 persona )
4	Hidraulik	( 1 person )
5	Elektracist	( 2 persona )
6	Murator	( 2 persona )
7	Pllakashtrues	( 2 persona )
8	Suvatues	( 2 persona )
	<b>Total</b>	<b>14</b>

-Nga shqyrtimi i procesverbalit përkatës, konstatohet se nuk argumentohet periudha e vendosur për disponimin në listë-pagesë, si dhe numri. Gjithashtu nuk është përcaktuar sasia e orëve të punës për çdo zë pune, e cila të sjellë vlerësimin dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të nevojshëm për zbatimin e projektit.

**-Pika 2.3.7.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetë shkarkues 7-12 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë deri në 3.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësiose me qera
Betoniere kantieri	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Tabela sinjalistike	10 copë	Pronësi ose me qera

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri i mjeteve që kërkohet dhe lloji i tyre, në përputhje me natyrën, sasinë dhe grafikun e punimeve.

-Veç sa më sipër janë kërkuar makineri ndërtimi si kamion vetëshkarkues 7-12 ton, kamionçinë deri në 3.5 ton, minieskavator dhe autobot uji, por në asnjë rast nuk është kërkuar edhe disponimi i manovratorë/shoferave për drejtimin e mjeteve të kërkuara.

*-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi M.M specialisti i fushës në NJP.*

### **Vlerësimi i ofertave.**

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me nr.223, me nr. 4050/1 datë 24.08.2022 është ngritur KVO i cili përbëhet nga E.B, Kryetar, A.X dhe N.S, Anëtar. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. s'ka, datë 12.09.2022 për hapjen e tenderit, procesverbali nr. 4050/6, datë 13.10.2022 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim me nr.4050/7 datë 17.10.2022. Me shkresën nr.4050/8 prot., datë 18.10.2022, NJP i është drejtuar BOE V.K dhe Z për dorëzimin e dokumentacionit. Me shkresën nr.s'ka datë 18.10.2022 nga BOE V.K dhe Z është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Mallakastër. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali

nr.4050/8, datë 18.10.2022 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 9 OE (renditur OE diferenca më e lartë nga fondi limit – diferenca më e ulët), përkatësisht:*

- 1-BOE “V.K” shpk dhe “Z” Sh.P.K., me ofertë ekonomike 23,242,924 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **7,999,779 lekë/25.6% më pak;**
- 2-BOE “N 1934” shpk dhe “B” Sh.P.K, me ofertë ekonomike 26,537,347 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 4,705,356 lekë/15% më pak;
- 3-OE “I” Sh.P.K., me ofertë ekonomike 26,981,598 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 4,261,105 lekë/13.6% më pak;
- 4-BOE “C M” Sh.P.K., dhe “K” Sh.P.K., me ofertë ekonomike 28,154,840 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 3,087,863 lekë/9.9% më pak;
- 5-OE “G” Sh.P.K., me ofertë ekonomike 28,491,499 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 2,751,204 lekë/8.8% më pak;
- 6-OE “A” Sh.P.K., me ofertë ekonomike 29,616,496 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,626,207 lekë/5.2% më pak;
- 7-OE “A” Sh.P.K., me ofertë ekonomike 29,641,861 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,600,842 lekë/5% më pak;
- 8-OE “B/L” Sh.P.K., pa ofertë ekonomike;
- 9-OE “E.A” Sh.P.K., me ofertë ekonomike 35,224,402 lekë pa TVSH.

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s’kualifikuar, si më poshtë:

OE/BOE	Arsye e s’kualifikimit
“A” shpk	Nga dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “A” shpk, rezulton se <b>nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim</b> të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe <b>Oferta e tij nuk është e vlefshme</b> për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur: Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.2. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi nuk ka paraqitur licencën profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve objekt kontrate. Rrjedhimisht, referuar sa më sipër, OE “A” shpk skualifikohet nga procedura objekt prokurimi.
“B/L” shpk	Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion, si dhe nuk ka paraqitur ofertë
“C M” shpk dhe “K” shpk	Nga dokumentacioni i paraqitur nga ky bashkim operatorësh, rezulton se nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur: Nga anëtarë i BOE “K” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.7. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi nuk ka paraqitur: - “Certifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente”, - “Certifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 ose ekuivalente”, - “Certifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 ose ekuivalente”, certifikata të cilat përfshijnë natyrën e punimeve të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit. Në nenin 83, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. [...]”. Rrjedhimisht, referuar sa më sipër, BOE “C M” shpk & “K” shpk skualifikohet nga procedura objekt prokurimi.
“E.A” shpk	Nga dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “EA” shpk, rezulton se nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur: Oferta e paraqitur bie ndesh me përcaktimet e bëra në “Seksionin I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë”, gërma B, pika 4, të Dokumentat Standarte të Tenderit, dhe pikën 1/c, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi Formulari i Ofertës sipas Shtojcës 1, nuk është plotësuar në mënyrë të saktë. Konkretisht, ka mospërputhje të numrit të referencës së plotësuar nga “EA” shpk REF-35644-07-06-2022, i cili nuk përputhet me numrin e referencës objekt prokurimi REF-39791-08-25-2022. Gjithashtu, rezulton se ka mospërputhje të vlerës së ofertuar në Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1, ku çmimi i ofertës është 35,224,402.61 lekë pa TVSH dhe atij në Listën e Çmimeve sipas Shtojcës 2, ku çmimi i ofertës është 26,936,774.2 lekë pa TVSH, gjë e cila çon në refuzimin e ofertës pasi diferenca është më shumë se 2%. Rrjedhimisht, referuar sa më sipër, OE “EA” shpk skualifikohet nga procedura objekt prokurimi.
“N 1934” shpk dhe “B” shpk	Nga dokumentacioni i paraqitur nga ky bashkim operatorësh, rezulton se nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur: Oferta e paraqitur bie ndesh me përcaktimet e bëra në “Seksionin I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë”, të Dokumentave Standarte të Tenderit, me pikën 1 të Kriteve të Përgjithshme të Përgjedhjes/Kualifikimit, të

	<p>Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, si dhe me pikën 1/a, të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit i subjektit “N 1934” shpk, ka pasaktësi në plotësim. Konkretisht, në formular përveç dy anëtarëve të BOE përmendet edhe një subjekt tjetër dhe administratori i tij, i cili nuk është selektuar në sistem si pjesë e BOE. Gjithashtu, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit të paraqitur, rezulton se është e njëjta situatë, ku subjekti tjetër i cili nuk është selektuar në sistem si pjesë e BOE ka 63% të punimeve, ndërkohë që nuk ka nënshkruar në marrëveshjen e bashkëpunimit. Ndërsa për subjektin “B” shpk, i cili është selektuar në sistem si pjesë e BOE dhe që ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit, nuk rezulton të jetë përcaktuar raporti i pjesëmarrjes në BOE.</p> <p>Nga ana tjetër, edhe sikur pasaktësia e mësipërme të konsiderohej lapsus, nga BOE nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.5. të Kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi referuar Formularëve Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezulton se të dyja shoqëritë pjesë e bashkimit, në total kanë deklaruar vetëm 1 murator nga 2 të kërkuar.</p> <p>Rrjedhimisht, referuar sa më sipër, BOE “N 1934” shpk &amp; “B” shpk skualifikohet nga procedura objekt prokurimi.</p>
--	---

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues BOE “V.K” Sh.P.K dhe “Z” Sh.P.K me ofertën ekonomike me vlerë 23,242,924 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 7,999,779 lekë/25.6% më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

### **Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>37</sup>, nga BOE shpallur fitues, konstatohet se:**

-Kamioni vetë shkarkues me targa LU2004SC i marrë më qira nga OE “Z” Sh.P.K nuk disponon certifikatë për transportin e mallrave për të tretë dhe me qira për mjetet e transportit.

-Kamionçinë me targa AA410SC në pronësi të OE “Z” Sh.P.K nuk disponon certifikatë për transportin e mallrave për llogari të nevojave të veta.

-Kamionat vetë shkarkues të deklaruar në shtojcën 8 me targë AA651DY dhe AB753FN të marra më qira nga OE “V.K” shpk nuk disponojnë certifikatë për transportin e mallrave për të tretë dhe me qira për mjetet e transportit.

-Kamioni vetë shkarkues i deklaruar në shtojcën 8 me targë LU2004C i marrë më qira nga OE “Z” shpk nuk disponon certifikatë për transportin e mallrave për të tretë dhe me qira për mjetet e transportit.

-Kamionçinë me targë AA410SC në pronësi të OE “Z” shpk nuk disponon certifikatë për transportin e mallrave për llogari të nevojave të veta.

### **8.Tenderi me objekt: “Blerje karburant (Diezel), viti 2022”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi Nr. 03, nr. 1934 prot., Datë 12.04.2022</b>	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Urdhër Nr.03, nr.1934 dt. 12.04.2022 1.B.F (Jurist) 2.F.A (Ekonomist) 3.M.M (Inxhinier)	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër Nr. 94, nr.1934/1 dt. 12.04.2022 -E.B, Kryetar. -A.R, Anëtar. -A.X, Anëtar.
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Procedurë e Hapur - Mallra		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 21,694,322 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> OE “N” sh.p.k, 21,694,322 lekë me marzh fitimi 14 lekë/litër	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 0 lekë.</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 29.04.2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë dhe Granti i qeverisjes qendrore	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 2 OE
<b>11. Ankimime</b> AK-s’ka; APP-s’ka KPP-s’ka.	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S’ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP</b> S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr.1934/9 prot., datë 23.05.2022 Nr.52/5 prot., datë 18.05.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh) 26,033,187 lekë</b>	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.</b>
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> Parashikuar 12 muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës me - ditë</b> S’ka

*Sa më sipër u konstatua:*

37 Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e dokumentimit dhe argumentimit të fondit limit, si dhe vendosja e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara plotësisht.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se përlogaritja e fondit limit nuk është argumentuar dhe dokumentuar plotësisht, si dhe në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i fondit limit dhe përcaktimi i kërkesave për karburant.**

Me urdhrin e brendshëm nr.16 datë 11.04.2022 është ngritur komisioni i përlogaritjes së fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike, përcaktimin e nevojave sasiore dhe afatin e lëvritit me përbërje z.F.B, Kryetar, N.O dhe F.A, Anëtar.

-Fondi limit është përlogaritur në vlerën 21,694,322 lekë pa TVSH. Komisioni i është referuar çmimeve të tregut përkatësisht; OE “L 04” shpk në vlerën 219 lekë/litër; “N” shpk në vlerën 219 lekë/litër dhe “K” shpk në vlerën 219 lekë/litër. Në procesverbalin e mësipërm pasqyrohet informacioni nga komisioni i cili i është referuar vendimit të Bordit të Transparencës në faqen e MFE të datës 08.04.2022 i cili rezulton të jetë në cmimin 219 lekë/litër me TVSH.

-Sasia totale e nevojshme për konsum për vitin 2022 është bërë për nevojat e Bashkisë Mallakastër për sasinë 11,415 litra në vlerën 2,083,237 lekë pa TVSH dhe për nevojat e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për sasinë 107,458 litra në vlerën 19,611,085 lekë pa TVSH.

-Nga auditimi i kërkesës së bërë për sasinë e nevojshme të karburantit, konstatohet se kërkesa mësipërme nuk dokumentohet me program pune vjetor, ku përcaktohen punët që do të kryhen nga Bashkia Mallakastër dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, për të arritur në vlerësimin e sasisë së nevojshme për karburant.

-Në përfundim është caktuar 219 lekë/litër me TVSH dhe 182,5 lekë/litër pa TVSH me marzh fitimi 14 lekë/litër pa TVSH dhe sasia 118,873 litra, pra vlera totale 21,694,322 lekë pa TVSH dhe 26,033,187 lekë me TVSH.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, F.B, N.O dhe F.A, të cilët veç përlogaritjes së fondit limit, duhet të kishin arsyetuar edhe kërkesën për sasinë e karburantit.

**Hartimi i kriterëve nga NJP.**

**Pika 3.1** - Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Në cdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet – Ndërkohë që sipas pikës 4 në nenin 40 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, në rastet e prokurimeve për mallra vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës limit të kontratës që prokurohet;

-Sa më sipër kriteret e kualifikimit janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 2, 3, 4, gërma “c” në pikën 6 në nenin 40, nenin 44, dhe pikën 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, B.F, F.A dhe M.M.

**Vlerësimi i ofertave**

-KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me Urdhër Nr. 94, nr.1934/1 prot., datë 12.04.2022 dhe përbëhet nga z. E.B, Kryetar, z. A.R dhe z. A.Z. Anëtar.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE dhe janë kualifikuar; OE “K” Sh.P.K., me marzh fitimi 14,9 lekë/litër dhe OE “N” Sh.P.K., dhe është shpallur fituese OE “N” Sh.P.K., me marzh fitimi 14 lekë/litër.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 80 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Nga auditimi i vlerësimit të ofertës së mësipërme, kualifikimi dhe shpallja fitues i OE “N” Sh.P.K qëndron.

*Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar në krye të herës, detyrat e përcaktuara për rolin e titullarit, NJP dhe KVO në administrimin e procedurave të prokurimit publik deri në lidhjen e*

kontratës me OE të shpallur fitues, si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohen me përgjegjësi: M.M, B.F, F.A, E.B, A.R, N.S, A.X, A.S, F.B, N.O, K.S, L.S, E.Y, E.H, A.B, B.Y, P.G, Q.L, E.B.

**Kriteri:** Nenin 2, pikën 2 në nenin 3, nenin 77 dhe nenin 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”;

Shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 2, pikën 4 në nenin 39, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43, pikën 1 të nenit 44 dhe pikën 4 në nenin 55, pikën 2 të nenit 82, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Uljen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Njësia e Prokurimit Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH-së, të analizojë arsyet e përcaktimit të kriterëve të kualifikimit në kundërshtim me kuadrin rregullator, si dhe të kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

**Titulli i Gjetjes:** Mbi auditimin e procedurave të prokurimit publik, për blerje mallrash, shërbimesh dhe investimesh (blerje të vogla).

**Situata:** Nga auditimi i këtyre procedurave u konstatua si më poshtë:

- Në 4 raste nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përlogaritjen e fondit limit;
- Në 3 raste rezulton se OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara nga AK, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues, përmban mangësi në formë dhe përmbajtje;
- Në 6 raste nga autoriteti kontraktor nuk është kërkuar deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore, konfliktin e interesit, deklaratë garancie për mallrat objekt prokurimi.

**Kriteri:** Nenin 36, pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenin 76, pika 1 dhe 2, VKM nr.285 datë 19.05.2021 për “Rregullat e Prokurimit Publik”.

**Ndikimi/Efekti:** Ndikim negativ në transparencën dhe administrimin e fondeve buxhetore të alokuara për prokurimin me vlerë të vogël.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

**Rëndësia:** I Mesëm.

**Rekomandimi:** Komisioni i blerjeve të vogla Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, garantimin e cilësisë së mallrave, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përlogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

*Më hollësisht rastet trajtuar si më posht vijon:*

9.Për procedurën me objekt “**Blerje uniforma për punonjësit e MZSH Mallakastër**” me fond limit 898,160 lekë.

Autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar:

-Deklarata e operatorit ekonomik që nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjisllacionit në fuqi.

-Nga OE të provojë me anën e dokumentacionit se veprimtaria e tij është në përputhje me legjisllacionin në fuqi për punën dhe mjedisin. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim

me përcaktimet e bëra në VKM nr.285. dt. 19.05.2021 për Rregullat e Prokurimit Publik, neni 40, pika 4 dhe pika 7.

-Nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit dhe metoda që është përdorur për llogaritjen e fondit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenin 76, pika 1 dhe 2, VKM nr.285. dt. 19.05.2021, për Rregullat e Prokurimit Publik.

10.Për procedurën me objekt **“Blerje Tонера për printer dhe fotokopje”** me fond 494,000 lekë.

Autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar:

-Deklarata e operatorit ekonomik që nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

-Nuk është kërkuar deklaratë garancie për mallrat objekt prokurimi, si dhe specifitime për tonerat të jenë me pullë sigurie duhet të jenë origjinal ose ekuivalent i origjinalit.

-Autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar nga OE të provojë me anën e dokumentacionit se veprimtaria e tij është në përputhje me legjislacionin në fuqi për punën dhe mjedisin.

-Veprimet dhe mosveprimet me mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në VKM për Rregullat e Prokurimit Publik, neni 40, pika 4 dhe pika 7.

-Nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit dhe metoda që është përdorur për llogaritjen e fondit, në kundërshtim me nenin 76, pika 1 dhe 2, VKM nr.285. dt. 19.05.2021 për Rregullat e Prokurimit Publik.

11.Për procedurën me objekt: **“Blerje Materiale Kancelarie”** me fond limit 443,100 lekë.

**Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua mungesa e këtyre dokumenteve si më poshtë:**

-Vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve për energjinë elektrike;

-Deklarata e operatori ekonomik që nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

-Në specifikimet teknike për llojin e mallit **“stilolaps”**, është paraqitur marka e stilolapsit, duke e përcaktuar kështu llojin dhe markën e mallit që kërkohet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 36, pika 4 të Ligjit për Prokurimin Publik, Nr.162/2020.

-Nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit dhe metoda që është përdorur për llogaritjen e fondit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 76, pika 1 dhe 2, VKM nr.285. dt. 19.05.2021 për Rregullat e Prokurimit Publik.

12.Për procedurën me objekt **“Mbikqyrje punimesh në objektin: Rikonstruksioni i rrugëve në fshatrat Dukas, Visokë, Greshicë, Mollaj”**, me fond limit 720,588 lekë.

Autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar:

- Deklarata e operatorit ekonomik që nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

-Nuk është kërkuar deklaratë se OE nuk vepron në kushtet e konfliktit të interesit në kundërshtim me nenin 41, pika b e VKM për Rregullat e prokurimit publik.

**-Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:**

Fituesi i këtij prokurimi, Mag Partners, nuk ka dorëzuar dokumentet e kërkuara në ftesën e ofertës si më poshtë:

Vërtetimi se nuk është dënuar për kryerjen e një vepre penale sipas parashikimeve në LPP;

Vërtetim se nuk është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për një vepër që ka lidhje me aktivitetin profesional të subjektit;

Vërtetim nga organet kompetente për pagesën e sigurimeve shoqërore për punonjësit. Për sa më sipër OE nuk ka plotësuar kriteret e përgjithshme të pranimit.

Mungesa e dokumentacionit të përmendur më lart e detyron autoritetin kontraktor të skualifikojë OE nga procedura, për të kaluar në OE të radhës.

13. Për procedurën me objekt “**Mbikëqyrje punimesh në objektin Rikonstruksion Diga e Rezervuarit- Anbreg-Kutë-Corrush**”, me fond limit 647,931 lekë.

-Nuk dokumentohet për llogaritja e fondit limit dhe metoda që është përdorur për llogaritjen e fondit limit.

-Nuk është kërkuar deklarata për konfliktin e interesit në kundërshtim me përcaktimet në nenin 41, pika 5, shkronja b.

**Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se OE nuk ka paraqitur:**

-Vërtetimi se nuk është dënuar për kryerjen e një vepre penale sipas parashikimeve në LPP;

-Vërtetim se nuk është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për një vepër që ka lidhje me aktivitetin profesional të subjektit;

-Vërtetim nga organet kompetente për pagesën e sigurimeve shoqërore për punonjësit. Për sa më sipër OE nuk ka plotësuar kriteret e përgjithshme të pranimit.

-Mungesa e dokumentacionit të përmendur më lart e detyron autoritetin kontraktor të skualifikojë OE nga procedura, për të kaluar në OE të radhës.

14. Për procedurën me objekt: “**Blerje materiale kancelarie**”, me fond limit 492,150 lekë. Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar:

-Deklarata për konfliktin e interesit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me përcaktimet në nenin 41, pika 5, shkronja b.

-Në specifikimet teknike për llojin e mallit “stilolaps”, është vendosur marka e stilolapsit, duke e përcaktuar kështu llojin dhe markën e mallit që kërkohet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenin 36, pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

-Nuk dokumentohet për llogaritja e fondit limit dhe metoda që është përdorur për llogaritjen e fondit limit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenin 76, pika 1 dhe 2, VKM nr.285. dt. 19.05.2021 për Rregullat e Prokurimit Publik.

### **Zbatimi i punimeve.**

Në zbatim të pikës 4.4/4 me objekt: “*Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik*” të Programit të Auditimit, në Bashkinë Mallakastër, nga ana e audituesve të KLSH-së, u auditua kontrata për punë publike, si më poshtë:

### **Mbi zbatimin e Kontratës së punimeve civile “Rikonstruksion i rrugës Bejar-Diga e rezervuarit”.**

Kontrata e punimeve civile “Rikonstruksion i rrugës Bejar-Diga e rezervuarit”, është nënshkruar me nr. 1424/9 prot., datë 19.08.2021, ndërmjet Bashkisë Mallakastër dhe Kontraktorit BOE “K SHPK & C M” SHPK, me vlerë 41,983,200 lekë me TVSH. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 6 muaj, referuar datës së fillimit të punimeve. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur BOE “L” SHPK & “K” SHPK, me të cilin është nënshkruar kontrata nr. 1982 prot., datë 11.08.2021. Njoftimi i fillimit të punimeve nga ana e Kontraktorit është bërë me datë 25.08.2021. Po në këtë datë është bërë njoftimi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve e cila është protokolluar në Bashkinë Mallakastër me nr. 2127/1. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit dhe akti i piketimit janë hartuar po në këtë datë.

Rikonstruksioni i rrugës ka të bëjë me:

-Punime në trupin e rrugës si skarifikim shtresë asfalti, shtresë me çakëll e gur guroreje, shtresë stabilizanti, shtresë binderi dhe asfaltbetoni.

-Punime vepra arti tombino tuba betoni Ø 600 mm deri 800 mm dhe mure betoni.

- Sinjalistikë rrugore (vijëzim gjatësor).

Gjatë zbatimit të kontratës janë konstatuar shtesa dhe ndryshime të volumeve faktike, për të cilat është mbajtur procesverbali datë 13.06.2022. Në këtë procesverbal përcaktohet se ndryshimet e volumeve të punimeve kanë ardhur si rezultat i zbatimit të projektit me qëllim



përmirësimin e tij dhe matjeve faktike në objekt, me qëllim përmirësimin e funksionalitetit të objektit pa cenuar qëndrueshmërinë tij. Nga ndryshimi i volumeve në rritje dhe zbritje nuk ka rritje të kostos së investimit.

Bazuar në ditarin e punimeve, punimet kanë filluar me datë 25.08.2021 dhe kanë përfunduar datë 30.07.2022. Njoftimi i fillimit të punimeve nga ana e Kontraktorit është bërë me datë 25.08.2021 dhe i përfundimit me datë 30.07.2022. Nga data 20.09.2021 deri me datë 18.11.2021, nuk është punuar për arsye të pezullimit nga nevoja për rishikimin e projektit. Nga data 18.12.2021 deri datë 27.03.2022, nuk është punuar për arsye të kushteve të papërshtatshme të motit. Bazuar në sa më sipër, zbatimi i punimeve konsiderohet i realizuar brenda periudhës së përcaktuar në kontratë.

Për kolaudimin e punimeve është përzgjedhur Shoqëria "P.C" SHPK, përfaqësuar nga znj. V.G, me të cilën është nënshkruar Kontrata nr. 5860/1 prot., datë 24.11.2022. Kolaudimi i punimeve është realizuar me datë 01.12.2022. Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve është lëshuar me datë 01.12.2022.

Deri në momentin e auditimit, është likuiduar vlera 30,135,251 lekë me TVSH.

Nga auditimi konstatohen mangësi si më poshtë:

**Titulli i gjetjes:** Referencë e gabuar në përcaktimin e çmimit për zëra të rinj punimesh.

**Situata:** Në ndryshimet përfshihet edhe një zë i ri punimi "Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zakonshme, kategoria III, me shkarkim në mjet + transport deri 3 km". Për këtë zë është vendosur çmimi 344 lekë/m<sup>3</sup>, kjo si përlllogaritje e çmimeve të përcaktuara në manual konkretisht analiza 3.89/a "Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zakonshme, kategoria III, me shkarkim në mjet" me çmim 361 lekë/m<sup>3</sup> dhe sipas analizës sipas analizës 3.158/5a "Transport dheu me auto deri 5 km" me çmim 266 lekë/m<sup>3</sup>. Mbledhja e këtyre dy çmimeve rezulton 627 lekë/m<sup>3</sup>. Në relacionin e datës 13.06.2022, përcaktohet se çmimi i negociuar është llogaritur nga përqindja e uljes së preventivit të ofertës nga fondi limit i objektit, e cila është 54.8 %, nga ku ka rezultuar çmimi 344 lekë/m<sup>3</sup>.

Referuar distancës së transportit 3 km, referenca e analizës 3.158/5a është e gabuar (i përket distancës 5 km), pasi kësaj distancë i përket analiza 3.158/3a "Transport dheu me auto deri 3 km", me çmim 223 lekë/m<sup>3</sup>.

Nga përlllogaritja rezulton se çmimi sipas manualit duhet të ishte 584 lekë. Zbritja në nivelin 54.8 % rezulton në çmimin 320 lekë/m<sup>3</sup>. Sa më sipër, nga ana e Kontraktorit është përfituar më shumë vlera 81,216 lekë [3384 m<sup>3</sup> (344 lekë/m<sup>3</sup> – 320 lekë/m<sup>3</sup>)].

Nga verifikimi i disa zëra punimesh të realizuara në objekt rezultoi se sipas zërit III.1 "Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm, termoplastike sprajt (3 vija)" nuk janë realizuar vijëzimet që përcaktojnë gjerësinë e rrugës në xhepa. Sasia e situacionuar është 209 ml. Vlera 31,350 lekë (209 ml x 150 lekë/ml), është certifikuar padrejtësisht.

**Kriteri:** VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", kreu II, pika 4.1.

**Ndikimi:** Përfitim i padrejtë.

**Shkaku:** Referencë e gabuar për çmimin e punimeve.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër të marrë masa për zbritjen e vlerës 112,566 lekë nga vlera e garancisë së punimeve të Kontraktorit BOE "K SHPK & C M" SHPK, për përfitim të padrejtë si referencë e gabuar e çmimit për zëra të rinj punimesh, si dhe për punime të certifikuara dhe të pa realizuara.

**Titulli i gjetjes:** Mangësi në hartimin e dokumentacionit teknik.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike, konkretisht librit të masave, konstatohet se për zëra të punimeve si shtresa rrugore (përjashtuar xhepat), gërmim dheu etj., volumet e përcaktuara në librezën e masave janë hartuar duke marrë si produkt gjatësinë

ndërmjet piketave dhe gjerësi mesatare e cila është përcaktuar e njëjtë për të gjithë gjatësinë e rrugës, duke mos reflektuar në mënyrë të saktë volumin sipas prerjeve tërthore. Sipas zërit “Gërmim dhe me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zakonshme, kategoria III, me shkarkim në mjet + transport deri 3 km”, sasia është përcaktuar nga produkti i gjatësisë 4000 m me volum 1 m<sup>3</sup>/ml, pasojë e të cilit nuk mund të bëhen sondazhe për seksione të caktuara për të vërtetuar saktësinë e volumeve të raportuara.

Po ashtu vijëzimi gjatësor në anën e majtë të rrugës nuk është realizuar në gjerësinë 12 cm, por 11 cm.

Shtresat asfaltike ndërmjet kilometër 1 dhe kilometër 2, kanë pësuar dëmtime serioze, të cilat mund të kenë ardhur si pasojë e ngopjes së nënshtresave me ujë, por edhe të kalimit të automjeteve të tonazhit të rëndë, të cilat transportojnë material ndërtimi për punimet që po realizohen për ndërtimin e segmentit rrugor “Rezervuari i Bregasit-Kutë”.

**Kriteri:** Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu III, pika 4.

**Ndikimi:** Nuk mund të verifikohet me saktësi volumi i punimeve të realizuara në fakt. Vështirësi në qarkullimin e automjeteve.

**Shkaku:** Neglizhencë në përgatitjen e dokumentacionit.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër të marrë masa për rritjen e monitorimit të kontratave të punimeve civile, për plotësimin me saktësi dhe konformë kërkesave ligjore të dokumentacionit të dosjes teknike.

**Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër të marrë masa për vendosjen e tabelave kufizuese për tonazh sipas aftësisë mbajtëse të shtresave rrugore të projektuara. Të kërkohet nga Kontraktori riparimi i defekteve të shtresave asfaltike, por dhe defekteve të tjera të mundshme, para përfundimit të periudhës së garancisë së riparimit të defekteve.

Dëmtime të shtresave rrugore paraqiten si më poshtë:



### **III.2.5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.**

Për auditimin e pikës 5 “Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, u shqyrtua:

-Dokumentacioni mbi lejet e ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerje punimesh dhe certifikatat e përdorimit për subjektet përfitues të lejeve të ndërtimit për periudhën 01.07.2021-31.12.2021;

-Ligji nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;

-VKM nr.408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar;

-Paketa fiskale për vitin 2022 mbi shkallën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja.

**Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar.**

Këshilli Kombëtar i Territorit në përputhje me ligjin Nr.107/2017, Datë 31.07.2014 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar dhe VKM Nr.408, Datë13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, **Bashkia Mallakastër me Vendim të Këshillit të Bashkisë me Vendim Nr.29, Datë 24.06.2020** (Shkresë Nr.1410/1 Regj., Dt.26.06.2020 Bashkia Mallakastër) për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkia Mallakastër. Ky Plan mbulon Territorin e Bashkisë Mallakastër me sipërfaqe **329.4 km<sup>2</sup>**, ku përfshihen **9** (nëntë) Njësi Administrative. Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë së bashku me tarifatat që aplikohen në aplikimet që kryhen në sistemin e-leje, janë të përcaktuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, në paketën fiskale vjetore, përkatësisht: **V.K.B Nr.45, datë 25/11/2021** (Shkresë Nr.3940 Regj., datë **26.11.2021** **Bashkia Mallakastër për vitin 2022.**

Zyra e Planifikimit të Territorit në Bashkinë ka ushtruar funksionet dhe detyrat e saj bazuar në ligjin Nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar si dhe V.K.M.-së Nr.408, Datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me V.K.M.-në Nr.271 Datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në V.K.M.-në Nr. 408 Datë 13.05.2015”.

Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) për territorin administrativ të Bashkisë Mallakastër ka nisur procesin e hartimit në kuadër të prokurimit të shërbimit të konsulencës nga ish Ministria e Zhvillimit Urban për Hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore për 26 Bashki në Shqipëri, “Hartimi i planeve të përgjithshme vendore për bashkitë...”, dhe është miratuar me Vendimin Nr. 07, datë 14.10.2020 i Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Mallakastër”.

**Bashkia Mallakastër, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022**, ka pasur **51** (pesëdhjetë e një) aplikime në sistem për leje zhvillimi, leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup>, leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>, leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup>, leje për prishje objekti, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim projekti, leje për ndryshim subjekti zbatues, leje për shtyrje afati punimesh, njoftim fillim punimesh, njoftim raport mbikqyrje dhe certifikata përdorimi, përkatësisht:

- **16** (gjashtembëdhjetë) kërkesa për leje zhvillimi;
- **9** (nëntë) kërkesa për leje ndërtimi;
- **5** (pesë) kërkesa për certifikatë përdorimi;
- **6** (gjashtë) kërkesa për deklaratë paraprake punimesh;
- **3** (tre) kërkesa për ndryshim projekti gjatë ndërtimit;
- **2** (dy) kërkesa për leje shtyrje afati punimesh;
- **2** (dy) kërkesa për leje ndryshim subjekti zbatues;
- **6** (gjashtë) kërkesa për deklaratë paraprake punimesh;
- **5** (pesë) kërkesa për njoftim fillim punimesh;
- **3** (tre) kërkesa për njoftim raport mbikqyrje.

Në kërkesat e paraqitura për aplikimet e mësipërme një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk janë miratuar e më konkretisht:

1. Nga **16** kërkesa për leje zhvillimi, **9** kërkesa janë miratuar dhe **7** kërkesa janë refuzuar;
2. Nga **10** kërkesa për leje ndërtimi (përfshirë leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup>, leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>, leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup>, për leje prishje), **8** kërkesa janë miratuar dhe **2** kërkesa janë refuzuar;
3. Nga **5** kërkesa për certifikatë përdorimi, **1** kërkesë është miratuar dhe **4** kërkesa janë refuzuar;
4. Nga **3** kërkesa për leje ndryshim projekti gjatë ndërtimit, **2** kërkesa janë miratuar dhe **1** kërkesë është refuzuar;
5. Nga **2** kërkesa për leje shtyrje afati punimesh, **1** kërkesë është miratuar dhe **1** kërkesë është refuzuar;

6. Nga **2** kërkesa për leje ndryshim subjekti zbatues, të dy kërkesat janë miratuar;
7. Nga **6** kërkesa për deklaratë paraprake punimesh, **5** kërkesa janë miratuar dhe **1** kërkesë është refuzuar;
8. Nga **5** kërkesa për njoftim fillim punimesh, **5** kërkesat janë miratuar;
9. Nga **3** kërkesa për njoftim raport mbikqyrje, **2** kërkesa janë miratuar dhe **1** kërkesë është refuzuar.

**Nga auditimi u konstatua se**, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 në Bashkinë Mallakastër nuk është miratuar Leje Ndërtimi për subjekte private në pronë shtetërore. Të gjitha Lejet Mallakastër e miratuara kanë qënë në truall privat të personave apo subjekteve që kanë aplikuar dhe janë pajisur me leje ndërtimi. Nga auditimi i lejeve infrastrukturore dhe lejeve ndërtimore me zhvillues Bashkia rezultoi se për periudhën objekt auditimi nga Janar 2022 deri Dhjetor 2022 nuk janë dhënë leje infrastrukturore nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe asnje leje ndërtimi me Zhvillues Bashkia Mallakastër.

Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 nga sistemi e-Leje			
Nr.	Përshkrimi i lejes	Numri i aplikimeve	Numri i miratimeve
1	Certifikatë përdorimi	5	1
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	6	5
3	Leje infrastructure	0	0
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	6	5
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	0	0
6	Leje për ndryshim funksioni	0	0
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	3	2
8	Leje për prishje objekti	1	1
9	Leje përshtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	2	1
10	Njoftim për raport mbikqyrje	3	2
11	Leje zhvillimi	16	9
12	Njoftim për fillim punimesh	5	5
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	2	2
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	1	1
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	1	1

### **Situata:**

**I. Cështja me Nr. 650 Prot., Datë 22.02.2022 sipas aplikimit në sistemin e leje.**

**Objekti: “Ndërtim Magazine për produkte bujqësore”**

**Leje Zhvillimi:** Vendim Nr.09 Datë 20.12.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me zhvillues P.B për pasuritë me Nr.3\38, në Zk.3191.

**Leje ndërtimi :** Vendim Nr.03 Datë 25.02.2022 të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër.

**Me zhvillues:** P.B me subjekt zhvillues shoqerine EB 2000 Sh.P.K.

**Të dhëna për pasuritë:** Pasuritë me: Nr.3\38, në Zk.3191, në pronësi P.B, me sipërfaqe 8658m<sup>2</sup>, me adresë në fshati Rromes, Njesia Administrative Hekal, Bashkia Mallakastër sipas paraqitjes grafike të fragmentit të hartës në gjendjen ekzistuese. Gjendja e dokumentacionit sipas sistemit e-leje krahasuar me bazën ligjore, paraqitet sipas tabelave të më poshtme:

Nr.	Dokumentacioni që duhet të dorëzojë aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi sipas nenit 15, të VKM nr.408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së zhvillimit të territorit”	Po/Jo	Shënime/ Komete
1	Kërkesa për leje ndërtimi, sipas formatit të aplikimit	Po	E rregullt
2	Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronësisë	Po	Të rregullta
3	Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese	Po	Jo i rregullt
4	Projekti i ndërtimit dhe relacioni përkatës	Po	E rregullt
5	Grafiku paraprak i punimeve	Po	I rregullt
6	Deklarata e projektuesit të licencuar (arkitekt, inxhinierë konstruktor, elektrik, MNKZ, hidraulik)	Po	Të rregullta
7	Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme	Po	Të rregullta
8	Kopje e policës së sigurimit të projektuesve, për mbulimin e përgjegjësive profesionale	Po	E rregullt
9	Mandat pagesa(t) e tarifës/tarifave të aplikimit	Po	E rregullt
10	Studimi sizmik, gjeologjik	Jo	mungese
11	Projekti arkitektonik	Po	I rregullt
12	Projekti konstruktiv	Po	I rregullt
13	Projekti i instalimeve elektrike	Po	I rregullt
14	Projekti i instalimeve hidraulike	Po	I rregullt
15	Projekti i instalimeve ngrohje-ftohje	Po	I rregullt
16	Projekti për mbrojtjen nga zjarri MNZ /Në rastin kur është i detyrueshëm me ligj	Po	I rregullt
17	Projekti i eficiencës energjetike AEE / Në rastin kur është i detyrueshëm me ligj	Jo	mungese
Nr.	Licencat që duhet të disponojnë projektuesit sipas projekteve përkatëse	Po/Jo	Shënime/ Komete
1	Licenca për projektin arkitektonik	Po	
3	Licenca për projektin konstruktiv	Po	
4	Licenca për projektin elektrik	Po	

5	Licenca për projektin hidraulik	Po	
6	Licenca për projektin ngrohje-ftohje	Po	
7	Licenca për projektin MNZ	Po	
8	Licenca për AEE	Jo	Mungesë
9	Licenca për VNM	Jo	Mungesë
<b>Nr.</b>	<b>Miratimet nga Institucionet e tjera</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Shënime/ Komente</b>
1	Miratimi nga AZHT	Jo	Mungesë
2	Miratimi nga AKM	Jo	Mungesë
3	Miratimi nga OST	Jo	mungesë
4	Miratimi nga ASHK	Jo	Mungesë
5	Miratimi nga UK	Jo	Mungesë
6	Miratimi nga AKZM	Jo	Mungesë
7	Miratimi nga AEE	Jo	Mungesë
<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja e lejes së ndërtimit sipas nenit 16 të VKM nr.408</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Shënime/ Komente</b>
1	Data dhe numri i lejes së ndërtimit, që korrespondon me numrin e praktikës në Regjistrë	Po	
2	Data dhe numri i vendimit të Kryetarit për miratimin e lejes	Po	
3	Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve	Po	
4	Të dhënat identifikuese të pronarit të tokës	Po	
5	Adresa dhe kufijtë e pasurisë	Po	
6	Të dhënat identifikuese të zhvilluesit	Po	
<b>Nr.</b>	<b>Vërtetimi për riskun e subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi sipas VKM 1162, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për paisjen me vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë paisje me leje zhvillimi/leje ndërtimi".</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Shënime/Komente</b>
1	Projekti inxhinierik i certifikuar	-	
2	Studimi sizmologjik	Jo	Mungesë
3	Studimi gjeologjik:	Jo	Mungesë
4	Projekti teknik i sigurisë nga zjarri dhe shpërthimet, i miratuar nga shërbimi qendror i MZSH-së	Po	
5	Plani kundër rrezatimit/ose vërtetim për mos ekspozimin	-	
6	Studimi hidrik i ujërave nëntokësore dhe i burimeve ujore që mund të cenojnë zonën ku zhvillohet projekti.	-	

### Krahasimi i treguesve

Krahasimi i treguesve parametrik ndërmjet projektit të zbatimit dhe pasaportës së njësisë strukturore	Sipas projektit të zbatimit dhe planvendosjes	Sipas Rregullores dhe Pasaportës së Njësisë Strukturore
Njësia Strukturore	_MK_B_B2_111\214	_MK_B_B2_111\214 (Total bujqësi)
Sipërfaqja e truallit që zhvillohet	8658m <sup>2</sup>	8658
Sipërfaqja e truallit të zënë nga struktura	248 m <sup>2</sup>	0
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë	248 m <sup>2</sup>	0
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit nën tokë	0 m <sup>2</sup>	0
Sipërfaqja totale e ndërtimit	248 m <sup>2</sup>	0
Numri i kateve	1 Kate	0 Kate
Lartësia maksimale e strukturës	5m	M
Distancat e strukturës nga trupi i rrugës	-	-
Koeficienti i Shfrytëzimit të Truallit (KSHT)	2.86 %	0%
Intesiteti i ndërtimit	0.0286 m <sup>2</sup> ndërtësë/ m <sup>2</sup> tokë	0 m <sup>2</sup> ndërtësë/ m <sup>2</sup> tokë

### Ligji/VKM/Rregullore/Kritere:

Duke u bazuar në Vendim Nr.11 datë 29.01.2019 Pika 1.4 Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Llogaritja e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI)						
Specifikimi i kati/	Numri i kateve	Koeficienti sipas nivelit të kateve	Sipërfaqja	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas paketës fiskale të miratuar	Çmimi/ m <sup>2</sup> (Lek)	Llogaritja e vlerës sipas nivelit të kateve (Lek)
Katet nëntoke	0	0	0m <sup>2</sup>	-	-	-
Kati përdhe	1	2.86	248 m <sup>2</sup>	2 %	8,575,794	<b>171,515 L</b>
Katet e sipërme	0	0	0 m <sup>2</sup>	-	-	-
<b>Vlera që duhet e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë</b>						
<b>Vlera e llogaritit nga Bashkia e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë</b>						<b>171,515 L</b>
<b>Diferenca e vlerës</b>						<b>.....</b>

### ➤ Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit Nr. 3, Date 28.12.2016 "Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar", dhe sipas V.K.B Nr.45, Datë 25/11/2021 (Shkresë Nr.3940 Regj., Dt.26.11.2021 Bashkia Mallakastër) për vitin 2022 "Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022".

## II. Cështja me Nr.3334 Prot., sipas aplikimit në sistemin e leje.

**Objekti:** “Ndërtim magazine grumbullimi për produkte bujqësore”

**Leje Zhvillimi:** Vendim Nr.01 Datë 04.05.2022 të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me zhvillues G.L për pasuritë me Nr.266\46, në Zk.1945.

**Leje ndërtimi:** Vendim Nr.07 Datë 18.08.2022 të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër.

**Me zhvillues:** G.L me subjekt shoqërinë ndërtuese “6D”.

**Të dhëna për pasuritë:** Pasuritë me: Nr.266\46, në Zk.1945, në pronësi G.L, me sipërfaqe 4980 m2 Arë, me adresë në Njësia Administrative Hekal, Bashkia Mallakastër sipas paraqitjes grafike të fragmentit të hartës në gjendjen ekzistuese.

Gjëndja e dokumentacionit sipas sistemit e-leje krahasuar me bazën ligjore, paraqitet sipas tabelave të më poshtme:

Nr.	Dokumentacioni që duhet të dorëzojë aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi sipas nenit 15, të VKM nr.408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullore së zhvillimit të territorit”	Po/Jo	Shënime/ Komete
1	Kërkesa për leje ndërtimi, sipas formatit të aplikimit	po	E rregullt
2	Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronësisë	po	Të rregullta
3	Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese	po	Jo i rregullt
4	Projekti i ndërtimit dhe relacioni përkatës	po	E rregullt
5	Grafiku paraprak i punimeve	po	I rregullt
6	Preventivi	po	00,000,000 L
7	Deklarata e projektuesit të licencuar (arkitekt, inxhinierë konstruktor, elektrik, MNKZ, hidraulik)	po	Të rregullta
8	Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme	po	Të rregullta
9	Kopje e policës së sigurimit të projektuesve, për mbulimin e përgjegjësive profesionale	po	E rregullt
10	Mandat pagesa(t) e tarifës/tarifave të aplikimit	po	E rregullt
11	Studimi sizmik, gjeologjik	Jo	Mungese
12	Projekti arkitektonik	po	I rregullt
13	Projekti konstruktiv	po	I rregullt
14	Projekti i instalimeve elektrike	po	I rregullt
15	Projekti i instalimeve hidraulike	po	I rregullt
16	Projekti i instalimeve ngrohje-ftohje	po	I rregullt
17	Projekti për mbrojtjen nga zjarri MNZ /Në rastin kur është i detyrueshëm me ligj	po	I rregullt
18	Projekti i eficientës energjetike AEE / Në rastin kur është i detyrueshëm me ligj	Jo	Mungese
Nr.	Licencat që duhet të disponojnë projektuesit sipas projekteve përkatëse	Po/Jo	Shënime/ Komete
1	Licenca për projektin arkitektonik	Po	
3	Licenca për projektin konstruktiv	Po	
4	Licenca për projektin elektrik	Po	
5	Licenca për projektin hidraulik	Po	
6	Licenca për projektin ngrohje-ftohje	Po	
7	Licenca për projektin MNZ	Po	
8	Licenca për AEE	Jo	Mungesë
9	Licenca për VNM	Jo	Mungesë
Nr.	Miratimet nga Institucionet e tjera	Po/Jo	Shënime/ Komete
1	Miratimi nga AZHT	Jo	Mungesë
2	Miratimi nga AKM	Jo	Mungesë
3	Miratimi nga OST	Jo	Mungesë
4	Miratimi nga ASHK	Jo	Mungesë
5	Miratimi nga UK	Jo	Mungesë
6	Miratimi nga AKZM	Jo	Mungesë
7	Miratimi nga AEE	Jo	Mungesë
Nr.	Përmbajtja e lejes së ndërtimit sipas nenit 16 të VKM nr.408	Po/Jo	Shënime/ Komete
1	Data dhe numri i lejes së ndërtimit, që korrespondon me numrin e praktikës në Regjistër	Po	
2	Data dhe numri i vendimit të Kryetarit për miratimin e lejes	Po	
3	Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve	Po	
4	Të dhënat identifikuese të pronarit të tokës	Po	
5	Adresa dhe kufijtë e pasurisë	Po	
6	Të dhënat identifikuese të zhvilluesit	Po	
Nr.	Vërtetimi për riskun e subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi sipas VKM 1162, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/ leje ndërtimi”.	Po/ Jo	Shënime/Komete
1	Projekti inxhinierik i certifikuar	Po	
2	Studimi sizmologjik	Jo	Mungesë
3	Studimi gjeologjik:	Jo	Mungesë
4	Projekti teknik i sigurisë nga zjarri dhe shpërthimet, i miratuar nga shërbimi qendror i MZSH-së	Po	
5	Plani kundër rrezatimit/ose vërtetim për mos ekspozimin	-	
6	Studimi hidrik i ujërave nëntokësore dhe i burimeve ujore që mund të cenojnë zonën ku zhvillohet projekti.	-	

## Krahasimi i treguesve

Krahasimi i treguesve parametrik ndërmjet projektit të zbatimit dhe pasaportës së njësive strukturore	Sipas projektit të zbatimit dhe planvendosjes	Sipas Rregullore dhe Pasaportës së Njësive Strukturore
Njësia Strukturore	_MK_B_B2_111/16	_UB_A2_318/3 (total bujqesi)
Sipërfaqja e truallit që zhvillohet	4980 m <sup>2</sup> arë (700 m <sup>2</sup> konvertim)	4980 m <sup>2</sup> arë (700 m <sup>2</sup> konvertim)
Sipërfaqja e truallit të zënë nga struktura	249 m <sup>2</sup>	0

Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë	249 m <sup>2</sup>	0
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit nën tokë	Nuk evidentohet- m <sup>2</sup>	0
Sipërfaqja totale e ndërtimit	249 m <sup>2</sup>	0
Numri i kateve	1 Kate	0Kate
Lartësia maksimale e strukturës	7.6	0 m
Distancat e strukturës nga trupi i rrugës	-	0
Koeficienti i Shfrytëzimit të Truallit (KSHT)	5 %	0 %
Intesiteti i ndërtimit	0.05m <sup>2</sup> ndërtesë/ m <sup>2</sup> tokë	0 m <sup>2</sup> ndërtesë/ m <sup>2</sup> tokë

### Ligji/VKM/Rregullore/Kritere:

Duke u bazuar në Vendim Nr.11 datë 29.01.2019 Pika 1.4 Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Llogaritja e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI)						
Specifikimi i katit/	Numri i kateve	Koeficienti sipas nivelit të kateve	Sipërfaqja	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas paketës fiskale të miratuara	Çmimi/ m <sup>2</sup> (Lek)	Llogaritja e vlerës sipas nivelit të kateve (Lek)
Katet nëntoke	0	-	-	-	-	-
Kati përdhe	1	5	249 m <sup>2</sup>	2 %	8,082,665.8	-
Katet e sipërme	0	-	-	-	-	-
<b>Vlera që duhet e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë</b>						-
<b>Vlera e llogaritur nga Bashkia e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë</b>						<b>161,654</b>
<b>Diferenca e vlerës</b>						<b>Ska</b>

### ➤ Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit Nr. 3, Date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, dhe sipas V.K.B Nr.45, Datë 25/11/2021 (Shkresë Nr.3940 Regj., Dt.26.11.2021 Bashkia Mallakastër) për vitin 2022 “Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022”.

### III. Çështja me Nr.3264 Prot., Datë 08.07.2022 , sipas aplikimit në sistemin e leje.

**Objekti:** Ndërtim objekt banimi 1 kat.

**Leje Zhvillimi:** Vendim Nr.03 Datë 01.06.2022 të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me zhvillues P.V për pasuritë me Nr.310\2, në Zk.2160.

**Leje ndërtimi:** Vendim Nr.06 Datë 08.07.2022 të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër

**Me zhvillues:** P.V, me subjekt shoqërinë ndërtues shoqërinë F Sh.P.K..

**Të dhëna për pasuritë:** Pasuritë me: Nr. 310\2, në Zk.2160, në pronësi P.V, me sipërfaqe 1720 m<sup>2</sup>, me adresë në fshati Klos, Njësia Administrative Hekal, Bashkia Mallakastër sipas paraqitjes grafike të fragmentit të hartës në gjendjen ekzistuese.

Gjendja e dokumentacionit sipas sistemit e-leje krahasuar me bazën ligjore, paraqitet sipas tabelave të mëposhtme:

Nr.	Dokumentacioni që duhet të dorëzojë aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi sipas nenit 15, të VKM nr.408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së zhvillimit të territorit”	Po/Jo	Shënime/ Komete
1	Kërkesa për leje ndërtimi, sipas formatit të aplikimit	po	E rregullt
2	Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronësisë	po	Të rregullta
3	Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese	po	Jo i rregullt
4	Projekti i ndërtimit dhe relacioni përkatës	po	E rregullt
5	Grafiku paraprak i punimeve	po	I rregullt
6	Preventivi	po	00,000,000 L
7	Deklarata e projektuesit të licencuar (arkitekt, inxhinierë konstruktor, elektrik, MNKZ, hidraulik)	po	Të rregullta
8	Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme	po	Të rregullta
9	Kopje e policës së sigurimit të projektuesve, për mbulimin e përgjegjësive profesionale	po	E rregullt
10	Mandat pagesa(t) e tarifës/tarifave të aplikimit	po	E rregullt
11	Studimi sizmik, gjeologjik	Jo	mungesë
12	Projekti arkitektonik	po	I rregullt
13	Projekti konstruktiv	po	I rregullt
14	Projekti i instalimeve elektrike	po	I rregullt
15	Projekti i instalimeve hidraulike	po	I rregullt
16	Projekti i instalimeve ngrohje-ftohje	po	I rregullt
17	Projekti për mbrojtjen nga zjarri MNZ /Në rastin kur është i detyrueshëm me ligj	po	I rregullt
18	Projekti i eficiencës energjetike AEE / Në rastin kur është i detyrueshëm me ligj	po	I rregullt
Nr.	Licencat që duhet të disponojnë projektuesit sipas projekteve përkatëse	Po/Jo	Shënime/ Komete
1	Licenca për projektin arkitektonik	Po	
3	Licenca për projektin konstruktiv	Po	
4	Licenca për projektin elektrik	Po	
5	Licenca për projektin hidraulik	Po	



6	Licenca për projektin ngrohje-ftohje	Po	
7	Licenca për projektin MNZ	Po	
8	Licenca për AEE	Po	
9	Licenca për VNM	Jo	Mungesë
<b>Nr.</b>	<b>Miratimet nga Institucionet e tjera</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Shënime/ Komete</b>
1	Miratimi nga AZHT	Jo	Mungesë
2	Miratimi nga AKM	Jo	Mungesë
3	Miratimi nga OST	Jo	Mungesë
4	Miratimi nga ASHK	Jo	Mungesë
5	Miratimi nga UK	Jo	Mungesë
6	Miratimi nga AKZM	Jo	Mungesë
7	Miratimi nga AEE	Jo	Mungesë
<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja e lejes së ndërtimit sipas nenit 16 të VKM nr.408</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Shënime/ Komete</b>
1	Data dhe numri i lejes së ndërtimit, që korrespondon me numrin e praktikës në Regjistër	Po	
2	Data dhe numri i vendimit të Kryetarit për miratimin e lejes	Po	
3	Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve	Po	
4	Të dhënat identifikuese të pronarit të tokës	Po	
5	Adresa dhe kufijtë e pasurisë	Po	
6	Të dhënat identifikuese të zhvilluesit	Po	
<b>Nr.</b>	<b>Vërtetim për riskun e subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi sipas VKM 1162, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/ leje ndërtimi".</b>	<b>Po/ Jo</b>	<b>Shënime/Komete</b>
1	Projekti inxhinierik i certifikuar	Po	
2	Studimi sizmologjik	Jo	Mungesë
3	Studimi gjeologjik:	Jo	Mungesë
4	Projekti teknik i sigurisë nga zjarri dhe shpërthimet, i miratuar nga shërbimi qendror i MZSH-së	Po	
5	Plani kundër rrezatimit/ose vërtetim për mos ekspozimin	-	
6	Studimi hidrik i ujërave nëntokësore dhe i burimeve ujore që mund të cenojnë zonën ku zhvillohet projekti.	-	

## Krahasimi i treguesve

Krahasimi i treguesve parametrik ndërmjet projektit të zbatimit dhe pasaportës së njësisë strukturore	Sipas projektit të zbatimit dhe planvendosjes	Sipas Rregullores dhe Pasaportës së Njësisë Strukturore
Njësia Strukturore	MK_UB_A1_83/8	MK_UB_A1_83/8
Sipërfaqja e truallit që zhvillohet	1720m <sup>2</sup>	1720
Sipërfaqja e truallit të zënë nga struktura	156 m <sup>2</sup>	-
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë	217.9 m <sup>2</sup>	-
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit nën tokë	0 m <sup>2</sup>	-
Sipërfaqja totale e ndërtimit	217.9 m <sup>2</sup>	206.4
Numri i kateve	1 Kate	2Kate
Lartësia maksimale e strukturës	5.6m	M
Distancat e strukturës nga trupi i rrugës	-	-
Koeficienti i Shfrytëzimit të Truallit (KSHT)	12.6 %	45%
Intesiteti i ndërtimit	0.12 m <sup>2</sup> ndërtesë/ m <sup>2</sup> tokë	0.12 m <sup>2</sup> ndërtesë/ m <sup>2</sup> tokë

## Bashkëngjitur përlllogaritja e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Bashkisë:

Llogaritja e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI)						
Specifikimi i katit/	Numri i kateve	Koeficienti sipas nivelit të kateve	Sipërfaqja	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas paketës fiskale të miratuar	Çmimi/ m <sup>2</sup> (Lek)	Llogaritja e vlerës sipas nivelit të kateve (Lek)
Katet nëntoke	0	-		-	-	-
Katë përdhe	1	12.6	217.9m <sup>2</sup>	2	31597	-
Katet e sipërme	1			-	-	-
<b>Vlera që duhet e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë</b>						-
<b>Vlera e llogaritit nga Bashkia e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë</b>						<b>138,244</b>
<b>Diferenca e vlerës</b>						<b>Ska</b>

### ➤ Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit Nr. 3, Datë 28.12.2016 "Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar", dhe sipas V.K.B Nr.45, Datë 25/11/2021 (Shkresë Nr.3940 Regj., Dt.26.11.2021 Bashkia Mallakastër) për vitin 2022 "Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022".

## IV. Çështja me Nr. 1658 Prot., Datë 29.03.2022, sipas aplikimit në sistemin e leje.

**Objekti: Ndërtim godine shërbimi 1 kat dhe 1 kate nëntokë.**



**Leje Zhvillimi:** Vendim Nr.08 Datë 22.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me zhvillues SH.A 24 Sh.P.K., për pasuritë me Nr.331\46 dhe 331\43, në Zk.2160.

**Leje ndërtimi :** Vendim Nr.05 Datë 28.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër.

**Me zhvillues:** SH.A 24 shpk me subjekt ndërtues shoqërinë T Sh.P.K.

**Të dhëna për pasuritë:** Pasuritë me: Nr. 331\46, në Zk.2160, dhe Nr.331\43 Zk.2160 në pronësi N shpk dhe G.M, me sipërfaqe 9200 m<sup>2</sup> dhe 7000 m<sup>2</sup>, me adresë në fshati Klos, Njësia Administrative Hekal, Bashkia Mallakastër sipas paraqitjes grafike të fragmentit të hartës në gjendjen ekzistuese.

Gjendja e dokumentacionit sipas sistemit e-leje krahasuar me bazën ligjore, paraqitet sipas tabelave të më poshtme:

Nr.	Dokumentacioni që duhet të dorëzojë aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi sipas nenit 15, të VKM nr.408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e Rregullores së zhvillimit të territorit"	Po/Jo	Shënime/ Komete
1	Kërkesa për leje ndërtimi, sipas formatit të aplikimit	Po	E rregullt
2	Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronësisë	po	Të rregullta
3	Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese	po	Jo i rregullt
4	Projekti i ndërtimit dhe relacioni përkatës	po	E rregullt
5	Grafiku paraprak i punimeve	po	I rregullt
6	Preventivi	po	00,000,000 L
7	Deklarata e projektuesit të licencuar (arkitekt, inxhinierë konstruktor, elektrik, MNKZ, hidraulik)	po	Të rregullta
8	Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme	po	Të rregullta
9	Kopje e policës së sigurimit të projektuesve, për mbulimin e përgjegjësiwe profesionale	po	E rregullt
10	Mandat pagesa(t) e tarifës/tarifave të aplikimit	po	E rregullt
11	Studimi sizmik, gjeologjik	Jo	Mungesë
12	Projekti arkitektonik	po	I rregullt
13	Projekti konstruktiv	po	I rregullt
14	Projekti i instalimeve elektrike	po	I rregullt
15	Projekti i instalimeve hidraulike	po	I rregullt
16	Projekti i instalimeve ngrohje-ftohje	po	I rregullt
17	Projekti për mbrojtjen nga zjarri MNZ /Në rastin kur është i detyrueshëm me ligj	po	I rregullt
18	Projekti i eficiencës energjetike AEE / Në rastin kur është i detyrueshëm me ligj	jo	Mungese
Nr.	Licencat që duhet të disponojnë projektuesit sipas projekteve përkatëse	Po/Jo	Shënime/ Komete
1	Licenca për projektin arkitektonik	Po	
3	Licenca për projektin konstruktiv	Po	
4	Licenca për projektin elektrik	Po	
5	Licenca për projektin hidraulik	Po	
6	Licenca për projektin ngrohje-ftohje	Po	
7	Licenca për projektin MNZ	Po	
8	Licenca për AEE	Jo	Mungesë
9	Licenca për VNM	Po	
Nr.	Miratimet nga Institucionet e tjera	Po/Jo	Shënime/ Komete
1	Miratimi nga AZHT	Jo	Mungesë
2	Miratimi nga AKM	Jo	Mungesë
3	Miratimi nga OST	Jo	Mungesë
4	Miratimi nga ASHK	Jo	Mungesë
5	Miratimi nga UK	Jo	Mungesë
6	Miratimi nga AKZM	Jo	Mungesë
7	Miratimi nga AEE	Jo	Mungesë
Nr.	Përmbajtja e lejes së ndërtimit sipas nenit 16 të VKM nr.408	Po/Jo	Shënime/ Komete
1	Data dhe numri i lejes së ndërtimit, që korrespondon me numrin e praktikës në Regjistër	Po	
2	Data dhe numri i vendimit të Kryetarit për miratimin e lejes	Po	
3	Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve	Po	
4	Të dhënat identifikuese të pronarit të tokës	Po	
5	Adresa dhe kufijtë e pasurisë	Po	
6	Të dhënat identifikuese të zhvilluesit	Po	
Nr.	Vërtetim për riskun e subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi sipas VKM 1162, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për paisjen me vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë paisje me leje zhvillimi/ leje ndërtimi".	Po/ Jo	Shënime/Komete
1	Projekti inxhinierik i certifikuar	Po	
2	Studimi sizmologjik	Jo	Mungesë
3	Studimi gjeologjik:	Jo	Mungesë
4	Projekti teknik i sigurisë nga zjarri dhe shpërthimet, i miratuar nga shërbimi qendror i MZSH-së	Po	
5	Plani kundër rrezatimit/ose vërtetim për mos ekspozimin	-	
6	Studimi hidrik i ujërave nëntokësore dhe i burimeve ujore që mund të cenojnë zonën ku zhvillohet projekti.	-	

## Krahasimi i treguesve

Krahasimi i treguesve parametrik ndërmjet projektit të zbatimit dhe pasaportës së njësisë strukturore	Sipas projektit të zbatimit dhe planvendosjes	Sipas Rregullores dhe Pasaportës së Njësisë Strukturore
Njësia Strukturore	MK_UB_S1_66\1	_MK_UB_S1_66\1
Sipërfaqja e truallit që zhvillohet	16200 m <sup>2</sup>	16200 m <sup>2</sup>
Sipërfaqja e truallit të zënë nga struktura	500 m <sup>2</sup> dhe 1329m <sup>2</sup>	-

Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë	1829	-
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit nën tokë	1012 m <sup>2</sup>	-
Sipërfaqja totale e ndërtimit	2341 m <sup>2</sup>	-
Numri i kateve	1 Kat	3 Kate
Lartësia maksimale e strukturës	11 m	7.5 m
Distancat e strukturës nga trupi i rrugës	-	-
Koeficienti i Shfrytëzimit të Truallit (KSHT)	11.29 %	50%
Intesiteti i ndërtimit	0.26m <sup>2</sup> ndërtesë/ m <sup>2</sup> tokë	0.26 m <sup>2</sup> ndërtesë/ m <sup>2</sup> tokë

### Ligji/VKM/Rregullore/Kritere:

Duke u bazuar në Vendim Nr.11 datë 29.01.2019 Pika 1.4 Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Llogaritja e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI)						
Specifikimi i kati/	Numri i kateve	Koeficienti sipas nivelit të kateve	Sipërfaqja	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas paketës fiskale të miratuar	Çmimi/ m <sup>2</sup> (Lek)	Llogaritja e vlerës sipas nivelit të kateve (Lek)
Katet nëntoke	1	-	1012 m <sup>2</sup>	-		-
Kati përdhe	1	11.29	1329 m <sup>2</sup> dhe 500 m <sup>2</sup> ekzistues	2		-
Katet e sipërme	0	-	-	-		-
<b>Vlera që duhet e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë</b>						-
<b>Vlera e llogaritur nga Bashkia e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë</b>						<b>1,479,372 leke</b>
<b>Diferenca e vlerës</b>						<b>Ska</b>

### ➤ Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit Nr. 3, Date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, dhe sipas V.K.B Nr.45, Datë 25/11/2021 (Shkresë Nr.3940 Regj., Dt.26.11.2021 Bashkia Mallakastër) për vitin 2022 “Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022”.

**Titulli i gjetjes:** “Mos ushtrimi i kontrolleve dhe moszbatimi i procedurave ligjore për miatimin e lejeve të ndërtimit.”

**Situata:** Nga auditimi i zbatimit të procedurave për miratimin e lejeve të ndërtimit u konstatuan mangësi në praktikat si vijon:

i) Çështja me Nr. 650 Prot., Datë 22.02.2022 sipas aplikimit në sistemin e\_ leje me objekt: “Ndërtim magazine për produkte bujqësore” në Mallakastër.

ii) Çështja me Nr.3334 Prot.,Dt.18.08.2022 sipas aplikimit në sistemin e\_ leje me objekt: “Ndërtim magazinë grumbullimi për produkte bujqësore”, në Mallakastër.

iii) Çështja me Nr.3264 Prot., Datë 08.07.2022, sipas aplikimit në sistemin e\_ leje me objekt: “Ndërtim objekt banimi 1 kat”, në Mallakastër.

iv) Çështja me Nr.1658 Prot., Datë 29.03.2022, sipas aplikimit në sistemin e\_ leje me objekt: “Ndërtim godinë shërbimi 1 kat dhe 1 kat nëntokë”, në Mallakastër.

### **Në të cilat është konstatuar:**

1. Mosrespektimi i distancave të lejuara nga objekti në objekt.
2. Mosrespektimi i distancave të lejuara nga objekti në kufirin e pronës.
3. Parregullsi në mënyrën e paraqitjes së projektit të miratuar.
4. Problematika në lidhje me dokumentat e pronësisë.
5. Problematika në hedhjen e Gis Kadastrës (për të cilën nuk kemi një sektor përkatës në këtë Bashki).
6. Mungesë në plotësim të dokumentacionit ligjor për lejet e ndërtimit (neni 15, 11, 10, 16) të VKM nr.408, datë13.05.2015“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.
7. Mospërputhje mes lejes zhvillimore dhe lejeve të ndërtimit si dhe planvendosjes së pronës, të dhënë për të njëjtin individ etj-etj.
8. Llogaritja në mënyrë jo të saktë të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë TNI etj.

➤ Sa më sipër rezultojnë referuar lejeve të ndërtimit të sipërcituara problematikat e konstatuara janë të njëjta në përgjithësi me kuptimin dhe zbatimin e ligjit në kontekst të VKM

Nr.408, Datë 13.05.2015“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin Nr.107/2014“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, ku vërehet që bien ndesh me disa nga pikat e bazës ligjore sipercituar; me Ligjin Nr. 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”; Ligji Nr.124/2015 “Per eficensen...”

Në dosjet e lejeve mungon dokumentacioni i plote tekniko-ligjor, specifikisht të katër pikat si më poshtë konstatohet që nuk procedohen në kërkesën për plotësim të tyre nga subjektet përfitues të lejeve dhe miratohen në mungesë, duke qënë në kundërshtim me nenin 15 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar:

➤ pikën e) Deklarata e projektuesit të licencuar, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit, nëpërmjet së cilës konfirmohet përputhshmëria e projektit me lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit, në fuqi, dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjieno-sanitare (dhe me VKM Nr.650/2019);

➤ pikën v) Projektin e eficencës energjetike, në rastet kur është e detyrueshme me ligj.

Konstatohet se ka mangësi në punimet e hedhjes së hartave nga sektori i Gis Kadastrës së Bashkisë Mallakastër, duke mos përcaktuar qartë kufijtë e pronës objekt zhvillimi, duke mos përcaktuar sakte gjëndjen faktike të terrenit me objektet informale si dhe me poseduesit e ligjshëm dhe të paligjshëm mbi pronat objekt zhvillimi e dhënie leje ndërtimi për to, për pasojë duke cuar në mozbatim të kriterëve, distancave dhe evidence te pronarëve, të cilat bien ë kundërshtim me nenin **10 (vkm 408\2015)**:

*pika c) dokument që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe, nëse ka, kopje të marrëveshjeve për pronën;*

*pika ç) planin e riveimit të pronës, në shkallë 1:500, nga topograf i licencuar; dhe në kundërshtim me Nenin 16:*

*pika d) të dhënat identifikuese të pronarit të tokës, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.408, Datë 13.05.2015“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. Rezulton që nuk kemi një sektor të krijuar për Gis Kadastrën në Bashkia Mallakastër për rrjedhojë lejet e zhvillimit dhe lejet e ndërtimit trajtohen me një plan riveimi, pa një riveim të saktë të pronës sipas gjëndjes aktuale dhe pa hedhje prone sipas Gis-it.*

➤ Konstatohet se për miratimin e lejes së ndërtimit nuk është marrë miratim nga insitucionet përkatëse si: Miratim nga AZHT, AKM, OST, ASHK, UK, AKZM dhe AEE kjo në kundërshtim me **Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, Datë 13.05.2015** “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” (neni 21, pika 6 e saj).

Konstatohet që në dosjet e lejes së ndërtimit mungon raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kundërshtim kjo me Ligjin Nr.10 440, Datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, neni 7 dhe 8 i saj.

➤ Konstatohet se Akt-Kontrollet janë në mungesë, Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe IMTV me përfaqësues: 1.Z.M.M, 2.Znj.B.V, 3.Z.A.X, në zbatim të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores se Zhvillimit të Territorit të ndryshuar **rezulton që nuk ka mbajtur Akt Kontrolli i Piketimit të Objektit në subjektët zhvillues.**

➤ Konstatohet se, në tokat bujqësore trajtuar me ligjin 7501/1991 i shfuqizuar, përfaqësuesit e familjes bujqësore nuk ka të drejtën të veprojnë pa nënshkrim për miratim nga anëtarët e tjerë. Në dosjen e lejes së zhvillimit dhe lejes së ndërtimit për keto raste nuk figuron të kemi **deklaratë noteriale nga anëtarët e familjes bujqësore viti 1991 dhe 1992 si dhe ajo aktuale në referim të ligjit nr.20\2020** “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe **vkm nr.1174 \2020** “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese”, ku të kemi miratim të anëtarëve për zhvillimin dhe ndërtimin mbi këtë pasuri duke qënë se kemi të bëjmë me familje bujqësore referuar certifikatës së pronësisë.

➤ Konstatohet se, nga auditimi i mandat pagesave që ndodhen në dosjen e çdo objekti, u konstatua se nga ana e Bashkisë nuk është llogaritur saktë taksa e ndikimit në infrastrukturë duke krijuar diferencën për vlerën 228,066 lekë vlerë e cila përben të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër (detyrim që duhet ta likujdojë subjekti). Diferenca e

mësipërme është krijuar si rrjedhojë e aplikimit të çmimit sipas koston mesatare të ndërtimit, referuar Udhëzimit nr.3, datë 28.06.2016 të Këshillit të Ministrave, ndërkohë duhet të ishte marrë çmimi sipas VKM Nr. 132, datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, konkretisht:

Sipërfaqja prej 1329 m<sup>2</sup> (volum ndërtimor) Mbitoka \* (31,597 lekë \* 1.5 herë më e lartë kur ndërtimi është shërbim) \* 2% = 1,259,772 lekë;

Sipërfaqja prej 1012 m<sup>2</sup> (volum ndërtimor) Nëntoka \* (70% \* 31,597 lekë) \* 2% = 447,666 lekë;

Gjithsej 1,707,436 lekë - 1,479,372 lekë = 228,066 lekë.

**Kriteri:** Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit” dhe VKM Nr. 408, Datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit, neni 15 (pika v, e); neni 10 (pika c, ç); neni 16 (pika d); neni 21 (pika 6); Ligji Nr.10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”; Ligji Nr.116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i rregullores së miratuar nga institucioni i cili nuk ka siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit duke mos krijuar kushte të përshtatshme, të drejta dhe shanse të barabarta për banim. Gjithashtu mosrespektim të ligjit dhe moszbatim të tij në nivel procedural duke sjell parregullsi juridike në cdo akt të prodhuar nga institucioni.

**Shkaku:** Mos respektimi i përcaktimeve të Ligjit Nr.107, Datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, të VKM Nr.408, Datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtorja e Planifikimit të Territorit, të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit të munguar në lejet e ndërtimit të miratuara përgjatë periudhës 2022, si dhe bashkërendimin e punës, vlerësimin dhe marrjen në konsideratë të mendimeve të autoriteteve publike kompetente gjatë aplikimit deri në miratimin e lejes së ndërtimit.

**Rekomandimi:** Drejtorja e Planifikimit të Territorit në bashkëpunim me Sektorin e Tatim-Taksave Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën 228,066 lekë ndaj subjektit “Sh. A. 24” Sh.P.K, si rrjedhojë e diferencës së krijuar nga përllogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

### **III.2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).**

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit, grupi i auditimit, për periudhën objekt auditimi 01.01.2022 – 31.12.2022, kërkoi vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme siç janë, struktura e IVMT dhe formimi profesional i stafit të kësaj strukture, dosjet e procedurave të mbajtura nga IVMT, në të cilat duhet të përfshihen procesverbalet e konstatimit të mbajtura nga inspektorët, vendimet e gjobave, vendimet e pezullimit, vendimet e prishjeve dhe procesverbalet e ekzekutimit të këtyre prishjeve, kallëzimet penale, kërkesat drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv, informacioni periodik 3 mujor që dërgohet pranë IVMT, planet vjetore dhe planet mujore të punës të miratuara nga kryeinspektori.

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, u konstatua si më poshtë vijon:*

➤ **Vlerësimi i nivelit të kontrollit të territorit bazuar në organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IVMT).**

#### **Mbi krijimin e organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit.**

Struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë Mallakastër (IVMT) për vitin 2022 është miratuar me VKB Nr.01, Datë 18.05.2020, “Për miratimin e rregullores për

organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë Mallakastër”, ku përfshihet Inspektoratit së Mbrojtjes së Territorit Vendor e cila përbehet nga **3** punonjës, nga të cilët **1** kryeinspektor dhe **2** inspektorë në fakt aktualisht në punë janë tre punonjës, Kryeinspektori dhe dy Inspektori në formë tabele paraqitet si vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni sipas strukturës	Lloji i arsimit/degë	Data emërimit në detyrë	Aktualisht në punë apo larguar, data
1	A.X	Kryeinspektor	I Lartë, Ing.Ndërtimi	06.04.2016	Në punë
2	A.S	Inspektor	Drejtimi	19.08.2016	Në punë
3	SH.X	Inspektor	Teknik i Mesem	14.10.2019	Në punë

Burimi: Sektori i Burimeve Njerëzore, Bashkia Mallakastër

Arsimimi i inspektorit **Z.A.S** të inspektoratit ndërtimor e urbanistik (IVMT) Mallakastër është në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në ligjin Nr.9780, Datë 16.07.2007“Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin Nr.183/2014 “Për inspektimin e ndërtimit” neni 11 “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit”, ku përcaktohet se: “*Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjes vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.*

Nga auditimi u konstatua se Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Mallakastër i ushtron funksionet e veta **jo në përputhje të plotë me ligjin Nr. 9780, Datë 16.07.2007** “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, me qëllim mbrojtjen e territorit nga ndërhyrjet e paligjshme si dhe kontrollin ndërtimor të pajisura me leje. Nga IVMT Mallakastër u evidentua se në fillim të vitit është hartuar një program për kontroll periodik të territorit nga ana e tyre, me qëllim parandalimin dhe evidentimin e ndërhyrjeve (kryesisht të ndërtimeve pa leje) të paligjshme, duke i detajuar me plane-kontrolli mujore.

Vërehet që plani i punës nuk është zbatuar nga ana e sektorit të IVMT-së të Bashkisë Mallakastër për vitin 2022 duke sjell një mungesë aktiviteti dhe funksionimi në përmbajtje të tij. Në evidencë të planeve mujore dhe akt kontrollit e kryera sipas planeve të punës të përcaktuar në cdo muaj kalendarik për vitin 2022 ku rezultojnë 34 Akte Kontrolli gjithsej për këtë vit, si më poshtë:

- 1.Janar - 4 Akte Kontrolli, Njësia Administrative Qëndër, Fratar dhe Aranistas (sipas akt kontrolleve nuk u konstatuan ndërtime të paligjshme).
- 2.Shkurt – 3 Akte Kontrolli, Njësia Administrative Qëndër dhe Fratar (sipas akt kontrolleve nuk u konstatuan ndërtime të paligjshme).
- 3.Mars – 4 Akte Kontrolli, Njësia Administrative Aranistas dhe Ngracar (sipas akt kontrolleve nuk u konstatuan ndërtime të paligjshme).
- 4.Prill - 3 Akte Kontrolli, Njësia Administrative Greshicë dhe Hekal (sipas akt kontrolleve nuk u konstatuan ndërtime të paligjshme).
- 5.Maj – 3 Akte Kontrolli, Njësia Administrative Kute dhe Fratar (sipas akt kontrolleve nuk u konstatuan ndërtime të paligjshme).
- 6.Qershor - 4 Akte Kontrolli, Njësia administrative Aranistas, Greshicë dhe Fratar (sipas akt kontrolleve nuk u konstatuan ndërtime të paligjshme) dhe dy mbikëqyrje punimesh, 2 Akte Kontrolli, Njësia Administrative Hekal (sipas akt kontrollit objekti me Zhvillues B.P etj ishte sipas LND) dhe (sipas akt kontrollit objekti me zhvillues B.H ishte sipas LND).
- 7.Korrik – 3 Akte Kontrolli, Njësia Administrative Ngracan dhe Aranistas (sipas akt kontrolleve nuk u konstatuan ndërtime të paligjshme).
- 8.Gusht - 1 Akt Kontrolli, Ballsh (sipas akt kontrollit nuk u konstatua ndërtim i paligjshëm).
- 9.Shtator - 3 Akte Kontrolli, Njësia Administrative Fratar dhe Greshicë (sipas akt kontrolleve nuk u konstatuan ndërtime të paligjshme).
10. Tetor – 4 Akte Kontrolli, Njësia Administrative Hekal, Qëndër, Fratar dhe Greshicë (sipas akt kontrolleve nuk u konstatuan ndërtime të paligjshme).
11. Nëntor - 2 Akte Kontrolli, Njësia Administrative Fratar (sipas akt kontrolleve nuk u konstatuan ndërtime të paligjshme).
12. Dhjetor - 2 Akte Kontrolli, Ballsh (sipas akt kontrolleve nuk u konstatuan ndërtime të paligjshme).

Në shqyrtim të tyre vërehet që ka një plan pune cdo muaj me përcaktimin e detyrave por në vetvete mbeten të pazbatueshme, aktet e kontrollit janë në formë shkresore në konstatimet e kryera por nuk kanë të përcaktuar dokument ligjor për to si dhe nuk ka një relativitet mbi pikat e programit të cdo muaji të pa ndjekura nga ana e tyre.

Gjithashtu vërehet që nuk është ushtruar kontroll në shumë subjekte të pajisura leje ndërtimi me qëllim kjo garantimin e zbatimit të punimeve konform lejes së miratuar, për të cilat duhen mbajtur aktet e kontrollit në të cilat përshkruhen të gjitha rezultatet e konstatuara, veprim ky në kundërshtim me shkronjën “a” në nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

**Në aktin e kontrollit të datës 28.09.2022**, plan pune për muajin Tetor 2022, ky akt figuron i pa firmosur nga Drejtori Z.H.M si dhe në plan pune për këtë muaj në pikën 7 të saj shënohet për kontroll zhvilluesit A.Z pajisur me leje ndërtimi Nr.04., Dt.24.08.2020, rezulton që ska një akt kontrolli apo konstatimi për të si dhe ndonjë relacion për shtyrje afati muajin e ardhshëm për kontroll dhe mbikëqyrje sipas parashikimeve ligjore në zbatim të ligjit **Nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar. Konstatohet se IVMT Bashkia Mallakaster nuk bashkëvepron me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të lejeve të ndërtimit me qëllim që cdo leje e miratuar të finalizohet në kushtet e përcaktuara ligjore.**

### **Përshkrimi i situatës për periudhën 01/01/2022-31/12/2022**

Në lidhje me auditimin e kryer të dokumenteve të vëna në dispozicion nga zyra e IVMT, për ushtrimin e kontrollit në terren të kontrollit mbi territorin e Bashkisë, nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Mallakastër për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2022 rezultoi se janë mbajtur gjithsej **34 akte kontrolli** në njësitë administrative përfshirëse të Mallakastrës për ndërtime pa leje, në zbatim të nenit 12, të ligjit Nr. 9780, Datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

Në lidhje me realizimin e të ardhurat nga gjobat e vendosura nga Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë (IVMT) konstatohet se:

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale IVMT, Bashkia Mallakastër, sipas evidencave të vëna në dispozicion për periudhën objekt auditimi, rezultoi se:

- Për vitin 2022 nuk është konstatuar asnjë ndërtim pa leje dhe për rrjedhojë nuk ka vendime për marrje të masave administrative apo kallzime për ndjekje penale.
- Janë vetëm dy (2) gjoba të pa arkëtuara të cilat ndiqen nga Drejtoria Juridike.

### **Në formë tabelle paraqiten vendimeve të marra nga IVMT për vitin 2022 si vijon:**

Nr.	Lloji i aktit	2022
1	PV/Akte kontrolli	34
2	PV/Akte konstatimi	0
3	Vendime gjobe	2
4	Vendime pezullimi	0
5	Vendime prishje	0
6	PV ekzekutimi të prishjeve	0
7	Kallëzime penale	0
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	0
9	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	0
10	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	1
11	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	12

### **Burimi i krijimit të të ardhurave, bazuar në kuadrin rregullator ligjor / nënligjor në fuqi.**

**Titulli i gjetjes:** *Krijimi i debitorëve nga mos arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IVMT) në vlerën 200,000 lekë në total.*

**Situata:** Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IVMT) të Bashkisë Mallakastër për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si vijon:

Subjekte kundërvajtës të konstatuar IVMT, Bashkia Mallakastër					
Nr	Subjekti	Kundërvajtja	Process-verbal nr./datë	Vlera e gjobës Lekë	Arkëtuar dhe shfuqizuar me vend. Gjyk.
4	"M" shpk	Shkelje e afatit të përfundimit të punimeve	6, 06.12.2019	100,000	Në proces gjyqësor, ndiqet nga drejtoria juridike
5	"M.K" shpk	Shkelje e afatit të përfundimit të punimeve	8, 25.02.2020	100,000	Ndiqet nga Drejt.Juridike
	Total			200,000	Pa arkëtuar

**Për vitin 2022 nuk është konstatuar asnjë ndërtim pa leje dhe për rrjedhojë nuk ka vendime për marrje të masave administrative apo kallzime për ndjekje penale.**

Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMT, për subjektet të cilat kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMT, rezulton që janë vetëm dy (2) gjoba të pa arkëtuara në vlerën **200,000 lekë në total** (nga 100,000 lekë për secilin) me kundërvajtës subjektin "M" shpk dhe subjektin "M.K" shpk, ku nuk është kryer asnjë veprim ndaj tyre.

Me shkresë Nr.5498 Prot., Datë 08.11.2022, Bashkia Mallakastër ka bërë njoftimin për shpërbllim dëmi dhe procesi është në ndjekje nga Drejtoria Juridike.

Konstatohet se për dy gjobat e mëposhtme nuk është përlllogaritur kamatë-vonesë, në masën 2%<sup>38</sup> të vlerës së gjobës për 30 ditë vonesë, ose 60,000 lekë kamatë-vonesë për gjobë, **duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën 320,000 lekë gjithësej (2 gjoba + kamatëvonesë).**

Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikat IVMT-ja, Drejtoria Juridike nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën prej **320.000lekë**, në kundërshtim me:

**a-neni 16**, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime, **përcaktohet se:** -Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj.** Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.

**-Neni 15-**(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni ) (Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3);

**b-**nuk janë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobës) të përcaktuara në nenet, 9,22 dhe 30, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

**c-**Nga Drejtoria Juridike dhe IVMT, nuk është kërkuar në Gjykatë, shndërrimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar.

**d-**Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IVMT) dhe Drejtoria Juridike të Bashkisë Cërrik nuk ka marrë masat dhe nuk ka kërkuar në Gjykatë rivendosjen në afat të 31 vendimeve të gjobave në vlerën **320,000 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996, "Kodi i Procedurës Civile në RSH" i ndryshuar, nenet 17 dhe 55- Vënia në ekzekutim, shkronja (ç) **ku përcaktohet se:** Vënia në ekzekutim e urdhrit të ekzekutimi bëhet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kreditorit dhe nenet 151 dhe 152, të "Kodit Procedurës Civile në RSH-se".

**Kriteri:Neni 16**, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime; **Neni 15-**(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni ) (Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3); - **Nenet**, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

**Shkaku:**Mos vjelja e gjobave të vendosura nga IVMT-ja.

**Ndikimi/Efekti:**Mungesë të ardhurash nga mos arkëtimi i penaliëve dhe prishje të planit urbanistik nga ndërtimet pa leje dhe në kundërshtim me lejet e ndërtimit.

**Rëndësia:** I Lartë.

<sup>38</sup> Neni 16 në Ligjin 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.

**Rekomandimi:** Kryeinspektori i IVMT Bashkia Mallakastër në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 320,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

**Rekomandimi** Kryeinspektori i IVMT Bashkia Mallakastër në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimit të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbaruesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/paluajtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamatë vonesë) të palëve të treta ndaj Bashkisë Mallakastër.

**Titulli i gjetjes:** Mungesë aktiviteti dhe mungesë profesionale nga IVMT- Mallakastër.

**Situata:** Nuk janë përcaktuar objektivat vjetorë dhe afatmesëm strategjikë, treguesit specifikë të efektivitetit e të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, veprim ky në kundërshtim me pikën 2 në nenin 19 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se në akt-kontrollet e mbajtura nuk disponohen foto të situatës në terren, të cilat janë të nevojshme për dokumentimin dhe pasqyrimin e veprimeve nga subjektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me nenin 41 “Të drejta të tjera të inspektorit”, germa (a) të ligjit me nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Nga IVMT nuk dokumentohet kryerja e inspektimeve pranë subjekteve të cilët përgjatë vitit 2022 kanë kryer punime ndërtimi, me qëllim verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga zotëruesit e mbetjeve inerte, gjatë prodhimit, përpunimit dhe dorëzimit të tyre pranë subjekteve të cilat janë të pajisura me leje mjedisore, detyrë në zbatim të pikës 23 në VKM nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

Nga IVMT nuk dokumentohet kryerja e inspektimeve pranë subjekteve të cilët kanë lidhur kontratë për kryerjen e punëve publike (fitues të tenderave) me Bashkinë Mallakastër, për verifikimin e respektimit të detyrimit për vendosjen e tabelës informuese në kantier, praninë e mbikëqyrësit gjatë realizimit të punimeve, etj.

**Kriteri:** Pika 2 në nenin 19 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe neni 41 “Të drejta të tjera të inspektorit”, germa (a) të ligjit me nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” si dhe pika 23 në VKM nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

**Shkaku:**Mungesë aktiviteti nga sektori i IVMT dhe profesionalizmi i burimeve njerëzore.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e aktivitetit dhe profesionalizmit sjell në mosfunksionimin dhe /ose keqfunksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore, të marrë masat e nevojshme për, rekrutimin në stafin e IVMT të punonjësve me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

**Titulli i gjetjes:** Mosfunksionim i IVMT-Mallakatër në zbatim të ligjit dhe mungesë bashkëpunimi me institucionet në hierarki e më gjerë.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se për periudhën objekt auditimi, ndërmjet IVMT dhe drejtorisë së urbanistikës, ka munguar bashkëpunimi, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të



territorit në Bashkinë Mallakaster, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 51 në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar.

Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 mujor për IKMT për masat e marra, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

Konstatohet se, IMT Bashkia Mallakastër është në kushtet e mungesës së mjeteve motorike dhe në pritje të sigurimit të mjeteve motorike. Nderkohë konstatohet që nuk administrohet një shkresë përcjellëse nga IVMT, Bashkia Mallakastër drejtuar Kryetarit të Bashkisë Mallakastër apo instanca më lart me lëndën për kërkesë për fond publik lidhur me mjetet motorike për blerje në funksion dhe mbarëvajtje të këtij sektori publik.

Në evidencën e kryer mbi procedurën e ndjekur vërehet se Inspektoriati Mbrojtjes Territorit, Bashkia Mallakastër (*ne zbatim te VKB Nr.01, dt.18.05.2020, neni 52 i saj, pika 12*) në asnjë moment nuk ka kryer një korrespondencë me institucione të tjera, ndalemi këtu në korrespondencën e domosdoshme me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, respektivisht Sektori i Legalizimeve pranë kësaj drejtorie për të kërkuar një shkresë apo konfirmim nëse këta subjekte që i nënshtrohen prishjes, gjobës etj nga IMT, Bashkia kanë vetdeklarim për ndërtim pa leje, nëse ky vetdeklarim është në sistemin e tyre, nëse ka raste përjashtimore të vetdeklarimeve duke u bazuar në ortofoton fotografimin ajror në vite në referim të Ligjit Nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr.1040, Datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimit të modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”.

**Kriteri:** Neni 5 dhe 6 i ligjit Nr. 9780, Datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar; VKM-së Nr. 862, Datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV” i ndryshuar; pika 3 e nenit 51 në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar; *VKB Nr.01, dt.18.05.2020, neni 52 i saj, pika 12 e saj.*

**Shkaku:** Moszbatimi i procedurave për prishjen e objekteve pa leje, moszbatim i parashikimeve ligjore si dhe mosbashkëpunim me institucionet në hierarki e më gjerë.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e besueshmërisë dhe profesionalizmit në funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit dhe mungesa e bashkëpunimit me institucionet e tjera në varësi apo jo me qëllim efektivitetin dhe ligjshmërinë në veprime apo mosveprime që parashikon ligji.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe IVMT Mallakastër të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre, ku për çdo leje ndërtimi të miratuar/deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, të informohet edhe IVMT, me qëllim miratimit të akt-kontrolleve për lejet e ndërtimit, si dhe rritjen e efektivitetit të inspektimit të zhvillimit të territorit në Bashkinë Mallakastër.

*Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, Kryetari i Bashkisë Z.Q.I, Kryeinspektori IVMT Z.A.X, Specialisti IVMT Z.A.S, Specialisti IVMT Z.SH.X, Drejtor Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Z.L.S, Përgjegjës Sektori Juridik Z.N.S.*

### **III.2.7. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.**

**Titulli i gjetjes:** Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

**Situata:** Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmblendhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

1.Me shkresën nr.189/22 prot., datë 04.07.2022 “Kthim përgjigje për raportin përfundimtar të auditimit dhe rekomandimet e lëna”, Bashkia Mallakastër ka respektuar afatin prej 20-ditësh për dërgimin e planit të veprimit nr.3316/2 prot., datë 30.06.2022, për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**Shkalla e zbatimit:** Ky detyrim ligjor është zbatuar në afat.

2. Bashkia Mallakastër nuk ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit prej 6-muajsh, në përputhje me pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**Shkalla e zbatimit:** Ky detyrim ligjor nuk është zbatuar.

### **3. Analizimi dhe nxjerrja e përgjegjësi në Bashkinë Mallakastër:**

Nga KLSH janë lënë gjithsej **59** rekomandime, të grupuara në:

- **36** masa organizative;
- **2** masa shpërblim dëmi;
- **10** masa për eliminimin e efekteve negative lidhur me eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficecne dhe efektivitet të fondeve publike;
- **11** masa disiplinore.

-Për zbatimin e rekomandimeve të lëna, nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër është nxjerrë urdhri me nr.161, datë 21.06.2022 për ngritjen e komisionit për Analizimin dhe Hartimin e Planit të Masave për Zbatimin e Rekomandimeve:

Me urdhrin e brendshëm nr.174 nr. 3458 prot., datë 01.07.2022 është ngritur komisioni i disiplinës për vlerësimin e përgjegjësisë dhe marrjen e masës disiplinore ndaj punonjësve të përmendur në raportin përfundimtar të auditimit;

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë<sup>39</sup>:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **36** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 10 janë zbatuar, 2 zbatuar pjesërisht, 2 janë në proces zbatimi dhe 22 nuk janë zbatuar. Pra janë zbatuar **27 %** e masave organizative dhe **61 %** nuk janë zbatuar.

-Për shpërblimin e dëmit janë lënë 2 rekomandime për 2 subjekte në vlerën 847,516 lekë dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat të cilat nuk janë zbatuar 2 rekomandime për 2 subjekte në vlerën 847,516 lekë.

-Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë 10 rekomandime në vlerën 1,455,619,879 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, 1 rekomandim për vlerën 11,534,944 lekë zbatuar, 2 rekomandime në proces zbatimi për vlerën 1,137,138,382, 6 rekomandime për vlerën 300,946,553 lekë nuk janë zbatuar, dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht për vlerën 6,000,000 lekë.

-Janë lënë 11 masa disiplinore, të cilat janë zbatuar.

**Më hollësisht rekomandimet e pazbatuara dhe zbatuar pjesërisht, për të cilat nga KLSH rikërkohet zbatimi i tyre, paraqiten si më poshtë vijon (numrat rendor janë sipas renditjes në shkresën përcjellëse dërguar subjektit):**

#### **A.MASA ORGANIZATIVE**

**1.1. Rekomandimi:** Nga Titullari i Bashkisë Mallakastër, me atributet e Kryetarit të GMS dhe të Nëpunësit Autorizues të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin strategjisë së risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

<sup>39</sup> Pasqyruar më hollësisht auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.7” të raportit përfundimtar të auditimit.

**1.2. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër, të kryhen investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryhen procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimesh për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve për realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Të vendoset një sistem komunikimi, i cili të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**1.3. Rekomandimi:** Të kryhen ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit, për ato funksione të cilat me ligj janë kompetencë e institucioneve të tjera duke rishikuar edhe strukturën e bashkisë me qëllim alokimin eficient të burimeve njerëzore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2.1. Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut, ku të planifikojë auditime tematike për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

**2.2. Rekomandimi:** Të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Mallakastër.

**3.2. Rekomandimi:** Për çdo vit buxhetor të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Mallakastër.

**Në vijimësi**

**4.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse.

**Në vijimësi**

**7.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

**7.2. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet. Gjithashtu për çdo rast të likuidimit të detyrimeve të vendimeve gjyqësore, në urdhrin e autorizimit të shpenzimit, të evidentohet dhe të kërkohet nxjerrja e përgjegjesisë administrative, të punonjësit përgjegjës.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**8.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijohet kufizime limiti të arkës (përjashtuar kufizimet e MFE), për likuidimin e

faturave në kohë dhe duke respektuar radhën e likuidimit sipas parimit “hyrje e parë – dalje e parë”.

## Në vijimësi

**9.1. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit, sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**10.2. Rekomandimi:** Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

**10.3. Rekomandimi:** Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtime e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transporti”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivit përkatës.

**10.4. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 “Rezultati i mbartur i seksionit të funksionimit”.

## Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

**11.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive: **1.** “Ujësjetës Kanalizime Mallakastër Sh.a.”, me NUIS K47605804N, për 100% të aksioneve, në vlerën 621,858,000 lekë; **2.** “B” Sh.a., për 25% të aksioneve në vlerën 500,000 lekë; **3.** “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Mallakastër”, me NUIS M07509871Q, për 100% të aksioneve, në vlerën 67,105,362 lekë, si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive prej **689,463,362 lekë** në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**11.2. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të bërë çregjistrimin e shoqërisë “Ujësjetës kanalizime”, e themeluar në datën 28.02.1997, aktualisht me status “Aktiv”, me NIPT/NUIS J77517803S, kapitali i së cilës rezulton të jetë transferuar i gjithi në shoqërinë “Ujësjetës Kanalizime Mallakastër Sha”, me NIPT/NUIS K47605804N.

## Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

**12.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike dhe e Çështjeve Sociale në Bashkinë Mallakastër të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

## Në vijimësi

**15.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mallakastër, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve, duke dhënë argumente për secilin kriter, të cilat të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kritere të përshtatshme me procedurën dhe duke dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**20.4. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Mallakastër, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve të faturave brenda afatit ligjor 30 ditor.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**21.1. Rekomandimi:** Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Mallakastër, të marrë masa për shqyrtimin e lejeve të ndërtimit, ku të bashkërendohet puna me të gjitha institucionet e tjera publike brenda kompetencave që u njeh ligji, duke përfshirë edhe kërkesën drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nëse objektet për të cilat është aplikuar për leje ndërtimi, duhet t'i nënshtrohen apo jo Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

**Në vijimësi**

**22.1. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMTV-së, të marrë masa për plotësimin e procedurave, duke vendosur masat e pezullimit për ndërtimet që kryhen pa lejet përkatëse. Të administrohet në dosjet e tyre praktika, duke bashkëlidhur fotografitë e kundërvajtjes ku të pasqyrohet fakti i evidentuar në procesverbalet e konstatimit. Të mbahet korrespondencë me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, ku çdo 3 muaj të përcillet informacioni periodik i aktivitetit të tyre.

**22.2. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMTV-së, të marrë masa për kontrollin e objekteve të pajisura me leje ndërtimi dhe në çdo rast të mbajë aktet e kontrollit ku të pasqyrohet situata e objektit në ndërtim dhe evidentimi i shkeljeve në rast konstatimi.

**22.3. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMT në vlerën **750,000 lekë**.

**Në vijimësi**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

**1.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **621,602 lekë pa tvsh** nga BOE "SH" Shpk, & "A" Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1604 prot., datë 17.07.2019, me objekt "Ndërtim shëtitore nga shkolla "O" deri tek varrezat e qytetit", Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **225,914 lekë pa tvsh** nga OE "A" Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 462 prot., datë 15.02.2019, me objekt "Rikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja "5 Shkurti", Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

## **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër të marrë masat e nevojshme për analizimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, duke identifikuar personat përgjegjës dhe vendosjen e masave administrative ndaj tyre, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin Juridik të bashkëveprojnë për shmangien e penalizimeve të tilla financiare.

**Menjëherë**

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

**2.2. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar/vjelë detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës debitoare prej **30,433,851 lekë**.

**2.3. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK dhe Qarku Fier). Për familjet fermere debitoare të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë periudhën/vlerën e papaguar, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës debitoare prej **68,669,251 lekë**.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **2,218,252 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave, (sipas normës së interesit të Bankës së Shqipërisë, plus tetë pikë përqindje) për të gjitha rastet e detyrimeve të paarkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**6.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojnë tarifatat e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej **6,000,000 lekë**, sipas Anekseve bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, **Pasqyra A22**. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**7.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E-të), **197,346 mijë lekë** pa TVSH.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër, në cilësinë e Titullarit të AK, të nxjerrë përgjegjësitë për marrjen në dorëzim të objektit jo sipas projektpreventivit dhe pa plotësuar specifikimet teknike të miratuara dhe të marrë masa që në ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim të objektit, të përcaktohen qartë detyrimet dhe përgjegjësitë për secilin anëtar, në mënyrë që objektet e ndërtuara me financim nga Bashkia, t'i shërbejnë sa më mirë komunitetit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **II.2.8.Të ndryshme të dala gjatë auditimit.**

-Gjatë auditimit nuk ka pasur çështje të tjera, veç çështjeve të programit të trajtuara më sipër.

## **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:**

**Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

-Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.

-Nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

-Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.

-Në Bashkinë Mallakastër nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.

-Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.

-Në Bashkinë Mallakastër, Sektori i të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

**1.2.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe investimit për blerjen e programit kompjuterik të licencuar, për administrimin e taksave dhe tarifave vendore etj.

**1.3.Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për:

-Kryejen e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune, si dhe hartimin e dokumentit “Harta e proceseve të punës”.

-Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre.

### **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Mallakastër përgjatë vitit 2022, u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm.

-Nuk është realizuar plani vjetor i auditimeve.

-Në auditimet e kryera për vitin 2022, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të

menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Për periudhën 2022, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Mallakastër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Financës, Sektori i të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bëra në shkronjën “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronja “ç” në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 17-20, të Projekt Raportit të Auditimit)*

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe Përgjegjësi i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për:

-Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

### **Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2023**

**2.2.Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Mallakastër, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve, ndërmarrjen e shërbimit publik etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

### **Përgjatë vitit 2023 dhe në vijimësi**

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Mallakastër për arkëtim ndaj të tretëve, është pasqyruar më pak për vlerën 257,264,483 lekë. Gjithashtu konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ë”, pika 3, neni 12 në ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c” dhe pika 10 në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.470 “Të ardhura për t’u marrë”.

### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim**

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar me 622,907,000 lekë, vlera e aksioneve në shoqërinë aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër Sh.A” me NIPT K47605804N, vlera e aksioneve në shoqërinë “Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier” me NIPT M23315402G, si dhe vlera e aksioneve në shoqërinë aksionare “B Sh.A”. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Urdhrin e Ministrit të MFE nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe



Aktivitet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”; Kreun 3.1, pika 31, shkronja “b” në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**4.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim**

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë për vlerën 33,059,961 lekë, për garanci të cilave i ka kaluar afati dhe duhet t’u kthehen subjekteve përkatëse<sup>40</sup>. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4” në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër në bashkëpunim me Drejtorin e Planifikimit të Territorit, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave i’u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim**

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr. 202 “Studime dhe kërkime”, u konstatua se nuk është kryer amortizimi në vlerën 9,083,682 lekë sipas normës 15% për aktivet afatgjata jomateriale. Veç sa më sipër konstatohet se në këtë llogari janë të kontabilizuara projekte për investime për punë publike të përfunduara dhe sipas rastit të marra në dorëzim nëpërmjet akt-kolaudit përfundimtar. Këto projekte duhet të ishin kontabilizuar rast pas rasti në objektin përkatës (llogaritë e klasës 2, ndërtesa, konstruksione, rrugë etj) si pjesë e kostos totale të tij. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2, Klasa 2 “Trajtimi kontabël për AAGJ jomateriale, shkronja “d” në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, si dhe pikën 36 “Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritit me metodën lineare me normë amortizimi 15%”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim**

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr. 231 “Investime në proces”, e cila përfaqëson shpenzime për investime në proces, u konstatua se kjo llogari, është mbivlerësuar për vlerën 38,170,024 lekë, si rrjedhojë e kontabilizimit të investimeve për aktive të marra në dorëzim dhe të kapitalizuara si AQT. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun 2, klasa 2 në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022

<sup>40</sup> Llogaria 466 për garancitë që i ka kaluar afati, pasqyrohet në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.4” të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

“Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**7.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr.231 “Investime në proces” dhe llogarive nr. 213/212 sipas rastit, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitetit afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim**

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr.467 “Kreditor të tjerë” me kundërparti llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më pak, për vlerën 3,977,574 lekë, si rrjedhojë e moskontabilizimit të detyrimeve për shpronësim. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” - “funksionimi kontabël i llogarive të klasës 4”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Në përfundim të merren masa për raportimin e detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr.401-408 “Furnitor dhe llogari të lidhura me to”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më pak, për vlerën 5,325,960 lekë, për fatura të mbërritura, të palikujduara në fund të vitit 2022 dhe të pa regjistruara në pasqyrat financiare. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” - “funksionimi kontabël i llogarive të klasës 4”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të detyrimeve të bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim**

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi procesin e inventarizimit, kontabilizimit dhe regjistrimit në kadastër të aseteve në pronësi të Bashkisë Mallakastër, të tokave, trojeve, terreneve, pyjeve, kullotave, ndërtesave dhe konstruksioneve, në mënyrë të përmbledhur u konstatua se nuk është kryer inventarizimi i tyre; Objektet e kontabilizuara nuk pasqyrohen me emërtimet e tyre, por vetëm me mbishkrimin “Toka, troje dhe terrene”, pra nuk identifikohet përbërja e kësaj llogarie dhe saktësia e veprimeve kontabël; Rregjistri që mbahet nga Drejtoria e Financës për këtë llogari, nuk është i plotë me informacion, pasi mungon informacioni për datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës etj; Nuk është kryer kontabilizimi i trojeve të lira dhe ato të zëna me ndërtesat, që sipas rastit i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Mallakastër, nëpërmjet akteve ligjore/nënligjore, si dhe për më tepër ato troje të cilat janë pajisur edhe me certifikatë pronësie; Nga 1326 pasuri në pronësi të Bashkisë Mallakastër, asnjë prej tyre nuk është regjistruar në kadastër dhe janë pajisur me certifikatë pronësie.

-Veç sa më sipër konstatohet se Bashkia Mallakastër nuk ka një punonjës/strukturë të posaçme për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për

çdo pasuri. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 35, nenin 37, nenin 41 dhe nenin 44 në Ligjin nr. 20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 6 në Ligjin nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar; Nenin 62 në Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; Nenin 9 dhe nenin 12 në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM Nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Kapitulli III, pika 30 dhe paragrafi 104 në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**10.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me Drejtorin e Financës të planifikojë në buxhet një fond të detajuar për kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve nga ekspertë vlerësues të liçencuar.

**Në vijimësi**

**10.2.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër të nxjerrë urdhër të brendshëm, për përcaktimin e afatit konkret si dhe ngritjen e një strukture të posaçme, me objekt vetëm inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për çdo pasuri.

**Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**10.3.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, për:

- Kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene”, nr.211 “Pyje, kullota, plantacione” dhe nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione”.
- Hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim**

**11.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, për punë publike mallra dhe shërbime, u konstatua se në 8 raste, në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar plotësisht vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2, pikën 2 në nenin 3, nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”; Shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 2, Shkronjën “b” të pikës 3 në nenin 15, pikën 4 në nenin 39, pikën 1 të nenit 40, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43, pikën 1 të nenit 44 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**11.1.Rekomandimi:** Njësia e Prokurimit Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

**Në vijimësi**

**12.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se në 4 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, duke sjellë në total lidhjen e 4 kontratave me vlerë 246,895 mijë lekë pa TVSH, me OE të cilët janë shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 98 në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; Pikën 2 të nenit 82, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorit ekonomik, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, u konstatua se në:

- Në 4 raste nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit;
- Në 3 raste rezulton se OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara nga AK, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues, përmban mangësi në formë dhe përmbajtje;
- Në 6 raste nga autoriteti kontraktor nuk është kërkuar deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore, konfliktin e interesit, deklaratë garancie për mallrat objekt prokurimi. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 36, pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenin 76, pika 1 dhe 2 në VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**13.1. Rekomandimi:** Komisioni i blerjeve të vogla Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, garantimin e cilësisë së mallrave, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

**Në vijimësi**

**14.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, u konstatua se:

- Në strukturën e IVMT Mallakastër nuk janë të gjithë punonjësit me formimin profesional të fushës;
- Kryeinspektori i IVMT nuk ka miratuar akt-kontrolli për të gjithë objektet e pajisura me leje ndërtimi, sipas fazave të punimeve (Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues deri në përfundimin e sistemimit të jashtëm);
- Kryeinspektori nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, gjatë ushtrimit të detyrave;
- Nuk dokumentohet kryerja e inspektimeve pranë subjekteve të cilët përgjatë vitit 2022 kanë kryer punime ndërtimi, me qëllim verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga zotëruesit e mbetjeve inerte, gjatë prodhimit, përpunimit dhe dorëzimit të tyre pranë subjekteve të cilat janë të pajisura me leje mjedisore;
- Ndërmjet IVMT dhe Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, ka munguar bashkëpunimi, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 4, nenin 5, nenin 11, pika 8 në nenin 12, në Ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e

kundërligjshme”, i ndryshuar; Nenin 1 në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Pikat 1, 2 dhe 3 në nenin 51 në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neni 41 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Pikën 1 germa b/ii, pikën 4 në VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 102-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**14.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore, të marrë masat e nevojshme për, rekrutimin në stafin e IVMT të punonjësve me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

**Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**14.2.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe IVMT Mallakastër të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre, ku për çdo leje ndërtimi të miratuar/deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, të informohet edhe IVMT, me qëllim miratimin e akt-kontrolleve për lejet e ndërtimit, si dhe rritjen e efektivitetit të inspektimit të zhvillimit të territorit në Bashkinë Mallakastër.

**Në vijimësi**

**15.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekuara nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Mallakastër, për miratimin e lejeve të ndërtimit/deklarata paraprake për kryerjen e punimeve, u konstatua se në 4 raste është miratuar leja e ndërtimit në kushtet e mungesës së dokumentacionit të plotë në formë dhe përmbajtje, si dhe në kundërshtim me tipologjinë e ndërtimit që lejohet në njësinë strukturore përkatëse. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nënpikën 1.1.2 të pikës 1.1/1 në nenin 15, pikën 2 të nenit 20, shkronjën “a” të nenit 29, pikën 2 të nenit 43, pikën 1 të nenit 44 në Ligjin nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; Pikën 3 dhe 3/1 në nenin 3, pikat 1 dhe 3 të nenit 14, shkronjën “ë” të pikës 1 dhe pikën v të pikës 1/1 në nenin 15, pikën 6 të nenit 21 në VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 92-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**15.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit, të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit të munguar në lejet e ndërtimit të miratuara përgjatë periudhës 2022, si dhe bashkërendimin e punës, vlerësimin dhe marrjen në konsideratë të mendimeve të autoriteteve publike kompetente gjatë aplikimit deri në miratimin e lejes së ndërtimit.

**Në vijimësi**

**16.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike sipas kontratës “Rikonstruksion i rrugës Bejar-Diga e rezervuarit”, konkretisht librit të masave, konstatohet se për zëra të punimeve si shtresa rrugore (përfunduar xhepat), gjurmim dhe etj., volumet e përcaktuara në librezën e masave janë hartuar duke marrë si produkt gjatësinë ndërmjet piketave dhe gjerësi mesatare, e cila është përcaktuar e njëjtë për të gjithë gjatësinë e rrugës, duke mos reflektuar në mënyrë të saktë volumin sipas prerjeve tërthore. Sipas zërit “Gjurmim dhe me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zakonshme, kategoria III, me shkarkim në mjet + transport deri 3 km”, sasia është përcaktuar nga produkti i gjatësisë 4000 m me volum 1 m<sup>3</sup>/ml, pasojë e të cilit nuk mund të bëhen sondazhe për seksione të caktuara për të vërtetuar saktësinë e volumeve të raportuara. Po ashtu vijëzimi gjatësor në anën e majtë të rrugës nuk është realizuar në gjerësinë 12 cm, por 11 cm. Shtresat asfaltike ndërmjet kilometër 1 dhe kilometër 2, kanë pësuar dëmtime serioze, të cilat mund të kenë ardhur si pasojë e ngopjes së nënshtresave me ujë, por edhe të kalimit të automjeteve të tonazhit të rëndë, të cilat transportojnë material ndërtimi për punimet që po realizohen për ndërtimin e segmentit rrugor “Rezervuari i Bregasit-Kutë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**16.1.Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër të marrë masa për vendosjen e tabelave kufizuese për tonazh sipas aftësisë mbajtëse të shtresave rrugore të projektuara. Të kërkohet nga Kontraktori riparimi i defekteve të shtresave asfaltike, por edhe të defekteve të tjera të mundshme, para përfundimit të periudhës së garancisë së riparimit të defekteve.

**Brenda periudhës së garancisë**

**17.Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 36 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 10 janë zbatuar, 2 zbatuar pjesërisht, 2 janë në proces zbatimi dhe 22 nuk janë zbatuar. Pra janë zbatuar 27 % e masave organizative dhe 61 % nuk janë zbatuar.

-Për shpërblimin e dëmit janë lënë 2 rekomandime për 2 subjekte në vlerën 847,516 lekë dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat të cilat nuk janë zbatuar 2 rekomandime për 2 subjekte në vlerën 847,516 lekë.

-Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë 10 rekomandime në vlerën 1,455,619,879 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, 1 rekomandim për vlerën 11,534,944 lekë zbatuar, 2 rekomandime në proces zbatimi për vlerën 1,137,138,382, 6 rekomandime për vlerën 300,946,553 lekë nuk janë zbatuar, dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht për vlerën 6,000,000 lekë.

-Janë lënë 11 masa disiplinore, të cilat janë zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 108-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**17.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre.

**Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**18.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2022-2024, u konstatua se:

Për PBA 2022-2024 dhe Buxhetin vjetor 2022 Kryetari i Bashkisë Mallakastër nuk ka marrë masat për të përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin e Bashkisë, kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor;

- Për PBA 2022-2024 nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit;

- Për PBA 2022-2024 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Mallakastër;

- Nuk administrohet dokumenti përfundimtar i PBA për periudhën 2022-2024, por në dosje administrohet vetëm VKB që kanë miratuar buxhetin vjetor 2022;

- Procedura e përgatitjes së PBA 2021-2023 nuk dokumentohet plotësisht, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat e bëra për fondet nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Mallakastër, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

- Tavanet Përgatitore të PBA-së 2021-2023, janë miratuar jashtë afateve;

- Në buxhetin vjetor të vitit 2022 nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin dhe përmirësimin e fondit pyjor. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 të nenit 13, pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij

vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Mallakastër.

-Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavaneve Përgatitore të PBA-së;

-Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat çënojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;

-Gjithashtu për çdo vit të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Mallakastër.

**Në vijimësi**

**19.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime publike, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të planifikuara në vitin 2022 paraqitet masën 75%. Kjo situatë është krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Mallakastër në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3, nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**19.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

**Në vijimësi**

**20.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave të lidhura nga Bashkia Mallakastër për kryerjen e punëve publike dhe listës së projekteve sipas PBA 2022-2024, u konstatua se në 5 raste për vlerën totale të kontratave 11,213 mijë lekë, janë ndërmarrë angazhime buxhetore pas datës 15 Tetor të vitit 2022, për projekte të cilat nuk janë pjesë e PBA 2022-2024. Këto projekte janë: “Mirëmbajtjen e mjeteve të transportit” në vlerën 8,280 mijë lekë, “Blerjen e ushqimeve për kopështin dhe çerdhen Ballsh” në vlerën 1,197 mijë lekë, “Blerje materiale kancelarie” në vlerën 556 mijë lekë, mbikqyrje punimesh për “Përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara” në vlerën 319 mijë lekë si dhe “Blerje për pakot e vitit të ri” në vlerën 860 mijë lekë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “c” në pikën 4 në nenin 36 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, dhe pikën 2 të VKM nr. 807, datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**20.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Njësia e Prokurimit, të marrë masa për eliminimin e praktikave të ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore pas datës 15 Tetor të vitit buxhetor, për projekte të cilat nuk janë planifikuar në PBA.

**Në vijimësi**

**21.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022, u konstatua se janë të pa likuiduara gjithsej 81 fatura për vlerën totale 10,419 mijë lekë. Nga

shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2022, rezultoi se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Mallakastër ndaj palëve të treta raportuar në MFE, përbëhet nga detyrime për vendime gjyqësore dhe shpenzime korrente, shpenzime kapitale në vlerën 10,422 mijë lekë. Nga përlllogaritjet e kryera nga grupi i auditimit, mbi bazën e dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura në 31.12.2022, që duhej të raportohet në MFE duhet të ishte në vlerën 19,724 mijë lekë. Drejtoria Financës në raportin e shkallës së vështirësisë financiare, nuk ka përfshirë vlerën e detyrimeve të shpronsimeve si dhe likuidimit e 2 faturave për 2 subjekte.

-Gjithashtu sa i përket respektimit të radhës së likuidimit të detyrimeve të prapambetura (pra fatura e parë likujdohet më parë), u konstatua se nuk është respektuar ky detyrim në 30 raste. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr.26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësisë financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”; Kreun XI pika 1, neni 56 në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”; Pikat 8, 106 dhe 107 të udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 20-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**21.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

### **Përgjatë vitit buxhetor 2023 dhe në vijim**

**21.2.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

**21.3.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta.

**Në vijimësi**

## **B.1. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.**

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se janë **36** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 10 janë zbatuar, 2 zbatuar pjesërisht, 2 janë në proces zbatimi dhe 22 nuk janë zbatuar.

-Për shpërblimin e dëmit janë lënë 2 rekomandime për 2 subjekte në vlerën 847,516 lekë dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat të cilat nuk janë zbatuar 2 rekomandime për 2 subjekte në vlerën 847,516 lekë.

-Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë 10 rekomandime në vlerën 1,455,619,879 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga kqto 1 rekomandim për vlerën 11,534,944 lekë zbatuar, 2 rekomandime për vlerën 1,137,138,382 lekë në proces zbatimi, 6 rekomandime për vlerën 300,946,553 lekë nuk janë zbatuar, si dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht për vlerën 6,000,000 lekë.

-Janë lënë 11 masa disiplinore, të cilat janë zbatuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 108-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Konkretisht rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara, zbatuar pjesërisht dhe përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve në proces, si më poshtë vijon:



## **B.1. MASA ORGANIZATIVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM:**

**1.1. Rekomandimi:** Nga Titullari i Bashkisë Mallakastër, me atributet e Kryetarit të GMS dhe të Nëpunësit Autorizues të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin strategjisë së risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

**1.2. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër, të kryhen investime në programe kompjuterike të liçencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryhen procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimesh për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve për realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Të vendoset një sistem komunikimi, i cili të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**1.3. Rekomandimi:** Të kryhen ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit, për ato funksione të cilat me ligj janë kompetencë e institucioneve të tjera duke rishikuar edhe strukturën e bashkisë me qëllim alokimin eficient të burimeve njerëzore.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**2.1. Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut, ku të planifikojë auditime tematike për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

**2.2. Rekomandimi:** Të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**3.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Mallakastër.

**3.2. Rekomandimi:** Për çdo vit buxhetor të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Mallakastër.

### **Në vijimësi**

**4.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse.

### **Në vijimësi**

**7.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

**7.2. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet. Gjithashtu për çdo rast të likuidimit të detyrimeve të vendimeve gjyqësore, në urdhrin e autorizimit të shpenzimit, të evidentohet dhe të kërkohet nxjerrja e përgjegjësisë administrative, të punonjësit përgjegjës.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**8.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijohet kufizime limiti të arkës (përjashtuar kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë dhe duke respektuar radhën e likuidimit sipas parimit “hyrje e parë – dalje e parë”.

Në vijimësi

**9.1. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit, sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

**10.2. Rekomandimi:** Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

**10.3. Rekomandimi:** Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtime e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transporti”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës.

**10.4. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit”.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

**11.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive: **1.** “Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër Sh.a.”, me NUIS K47605804N, për 100% të aksioneve, në vlerën 621,858,000 lekë; **2.** “B” Sh.a., për 25% të aksioneve në vlerën 500,000 lekë; **3.** “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Mallakastër”, me NUIS M07509871Q, për 100% të aksioneve, në vlerën 67,105,362 lekë, si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive prej **689,463,362 lekë** në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**11.2. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të bërë çregjistrimin e shoqërisë “Ujësjetllës kanalizime”, e themeluar në datën 28.02.1997, aktualisht me status “Aktiv”, me NIPT/NUIS J77517803S, kapitali i së cilës rezulton të jetë transferuar i gjithi në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër Sha”, me NIPT/NUIS K47605804N.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

**12.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike dhe e Çështjeve Sociale në Bashkinë Mallakastër të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Në vijimësi

**15.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mallakastër, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve, duke dhënë argumente për secilin kriter, të cilat të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kritere të përshtatshme me procedurën dhe duke dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**20.4. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Mallakastër, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve të faturave brenda afatit ligjor 30 ditor.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**21.1. Rekomandimi:** Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Mallakastër, të marrë masa për shqyrtimin e lejeve të ndërtimit, ku të bashkërendohet puna me të gjitha institucionet e tjera publike brenda kompetencave që u njeh ligji, duke përfshirë edhe kërkesën drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nëse objektet për të cilat është aplikuar për leje ndërtimi, duhet t'i nënshtrohen apo jo Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

**Në vijimësi**

**22.1. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMTV-së, të marrë masa për plotësimin e procedurave, duke vendosur masat e pezullimit për ndërtimet që kryhen pa lejet përkatëse. Të administrohet në dosjet e tyre praktika, duke bashkëlidhur fotografitë e kundërvajtjes ku të pasqyrohet fakti i evidentuar në procesverbalet e konstatimit. Të mbahet korrespondencë me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, ku çdo 3 muaj të përcillet informacioni periodik i aktivitetit të tyre.

**22.2. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMTV-së, të marrë masa për kontrollin e objekteve të pajisura me leje ndërtimi dhe në çdo rast të mbajë aktet e kontrollit ku të pasqyrohet situata e objektit në ndërtim dhe evidentimi i shkeljeve në rast konstatimi.

**22.3. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMT në vlerën **750,000 lekë**.

**Në vijimësi**

## **B.2. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM**

**1.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **621,602 lekë pa tvsh** nga BOE "SH" Shpk, & "A" Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1604 prot., datë 17.07.2019, me objekt "Ndërtim shëtitore nga shkolla "O" deri tek varrezat e qytetit", Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **225,914 lekë pa tvsh** nga OE "A" Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 462 prot., datë 15.02.2019, me objekt "Rikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja "5 Shkurti", Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

## **B.3. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.**

**1.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër të marrë masat e nevojshme për analizimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, duke identifikuar personat përgjegjës

dhe vendosjen e masave administrative ndaj tyre, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin Juridik të bashkëveprojnë për shmangien e penalizimeve të tilla financiare.

#### **Menjëherë**

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

**2.2. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar/vjelë detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës debitorë prej **30,433,851 lekë**.

**2.3. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK dhe Qarku Fier). Për familjet fermere debitorë të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë periudhën/vlerën e papaguar, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës debitorë prej **68,669,251 lekë**.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **2,218,252 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave, (sipas normës së interesit të Bankës së Shqipërisë, plus tetë pikë përqindje) për të gjitha rastet e detyrimeve të paarkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**6.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifatat e plotat për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej **6,000,000 lekë**, sipas Anekseve bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, **Pasqyra A22**. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**7.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E<sup>-të</sup>), **197,346 mijë lekë** pa TVSH.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër, në cilësinë e Titullarit të AK, të nxjerrë përgjegjësitë për marrjen në dorëzim të objektit jo sipas projektpreventivit dhe pa plotësuar specifikimet teknike të miratuara dhe të marrë masa që në ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim të objektit, të përcaktohen qartë detyrimet dhe përgjegjësitë për secilin anëtar, në mënyrë që objektet e ndërtruara me financim nga Bashkia, t'i shërbejnë sa më mirë komunitetit.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

### **B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në përcaktimet e bëra në shkronjën “b” në nenin 15 në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjën “b” në pikën 1.1 dhe shkronjën “c” në pikën 1.6 në nenin 9 dhe shkronjën “gj” në nenin 64, në

Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe nenin 2, nenin 32, nenin 66, nenin 68, nenin 153 dhe nenin 154 në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Kryetari i Bashkisë të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, shpërblimi i dëmit të krijuar ndaj buxhetit të Bashkisë Mallakastër në vlerën 112,566 lekë, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratës “Rikonstruksion i rrugës Bejar-Diga e rezervuarit”, konstatohet se në ndryshimet e punimeve sipas kontratës përfshihet edhe një zë i ri punimi “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zakonshme, kategoria III, me shkarkim në mjet + transport deri 3 km”. Për këtë zë është vendosur çmimi 344 lekë/m<sup>3</sup>, kjo si përlllogaritje e çmimeve të përcaktuara në manual konkretisht analiza 3.89/a “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zakonshme, kategoria III, me shkarkim në mjet” me çmim 361 lekë/m<sup>3</sup> dhe sipas analizës sipas analizës 3.158/5a “Transport dheu me auto deri 5 km” me çmim 266 lekë/m<sup>3</sup>. Mbledhja e këtyre dy çmimeve rezulton 627 lekë/m<sup>3</sup>. Në relacionin e datës 13.06.2022, përcaktohet se çmimi i negociuar është llogaritur nga përqindja e uljes së preventivit të ofertës nga fondi limit i objektit, e cila është 54.8 %, nga ku ka rezultuar çmimi 344 lekë/m<sup>3</sup>.

Referuar distancës së transportit 3 km, referenca e analizës 3.158/5a është e gabuar (i përket distancës 5 km), pasi kësaj distancë i përket analiza 3.158/3a “Transport dheu me auto deri 3 km”, me çmim 223 lekë/m<sup>3</sup>. Nga përlllogaritja rezulton se çmimi sipas manualit duhet të ishte 584 lekë. Zbritja në nivelin 54.8 % rezulton në çmimin 320 lekë/m<sup>3</sup>. Sa më sipër, nga ana e Kontraktorit është përfituar më shumë vlera 81,216 lekë [3384 m<sup>3</sup> (344 lekë/m<sup>3</sup> – 320 lekë/m<sup>3</sup>)]. Nga verifikimi i disa zëra punimesh të realizuara në objekt rezultoi se sipas zërit III.1 “Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm, termoplastike sprajt (3 vija)” nuk janë realizuar vijëzimet që përcaktojnë gjerësinë e rrugës në xhepa. Sasia e situacionuar është 209 ml. Vlera 31,350 lekë (209 ml x 150 lekë/ml), është certifikuar padrejtësisht. Veprime të cilat bien në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu II, pika 4.1.(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 41-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër të marrë masa për zbritjen e vlerës **112,566 lekë** nga vlera e garancisë së punimeve të Kontraktorit BOE “**K SHPK & C M**” SHPK, për përfitim të padrejtë si referencë e gabuar e çmimit për zëra të rinj punimesh, si dhe për punime të certifikuar dhe të pa realizuara.

**Brenda periudhës së garancisë**

## **C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, rezulton se Bashkia Mallakastër për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 846,572 lekë, për 4 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Në urdhrin e Titullarit të institucionit për likuidimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Mallakastër. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,

i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njëria e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

**Përgjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2023 dhe në vijimësi**

**1.2.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimeve të prapambetura, krijuar nga vendimet gjyqësore.

**Brenda vitit 2023**

### **C.1 MASA PËR ARKËTIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se vlera progresive e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore në datën 31.12.2022 është në vlerën **1,147,936,403 lekë** për **140** subjekte, që përfshin debitorët e krijuar gjatë vitit 2022 dhe të viteve të mëparshme, të cilat përbëjnë të ardhura të pa arkëtuara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Nga vlera e mësipërme, janë 1,113,818,553 lekë, detyrim që kanë kompanitë e naftës ndaj Bashkisë Mallakastër, detyrim i pakontabilizuar, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Pra gjatë vitit 2022 janë krijuar debitor për vlerën 28,018,213 lekë. Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Mallakastër, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje duke mos aplikuar masa shtrënguese (vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), nuk është vazhduar me masa të tjera shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 në nenin 89 në Kreu XI të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Pikat 1 dhe 2 në nenin 4 dhe neni 22/5 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës **1,148,624,094 lekë** për **140** subjekte (principial dhe kamatë vonesë).

**Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Mallakastër me palët e treta, konkretisht të respektimit të detyrimeve ligjore për përlllogaritjen dhe pagesën e qirasë (për vitin 2022), përlllogaritjen e kamat-vonesave, si dhe marrjen e masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, u konstatua se në vitin 2022, janë krijuar 4 subjekte debitorë për vlerën 215,715 lekë, si dhe progresivisht në fund të vitit 2022 janë 92 subjekte për vlerën 2,466,047 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Gjithashtu u konstatua se kontratat e qirasë së tokës bujqësore nuk janë përditësuar sipas formatit të ri të kontratës tip, miratuar me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënie me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar, pasi nëpërmjet formatit të ri, ka ndryshuar masa e kamatvonesës për mospagesën në kohë, pra nga 1% bëhet 0.5%, si dhe është parashikuar indeksimi i tarifës së qirasë 1 herë në 5 vite, periudhë e cila përkon me indeksimin që duhet t’i bëhet tarifës së qirasë në vitin 2023.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e këtyre subjekteve, konstatohet se nuk janë njoftuar subjektet për zgjidhje të njëanshme të kontratës së qirasë, si dhe nuk është hapur proces gjyqësor, me qëllim mbledhjen e detyrimeve me forcë nëpërmjet shërbimit të përmbartimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 296 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pikën 4 të nenit 13 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Lidhja 2, tabela 2 në VKM nr.391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar; Paketa fiskale e vitit 2022, pika 17, shkronja “b”; Neni 3 dhe neni 4 në Ligjin nr.8318, datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1.Rekomandimi:** Sektori i Tatim-Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Mjedisit të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitoare 2,466,047 lekë (principal dhe kamatë vonesë).

**Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**2.2.Rekomandimi:** Drejtoria Juridike të marrë masa, për ndryshimin e përmbajtjes së kontratave të qirasë për tokat bujqësore, duke reflektuar ndryshimin në kamatëvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.

**Menjëherë**

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se vlera debitoare për këtë taksë në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është 12,874 mijë lekë për 423 subjekte, nga të cilat 42 subjekte për vlerën 1,339 mijë lekë janë krijuar në vitin 2022. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Mallakastër, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Sektorit të Tatim Taksave Bashkia Mallakastër, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, t’i përcillen sektorit të mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të Paketës Fiskale për vitin 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit t’i përcjellë Sektorit të Tatim Taksave listën me subjektet debitoare për taksën e ndikimit në infrastrukturë, si dhe Sektori i Tatim Taksave Bashkia Mallakastër të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore, për arkëtimin e vlerës debitoare prej 12,874 mijë lekë.

**Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit, rezulton se përgjatë vitit 2022 në territorin e Bashkisë Mallakastër dhe NJA, është ushtruar aktivitet për tregëtimin e karburantit nga 12 stacione shitje. Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2022, gjithsej rezultojnë 8 subjekte debitor për vlerën 1,116 mijë lekë, si rrjedhojë e mosrilecencimit/moslikuidimit të tarifës së licencimit të tregëtimit të karburantit. Për këto stacione konstatohet se përgjatë vitit 2022 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë, kërkesë për bashkëpunim nga DAV dhe Policisë Bashkiake. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”

i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017. Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja “b” në pikën 1 në nenin 131 “...nuk i paguan ato në buxhet” të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar. Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”. Rregullore e brendshme e Bashkisë Mallakastër “Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit”, pika 1, si dhe shkronja d, si dhe “Policia Bashkiake”, neni 5 dhe neni 8; Pika 10 në Paketën Fiskale të Bashkisë Mallakastër, për vitin 2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**4.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Sektori i Tatim-Taksave, Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t’i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial, për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregëtimit me pakicë të karburanteve.

**4.2.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Sektori i Tatim-Taksave, Bashkia Mallakastër në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave, të marrë masat e nevojshme për ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 1,116 mijë lekë.

### **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e ndotjes, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Mallakastër (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Mallakastër) u konstatua se nga Sektori i Tatim Taksave, Drejtoria e Mjedisit, si dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Mallakastër, nuk është aplikuar dhe nuk është arkëtuar tarifa e ndotjes, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e bashkisë. Nga përllogaritjet e kryera rezultoi se për vitin 2022 në 10 raste, subjektet e ndërtimit nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit, ndriçimit, ndotjes në vlerën 986,696 lekë gjithësej, vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun II, pika 2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Mallakastër të vitit 2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**5.1.Rekomandimi:** Sektori i Tatim-Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Drejtorinë Mjedisit, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 986,696 lekë.

### **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Tatim Taksave për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” rezultoi se në Bashkinë Mallakastër dhe NJA për vitin 2022 janë taksuar 9455 familje. Me qëllim vlerësimit nëse është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga struktura e mësipërme me informacionin e gjendjes civile. Nga përllogaritjet e kryera, rezultoi se për vitin 2022 janë taksuar 2581 familje më pak.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Mallakastër nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përllogaritjet vetëm për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe pastrimit (duke aplikuar tarifën më të ulët në vlerë), për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 1,750 lekë \* 2581 familje mesatarisht taksuar më pak = 4,516,750 lekë planifikuar më pak.

-Gjithashtu situata e mësipërme tregon se Sektori i Tatim Taksave Bashkia Mallakastër nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që



përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018<sup>41</sup>, e ndryshuar, detyrim për t'u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "Familjar". Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore"; Kreu II në Paketën Fiskale të Bashkisë Mallakastër. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Sektori i Tatim-Taksave, në bashkëpunim me Administratorët e Njësisë Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë "Familje", ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së ndriçimit, gjelbërimit dhe arsimit për vitin 2022, rezultojnë 4,516,750 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.

### **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022, u konstatua se në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 6532 familje debitorë për vlerën 98,950,036 lekë, nga të cilat, në vitin 2022 janë krijuar 1652 familje debitore për vlerën 18,660,123 lekë. Pra në krahasim me vitin 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitore për taksat dhe tarifat për kategorinë "familje", ç'ka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Mallakastër në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme.

-Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezulton se për arkëtimin e taksave të familjeve të qytetit Mallakastër, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Ujësjetllës-Kanalizime Sh.A Fier – Mallakastër, i cili vepron si agjent tatimor për llogari të Bashkisë Mallakastër. Përrjashtuar familjet e qytetit, në NJA taksimi dhe tarifimi i familjeve bëhet fizikisht, pra lëshohet faturë kur familjari paraqitet pranë zyrove të bashkisë për të përfituar shërbim, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të "Njoftim Vlerësimit", apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Sa i përket familjeve debitore, rezulton se nga DAV dhe NJA nuk janë marrë masa ligjore shteruese për arkëtimin e vlerës debitore.

- Gjithashtu ndaj Bashkisë Mallakastër rezulton të jetë debitor edhe UK Sh.A për vitin 2022 në rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj kategorisë "Familjar". Detyrimi që ka UK. Sh.A Mallakastër në fund të vitit 2022 (në rolin e agjentit tatimor) ndaj Bashkisë Mallakastër është në vlerën prej 811,920 lekë. *Nga sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Mallakastër për këtë situatë nuk janë marrë masat ligjore (aplikimin e gjobave) ndaj agjentit tatimor UK Sh.A Mallakastër, i ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj kategorisë "Familjar".*

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore"; Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për përfshirjen e taksave dhe tarifave vendore që aplikohen në NJA, në faturën e ujit të pijshëm, duke përdorur si agjent tatimor UK Sh.A Fier –Mallakastër, për arkëtimin e tyre.

<sup>41</sup> Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

**7.2.Rekomandimi:** Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga taksat familjare prej 98,950 mijë lekë.

**7.3.Rekomandimi:** Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga agjenti tatimor UK SH.A Fier-Mallakasër prej 811 mijë lekë.

### **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IVMT Bashkia Mallakastër, u konstatua se deri më datë 31.12.2022 në mënyrë progresive, si rrjedhojë e mos likuidimit të gjobave të vendosura, janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 320,000 lekë, Gjobat e mësipërme janë të formës së prerë, për të cilat nuk është bërë kërkesë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të tyre nëpërmjet përbarimit gjyqësor. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të nenit 30 në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet 164 dhe 165 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në RSh”, neni 14 në ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 10-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1.Rekomandimi:** Kryeinspektori i IVMT Bashkia Mallakastër në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 320,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

**8.2.Rekomandimi** Kryeinspektori i IVMT Bashkia Mallakastër në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimin të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përbaruesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/paluajtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamatë vonesë) të palëve të treta ndaj Bashkisë Mallakastër.

### **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023 dhe në vijimësi**

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për miratimin e lejeve të ndërtimit, në një rast u konstatua përllogaritje e gabuar e taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën 228,066 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të Paketës Fiskale të Bashkisë Mallakastër, për vitin 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 92-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**9.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit të Territorit në bashkëpunim me Sektorin e Tatim-Taksave Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën 228,066 lekë ndaj subjektit “Sh. A. 24” Sh.P.K, si rrjedhojë e diferencës së krijuar nga përllogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

### **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023 dhe në vijimësi**

## **V.ANEKSE**

**Aneksi nr.1 – Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin trajtuar nga faqja nr.15 deri në faqen nr.17 të raportit përfundimtar të auditimit.**

Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit:“Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”,u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;

3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetësori i Vetëvlerësimit dhe a është dërguar në Ministrinë e Financave

#### **Baza ligjore ku mbështetet auditimi mbi MFK është:**

Ligji nr.10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar  
 Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016;

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”  
 Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar  
 Ligji nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,  
 VKM nr.243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr.746/2018  
 Ligji nr.68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.  
 Ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”  
 Udhëzimi nr. 15 dt 20.07.2016  
 Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Mallakastër, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i Kontrollit*”, “*Menaxhimi i Riskut*”, “*Aktivitetet e Kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në zbatim të auditimit, u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Baza rregullatore mbi të cilën ushtron funksionet e saj Bashkia Mallakastër: Rregullorja e brendshme e miratuar, Rregullorja për sinjalizimin, planet mujore dhe vjetore të punës. etj
2. Strukturën organizative dhe organigramën e institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi; dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
3. Shkresat e përcaktimit të NA dhe NZ në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, si dhe ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
4. Shkresat për krijimin e grupeve të menaxhimit strategjik [GMS]

5. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre në një vit;
6. Regjistrin e riskut
7. Raportet e monitorimit ku përfshihen edhe Deklarata e cilësisë dhe Pyetëtori i vetëvlerësimit;
8. Plotësimi i pyetësorëve të KLSH për bashkinë e Mallakastrës, dërguar me email

Nga auditimi i dokumentacionit të vene në dispozicion nga Bashkia e Mallakastër, në përgjigje të kërkesave të përshkuara më lart lidhur me MFK-në, grupi i auditimit rezultoi me këto konstatime:

➤ Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Mallakastër, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

### **I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:**

**Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.**

-Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili siguron vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit. Mjedisi i kontrollit përmban: a) integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; b) politikat menaxheriale dhe stilin e punës; c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; ç) politikat dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore; d) aftësitë profesionale të punonjësve.

-Nga shqyrtimi i Strukturës dhe Organigramës së Bashkisë Mallakastër në Rregulloren e saj, u konstatua se në disa raste ka mbivendosje dhe mbingarkesë kompetencash.

Në rregulloren e miratuar me Vendimin nr. 01, datë 18.05.2020, konstatohet se ka mbivendosje të detyrave të përgjegjësit të sektorit të burimeve njerëzore me specialistin (të cituara edhe më sipër), përcaktohen si detyra për specialist të sektorëve të ndryshëm, ngarkimi i tyre për realizimin e detyrave të tjera që i kërkojnë nga eprori, por të cilat nuk janë shprehur specifikisht; Për specialistin e kadastrës parashikohet kryerja e veprimeve kadastrale si: “Pajis qytetarët, në bazë të ligjeve dhe rregullave, me vërtetime faktesh që kanë të bëjnë me posedim të sipërfaqeve të pronës private dhe tokës bujqësore”, “lëshon kopje të hartave, plan-vendosjeve të objekteve sipas kërkesave të qytetarëve”, ndërkohë që këto funksione mbështetur në ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, neni 2, neni 3: “Aktet kadastrale janë dokumentet zyrtare unike që Agjencia Shtetërore e Kadastrës lëshon për çdo pronar të pasurive të paluajtshme ose titullar të të drejtave reale mbi to. Këto akte përfshijnë: certifikatat, vërtetimet, ekstrakte të kartelës kadastrale, hartës kadastrale dhe akte të tjera të parashikuara në këtë ligj”, “Hartë kadastrale” është harta shkresore dhe digjitale, në të cilën pasqyrohen kufijtë, përmasat, pozicioni gjeografik, në përputhje me rregullat dhe 42 standardet zyrtare për pasuritë e paluajtshme, si dhe tregues të tjerë. “Veprimtari kadastrale” është tërësia e akteve dhe veprimeve administrative, në bazë të këtij ligji, që kryhet nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e përditësimin e të dhënave kadastrale të çdo pasurie, si dhe për lëshimin e akteve kadastrale”; Për sektorin e AKU dhe Bujqësisë, parashikohen funksione si: Kontrolli i analizave laboratorike, kontrolli i sëmundjeve të kafshëve që janë ngjitëse për njeriun, kontrolli i etiketave të shitjes së mallrave”, etj, detyra të cilat sipas ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 10465, datë

29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i përkasin Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe Drejtorive Rajonale të tij, si dhe shërbimit veterinar zyrtar.

-Për vitin 2022, Bashkia Mallakastër ka miratuar Strukturën dhe Organigramën e saj me Vendimin 55 datë 20.12.2021 , ku përcaktohet numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë prej 475 punonjësish, nga të cilët 49 nëpunës civilë, 7 me funksione të deleguar, 49 punonjës të Njesisë Administrative Fratar, 176 punonjës të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, 122 funksione të tranferuara.

- Për vitin 2022, Bashkia Mallakastër ka ushtruar veprimtarinë e saj nëpërmjet Rregullores së brendshme të institucionit. Bashkia nuk ka një Kod Etike të hartuar dhe miratuar si një dokument të veçantë, por dispozitat që rregullojnë etikën dhe disiplinën e administratës së institucionit janë integruar në Rregulloren e institucionit. Në bazë të pyetësorit dërguar njësive të menaxhimit, nuk ka një urdhër nga titullari i institucionit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi. Komunikimi për rregulloren e brendshme dhe dispozitat përkatëse për etikën dhe disiplinën është kryer nëpërmjet postës elektronike.

-Për ndëshkimin e rasteve korruptive ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen

- Bashkia Mallakastër ka hartuar dhe krijuar Rregulloren “Për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Konfidencialitetit me aktin 3947/1, prot. dt. 01.12.2021, si dhe Rregulloren “Për Hetimin Administrativ dhe Kërkesën e Sinjalizuesit për Mbrojtjen nga Hakmarrja” me akt 3947/2, prot. dt 01.12.2021. Është krijuar Njësia e Sinjalizimit të Brendshëm të përbërë aktualisht nga dy punonjës me. Për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrdhënieve me Publikun), duke i'u adresuar strukturave të bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga Drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 16 të Rregullores së Brendshme.

-Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen

-Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj.

**Në lidhje me parimin nr 2** “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje”.

-Për vitet 2022, Bashkia Mallakastër nuk ka hartuar dhe miratuar Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm në kundërshtim me përcaktimet e Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

-Për periudhën vitin 2022, janë hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për çdo 4-muaj, duke u paraqitur MFE.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga njësitet e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ndërsa nga shoqëritë e përbashkëta, ku bashkia është aksionere dhe nga ndërmarrjet në varësi të saj, bashkia merr raporte në lidhje me vendim-marrjen e këshillit drejtues, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe Njësia e Harmonizimit në MFE si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

- Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendimmarrjes ushtron përgjegjësitë e mbikqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

**Në lidhje me parimin nr. 3** “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”

-Bashkia Mallakastër nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim duke rënë në kundërshtim me Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin neni 8, pika 8, shkronja “a”. Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu III, paragrafi 3.2.

-Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, por është bërë pjesë e dokumentit e PBA-ve, si dhe nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme. Për çdo drejtori janë përcaktuar objekti, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

**Në lidhje me parimin 4** “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”.

-Punësimi në Bashkinë Mallakastër bëhet në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Ligjit nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr.243/2015 i ndryshuar me VKM nr.746/2018 Kreu I pika 1,2. Kjo procedurë rregullohet nga Strukturat e Bashkisë së Mallakastër: -Sektori i Burimeve Njerëzore [SBNJ] është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr.243/2015 i ndryshuar Kreu II.

- Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr.243/2015 i ndryshuar.

- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika e,ë,f,g të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

-Strukturat përgjegjëse të Bashkisë Mallakastër hartojnë në fillim të çdo viti Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil duke zbatuar Ligjin nr.152/2015 “Për nëpunësin civil” neni 18, VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre”, si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Mallakastër” për çdo vit ushtrimor.

-Në Bashkinë Mallakastër nuk është hartuar “Harta e procesit të Punës”, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve. - Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Mungesa e një plani të brendshëm trajnimesh bien në kundërshtim me Kreun III, paragrafin 3.1 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin.

-Në Bashkinë Mallakastër nuk ka Koordinatorin e Riskut.

-Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është z. A.R, i cili mban pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Çështjeve Sociale.

Për vitin 2022 është lëshuar një autorizim, ku kryetari i Bashkisë ka autorizuar përkatësisht z. Z.M (Nënkryetar i Bashkisë Mallakastër) si autoritet kontraktor për Bashkinë Mallakastër.

- *Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).*

Në zbatim të nenit nr. 24 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”, është ngritur GMS.

-Lidhur me përbërjen e GMS, në përgjithësi ajo është sipas përcaktimit të bërë në pikën 30 të Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”, ku drejtuesi i grupit është Kryetari i Bashkisë, si dhe ka përfaqësues nga të gjitha drejtoritë e bashkisë. Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se:

- Bashkia Mallakastër nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.
- Nuk administrohen procesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.
- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të bashkisë, në të cilën të përfshihej edhe Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS).
- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse, në kundërshtim me Udhëzimin nr 16 dt 20.07.2016 për Koordinatorin MFK dhe koordinatorin e riskut në njësinë publike, pika 2.2.4.

## **II.Komponenti“Menaxhimi i Riskut”**

**Në lidhje me parimin 6:** Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

- Nga Bashkia Mallakastër përcaktohen objektiva sasior (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxheteve vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nga Bashkia Mallakastër nuk ka plane operationale të punës.

**Në lidhje me parimin 7:** “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

-Bashkia Mallakastër nuk ka miratuar një regjistër risku, në kundërshtim me Ligjin 10296 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, neni 11, pika 2, Udhëzimin nr.16 dt. 20.07.2016 Për Koordinatorin e MFK dhe Koordinatorin e Riskut, paragrafi 3.2.3.

-Në Bashkinë Mallakastër nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, në kundërshtim me Ligjin nr.10296 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, nenin 8, pika 8, shkronja a, Udhëzimin nr. 16 dt 20.07.2016 pika 3.2.2, si dhe në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel- it apo Word-it.

-Në Bashkinë Mallakastër, po ashtu Drejtoria Ekonomike për mbajtjen e Kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave e cila kryhet nga sektori i financës , niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Në bazë të këtij programi me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Ekonomike dhe hartimi i Pasqyrave Financiare, gjithashtu edhe Sektori i Tatim-Taksave operon me programin Excel për monitorimin e të ardhurave. Për sa më sipër vijnë në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.3.

-Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe me Agjentët Tatimorë.

-Përcaktimi i NA dhe NZ është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”, si dhe ligjit nr. 90 datë 27.09.2012 “Për organizimin e administratës shtetërore” si dhe janë njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues plotësojnë kriteret e kërkuara nga ligji si: (kriteri i varësisë NA-NZ, kriteri i arsimimit dhe kriteri i nivelit menaxherial).

## **III.Komponenti: “ Aktivitetet e Kontrollit”**

**Në lidhje me parimin 10:** “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.

-Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
  - Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, hartimi dhe rregjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.
  - Nga komunikimi me personat përgjegjës në Bashkinë Mallakastër, u konstatua se institucioni nuk ka hartuar dhe miratuar Hartat e Proceseve të Punës, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.3, Udhëzimi nr. 16, dt. 20.07.2016, pika 2.3.
  - Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimve/shërbimeve.
  - Për çdo vit buxhetor hartohet rregjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh.
  - Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.
  - Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit e bazës materiale. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.
  - Në përgjithësi për procedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe për asgjësimin e tyre. Ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimit për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, procesverbale dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe procesverbalet për asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet kontabël përkatës.
  - Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e thesarit për Bashkinë Mallakastër, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë sipas marrëveshjes së Bashkisë Mallakastër të bërë me këta agjentë. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar.
  - Bashkia Mallakastër në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga bashkia.
  - Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve.
- Në lidhje me parimin 11:** “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.
- Bashkia Mallakastër nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm, si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.
  - Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse.



- Në Bashkinë Mallakastër nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

- Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

**Në lidhje me parimin 12:** “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë të Drejtorëve dhe Përgjegjësve të sektorëve, ku vihen re mbivendosje/mbingarkesë të funksioneve.

- Me vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve merret Drejtoria Ekonomike, duke i'u referuar dispozitave ligjore në fuqi dhe rregullores së brendshme.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditareve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Ekonomike.

- Nuk ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF.

- Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

#### **IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”**

**Në lidhje me parimin 13:**

-Bashkia Mallakastër disponon faqen e saj zyrtare në internet [www.bashkiamallakastër.gov.al](http://www.bashkiamallakastër.gov.al), ku pasqyrohet aktiviteti i saj si: Rregullorja e brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, VKB, buxheti vjetor, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor, si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale.

-Përdoret sistemi e-albania për deklarime online për të marrë dokumente të ndryshme informimi. Nëpërmjet sistemit on-line të informimit,

-Komunikimi me publikun, ankesat dhe kërkesat për informacion menaxhohen nga organet e parashikuara në Rregulloren e brendshme.

-Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

**Në lidhje me parimin 14:** Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal, shkresor dhe atë elektronik, i cili rregullohet në Rregulloren e brendshme.

Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Në Bashkinë Mallakastër punonjësit punojnë me këto sisteme informatike Word dhe Excel. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale. Grupi auditues konstaton se, nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të emailit zyrtar të institucionit duke qënë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.

#### **V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”**

**Në lidhje me parimin 16:** “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

- Proçedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion nuk konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, nuk administrohen plotësisht raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj.

-Në Bashkinë Mallakastër mungojnë rregullat të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

- Në Bashkinë Mallakastër aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë raportet e zbatimit për planet e menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

-Bashkia Mallakastër ka dërguar Raportin e Vetëvlerësimit së bashku me pyetësorin në adresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr prot. 6249/2 dt. 21.02.2023. Raporti përshkruan në mënyrë të përciptë problematikat lidhur me 5 komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, dhe nuk jep zgjidhje konkrete mbi hapat që do të ndërmerren në tejkalimin e tyre.

## **Aneksi nr.2 – Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit trajtuar nga faqja nr.20 deri në faqen nr.46 të raportit përfundimtar të auditimit.**

Tabela nr.11 Pasqyra e faturave të likuiduara përtej afatit 30-ditor

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Vlera e faturës</b>	<b>Nr.fatur</b>	<b>Data e pages</b>
1	Blerje materiale kancelarie 2022	400,000	Fatura- Nr.145/2022 Dt. 06/05/2022	21/06/2022
2	Permiresim I kushteve te banimit per komunitete te	10,010,478	Fatura- Nr.01/2022 Dt. 28/01/2022	09/06/2022
3	Ushqime (Fruta-perime) per kopshtin dhe cerdhen Ballsh	93,770	Fatura- Nr.33/2022 Dt. 27/05/2022	05/07/2022
4	Blerje mish vici dhe pule per kopshtin dhe cerdhen Ballsh	31,580	Fatura- Nr.31/2022 Dt. 27/05/2022	05/07/2022
5	Blerje produkte bulmeti dhe veze per kopshtin dhe cerdhen Ballsh	60,394	Fatura- Nr.32/2022 Dt. 27/05/2022	05/07/2022
6	Blerje materiale pastrimi	648,000	Fatura- Nr.44/2021 Dt. 24/12/2021	13/07/2022
7	Blerje tonera per printera dhe fotokopje	296,400	Fatura- Nr.5518/2022 Dt. 26/04/2022	13/07/2022
8	Rikonstruksioni I rrjetit shperndares qyteti Ballsh	5,625,000	Fatura- Nr.122/2021 Dt. 29/12/2021	26/07/2022
9	Rikonstruksioni I rrjetit shperndares qyteti Ballsh	14,375,000	Fatura- Nr.03/2022 Dt. 11/01/2022	26/07/2022
10	Ushqime (Fruta-perime) per kopshtin dhe cerdhen Ballsh	106,494	Fatura- Nr.40/2022 Dt. 01/07/2022	29/08/2022
11	Blerje mish vici dhe pule per kopshtin dhe cerdhen Ballsh	36,682	Fatura- Nr.37/2022 Dt. 01/07/2022	29/08/2022
12	Blerje produkte bulmeti dhe veze per kopshtin dhe cerdhen Ballsh	69,099	Fatura- Nr.39/2022 Dt. 01/07/2022	29/08/2022
13	Projektim I rruges Aranitas-Cfir-Metoh	2,563,939	Fatura- Nr.06/2022 Dt. 17/02/2022	01/09/2022
14	Ndertimi I linjes se transmetimit te rrjetit te jashtem te Ujesjellesit Rajonal	4,500,000	Fatura- Nr.58/2022 Dt. 27/07/2022	01/09/2022
15	Mbikqyrje punimesh:Ndertim shetitore nga Shkolla Odisea der tek varrezat e qytetit	158,302	Fatura- Dt. 20/04/2020	03/10/2022
16	Rikonstruksioni I pjesshem I zyrave te zyrave te NJA Fratar	3,603,252	Fatura- Nr.68/2022 Dt. 02/08/2022	28/10/2022
17	Loti 1 Projektim me objekt:Ndertim KUZ ne qytetin Ballsh	4,397,299	Fatura- Nr.48/2022 Dt. 19/09/2022	05/12/2022
18	Diesel	70,512	Fatura- Nr.1068/2022 Dt. 31/07/2022	05/12/2022
19	Diesel	263,616	Fatura- Nr.1124/2022 Dt. 31/08/2022	07/12/2022
20	Diesel	233,666	Fatura- Nr.1162/2022 Dt. 30/09/2022	07/12/2022
21	Diesel	256,750	Fatura- Nr.1208/2022 Dt. 31/10/2022	07/12/2022
22	Sherbim inetrneti dhe telefonie	45,840	Fatura- Nr.1587657/2022 Dt. 01/11/2022	06/12/2022
23	Sherbim postar	1,680	Fatura- Nr.922/2022 Dt. 01/11/2022	06/12/2022
24	Sherbim postar	16,980	Fatura- Nr.1000/2022 Dt. 03/11/2022	06/12/2022
25	Transport I veteraneve dhe familjeve te deshmoreve	52,200	Fatura- Nr.31/2022 Dt. 21/07/2022	13/12/2022
26	Transport I veteraneve dhe familjeve te deshmoreve	25,500	Fatura- Nr.32/2022 Dt. 21/07/2022	13/12/2022
27	Transport I veteraneve dhe familjeve te deshmoreve	100,000	Fatura- Nr.33/2022 Dt. 21/07/2022	13/12/2022
28	Transport I veteraneve dhe familjeve te deshmoreve	16,000	Fatura- Nr.35/2022 Dt. 26/08/2022	13/12/2022
29	Mbikqyrje punimesh ne objektin:Rikonstruksion I pjesshem I ambjenteve te zyrave njesia administrative Fratar	95,066	Fatura- Nr.18/2022 Dt. 30/09/2022	20/12/2022
30	Mbikqyrje punimesh ne objektin:Rikonstruksion I Rruges "Gani Malasi" Ballsh	48,851	Fatura- Nr.17/2022 Dt. 30/09/2022	27/12/2022
	<b>Total</b>	<b>48,202,350</b>		

Burimi: Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.12 Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022

Nr.	Numri i faturës	Data e Fatutës	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2021	Shtesat gjate vitit 2022	Shlyerjet gjatë vitit 2022	Gjendja 31.12.2022
1			945,792			945,792
2	80	20.03.2012	22,000			22,000
3	17	24.10.2011	22,800			22,800
4	58	20.06.2011	30,000			30,000
5	141	01.12.2011	11,000			11,000
6	17	04.05.2012	22,500			22,500
7			40,060			40,060
8			89,043			89,043
10		3.06.2011	4,110			4,110
11	38	20.11.2013	479,220			479,220
12	4	22.02.2010	24,997			24,997
14	94	08.06.2009	28,800			28,800
15	15	15.09.2010	45,418			45,418
16	10	18.05.2011	5,800			5,800
17	99	26.09.2011	19,180			19,180
19	28	30.12.2010	96,600			96,600
20	37	20.11.2013	384,264			384,264
21	39	22.06.2012	1,493,817			1,493,817
22	35	15.03.2011	30,187			30,187
23			1,222,400			1,222,400
24			331,500			331,500
25	53	18.09.209	40,000			40,000
26	43	26.06.2012	75,600			75,600
27	49	17.09.2012	45,000			45,000
28	15/1	23.03.2015	1,890			1,890
29	19	29.11.2012	15,000			15,000
30	4	27.09.2012	5,400			5,400
31	2	13.05.2011	5,820			5,820
32	38	03.06.2015	40,260			40,260
34	2	30.05.2011	800			800
35	6	26.06.2012	46,200			46,200
36	40	29.07.2011	2,220			2,220
37	780	16.06.2011	11,100			11,100
38	931	15.06.2012	14,626			14,626
39	191	26.06.2011	100,800			100,800
40		14.07.2012	-			-
41	306	30.12.2013	7,920			7,920
42	279	27.11.2013	7,920			7,920
43			1,780,972			1,780,972
44	1	27.01.2011	47,695			47,695
45			497,000			497,000
46			491,000			491,000
47			410,000			410,000
48			485,750			485,750
49			78,000			78,000
50			35,000			35,000
51			24,592			24,592
52			4,600			4,600
53			30,800			30,800
54			40,000			40,000
55			54,860			54,860
56	48	10/02/2016	28,900			28,900
57			6,750			6,750
58			5,000			5,000
59			17,400			17,400
60			162,400			162,400
61			8,800			8,800
62			10,608			10,608
63			10,329			10,329
75	21	08.08.2019	95,890			95,890
76	71	08.08.2019	79,083			79,083
77	72	08.08.2019	28,629			28,629
78	70	01.08.2019	29,703			29,703
79	22	04.11.2019	116,431			116,431
80	146	20.04.2020	153,802		153.802	-
81	42	03.08.2020	69,533			69,533
			<b>10,573,571</b>		<b>153.802</b>	<b>10,419,769</b>

Burimi: Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

**Aneksi nr.3 – Mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave trajtuar nga faqja nr.20 deri në faqen nr.46 të raportit përfundimtar të auditimit.**

### Plani dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2022

Nr	Emërtimi	Viti 2022		
		Plan	Fakt	%
<b>I</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE</b>			
1	Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	36,482,000	4,240,162	12%
2	Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	25,462,000	14,379,888	56%
3	Të ardhura nga taksa mbi truallin	47,002,000	28,295,073	60%
4	Taksa e ndikimit në infr. nga ndërtimet e reja	12,699,000	6,701,846	53%
5	Takse Tabele	2,456,000	855,933	35%
<b>II</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA</b>			
1	Taksa per qarkullimin e mjeteve të përdorura	12,731,000	13,528,844	106%
2	Taksa pronësisë për pasuritë e paluajtshme			
3	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	3,342,000		0%
4	Të ardhura nga taksa e rentës minerare	7,883,000	1,681,435	21%
<b>III</b>	<b>TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE</b>			
1	<b>Te ardhura nga tarifa e pastrimit të mbeturinave</b>			
a	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Familje	4,010,000		0%
b	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Institucione	3,342,000		0%
c	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Biznesi	10,026,000	15,357,260	153%
2	<b>Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik</b>			
a	Të ardhura për ndriçimin publik nga Familje	1,950,000		0%
b	Të ardhura ndriçimi publik nga Institucione	468,000		0%
c	Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Biznesi	3,843,000	822,949	21%
3	<b>Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin</b>			
a	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga Familje	2,005,000		0%
b	Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Institucione	10,503,000		0%
c	Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Biznesi	3,342,000	11,568,611	346%
4	<b>Të ardh. tarifa të shërbimit të bashkisë</b>			
a	Nga tarifa veterinerë të bagëtive të therura	557,000		0%
b	Nga Tarifat e licënsimit të transportit	780,000	823,900	106%
c	Nga tarifa parkimi.	991,000	639,347	65%
d	Nga tarifë dhënie licënsa për tregtimin e naftës.	6,015,000	1,095,687	18%
e	Nga tarifatat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	1,671,000		0%
f	Nga tarifatat e shërbimeve që kryen e MNZ	178,000	113,000	63%
g	Nga tarifa për zënie e hapësirave publike	24,006,000	471,800	2%
i	Tarifa nga kopshtet	2,446,000	1,415,142	58%
j	Tarifa nga cerdhet	1,203,000	821,177	68%
<b>IV</b>	<b>TË ARDHURA TË TJERA</b>			
1	Të ardhura nga dhënie me qira e asetëve.	3,900,000	1,671,365	43%
2	Të ardhura te tjera	130,138,000	65,270,271	50%
<b>V</b>	<b>TË ARDHURA NGA DONACIONET</b>			
	<b>Total</b>	<b>359,431,000</b>	<b>169,753,690</b>	<b>47%</b>

### Bizneset e vogla debitore viti 2022 sipas Njësie Administrative

Nr.	Lagja	Progresive 31.12.2021	Krijuar viti 2022	Progresive 31.12.2022
1	5 Shkurti	60,400	30,200	90,600
2	5 Shkurti	0	11,150	11,150
3	5 Shkurti	0	24,190	24,190
4	5 Shkurti	265,370	42,250	307,620
5	5 Shkurti	47,500	0	47,500
6	5 Shkurti		16,150	16,150
7	5 Shkurti	166,180	18,200	184,380
8	5 Shkurti	0	34,000	34,000
9	5 Shkurti	19,220	19,220	38,440
10	5 Shkurti	0	20,810	20,810
11	28 Nentori	98,905	0	98,905
12	28 Nentori		3,875	3,875
13	5 Shkurti	57,425	17,465	74,890
14	28 Nentori	16,299	16,000	32,299
15	28 Nentori	124,920	19,300	144,220
16	18 Prilli	0	46,750	46,750
17	5 Shkurti	0	26,416	26,416
18	5 Shkurti	19,300	19,300	38,600
19	28 Nentori	59,450	13,100	72,550
20	5 Shkurti	48,750	15,200	63,950
21	28 Nentori	175,430	14,945	190,375
22	5 Shkurti	108,750	21,250	130,000

23	5 Shkurti	16,100	16,100	32,200
24	28 Nentori	0	30,200	30,200
25	5 Shkurti	113,110	13,520	126,630
26	5 Shkurti	24,500	24,500	49,000
27	28 Nentori	13,100	0	13,100
28	28 Nentori	147,380	13,556	160,936
29	18 Prilli	118,440	39,480	157,920
30	28 Nendori	67,775	19,150	86,925
31	5 Shkurti	22,320	22,320	44,640
32	5 Shkurti	173,800	0	173,800
33	5 Shkurti	0	11,840	11,840
34	Ballsh	47,560	0	47,560
35	Ballsh	11,000	11,000	22,000
36	28 Nentori	111,427	0	111,427
37	5 Shkurti	0	10,741	10,741
38	28 Nentori	0	18,100	18,100
39	18 Prilli	0	52,000	52,000
40	5 Shkurti	93,550	13,895	107,445
41	5 Shkurti	63,560	20,770	84,330
42	Gllavanic	264,920	38,600	303,520
43	28 Nentori	41,300	20,650	61,950
44	5 Shkurti	115,120	0	115,120
45	Gllavanic	118,520	59,260	177,780
46	Bylis	35,835	11,945	47,780
47	5 Shkurti	95,570	22,450	118,020
48	Gllavanic	32,300	32,300	64,600
49	5 Maji	45,600	15,200	60,800
50	Gllavanic	0	15,050	15,050
51	Bylis	90,903	14,945	105,848
52	Ballsh	0	9,000	9,000
53	18 Prilli	32,633	17,650	50,283
54	Gllavanic	41,750	41,750	83,500
55	18 Prilli	0	26,250	26,250
56	5 Shkurti	0	36,500	36,500
57	5 Shkurti	104,420	15,050	119,470
58	5 Shkurti	25,450	25,450	50,900
59	5 Maji	54,300	18,100	72,400
60	5 Maji	0	33,350	33,350
		<b>3,390,142</b>	<b>1,200,443</b>	<b>4,590,585</b>
1	Dukas	0	16,075	16,075
2	Dukas	0	56,600	56,600
3	Visok	0	8,175	8,175
4		63,790	63,790	127,580
5	Visok	159,050	24,700	183,750
6	Dukas	107,000	22,000	129,000
7	visok	165,764	0	165,764
8	Dukas	87,033	0	87,033
9	Dukas	28,600	28,600	57,200
10	Dukas	13,825	27,650	41,475
11	Lavdan	0	13,850	13,850
12	Drenove	9,582	0	9,582
13	Lapulec	58,064	0	58,064
14	Lapulec	18,432	4,332	22,764
15	Dukas	259,544	0	259,544
16	Dukas	27,380	27,380	54,760
17	Lavdan	0	50,072	50,072
		<b>998,064</b>	<b>343,224</b>	<b>1,341,288</b>
1	Anbreg	18,000	3,000	21,000
2	Kute	8,531	0	8,531
3	Kute	1,390	0	1,390
4	Kute	10,098	0	10,098
5	Kute	5,496	5,496	10,992
6	Kute	0	29,190	29,190
		<b>43,515</b>	<b>37,686</b>	<b>81,201</b>
1	Hekal	105,350	35,450	140,800
2	Hekal	55,000	16,000	71,000
3	Hekal	113,328	12,872	126,200
4	Hekal	293,200	55,100	348,300
5	Hekal	120,666	55,100	175,766
		<b>687,544</b>	<b>174,522</b>	<b>338,000</b>
1	Fratar	24,600	24,600	49,200
2	Fratar	0	17,360	17,360

3	Fratar	94,200	23,550	117,750
4	Fratar	176,000	51,500	227,500
5	Ninesh	10,800	10,800	21,600
6	Ziaj	87,200	21,800	109,000
7	Fratar	0	18,184	18,184
8	Bejar	0	29,400	29,400
9	Bejar	0	4,308	4,308
10	Fratar	0	16,550	16,550
11	Fratar	0	20,675	20,675
12	Fratar	73,000	18,250	91,250
13	Fratar	0	21,100	21,100
14	Bejar	72,000	11,500	83,500
15	Fratar	15,482	15,482	30,964
16	Fratar	85,760	21,440	107,200
17	Bejar	22,200	5,550	27,750
18	Fratar	0	22,402	22,402
19	Fratar	0	35,100	35,100
		<b>661,242</b>	<b>389,551</b>	<b>1,050,793</b>
107		<b>5,780,507</b>	<b>2,145,426</b>	<b>7,401,867</b>

Burimi: Sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

### Bizneset e mëdha debitoare viti 2022

Nr.	Lagja	Progresive 31.12.2021	Krijuar viti 2022	Progresive 31.12.2022
1	Aranitas	0	42,200	42,200
2	Lapulec	0	25,500	25,500
3	5 Shkurti pran Neri	481,000	76,500	557,500
4	Hekal	2,052,703	288,130	2,340,833
5	visok	0	19,300	19,300
6	Ballsh	171,560	85,780	257,340
7	Greshice	175,000	175,000	350,000
8	visok	0	43,800	43,800
9	Ballsh	0	9,332	9,332
10	Belishov	165,000	75,000	240,000
11	5 Shkurti	0	37,150	37,150
12	28 Nentori	0	74,800	74,800
13	Pocem	232,500	232,500	465,000
14	5 Shkurti	286,500	95,500	382,000
15	5 Maj	0	248,830	248,830
16	Ballsh	1,248,000	113,500	1,361,500
17	8 Nentori	444,133	70,000	514,133
18	Pocem	671,390	123,130	794,520
19	5 Shkurti	0	79,135	79,135
20	Ninesh	350,500	67,050	417,550
21	Dukas	507,410	71,700	579,110
22	Ninesh	56,500	9,050	65,550
23	Odisea	246,600	61,650	308,250
		<b>7,088,796</b>	<b>2,124,537</b>	<b>9,213,333</b>

Burimi: Sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

### Kompanitë e naftës debitoare për Bashkinë Mallakastër, me vlerat e debisë dhe kamatëvonesat përkatëse

Nr.	Detyrimi	Kamatëvonesë	31.12.2017	Detyrimi	Kamatëvonesë	31.12.2021	Detyrimi gjate vitit 2022	Kamatvonesë	31.12.2022
1	513,010,159	143,642,845	656,653,004	641,262,699	179,553,556	820,816,255	0		820,816,255
2	53,476,489	14,973,417	68,449,906	53,476,489	14,973,417	68,449,906	0		68,449,906
3	196,866,792	55,122,702	251,989,494	0	0	0	0	7,360,087	7,360,087
4	14,202,619	3,976,733	18,179,352	17,542,780	4,911,978	22,454,758	0		13,152,298
5	0	0	0	39,509,709	11,062,719	50,572,428	0		50,572,428
6	0	0	0	60,534,710	16,949,719	77,484,429	0		77,484,429
7	0	0	0	57,230,150	0	57,230,150	18,753,000		75,983,150
	<b>777,556,059</b>	<b>217,715,697</b>	<b>995,271,756</b>	<b>812,326,387</b>	<b>227,451,388</b>	<b>1,097,007,926</b>	<b>18,753,000</b>	<b>7,360,087</b>	<b>1,113,818,553</b>

Burimi: Sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Mallakastër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

**Aneksi nr.4 – Mbi hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare trajtuar nga faqja nr.46 deri në faqen nr.54 të raportit përfundimtar të auditimit.**

## Aktivi i Bilancit Kontabël 2022

	Viti 2022	Viti 2021
<b>A K T I V E T</b>	<b>2,044,356,105</b>	<b>2,215,499,987</b>
<b>I.Aktivët Afat shkurtra</b>	<b>283,349,848</b>	<b>348,120,020</b>
<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre</b>	<b>161,305,000</b>	<b>226,342,537</b>
Disponibilitete ne Thesar	158,788,270	223,825,807
Vlera te tjera	2,516,730	2,516,730
<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>33,541,096</b>	<b>34,621,123</b>
Materiale	3,160,744	3,633,613
Inventar i imet	30,380,352	30,987,510
<b>3.Llogari te Arketushme</b>	<b>78,081,253</b>	<b>76,582,789</b>
Debitore te ndryshem	61,111,859	60,528,690
Operacione me shtetin(Te drejta)Personel per paga tap e sigurime	16,969,394	16,054,099
<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>10,422,499</b>	<b>10,573,571</b>
Shpenzime te periudhave te ardhshme	10,422,499	10,573,571
<b>II.Aktivët Afat gjata</b>	<b>1,761,006,257</b>	<b>1,867,379,967</b>
<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>60,557,883</b>	<b>34,761,918</b>
Studime dhe kerkime	60,557,883	34,761,918
<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>1,460,802,223</b>	<b>1,645,780,105</b>
Toka, T,roje, Terene	309,970	309,970
Pyje, Plantacione	8,560,400	8,560,400
Ndertesa e Konstruksione	718,330,558	752,534,178
Rruge, rrjete, vepra ujore	708,932,190	850,018,562
Instalime teknike, makineri e paisje	10,510,247	13,137,809
Mjete Transporti	458,364	572,955
Inventar ekonomik	13,700,494	20,646,231
<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
<b>4.Investime</b>	<b>239,646,151</b>	<b>186,837,944</b>
Per Aktive Afatgjata jo materiale	25,795,965	5,236,027
Per Aktive Afatgjata materiale	213,850,186	181,601,917

### Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivët neto janë të barabarta me Aktivët-Pasivët= 1,895,945,859 lekë.

- Aktivët 2,044,356,105 lekë
- Pasivët 148,410,246 lekë
- Aktivët neto 1,895,945,859 lekë

### Aktivët afatshkurtra

Aktivët afatshkurtra më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **283,349,848 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 161,305,000 lekë, e cila përbëhet nga disponibilitet në thesar dhe vlera të tjera (pullat e gjëndjes civile);
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 33,541,096 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” dhe “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 78,081,253 lekë.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 158,788,270 lekë, përbëhet nga gjendja e fondeve në thesar më datë 31.12.2022 në vlerën 98,879,046 lekë (fonde që trashëgohen në vitin 2023/rezultati financiar dhe kreditor për mjete në ruajte (llogaria 466) në vlerën 59,909,224 lekë.

-Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar” dhe llogarisë 532 “Vlera të tjera” sipas mbylljes së bilancit të vitit 2022 është në vlerën prej 161,305,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 226,342,537 lekë, kuadruar me vlerat në rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likujditeve në fund të vitit ushtrimor” lekë. (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”)

### Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>33,541,096</b>	<b>34,621,123</b>
Materiale	3,160,744	3,633,613
Inventar i imet	30,380,352	30,987,510



Llogaria nr.312 “Materiale”, në fillim të vitit 2022 ka vlerën 3,633,613 lekë dhe në fund pasqyrohet me vlerën 3,160,744 lekë, si rrjedhojë e pakësimit të gjëndjes në magazinë.

Llogaria 327 “Objekte inventari”, ka vlerën 30,380,352 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën -1,080,027 lekë, e cila kuadron me llogarinë nr.63 “Ndryshimi gjëndjes së inventarit” (pasqyra F2 – performanca financiare) në shumën -1,080,027 lekë.

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Titullari i Bashkisë Mallakastër ka nxjerrë urdhrat e inventarizimit, si vijon:

Urdhër nr.346, dt.13.12.2022 “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve dhe materialeve, njësitë administrative të bashkisë dhe institucioneve të varësisë.”

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

**Llogaritë e arkëtueshme** janë në vlerën 78,081,253 lekë të përbëra nga:

-Llogaria 468–Debitor të ndryshem në vlerën prej 61,111,859 lekë, për taksa dhe tarifa vendore.

-Llogaria 4342-Operacione me shtetin të drejta (fonde që priten të alokohen në vitin në vijim nga buxheti i shtetit), debituar në vlerën prej 16,969,394 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e klasës së 4 të pasivit (si furnitorët, pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatim në burim) të pasqyrës financiare të pozicionit financiar.

Përshkrimi	Mbetja në fund të vitit 2022 (Debitimi)
401-408 - Furnitore e llogari te lidhura me to	674,453
42 – Detyrime ndaj personelit	11,662,879
431 – Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	669,552
435 – Sigurime shoqerore	3,484,571
436 – Sigurime shendetesore	477,939
<b>TOTALI</b>	<b>16,969,394</b>

**Të tjera aktive afatshkurtra** janë në vlerën 10,422,499 lekë të përbëra nga:

-Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme (detyrimet e prapambetura)” që janë në vlerën prej 10,422,499 lekë, lëvizja e të cilës pasqyrohet si më poshtë:

Nr	Emerimi	Celja 01.01.2022	Shtesa	Pakësim	31.12.2022
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	10,573,571	-	153,802	10,422,499

-Vlera e kësaj llogarie duhet të përfaqësojë detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve, si shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore, për detyrime të prapambetura për shërbime, për detyrime të prapambetura për mirëmbajtje, për investime, për detyrime të prapambetura të tjera. Kjo llogari ka si kundërparti gjendjen e llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasiv të bilancit në vitin 2022.

**Aktivët afatgjata** janë në vlerën neto prej 1,761,006,257 lekë, nga të cilat:

**Aktivët afatgjata jomateriale llogaria 202** - Studime dhe kërkime në vlerën prej 60,557,883 lekë;

**Aktivët afatgjata materiale** në vlerën prej 1,460,802,223 lekë të ndara përkatësisht:

-Llogaria 210-Toka troje dhe terrene në vlerën prej 309,970 lekë;

-Llogaria 211-Pyje dhe plantacione në vlerën prej 8,560,400 lekë;

-Llogaria 212-Ndertesa dhe konstruksione në vlerën prej 718,330,558 lekë;

-Llogaria 213-Rrugë rrjete dhe vepra ujore në vlerën prej 708,932,190 lekë;

-Llogaria 214-Instalime teknike makineri dhe paisje në vlerën prej 10,510,247 lekë;

-Llogaria 215-Mjete transporti në vlerën prej 458,364 lekë;

-Llogaria 218-Inventar ekonomik në vlerën prej 13,700,494 lekë;



-Llogaria 209 dhe 219-Amortizimi i akumuluar për aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale në vlerën 1,834,097,153 lekë.

Lëvizjet brenda vitit 2022 të llogarive të mësipërme pasqyrohen si më poshtë vijon:

Llog.Kontabel	Përshkrimi i llogarive	Çelje 2022	Shtesa 2022	Pakësime 2022	Gjendje në 31.12.2022
202	Studime dhe kerkime	34.761.918	25.795.965	-	60.557.883
	<b>AAGJM</b>	<b>1.645.780.105</b>	<b>41.975.574</b>	<b>3.453.414</b>	<b>1.460.802.223</b>
210	Toka ,troje, Terrene	309.970	0	0	309.970
211	Pyje, Kullota Plantacione	8.560.400	0	0	8.560.400
212	Ndërtesa e Konstruksione	752.534.178	3.603.252		718.330.558
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	850.018.562	36.146.676		708.932.190
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	13.137.809			10.510.247
215	Mjete transporti	458.364			572.955
216	Rezerva shtetërore				
217	Kafshe pune e prodhimi				
218	Inventar ekonomik	20.646.231	2.225.646	3.453.414	13.700.494

### **Pasivet (Detyrimet)**

	Viti 2022	Viti 2021
<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>148,410,246</b>	<b>135,978,397</b>
<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>148,410,246</b>	<b>135,978,397</b>
<b>1. Llogari te Pagushme</b>	<b>148,410,246</b>	<b>135,978,397</b>
Furnitore e llogari te lidhura me to	674,453	403,000
Detyrime ndaj personelit	11,662,879	11,247,905
Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	669,552	678,080
Sigurime Shoqerore	3,484,571	3,275,378
Sigurime Shendetesore	477,939	449,736
Kreditore per mjete ne ruajtje	59,909,224	48,822,037
Kreditore te ndryshem	10,419,769	10,573,571
Operacione me shtetin (detyrime)	61,111,859	60,528,690

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Mallakastër më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave të investimeve, kreditor të ndryshëm, operacione me shtetin/detyrime që ka Bashkia Mallakastër për të transferuar në llogari të buxhetit të shtetit.

### **Fondi i Konsoliduar.**

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën **2,097,235,289 lekë**. Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve me pasivet.

	Viti 2022	Viti 2021
<b>FONDI I KONSOLIDUAR</b>	<b>1,895,945,859</b>	<b>2,079,521,590</b>
Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	1,797,066,813	1,904,517,820
Rezultati i Veprimtarise Ushtrimore	98,879,046	175,003,770

-Llogaria 101-Teprica (Fondi Akumuluar), është në vlerën prej 1,797,066,813 lekë, e përbërë nga aktivet materiale dhe jomateriale, si dhe gjendja e aktiveve qarkulluese (materiale dhe objekte inventari).

-Llogaria 85-Rezultati veprimtarisë ushtrimore, është në vlerën prej 98,879,046 lekë, e përbërë nga fondet buxhetore të papërdorura, që trashëgoohen në vitin pasardhës buxhetor.

### **Pasqyra e Performancës Financiare**

	Viti 2022	Viti 2021
<b>TE ARDHURAT</b>	<b>744,747,987</b>	<b>743,168,907</b>
<b>I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</b>	<b>115,130,384</b>	<b>145,581,041</b>
1.Tatimi mbi te Ardhurat	94,265	563,723
Tatim mbi Biznesin e vogel	94,265	563,723
2.Tatimi mbi Pasurine	18,953,614	41,844,286
Tatim mbi Pasurine e palujtshme	18,953,614	41,844,186
Te tjera tatime mbi Pasurine	-	100
3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	96,082,505	103,173,032
Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	96,082,505	103,173,032

<b>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>29,942,367</b>	<b>41,021,227</b>
1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	1,991,125	25,104,758
Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	1,991,125	25,104,758
2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	27,951,242	15,916,469
Tarifa administrative dhe rregullatore	16,337,343	9,429,947
Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	9,243,939	4,174,958
Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	-	121,000
Gjoha, kamatvonesa, sekuestri dhe zhvendime	2,369,960	2,190,564
<b>V.GRANTE KORENTE</b>	<b>488,540,366</b>	<b>491,337,127</b>
1.Grant korent I Brendshem	488,540,366	491,337,127
Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	241,083,796	233,962,028
Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	194,239,959	197,948,729
Pjesmarje e institucioneve ne tatime nacionale	8,374,973	10,098,306
Financim I pritshem nga buxheti	16,294,941	15,651,099
Sponsorizime te brendshme( nga te trete)	28,546,697	33,676,965
<b>VI.TE ARDHURA TE TJERA</b>	<b>110,054,843</b>	<b>64,000,000</b>
Terheqje nga seksioni I investimeve	110,054,843	64,000,000
<b>VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE</b>	<b>1,080,027</b>	<b>1,229,512</b>
<b>SHPENZIMET</b>	<b>645,868,941</b>	<b>568,165,137</b>
<b>LPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE</b>	<b>163,646,135</b>	<b>164,137,167</b>
Paga, personel I perhershem	163,646,135	164,137,167
<b>II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</b>	<b>27,168,322</b>	<b>26,619,992</b>
Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	27,168,322	26,619,992
<b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>	<b>37,893,175</b>	<b>24,713,562</b>
Materiale zyre e te pergjitheshme	1,452,883	1,615,532
Materiale dhe sherbime speciale	3,781,206	4,521,391
Sherbime nga te trete	13,449,993	10,020,420
Shpenzime transporti	1,825,692	2,383,740
Shpenzime udhetimi	776,776	387,800
Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	-	30,000
Shpenzime per qeramarrje	233,750	248,022
Shpenzime per detyrime per kompesime legale	83,240	167,409
Shpenzime te tjera operative	16,289,635	5,339,248
<b>V.TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>416,081,282</b>	<b>351,464,904</b>
1.Transferime korente te brendshme	174,997,486	122,136,521
Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme(nshp)	171,730,402	113,563,563
Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	3,267,084	8,572,958
3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	241,083,796	229,328,383
Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	241,083,796	229,328,383
<b>VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>	<b>1,080,027</b>	<b>1,229,512</b>

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket të ardhurave:

### **Të ardhurat tatimore**

Llogaria 70 në vlerën prej 115,130,384 lekë, nga të cilat:

Llogaria 700-Tatimi mbi të ardhurat, në vlerën prej 94,265 lekë.

Llogaria 702-Të ardhura nga pasuria e paluajtshme, në vlerën prej 18,953,614 lekë ku përfshihen të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore, ndertesës, truallit.

Llogaria 703-Tatim mbi mallra dhe shërbime brenda vendit, në vlerën prej 96,082,505 lekë.

### **Të ardhurat jo tatimore**

Llogaria 71 në vlerën prej 29,942,367 lekë e përbërë nga:

Llogaria 710-Të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia (qirat), në vlerën prej 1,991,125 lekë.

Llogaria 711-Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare (tarifa administrative për lëshim dokumentesh, gjoha, shërbimi i zjarrëfikses), në vlerën prej 27,951,242 lekë.

### **Grante**

Llogaria 72-Grant Korent i brendshëm, në vlerën prej 488,540,366 lekë në të cilin përfshihen grante nga qeveria për shpenzime, financim i pritshëm, taksat e ndara, si dhe sponsorizime nga të tretë.

Llogaria 783-Tërheqje nga seksioni i investimeve, në vlerën prej 110,054,843 lekë, kreditimi i rezultatit të vitit 2020.

### **Shpenzimet**

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket shpenzimeve:

Emërtimi	Sipas Situacionit
600	163,646,135
601	27,168,322
602	37,893,175
604 + 606	416,081,282

63	-1,080,027
<b>Totali</b>	<b>645,868,941</b>

**Aneksi nr.5 – Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm trajtuar nga faqja nr.108 deri në faqen nr.113 të raportit përfundimtar të auditimit.**

Në zbatim të programit të auditimit të sipër cituar, pika 7, u auditua zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm në Bashkinë Mallakastër. Për auditimin e kësaj pike u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i audituar, si më poshtë vijon:

1. Shkresa përcjellëse nr.57/11 Prot., datë 15.06.2022 e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës.
2. Shkresa kthim-përgjigje (brenda afatit 20 ditë) për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit.
3. Shkresa kthim-përgjigje (brenda afatit 6-muajsh) së bashku me raportin për zbatimin e rekomandimeve të lëna.
4. Dokumentacion tjetër i paraqitur lidhur me vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve.

**3. Analizimi dhe nxjerrja e përgjegjësive në Bashkinë Mallakastër:**

Nga KLSH janë lënë gjithsej **59** rekomandime, të grupuara në:

- **36** masa organizative;
- **2** masa shpërblim dëmi;
- **10** masa për eliminimin e efekteve negative lidhur me eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficecne dhe efektivitet të fondeve publike;
- **11** masa disiplinore.

-Për zbatimin e rekomandimeve të lëna, nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër është nxjerrë urdhri me nr.161, datë 21.06.2022 për ngritjen e komisionit për Analizimin dhe Hartimin e Planit të Masave për Zbatimin e Rekomandimeve:

Me urdhrin e brendshëm nr.174 nr. 3458 prot., datë 01.07.2022 është ngritur komisioni i disiplinës për vlerësimin e përgjegjësive dhe marrjen e masës disiplinore ndaj punonjësve të përmendur në raportin përfundimtar të auditimit;

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **36** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 10 janë zbatuar, 2 zbatuar pjesërisht, 2 janë në proces zbatimi dhe 22 nuk janë zbatuar. Pra janë zbatuar **27 %** e masave organizative dhe **61 %** nuk janë zbatuar.

-Për shpërblimin e dëmit janë lënë 2 rekomandime për 2 subjekte në vlerën 847,516 lekë dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat të cilat nuk janë zbatuar 2 rekomandime për 2 subjekte në vlerën 847,516 lekë.

-Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë 10 rekomandime në vlerën 1,455,619,879 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, 1 rekomandim për vlerën 11,534,944 lekë zbatuar, 2 rekomandime në proces zbatimi për vlerën 1,137,138,382, 6 rekomandime për vlerën 300,946,553 lekë nuk janë zbatuar, dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht për vlerën 6,000,000 lekë.

-Janë lënë 11 masa disiplinore, të cilat janë zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si vijon:

## **A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1.1. Rekomandimi:** Nga Titullari i Bashkisë Mallakastër, me atributet e Kryetarit të GMS dhe të Nëpunësit Autorizues të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin strategjisë së risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

**1.2. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër, të kryhen investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryhen procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimesh për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve për realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Të vendoset një sistem komunikimi, i cili të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**1.3. Rekomandimi:** Të kryhen ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit, për ato funksione të cilat me ligj janë kompetencë e institucioneve të tjera duke rishikuar edhe strukturën e bashkisë me qëllim alokimin eficient të burimeve njerëzore.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se nuk janë marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit të MFK dhe komponentëve të tij si dhe nuk janë hartuar dhe miratuar strategjitë e risqeve, nuk janë kryer investime në programe kompjuterike të licencuara si dhe nuk janë hartuar programe trajnimesh për ngritjen profesionale të stafit si dhe në rregulloren e brendshme nuk janë kryer ndryshime.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 **nuk është zbatuar.**

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.2 **nuk është zbatuar.**

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.3 **nuk është zbatuar.**

**2.1. Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut, ku të planifikojë auditime tematike për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

**2.2. Rekomandimi:** Të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për aktivitetin e NJAB Mallakastër, rezulton se nuk janë planifikuar auditime tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna si dhe nuk kanë aplikuar opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 **nuk është zbatuar.**

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.2 **nuk është zbatuar.**

**3.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Mallakastër.

**3.2. Rekomandimi:** Për çdo vit buxhetor të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Mallakastër.

### *Në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit për vitin 2022, rezulton se nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik si dhe nuk janë dokumentuar kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Mallakastër. Nuk dokumentohen konsultimet me

grupet e interesit si dhe nuk janë planifikuar fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Mallakastër.

**Zbatimi:** Rekomandimi 3.1 **nuk është zbatuar.**

**Zbatimi:** Rekomandimi 3.2 **nuk është zbatuar.**

**4.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse.

*Në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar nga Nëpunësi Zbatues.

**Zbatimi:** Rekomandimi 4.1 **nuk është zbatuar.**

**5.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masa që planifikimi i fondeve për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave në vitin paraardhës dhe jo të planifikimit të tyre.

*Në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit përgjatë vitit 2022, rezulton se rekomandimi i mësipërm është në proces zbatimi (më hollësisht trajtuar në pikën e projekt raportit të auditimit për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2022).

**Zbatimi:** Rekomandimi 5.1 **është në proces zbatimi.**

**6.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masat e nevojshme për të eliminuar praktikat e ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore përtej afatit ligjor.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit përgjatë vitit 2022, rezulton se rekomandimi i mësipërm është në proces zbatimi (më hollësisht trajtuar në pikën e projekt raportit të auditimit për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2022).

**Zbatimi:** Rekomandimi 6.1 **është në proces zbatimi.**

**7.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

**7.2. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet. Gjithashtu për çdo rast të likuidimit të detyrimeve të vendimeve gjyqësore, në urdhrin e autorizimit të shpenzimit, të evidentohet dhe të kërkohet nxjerrja e përgjegjesisë administrative, të punonjësit përgjegjës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se gjatë hartimit të buxhetit nuk është planifikuar grafiku i likuidimit të detyrimeve të prapambetura si dhe nuk janë marrë masa që për vendimet gjyqësore në

urdrin e autorizimit të shpenzimit dhe nxjerrjen e përgjegjësive administrative (më hollësisht trajtuar në pikën e projekt raportit të auditimit për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit 2022).

**Zbatimi:** Rekomandimi 7.1 **nuk është zbatuar.**

**Zbatimi:** Rekomandimi 7.2 **nuk është zbatuar.**

**8.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përjashtuar kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë dhe duke respektuar radhën e likuidimit sipas parimit “*hyrje e parë – dalje e parë*”.

*Në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nuk janë marrë masa për sigurimin e likuiditeteve për likuidimin e faturave duke respektuar rradhën e likuidimit (më hollësisht trajtuar në pikën e projekt raportit të auditimit për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit 2022).

**Zbatimi:** Rekomandimi 8.1 **nuk është zbatuar.**

**9.1. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit, sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rekomandimi i mësipërm është zbatuar pjesërisht, sa i përket kontabilizimit të të ardhurave mbi bazën e akt-rakordimit të mbajtur me Degën e Thesarit.

**Zbatimi:** Rekomandimi 9.1 **është zbatuar pjesërisht.**

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike dhe e Çështjeve Sociale në Bashkinë Mallakastër, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të llogarive dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike.

**10.2. Rekomandimi:** Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

**10.3. Rekomandimi:** Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “*Toka, troje terrene*”; 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”; 212 “*Ndërtime e konstruksione*”; 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”; 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*” dhe 215 “*Mjete transporti*”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës.

**10.4. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 “*Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit*”.

*Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare rezulton se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar (më hollësisht trajtuar në pikën e projekt raportit të auditimit për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2022).

**Zbatimi:** Rekomandimi 10.1 është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 10.2 nuk është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 10.3 nuk është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 10.4 nuk është zbatuar.

**11.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive: **1.** “Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër Sh.a.”, me NUIS K47605804N, për 100% të aksioneve, në vlerën 621,858,000 lekë; **2.** “B” Sh.a., për 25% të aksioneve në vlerën 500,000 lekë; **3.** “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Mallakastër”, me NUIS M07509871Q, për 100% të aksioneve, në vlerën 67,105,362 lekë, si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive prej **689,463,362 lekë** në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**11.2. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të bërë çregjistrimin e shoqërisë “Ujësjetllës kanalizime”, e themeluar në datën 28.02.1997, aktualisht me status “Aktiv”, me NIPT/NUIS J77517803S, kapitali i së cilës rezulton të jetë transferuar i gjithi në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër Sha”, me NIPT/NUIS K47605804N.

*Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare rezulton se rekomandimi i mësipërm është nuk është zbatuar (më hollësisht trajtuar në pikën e projekt raportit të auditimit për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2022).

**Zbatimi:** Rekomandimi 11.1 nuk është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 11.2 nuk është zbatuar.

**12.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike dhe e Çështjeve Sociale në Bashkinë Mallakastër të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

*Në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare rezulton se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar (më hollësisht trajtuar në pikën e projekt raportit të auditimit për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2022).

**Zbatimi:** Rekomandimi 12.1 nuk është zbatuar.

**13.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuara.

*Në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion 2 praktika (rruga Bejar-Diga e rezervuarit dhe rikonstrukcion i zyrave të NJA Fratar) janë marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara.

**Zbatimi:** Rekomandimi 13.1 është zbatuar.

**14.1. Rekomandimi:** Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe në kredi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

**Me konstatimin e shpenzimit,** (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 404 “Furnitorë për investime”.

**Në momentin e pagesave** të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “Furnitorë për investime” dhe në kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.

**Në fund të vitit ushtrimor,** për fondet e përdorura për investimet e papërfunduara/në proces, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi të llogarisë 720 “Grant korrent i brendshëm” dhe në kredi të llogarisë 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

**Me përfundimin e investimit,** të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivitetit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.

**Me kapitalizmin e aktivitetit,** (për aktivitetin e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 “Shtesa të fondit bazë” dhe në debi të llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për vlerën e aktiveve të blera.

*Në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare rezulton se rekomandimi i mësipërm është zbatuar (me hollësisht trajtuar në pikën e projekt raportit të auditimit për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2022).

**Zbatimi:** Rekomandimi 14.1 është zbatuar.

**15.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mallakastër, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve, duke dhënë argumente për secilin kriter, të cilat të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kriterë të përshtatshme me procedurën dhe duke dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për procedurat e prokurimit publik Bashkia Mallakastër nuk ka marrë masa për të ngritur grup pune me specialistë të fushës si dhe nuk janë argumentuar kriteret sipas preventivit të punimeve. Gjatë vitit 2022 janë zhvilluar procedura me 1 OE.

**Zbatimi:** Rekomandimi 15.1 nuk është zbatuar.

**16.1. Rekomandimi:** Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit, Bashkia Mallakastër, të marrë masa për shmangien e kriterëve të tilla, të cilat nuk mbështeten në bazën ligjore, por krijojnë pengesë dhe kufizojnë numrin e operatorëve ekonomikë për të konkurruar në procedurat e prokurimit publik.

*Menjëherë dhe në vijimësi*



**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se specialisti i fushës në njësinë e prokurimit nuk ka krijuar pengesa dhe nuk ka kufizuar numrin e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik.

**Zbatimi:** Rekomandimi 16.1 është zbatuar.

**17.1. Rekomandim:** Titullari i AK, të krijojë komisionet për përlogaritjen e sasive dhe fondit limit, duke angazhuar personel të kualifikuar dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.

Në çdo rast, komisionet e përfshira në procedurat e prokurimit publik, të ngrihen me urdhër titullarit.

*Menjëherë*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion komisionet e përfshira në procedurat e prokurimit publik janë ngritur me urdhër të titullarit të AK.

**Zbatimi:** Rekomandimi 17.1 është zbatuar.

**18.1. Rekomandimi:** Titullari i AK, të marrë masa që në komisionet e ngritura për procedurat e prokurimit publik, të vendosen persona me kualifikimin e duhur. Të merren masa për vendosjen e specifikimeve teknike të duhura dhe për krijimin e kushteve për konkurrim të barabartë ndërmjet kandidatëve ofertues.

*Në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion janë marrë masa që nga komisionet e ngritura për procedurat e prokurimit të jenë persona të kualifikuar për vendosjen e specifikimeve teknike për krijimin e kushteve për konkurrim të barabartë ndërmjet kandidatëve ofertues.

**Zbatimi:** Rekomandimi 18.1 është zbatuar.

**19.1. Rekomandimi:** Titullari i AK, në çdo rast kur administrohen ankesa të cilat lidhen me procedurat e prokurimit publik, të marrë masa që në komisionet për shqyrtimin e tyre, të angazhojë personel i cili nuk ka qenë i përfshirë më parë në vendimmarrje për të cilën janë paraqitur ankesat.

*Në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për shqyrtimin e ankesave në procedurat e prokurimit publik, rezulton se rekomandimi i mësipërm është zbatuar (më hollësisht trajtuar në pikën e projekt raportit të auditimit për kryerjen e procedurave të prokurimit publik).

**Zbatimi:** Rekomandimi 19.1 është zbatuar.

**20.1. Rekomandimi:** Titullari i AK, në komisionet për përlogaritjen e sasive dhe fondit limit, të angazhojë persona të kualifikuar dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.

**20.2. Rekomandimi:** Në procedurat e ardhshme, të merren masa që hartimi i specifikimeve teknike të mundësojë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët, të rrisë konkurrencën ndërmjet tyre dhe njëkohësisht të bëhet përshkrim sa më i saktë dhe i plotë i objekteve që prokurohen.

**20.3. Rekomandimi:** Komisioni për blerjet e vogla, të hartojë kriteret në përputhje me objektin e kontratës, duke shmangur kriteret të cilat ulin konkurrencën dhe përbëjnë kufizim për operatorët ekonomikë.

**20.4. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Mallakastër, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve të faturave brenda afatit ligjor 30 ditor.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për kryerjen e procedurave të prokurimit publik janë angazhuar persona të kualifikuar si dhe për çdo rast janë dokumentuar veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore. Gjatë vitit 2022 likuidimi i faturave nuk është realizuar brenda 30 ditëve brenda afatit ligjor.

**Zbatimi:** Rekomandimi 20.1 është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 20.2 është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 20.3 është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 20.4 nuk është zbatuar.

**21.1. Rekomandimi:** Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Mallakastër, të marrë masa për shqyrtimin e lejeve të ndërtimit, ku të bashkërendohet puna me të gjitha institucionet e tjera publike brenda kompetencave që u njeh ligji, duke përfshirë edhe kërkesën drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nëse objektet për të cilat është aplikuar për leje ndërtimi, duhet t'i nënshtrohen apo jo *Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis*.

*Në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi i mësipërm është zbatuar pjesërisht.

**Zbatimi:** Rekomandimi 21.1 është zbatuar pjesërisht.

**22.1. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMTV-së, të marrë masa për plotësimin e procedurave, duke vendosur masat e pezullimit për ndërtimet që kryhen pa lejet përkatëse. Të administrohet në dosjet e tyre praktika, duke bashkëlidhur fotografitë e kundërvajtjes ku të pasqyrohet fakti i evidentuar në procesverbalet e konstatimit. Të mbahet korrespondencë me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, ku çdo 3 muaj të përcillet informacioni periodik i aktivitetit të tyre.

**22.2. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMTV-së, të marrë masa për kontrollin e objekteve të pajisura me leje ndërtimi dhe në çdo rast të mbajë aktet e kontrollit ku të pasqyrohet situata e objektit në ndërtim dhe evidentimi i shkeljeve në rast konstatimi.

**22.3. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMT në vlerën **750,000 lekë**.

*Në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar (më hollësisht trajtuar në pikën e projekt raportit të auditimit mbi organizimin dhe funksionimin të IMTV Bashkia Mallakastër).

**Zbatimi:** Rekomandimi 22.1 nuk është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 22.2 nuk është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 22.3 nuk është zbatuar.

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat e KLSH”, shkronja (b) dhe (c) dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike Bashkia Mallakastër, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohej në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi Zbatues të ndiqet procesi me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 847,516 lekë** si më poshtë:

**1.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **621,602 lekë pa tvsh** nga BOE “SH” Shpk, & “A” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1604 prot., datë 17.07.2019, me objekt “Ndërtim shëtitore nga shkolla “Odisea” deri tek varrezat e qytetit”, Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezulton se ky rekomandim është pranuar, si dhe nga titullari i institucionit është njoftuar subjekti me shkresën nr. 4522 prot., datë 16.09.2022 për ekzekutimin vullnetar të detyrimit të krijuar ndaj Bashkisë Mallakastër. Vlera e mësipërme nuk është arkëtuar nga subjekti BOE “SH” dhe “A” shpk për llogari të Bashkisë Mallakastër.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 nuk është zbatuar.

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **225,914 lekë pa tvsh** nga OE “A” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 462 prot., datë 15.02.2019, me objekt “Rikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja “5 Shkurti”, Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezulton se ky rekomandim është pranuar, si dhe nga titullari i institucionit është njoftuar subjekti me shkresën nr. 4521 prot., datë 16.09.2022 për ekzekutimin vullnetar të detyrimit të krijuar ndaj Bashkisë Mallakastër. Vlera e mësipërme nuk është arkëtuar nga subjekti “A” për llogari të Bashkisë Mallakastër.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 nuk është zbatuar.

## **C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Mallakastër të marrë masat e nevojshme për analizimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, duke identifikuar personat përgjegjës dhe vendosjen e masave administrative ndaj tyre, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin Juridik të bashkëveprojnë për shmangien e penalizimeve të tilla financiare.

*Menjëherë*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nuk janë marrë masa për analizimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 nuk është zbatuar.

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

**2.2. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar/vjelë detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës debitore prej **30,433,851 lekë**.

**2.3. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK dhe Qarku Fier). Për familjet fermere debitore të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë periudhën/vlerën e papaguar, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës debitore prej **68,669,251 lekë**.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion Bashkia Mallakastër nuk ka marrë asnjë masë për rekomandimet e mësipërme.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 nuk është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.2 **nuk është zbatuar.**

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.3 **nuk është zbatuar.**

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **2,218,252 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave, (*sipas normës së interesit të Bankës së Shqipërisë, plus tetë pikë përqindje*) për të gjitha rastet e detyrimeve të paarkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 3.1 **nuk është zbatuar.**

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër nëpërmjet bashkëpunimit institucional t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Fier, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Mallakastër. Drejtoria e administrimit, zhvillimit të territorit dhe kadastrës, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e vlerës **11,534,944 lekë** nga të gjithë individët e listuar si debitorë në **Pasqyrën A15**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, bazuar në legjislacionin tatimor.

***Menjëherë***

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër është nxjerrë urdhri nr. 4520 prot., datë 16.09.2022 drejtuar ASHK/Fier që mos të lëshojë dhe pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Zbatimi:** Rekomandimi 4.1 **është zbatuar.**

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Mallakastër, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pavjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura ndaj **290 subjekteve** debitore në vlerën prej **1,137,138,382 lekë** (*sipas Pasqyrave bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*), duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

**a. T'u dërgohen bankave** të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

**b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit**, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

**c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar**, Sektori i tatim-taksave të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

**d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset**, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë Ekonomike e Çështjeve Sociale dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Mallakastër, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

***Menjëherë***

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga sektori i Tatim Taksave janë dërguar letërkujtesat për detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore për të gjitha subjektet.

Për kompaninë A. sha janë nxjerrë urdhër bllokimet bankare dhe urdhër vendosje barre siguroese.

Për kompaninë A. Oil vazhdon procesi gjyqësor për taksat dhe tarifatat vendore.

Për kompanine T O S janë likuajuar detyrimet e prapambetura dhe për detyrimet e palikujdura është lidhur aktmarrvëshje për pagese me këste të detyrimeve. Aktmarrvëshja është lidhur në datën 28.09.2022 për shumën e detyrimit 21.920.500 lekë.

Për kompanine I janë bërë bllokimet e llogarive bankare.

Subjekti A.I nuk ka detyrime, pasi detyrimet për pronësin e ish K Ballsh janë likuajuar nga BK për periudhën që ka patur pronësinë e objektit.

Për kompanine B.E janë nxjerë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

**Zbatimi:** Rekomandimi 5.1 është në proces zbatimi.

**6.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojnë tarifat e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej **6,000,000 lekë**, sipas Anekseve bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, **Pasqyra A22**. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se ky rekomandim është pranuar, si dhe nga titullari i institucionit janë njoftuar subjektet për ekzekutimin vullnetar të detyrimit të krijuar ndaj Bashkisë Mallakastër. Konkretisht për subjektet;

-Subjekti B. 2003 shpk me shkresën nr. 3547 prot., datë 08.07.2022, vlera 1,000,000 lekë;

-Subjekti R. shpk me shkresën nr. 3548 prot., datë 08.07.2022, vlera 800,000 lekë ;

-Subjekti A. 2013 shpk me shkresën nr. 3550 prot., datë 08.07.2022, vlera 800,000 lekë;

-Subjekti I. shpk me shkresën nr.3551 prot., datë 08.07.2022, vlera 1,000,000 lekë;

-Subjekti SH. me shkresën nr.3553 prot., datë 08.07.2022, vlera 800,000 lekë ;

-Subjekti A. shpk me shkresën nr.3554 prot. datë 08.07.2022, vlera 1,000,000 lekë.

Nga Bashkia Mallakastër nuk është marrë asnjë masë shtrënguese ndaj subjekteve debitore të sipërcituara.

-Subjekti O. shpk është pajisur me licencë dhe ka paguar vlerën 1,000,000 lekë pranë Bashkisë Mallakastër.

**Zbatimi:** Rekomandimi 6.1 është zbatuar pjesërisht.

**7.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E<sup>të</sup>), **197,346 mijë lekë** pa TVSH.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 7.1 nuk është zbatuar.

**8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mallakastër, në cilësinë e Titullarit të AK, të nxjerrë përgjegjësitë për marrjen në dorëzim të objektit jo sipas projektpreventivit dhe pa plotësuar specifikimet teknike të miratuara dhe të marrë masa që në ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim të objektit, të përcaktohen qartë detyrimet dhe përgjegjësitë për secilin anëtar, në mënyrë që objektet e ndërtuara me financim nga Bashkia, t'i shërbejnë sa më mirë komunitetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 8.1 nuk është zbatuar.

#### **D. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 15, shkronja (c), të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “Masa Disiplinore”, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

#### **Për problemet e konstatuara në lidhje me kontabilitetin dhe pasqyrat financiare:**

1. A.R, me detyrë Drejtor Ekonomik, me status nëpunës civil, në cilësinë e nëpunësit zbatues, nënshkrues i pasqyrave financiare.
2. R.L, me detyrë specialist finance, me kod pune

#### **Për anëtarët e Komisionit për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, si më poshtë vijon:**

3. M.M, Drejtor Urbanistik, me status nëpunës civil, në cilësinë e anëtarit për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit në 3 raste.
4. B.V, Specialiste Urbanistike, me status nëpunës civil, në cilësinë e anëtarit për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit në 2 raste.

#### **Për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si më poshtë vijon:**

5. A.R, me detyrë Drejtor Ekonomik, me status nëpunës civil, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 4 raste.
6. A.X, me detyrë Kryeinspektor, me Kod Pune, për 4 raste në cilësinë e anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave, dhe 1 rast në cilësinë e anëtarit për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit.
7. E.B, Funkzioni, me funksion Drejtor Kabineti i Kryetarit, me Kod Pune, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 2 raste.
8. A.I, me funksion nën kryetare, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 1 rast.

#### **Për problematikat e konstatuara në lidhje me të ardhurat, si më poshtë vijon:**

9. B.J, me detyrë Përgjegjës i zyrës së Tatim -Taksave, me status nëpunës civil.
10. A.M, me detyrë Specialist i Tatim -Taksave, me status nëpunës civil.
11. A.XH, me detyrë Specialist i Tatim -Taksave, me status nëpunës civil.

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër është nxjerrë urdhri nr.174, me nr.3458 prot., datë 01.07.2022 për ngritjen e komisionit dhe shqyrtimin e procedurave me qëllim evidentimin e përgjegjësive për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore. Për zbatimin e rekomandimit të mësipërm administrohet dokumentacion mbi punën e bërë nga komisioni disiplinor.

**Zbatimi:** Rekomandimi është zbatuar.

Pasqyra e realizimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Nr	Emërtimi	Rekomandimet në numër :					Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rek. gjithsej	Nga rekomandimet janë:				Rekomanduar Gjithsej		Zbatuar arkëtuar		(Në proces)		Pa zbatuar	
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Proces zbatimi	Pa zbatuar	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek
1	Masa organizative	36	10	2	2	22								
2	Shpërblim demi	2	-	-	-	2	847	-	-	-	-	2	847	
3	Masa efekt adm. e fondeve publike	10	1	1	2	6								
4	Masa disiplinore	11	11	-	-	-								
	<b>Totali</b>	<b>59</b>	<b>22</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>30</b>	<b>2</b>	<b>847</b>					<b>2</b>	<b>847</b>

Nga rekomandimet gjithsej: Sa për eliminimin e efekteve negative			
Rekomanduar Gjithsej	Zbatuar	(në proces)	Pa zbatuar
Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek
1,455,619	11,534	1,137,138	300,946

**Për sa më sipër paraqitet Raporti Përfundimtar i Auditimit.**

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**